

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

# Ditët e Alfabetit

## – II –

*Materiale nga manifestimi kulturor-shkencor*  
*"DITËT E ALFABETIT"*  
*14-22 Nëntor 2020, Shkup*



Shkup, 2021

*Botues:*  
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

Edicioni: **DITËT E ALFABETIT – II –**

*Për botuesin:*  
**Prof. dr. Skender Asani**

*Kryeredaktor:*  
**Prof. dr. Sevdail DEMIRI**

*Redaksia:*  
**Prof. dr. Skender ASANI**  
**Prof. dr. Sefer TAHIRI**  
**Prof. dr. Hidajete AZIZI**  
**Prof. dr. Zeqirija IBRAHIMI**  
**Doc. dr. Besnik RAMETI**

ISBN: 978-608-4897-35-4  
[www.itsh.edu.mk](http://www.itsh.edu.mk)

*Të drejtat autoriale janë të rezervuara për botuesin*  
*Copyright©ITSHKSH, 2021*

*Ky botim financohet nga:*

Република Северна Македонија  
Министерство за култура



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Kulturës

**DITËT E ALFABETIT - II -**



# PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA .....	5
NË VEND TË HYRJES.....	9
NË ITSHKSH-SHKUP FILLUAN “DITËT E ALFABETIT - 2020” .....	10
<b>Skender ASANI:</b> DITËT E ALFABETIT, NË SHENJË TË ILUMINISTEVE SHQIPTARE.....	13
<b>Artan GRUBI:</b> 22 NËNTORI, NJË NGA TRI SHTYLLAT E KODIT IDENTITAR SHQIPTAR .....	15
<b>Sevdail DEMIRI:</b> “DITËT E ALFABETIT”, TRADITË E RE NË BOTIMET ALBANOLOGJIKE.....	17
STRUMICË, HOMAZHE TEK VARRI I ILUMINISTIT GJERASIM QIRIAZI .....	19
<b>Skender ASANI:</b> GJERASIM QIRIAZI, NJË FARË QË VAZHDON TË NA USHQEJË ME FRYTET E DITURISË.....	22
<b>Ylber SELA:</b> GJERASIMI, TËRË ENERJINË DHE DIJEN E VURI NË SHËRBIM TË GJUHËS DHE TË SHKOLLËS SHQIPE.....	24
<b>Ylli DOÇI</b> NJË DITË E VEÇANTË PËR UNGJILLORET! .....	26
<b>Fatmir BEQIR LIMANI:</b> LULE MBI NJË LULE TË ATDHETARIT TONË, I CILI PREHET PAQËSISHT NË STRUMËN ILIRE! .....	28
PËRKUJTOHEN DY PERLAT E MUZIKËS SHQIPTARE – NEXHMIJE PAGARUSHA DHE HANIFE REÇANI.....	31
<b>Skender ASANI:</b> NEXHMIJE PAGARUSHA DHE HANIFE REÇANI – DY PERLA QË E BËJNË TË PAVDEKSHME KËNGËN E MIRËFILLT SHQIPE.....	34
<b>Rreze KRYEZIU - BREZNICA:</b> NEXHMIJE PAGARUSHA, NJË FENOMEN I PAPËRSËRITSHËM.....	36
<b>Agim POSHKA:</b> HANIFE SEJFULLA REÇANI, MESAZHI EMANCIPUES I ZONJËS NGA GOSTIVARI.....	42
<b>Bekim RAMADANI:</b> HANIFE SEJFULLA REÇANI, ZONJA E MADHE E KËNGËS POPULLORE.....	47
<b>Ermal MEHMETI &amp; Jeta STAROVA-MEHMETI:</b> NEXHMIJE PAGARUSHA DHE “BARESHA” .....	59

NË “DITËT E ALFABETIT”, RINJOHJA E BALLKANOLOGES OLIVERA JASHAR NASTEVA .....	64
<b>Avzi MUSTAFA:</b> OLIVERA JASHAR-NASTEVA – PEDAGOGE E SHKËLQYESHME, SHKENCËTARE E PAPËRSERITUR DHE HUMANISTE E VEÇANTË.....	66
<b>Qemal MURATI:</b> DY FJALË PËR OLIVERA JASHAR-NASTEVA – DIJETARE E RRALLË E BALLKANOLOGJISË SHKENCORE .....	70
<b>Hidajete AZIZI:</b> OLIVERA JASHAR-NASTEVA – MË SHUMË SE NJË BALLKANOLOGE E SHQUAR.....	75
<b>Zeqirija IBRAHIMI:</b> OLIVERA JASHAR NASTEVA SI FAT I NJERIUT BALLKANIK.....	81
EXHLELE DOBRUNA-SALIHU, NJË JETË KUSHTUAR ARKEOLOGJISË .....	85
<b>Zana HOXHA:</b> VEPRIMTARIA SHEKENCORE E PROF.DR. EXHLELE DOBRUNA-SALIHU, ME FOKUS NE “SAXA LOQUUNTUR” .....	87
<b>Bedri MUHADRI:</b> EXHLELE DUBRUNA DHE ARKEOLOGJIA DARDANE .....	92
<b>Besnik RAMETI:</b> NJË STUDIUESE QË I FLET DHE I SHKRUAN NËNTOKËS DARDANE.....	95
<b>Sali ISLAMI:</b> PËR MONOGRAFINË “PLASTIKA DEKORATIVE DHE FIGURATIVE E GURIT NË DARDANI GJATË KOHËS ROMAKE – SEPULKRALE DHE E KULTIT I DHE II” .....	98
<b>Exhlale DOBRUNA-SALIHU:</b> UNË KËTË VEPRIMTARI E BËJ ME SHUMË VULLNET PASI KA TË BËJË ME KULTURËN E TË PARËVE TANË.....	101
<b>Anton NIKË BERISHA:</b> PERSONALITETE TË SHQUARA PËR NËNËN TEREZE.....	105
<b>Emin AZEMI:</b> REFLEKTIMI I FIGURËS SË NËNËS TEREZE NË NDËRTIMIN E KAUZAVE CIVILIZUESE .....	114
<b>Demush BAJRAMI:</b> NËNË TEREZA SHEMBULL UNIK I FLIJIMIT!.....	116
NJË AUREOLË E STUDIMIT TË LETËRSISË SHQIPTARE–FLORESHA DADO..	122
<b>Skender ASANI:</b> FLORESHA DADO NA KA NDERUAR TË GJITHËVE ME VEPRËN E SAJ SHKENCORE.....	124
<b>Ymer ÇIRAKU:</b> TË PËRBALLESHT ME SFIDAT LETRARE.....	126
<b>Hysen MATOSHI:</b> FLORESHA DADO – STUDIMI ATIPIK I LETËRSISË.....	130
<b>Agim LEKA:</b> FENOMENI FLORESHA DADO!.....	133

<b>Emin AZEMI:</b> FLORESHA DADO - IDENTITETI MË PËRFAQËSUES I NJË SISTEMI VLERËSUES NË LETRAT SHQIPE .....	138
<b>Floresha DADO:</b> Veprat e mia kanë në themele mendimin teorik letrar .....	144
AKADEMI SHKENCORE NË 112-VJETORIN E KONGRESIT TË MANASTIRIT....	147
<b>Skender ASANI:</b> TË PARËT TANË NA LANË ALFABET, NDËRSA NE DUHET TË LËMË VEPRA .....	151
<b>Talat XHAFERI:</b> PËR GJUHËN DHE ALFABETIN, TË GJITHË TË JEMI VIGJILENTË! .....	153
<b>Arafat SHABANI:</b> ABETARJA E UNIFIKUAR TË BËHET REALITET! .....	156
<b>Ylber SELA:</b> KONGRESI I MANASTIRIT - NJË TESTAMENT KULTUROR E QYTETËRUES I SHQIPTARËVE .....	158
<b>Xhevat LLOSHI:</b> PËRKUJTIMI I KONGRESIT TË MANASTIRIT.....	160
<b>David HOSAFLOOK:</b> KU JANË ESHTRAT E GJERASIM QIRIAZIT, GJERGJ QIRIAZIT DHE GJON CIKOS? TË PANJOHURAT PËR VARREZAT PROTESTANTE NË KORÇË, MANASTIR DHE STRUMICË .....	165
PËRKUJTIMI I NDRITSHËM PËR ZONJËN E PARË TË ALFABETIT – PARASHQEVI QIRIAZI .....	198
<b>Skender ASANI:</b> ITSHKSH DO TË JETË PËR MË SHUMË AJËR NË AMBIENTIN TONË TË PËRBASHKËT KULTUROR E SHOQËROR.....	202
<b>Irena STEFOSKA:</b> NËN KËTË QIELL TË PËRBASHKËT, NA QOFTË E GËZUAR DITA E ALFABETIT SHQIP .....	204
<b>Kejt BËRNS:</b> ÇMOJMË FORT RËNDËSINË E TRASHËGIMISË KULTURORE E SHPIRTËRORE.....	205
<b>Nora MALIQI:</b> PARASHQEVIA TEJKALOI STEREOTIPITË QË IMPONONTE APARTEIDI PATRIARKAL .....	207



## NË VEND TË HYRJES

Ky është edicioni i dytë i manifestimit kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit”, organizuar tanimë tradicionalisht nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, kushtuar një rës nga ngjarjet më madhore të historisë sonë kombëtare – Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe (Manastir, 14 – 22 Nëntor 1908).

Për shkak të gjendjes me pandeminë e shkaktuar nga virusi Covid -19, edhe ne ishim të kufizuar me mundësinë që aktivitetet t’i zhvillojmë me kapacitete të plota. Por megjithatë, shfrytëzuam maksimalisht edhe teknikat e reja digjitale, duke e përçuar kështu në kohë dhe në mënyrë të plotë mesazhin e duhur tek të gjithë ndjekësit e interesuar.

Manifestimi i vitit 2020, në fakt iu kushtua femrave iluministe shqiptare, që kanë lënë gjurmë në sfera të ndryshme nëpër rrjedhat e historisë sonë kombëtare. Kështu, përmes tribunave shkencore u nderuan figurat e Parashqevi Qiriazit, Shën Nënë Terezës, Nexhmije Pagarushës e Hanife Sejfulla Reçanit, Olivera Jashar Nastevës, Exhlale Dobruna - Salihut dhe Floresha Dados. Për to folën me kompetencë studiues të njohur dhe personalitete të dëshmuara të jetës akademike, kulturore e shkencore. Të gjitha referimet gjatë këtyre aktivitetëve, janë përfshirë në këtë edicion të veçantë të Institutit, me përjashtime të vogla, kur ndonjë autor nuk ka treguar kujdesin e duhur ndaj fjalës së shkruar!

Sikurse në botimin e parë, çdo aktiviteti i paraprinë një informacion gjithëpërfshirës, i mbështetur me fotografi nga ngjarja e caktuar. Pasonë fjalimet dhe recensionet tematike, të cilat japin një pasqyrë të qartë, jo vetëm se për rëndësinë e atyre ngjarjeve dhe personaliteteve për të cilat flitet, por edhe për shkencën albanologjike dhe arkivistikën shqiptare në veçanti.

Shpresojmë që me këtë kontribut modest, po vëmë gur të shëndoshë në zhvillimin e albanologjisë tek ne.

*Redaksia*

## NË ITSHKSH - SHKUP FILLUAN “DITËT E ALFABETIT - 2020”

*Shkup, 14.11.2020* – Sot në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITShKSh), filloi edicioni i dytë i manifestimit kulturor–shkencor “Ditët e Alfabetit”, me rastin e 112-vjetorit të Kongresit të Manastirit.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se këtë edicion të Ditëve të Alfabetit po e mbajmë në kushte paksa të jashtëzakonshme, për shkak të krizës shëndetësore që po mbretëron, por kjo nuk na ka zbrapsur nga synimi që edhe sivjet të organizohemi për të sjellë në vëmendje një program të ngjeshur, i cili sivjet do të jetë në shenjë të iluministëve shqiptarë në disa breza. “Konsiderojmë se edicioni i sivjetmë i Ditëve të Alfabetit vjen me disa risi, kurse risia kryesore ka të bëjë me Homazhin tek varri i Gjerasim Qiriazit, në Strumicë, një ngjarje kjo e shumëpritur dhe e planifikuar të bëhet publike pikërisht sot kur po startojmë me Ditët e Alfabetit, manifestim ky tash më tradicional i mbështetur edhe institucionalisht”, tha Asani.

Zëvendëskryeministri i Parë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, përgëzoi Institutin për këtë organizim serioz dhe ambicioz, në nderim të njëres nga ngjarjet më madhore të historisë sonë kombëtare – Kongresi i Manastirit. Ai tha se 22 Nëntori i është shtuar datave me rëndësi të madhe komëtare të historisë shqiptare, bashkë me 28 Nëntorin e Kuvendit të Vlorës dhe 10 Qershorin e Lidhjes së Prizrenit.

Me këtë rast u bë edhe promovimi i botimit të veçantë periodik “Ditët e Alfabetit –I–”, ku pasqyrohen të gjitha aktivitetet e edicionit të parë të këtij manifestimi nga viti i kaluar. Kryeredaktori Sevdail Demiri, tha se brenda kopertinave të këtij botimi, gjenden materialet e shkruara nga të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë nëntorit të vitit 2019, në shenjë nderimi të ish-presidentit amerikan Uilson. Aty bëjnë pjesë fjalime e vështrime shkencore në promovime librash nga autorë të shquar të kulturës e shkencës albanologjike.

Hapjen e manifestimit, me pjesëmarrjen e tij e nderoi edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj.

Ndryshe, “Ditët e Alfabetit” që do të zgjasin deri më 22 Nëntor 2020, do të jenë në shenjë nderimi e respekti të personaliteteve të shquara iluministe, që lanë gjurmë të thella në trashëgiminë tonë të pasur kulturore-historike që nga

Kongresi i Manastirit e deri në ditët e sotme, si: Parashqevi Qiriazi, Shën Tereza, Nexhmije Pagarusha e Hanife Sejfulla Reçani, Olivera Jashar Nasteva, Exhlale Dobruna-Saliu dhe Floresha Dado.

Për shkak të gjendjes aktuale me pandeminë, të gjitha aktivitetet do të zhvillohen duke respektuar protokollet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe kryesisht pa praninë e publikut të gjerë!





**Skender ASANI**

*Drejtor i ITShKSh - Shkup*

## **DITËT E ALFABETIT, NË SHENJË TË ILUMINISTEVE SHQIPTARE**

### **-fjalë përshëndetëse-**

I nderuari zëvendëskryeministër i Parë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, z. Artan Grubi, i nderuari ambasador i Kosovës – ekselencia juaj z.Gjergj Dedaj, i nderuari kryeredaktor i 'Ditëve të Alfabetit' z. Sevdail Demiri!

Këtë edicion të Ditëve të Alfabetit po e mbajmë në kushte paksa të jashtëzakonshme, për shkak të krizës shëndetësore që po mbretëron, por kjo nuk na ka zbrapsur nga synimi që edhe sivjet të organizohemi për të sjellë në vëmendje një program të ngjeshur, i cili sivjet do të jetë në shenjë të iluministëve shqiptarë në disa breza.

Konsiderojmë se edicioni i sivjetmë i Ditëve të Alfabetit vjen me disa risi, kurse risia kryesore ka të bëjë me Homazhin tek varri i Gjasim Qiriazit, në Strumicë, një ngjarje kjo e shumëpritur dhe e planifikuar të bëhet publike pikërisht sot kur po startojmë me Ditët e Alfabetit, manifestim ky tash më tradicional i mbështetur edhe institucionalisht.

ITShKSh në Shkup në bashkëpunim me Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante do të kurorëzojnë pikërisht sot një nismë që ndërlidhet me një prej figurave më të ndritshme të kombit, siç është Gjasim Qiriazit, nderimi për të cilin sot do të bëhet duke vënë lule të freskëta mbi varrin e tij, që do të jetë edhe një shkas që të kujtojmë kontributin madhor të kësaj familje në emancipimin kulturor e arsimor të kombit shqiptar.

Kur jemi te kontributi i familjes Qiriazit, pa shmangshëm na imponohet edhe një emër i nderuar i kësaj familje – Parashqevi Qiriazit dhe pikërisht do të jetë Ditari i saj, i posabotuar nga ana e Institutit tonë e që do të promovohet në kuadër të Ditëve të Alfabetit. Ky Ditar vjen për lexuesit pikërisht në 50 vjetorin e vdekjes së Parashqevi Qiriazit.

Në këtë përvjetor të vdekjes së saj, figura e Parashqevi Qiriazit ka frymëzuar edhe drejtuesit e UNESCO-s për ta përfshirë atë – si grua dhe pedagoge e

jashtëzakonshme, në kalendarin e jubileve të përkrahur nga kjo organizatë për vitin 2020.

Ditët e Alfabetit sivjet kemi dashur t'i vendosim në kontekst të gjithë frymës emancipuese e kulturore që ka prodhuar angazhimi i pandalshëm i gruas shqiptare, që nga motrat Qiriazi, duke qenë pjesë e Kongresit të Manastirit, e deri te krijueset, akademiket, këngëtaret, albanologet, arkeologet, veprimtaret dhe diplomatet e ditëve të sotme. Vet agjenda e manifestimit të sivjetmë shpërfaq këtë frymë, por edhe një mirënjohje modeste për kontributin e gruas shqiptare dje dhe sot.

Gjatë nëntë ditëve , sa zgjasin Ditët e Alfabetit, programi i manifestimit është i ngjeshur me aktivitete tematike, shumica prej të cilëve do të kenë bartës emra të shquar të jetës akademike e universitare tek ne, me ç'rast shpresojmë që do të përmbushim synimin tonë që ITSHKSH në Shkup të vazhdojë të jetë një promotor i mendimit shkencor dhe artikulues i ideve emancipuese e iluministe.

Duke iu dëshiruar mirëseardhje të gjithëve, uroj që të ndani me ne kënaqësinë e të qenit pjesëmarrës në një manifestim i cili tash më ka marrë fizionominë e vet.

Ju faleminderit shumë!

**Artan GRUBI**

*Zëvendëskryeministër i Parë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut*

## **22 NËNTORI, NJË NGA TRI SHTYLLAT E KODIT IDENTITAR SHQIPTAR**

### **-fjalë përshëndetëse-**

Shumë i nderuar drejtor – miku im i hershëm z. Asani, shumë i dashur ambasador Dedaj, të nderuar panelistë!

Ju falënderoj për ftesën dhe në fillim përgëzoj Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, për krijimin e një tradite të re për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet zhvillimit të manifestimit “Ditët e Alfabetit”.

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, 22 Nëntorin e konsiderojnë si një nga tri shtyllat kryesore të krijimit të kodit identitar shqiptar, bashkë me 10 Qershorin e vitit 1878 të Lidhjes së Prizrenit dhe me 28 Nëntorin e Shpalljes së Pavarësisë më 1912. Këto tri data të historisë moderne shqiptare, na bëjnë të jemi këto që jemi sot, dhe fatmirësisht janë zhvilluar në të tri trojet ku shqiptarët jetojnë në mënyrë dominante, pra në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri.

Më vjen shumë mirë fakti që ky manifestim i sivjetshëm i Ditëve të Alfabetit, i organizuar nga Instituti, i dedikohet kontributit të femrës shqiptare. Krahas perceptimit tradicional të femrës shqiptare, është me rëndësi të trajtohet roli i gruas iluministe shqiptare, e cila ka dhënë kontribut të madh në zhvillimin edukativ dhe kulturor të shqiptarëve, jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por gjithandej trojeve tona. Prandaj, organizatorët i përgëzoj për përzgjedhjen e tematikës së sivjetme të këtij manifestimi, dhe uroj të vazhdojmë të ndriçojmë rolin kyç të femrës shqiptare në historinë dhe shtetndërtimin.

Elementi i tretë për të cilin deshta të flas sot, është mënyra e trajtimit të datës së 22 Nëntorit! Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut këtë e konsiderojmë si datë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe me ndryshimin e Ligjit për festat, 22 Nëntori tashmë është festë shtetërore për gjithë komunitetin shqiptar në Maqedoninë e Veriut, pra është ditë jopune dhe e shënojme në këtë mënyrë

bashkërisht dhe solemnisht. Por, përtej kësaj, pikërisht më 22 Nëntor është themeluar edhe ky Institut në të cilin ne gjendemi sot. Ndërsa, me ndyshimin e Ligjit për çmimet shtetërore, tashmë e kemi zyrtarizuar edhe Çmimin shtetëror « 22 Nëntori » që u ndahet për çdo vit personaliteteve që kanë dhënë kontribut të veçantë në kulturë, arsim, shkencë, histori, etj. Pra, edhe sivjet në parlament do të ndahet ky çmim për dy personalitete të shquara, sikurse edhe vitin e kaluar kur ndodhi për herë të parë.

Përmes ambasadorit të nderuar Dedaj, që është këtu prezent me ne, do të kishim dashur të përcjellim mesazhin, që kjo datë të merr vëmendje më të madhe edhe në Kosovë, por edhe në Shqipëri, që të ngritet në të njejtin nivel sikurse që janë 10 Qershori dhe 28 Nëntori, si festa të rangut më të lartë për historinë e përbashkët shqiptare.

Për fund, ju uroj një javë të mbarë përplot me aktivitete, në përputhje me rekomandimet shëndetësore kundër pandemisë me Kovid-19, dhe të shihemi bashkë më 22 nëntor gjatë ndarjes së çmimeve për dy laureatët e sivjetshëm.

Ju faleminderit shumë!

**Sevdail DEMIRI**

*Kryeredaktor i botimit*

## **“DITËT E ALFABETIT”, TRADITË E RE NË BOTIMET ALBANOLOGJIKE**

I nderuari zëvendëskryeministër Grubi, ambasador Dedaj, drejtor Asani!

Me të vërtetë është kënaqësi e veçantë që sot t’ju drejtohem i juve dhe publikut të gjerë duke prezantuar këtë botim të ri – produkt konkret që e kemi nga manifestimi i kaluar i “Ditëve të Alfabetit”!

Megjithëse ne për çdo vit e kemi shënuar 22 Nëntorin, meqë kjo datë përkon edhe me ditëlindjen e Institutit tonë, që nga viti i kaluar kemi marrë vendim për të mbajtur një manifestim të tillë disaditor të çdovitshtëm me emrin ‘Ditët e Alfabetit’ me një format krejt të veçantë, siç është pra manifestimi kulturo-shekncor që nga viti i kaluar e që po vazhdon edhe sivjet dhe besojmë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Veçantia tjetër pra e këtij aktiviteti, është se të gjitha materialet e prezantuara brenda këtij manifestimi disaditor, do të botohen në një edicion të veçantë me emrin “Ditët e Alfabetit”, dhe në fakt ky është numri i parë i këtij botimi të veçantë të Institutit, që i bashkohet kolonës së botimeve të shumta vjetore.

Derisa sot po e fillojmë manifestimin e sivjetshëm kushtuar iluministëve shqiptarë, po ju rikujtojmë se vitin e kaluar ky manifestim u shtri në Manastir dhe në Shkup me aktivitete të shumta, kryesisht përmes botimeve që lidheshin me çështjen e alfabetit. Konkretisht, kemi filluar nga Manastiri me promovimin e librit të autorit David Hosaflook “Lëvizja protestante te shqiptarët”, vazhduam në këtë sallë ku gjendemi sot, duke promovuar librin e autorit akademik Luan Starova, kushtuar piktorit me nam ndërkombëtar Omer Kaleshi. Pastaj promovuam librin e autorit Vllado Popovski, një studim serioz dhe me një qasje krejt ndryshe historiografike që ka të bëjë me Rilindjen Kombëtare Shqiptare. Më tej promovuam veprimtarinë shkencore dhe arsimore të albanologut të njohur Remzi Nesimi, dhe ditën tjetër promovuam veprat monumentale të studiuesit të njohur Xhevat Lloshi kushtuar iluministit Gjergj Qiriazit. Ndërsa, ditën e fundit u mbajt në Manastir Akademia shkencore kushtuar 111-vjetorit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe, me pjesëmarrjen e personaliteteve më të larta nga bota akademike shqiptare në

trekëndëshin Tiranë – Shkup – Prishtinë. Në këtë botim të veçantë kemi pasqyruar edhe aktivitetet ku ne si Institut kemi qenë pjesë e organizimeve tematike që janë mbajtur në Komunën e Çairit të Shkupit, ku u ngrit busti i presidentit amerikan Uilson, si dhe ceremonisë me rastin e ndarjes së Çmimit shtetëror “22 Nëntorit” nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Natyrisht që në këtë botim janë përfshirë të gjitha fjalimet, studimet, recensionet, vështrimet, të shoqëruara edhe me fotografi nga aktivitetet konkrete. Prandaj, mendoj se të gjitha këto materiale do të jenë një dokumentim shumë i mirë dhe i vyeshëm për shkencën e studimeve albanologjike, bibliografinë dhe arkivistikën shqiptare.

Presim që edhe botimi i dytë i këtij edicioni që do të shoh dritën me materialet e manifestimit të sivjetshëm, të jetë me po aq vlerë dhe interes për kulturën dhe shkencën shqiptare.

Ju faleminderit shumë!

## STRUMICË, HOMAZHE TEK VARRI I ILUMINISTIT GJERASIM QIRIAZI

*Strumicë, 14.11.2020* - Aktivitetet në kuadër të manifestimit “Ditët e Alfabetit”, vazhduan në Strumicë, ku për herë të parë në mënyrë dinjitoze u bënë homazhe tek varri i iluministit Gjerasim Qiriazit.

Drejtori Asani tha se sot ndodhemi para një guri, që nuk shënjon vetëm vendndodhjen e një varri, por edhe trajektoren e një bote shpirtërore brenda së cilës lëvizti familja Qiriazit. “Në këtë trajektore e gjejmë edhe Gjerasimin, i lindur dhe rritur në Manastir, dhe brenda një moshe relativisht të re, atë e shohim vazhdimisht në lëvizje, kryesisht i ngarkuar me aktivitete që lidheshin me përhapjen e mësimave ungjillore. Gjerasimi jetoi vetëm 35 vite, deri më 24 janar 1884, kur i mbylli sytë për të fundit herë, por porositë që ai ia la të motrës Sevastisë dhe mbarë familjes, për të vazhduar përpjekjet iluministe në emancipimin dhe edukimin e popullit në frymën e shkronjave shqipe, dhanë fryte disa vite më vonë, konkretisht më 1908 kur në Manastir u mbajt Kongresi i Alfabetit, një ngjarje kjo e madhe kombëtare që kishte kaluar nëpër dyert e shtëpisë së Qiriazëve”, tha Asani.

Pas homazhit, me fjalimet e tyre u paraqitën edhe veprimtari Fatmir Limani, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve Ylber Sela, ambasadori i Kosovës në Shkup Gjergj Dedaj, përfaqësuesi i Kishës Protestante të Kosovës - Artur Krasniqi, kryetari i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë - Ylli Doçi, etj.

Në të vërtetë, falë kujdesit dhe përkushtimit të përfaqësuesve të Fondacionit 'Ms. Stone', varri i Gjerasim Qiriazit ruajt të mos grimcohet nga dhëmbi harrësës, kurse ITSHKSH-ja ishte logjistika kryesore e ritakimit me të, pikërisht në ditën kur filloi edhe manifestimi Ditët e Alfabetit, një ngjarje që përveç historisë, brenda ka edhe kujdesin dhe ndërgjegjësimin tonë në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave që ishin motor i zhvillimit tonë kombëtar.

Gjerasim Qiriazit dhe disa protestantë tjerë, fillimisht ishin varrosur në Manastir (Gjerasimi vdiq më 2 janar 1894), pranë kompleksit arkeologjik Heraklea, mirëpo mungesa e kujdesit dhe neglizhenca e autoriteteve komunale, kishte bërë që të rrezikohet edhe ekzistenca e këtyre varrezave. Më 2013, Bashkësia Ungjillore kishte vendosur t'i bart këto varre në një hapësirë tjetër dhe ishte gjetur një hapësirë në kuadër të varrezave të qytetit të Strumicës, që aty të pushojnë eshtrat e Gjerasimit dhe disa bashkëbesimtarëve të tij.





**Skender ASANI**

*Drejtor i ITShKSh – Shkup*

## **GJERASIM QIRIAZI, NJË FARË QË VAZHDON TË NA USHQEJË ME FRYTET E DITURISË**

Dua ta ndaj me gjithë juve gëzimin se ja më në fund, atë që kishim pëshpëritur në një rreth të ngushtë miqsh e kolegësh, sot mund ta bëjmë publike.

Sot ndodhemi para një guri, që nuk shënjon vetëm vendndodhjen e një varri, por edhe trajektoren e një bote shpirtërore brenda së cilës lëvizi familja Qiriazit.

Në këtë trajektore e gjejmë edhe Gjerasimin, i lindur dhe rritur në Manastir, dhe brenda një moshe relativisht të re, atë e shohim vazhdimisht në lëvizje, kryesisht i ngarkuar me aktivitete që lidheshin me përhapjen e mësimëve ungjillore. Konkretisht, ai drejtoi bashkësinë ungjillore në gjuhën shqipe qytetin e Manastirit.

Gjerasim Qiriazit jetoi vetëm 35 vite, deri më 24 janar 1884, kur i mbylli sytë për të fundit herë, por porositë që ai ia la të motrës Sevastisë dhe mbarë familjes, për të vazhduar përpjekjet iluministe në emancipimin dhe edukimin e popullit në frymën e shkronjave shqipe, dhanë fryte disa vite më vonë, konkretisht më 1908 kur në Manastir u mbajt Kongresi i Alfabetit, një ngjarje kjo e madhe kombëtare që kishte kaluar nëpër dyert e shtëpisë së Qiriazëve.

Gjerasimi edhe pse nuk e arriti ta përjetojë këtë ngjarje, fryma e tij megjithatë kishte ngelur, madje e gdhendur me shkronjat shqipe në varrin e tij disa vite para Kongresit të Alfabetit. Pra. Gjerasimi nuk ishte dëshmitar i ngjarjeve të bujshme që do të ndodhin më vonë, mirëpo nderimi ndaj tij u bë pikërisht ashtu siç e meritonte ai. Sepse vetëm kështu do të shkonte në vend amaneti i tij për një përparim iluminist, mbi baza të tolerancës me fqinjët dhe mbi vizionin për një të ardhme pa barriera dhe paragjykime në mes të popujve, ashtu siç e shpreh edhe kjo ditë e sotme një realitet me diversitete fetare, ku varret shndërrohen në porosi dhe mision për më shumë afrim dhe tolerancë ndëretnike e ndërfitare.

Siç mund ta shohim, pranë varrit të Gjerasim Qiriazit prehet edhe një bashkëpunëtor i tij i afërt, Gjon Ciko, një librashitës shqiptar. Në gurin e varrit

të tij, dikur në Manastir, por tani në Strumicë, shënohet se ai lindi në Korçë, më 1850 dhe vdiq më 1922. Sikundër dihet, Gjon Ciko u përfshi në elitën kulturore të qytetit të Korçës, jo vetëm si shpërndarës i Shkrimit të Shenjtë në shqip, por edhe si drejtuesi i parë i takimeve ungjillore dhe si anëtar i Shoqërisë së Mësimit Shqip në Korçë, e cila u themelua për të mbështetur punën e Mësonjëtores.

Figurat emblematike si kjo e Gjasim Qiriazit, nuk lindin shpesh, por ato mjaftojnë të na kujtojnë edhe kur nuk jetojnë më, se punët e dobishme janë si fara që hidhet, frytet e së cilës mund të shijohen më vonë. Një prej atyre fryteve e kemi dhuratë edhe nga Gjasim Qiriazit, sepse drita e diturisë që vazhdon të përhapet gjithandej është një farë e mbjellë prej tij para më shumë se një shekull.

Qoftë i bekuar emri i Gjasim Qiriazit!

**Ylber SELA**

*Drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe*

## **GJERASIMI, TËRË ENERGINË DHE DIJEN E VURI NË SHËRBIM TË GJUHËS DHE TË SHKOLLËS SHQIPE**

Duke i përkujtuar ngjarjet e mëdha kulturore e kombëtare, siç është Kongresi i Alfabetit, rruga e parë na shpie drejt familjes së Qiriazëve të Manastirit, nga gjiri i së cilës lindi dhe u rrit edhe Gjerasim Qiriazi, ky atdhetar, iluminist, ungjillor e intelektual i spikatur i kohës së tij, i cili vazhdon edhe sot e kësaj dite të na frymëzojë e të na udhëzojë drejt vlerave tona kombëtare.

Duke e braktisur besimin ortodoks që vepronte kundër interesave të shqiptarëve dhe duke e përqaftuar besimin protestant, ai tërë energjinë dhe dijen e vet e vuri në shërbim të gjuhës dhe të shkollës shqipe. Në këtë mënyrë ai u caktua ungjilltar i shqiptarëve duke e filluar veprimtarinë e tij pikërisht në Korçë. Së pari filloi të bënte shpërndarjen e ungjillit në mesin e shqiptarëve dhe të shkruante himnet e para në gjuhën shqipe. Pastaj e gjejmë si shërbestar në Kishën Ungjillore të Selanikut ku meshën e mbante në gjuhën shqipe, e pastaj edhe në kishën e Manastirit. Nëpërmjet rolit të tij shqipja zuri të marrë frymë në jetën publike. I nxitur nga dëshira e madhe që shqiptarëve çdo gjë t'ua jepte vetëm shqip, ai iu përvesh edhe punës së përkthimit. Kështu e përktheu dhe botoi Ungjillin e Mateut në shqip, pastaj me sugjerimin e Naim Frashërit bëri transkriptimin e pesë librave të parë të Biblës si tekste shkollore. Në këtë kohë ai e mbajti në Korçë edhe shërbesën e parë publike protestante. Mirëpo, për shkak të kësaj Kisha Ortodokse bëri një mallkim kundër tij duke e shkishëruar. Por ai jo vetëm që nuk u ndal nga ky akt, por edhe e themeloi Kishën Ungjillore të Korçës dhe Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë. Në vazhdim filloi të botojë edhe gazetën e shoqërisë “Letra e Vëllazërisë”. Megjithatë, kontributi më i madh i tij është në themelimin e Shkollës së Vajzave dhe Shkollën e së Dielës në Korçë.

Pikërisht ky aktivitet i pandalur bëri që Kisha Ortodokse të organizonte një atentat kundër tij për ta penguar përhapjen e gjuhës shqipe në jetën kishtarë e publike.

E gjithë kjo jetë dinamike në shërbim të kauzës kombëtare dhe të gjuhës shqipe e bën Gjerasim Qiriazit një figurë shumë të rëndësishme, e cila i kalon përmasat e kohës së tij, duke u reflektuar në të gjitha kohët dhe periudhat e mëvonshme. Prandaj ne sot e kemi detyrim moral dhe kombëtar që t'i për-ulemi me respektin më të thellë, jo vetëm duke bërë homazhe mbi varrin e tij, por aq më tepër ta vazhdojmë rrugën e tij për shkollën dhe për gjuhën shqipe.

Lavdi veprës së tij kombëtare!

## Ylli DOÇI

*Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë*

# NJË DITË E VEÇANTË PËR UNGJILLORËT!

Ati ynë Gjerasim Qiriaz!

Sot është dita e 14 Nëntorit, dhe në një ditë si sot Gjerasim Qiriaz themeloi Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë 128 vjet më parë në Korçë. Prandaj sot për ne Ungjillore kjo është një ditë e veçantë që të vijmë dhe të nderojmë Gjerasim Qiriazin tek varri ku prehen eshtrat e tij këtu në Strumicë.

Mihal Grameno, një prej rilindasve të shquar shqiptarë, e ka përshkruar kështu figurën e Gjerasimit: *“Nuk duhet mohuar dhe harruar kurrë shërbimet e mëdha që i ka sjellë çështjes një ‘fole kombëtare’, e cila ishte një qëndër dhe një fortesë ku mblihdeshin edhe ku përhapeshin ndjenjat e shkëndijat kombëtare. Kjo ‘fole’ ishte shkolla e vajzave në Korçë, e themeluar prej të pavdekurit dërgimtar kombëtar Gjerasim D. Qirias, emrin e të cilit, historia e Shqipërisë do t’a shkruaje me shkronja të arta duke u mburrur me veprat dhe me shërbimet e tij të paçmuara që ka sjellë mbi altarin e atdheut.”*

Duke e quajtur Gjerasim Qiriazin *“të pavdekurin dërgimtar kombëtar”* Mihal Grameno po e quan atë një *“apostull kombëtar të pavdekshëm”* duke përbërë kështu sot një kontrast maksimal me eshtrat e Gjerasimit në këtë varr sepse ndërkohë që ai pushon nën këtë gur varri, kontributi i jetës dhe veprës së Gjerasimit për kombin mbetet i gjallë edhe sot. Fakti që sot shqiptarët nuk kanë nevojë për ndonjë si Malala Yousufzai të ngrihet për të promovuar të drejtën e vajzave për arsim është sepse Gjerasimi dhe motra e tij Sevastia hodhën themelet e arsimit kombëtar shqiptar edhe për vajzat shqiptare qysh në shekullin XIX. Ungjillorja Sevasti Qiriaz është femra e parë shqiptare me diplomë kolegj dhe mësuesja e parë e vajzave të kombit tonë që u bënë nënat e kulturuara të atyre brezave që kultivuan vlerat e kombit deri me sot.

Është e vërtetë se ungjillori i parë i deklaruar vetë protestant me dokumente historike të vërtetueshme është *“babai i Shqipes së shkruar”* Kostandin Kristoforidhi, që u bashkua me një kishë protestante ungjillore në Izmir të Turqisë në 1857, por Gjerasim Qiriaz mbetet ungjillori më i madh. Ai mbetet ungjillori më i madh sepse ai filloi kishën e parë ungjillore në Shqipëri dhe në 1892 ai themeloi Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë që sot është shprehja e një komuniteti të përhapur në gjith vendin. Gjerasimi mbetet ungjillori më i

madh Shqiptar për kontributin e tij themelor me ungjillin si bekim për kombin dhe, gjithashtu, deri në fund të historisë kur shumë ungjillorë të tjerë do mund të kenë bërë shumë më tepër se sa ai, prapë-se-prapë, Gjerasim Qiriazit mbetet babai i ungjillorizmit Shqiptar; dhe kështu, përgjithmonë, më i madhi.

Askush pra, sado që për askënd nuk ka kufinj të madhështisë së kontributit bekues për kombin dhe për botën sepse vetë Jezusi u tha nxënësve të tij se ata do të bënin vepra më të mëdha se ato që bënte ai (Bibla, Gjoni 14:12); përsëri, askush nuk do mund ta eklipsojë madhësinë e Gjerasim Qiriazit, sepse ai është babai i ungjillorizmit/protestantizmit shqiptar!

Apostulli i pavdekshëm kombëtar dhe babai ynë Gjerasim Qiriazit, babai i gjithë ungjillorëve shqiptarë, me eshtrat e shenjta nën këtë gur varri dhe të gjithë ju sot jeni dëshmitarë që unë si përfaqësues i ungjillorëve shqiptarë përkushtohem që ne do të jemi bijtë e tij besnikë për ta ruajtur të pastër, për ta kultivuar me mençuri dhe për ta përhapur me vetëmohim si një bekim për kombin tonë dhe për botën - ungjillin e Krishtit - që na besoi si trashëgimi, ai, ati ynë ungjillor Gjerasim Qiriazit, betohem!

**Fatmir BEQIR LIMANI**

*Veprimtar*

## **LULE MBI NJË LULE TË ATDHETARIT TONË, I CILI PREHET PAQËSISHT NË STRUMËN ILIRE!**

I respektuar shok i veprimtarisë ilegale Skender Asani, tanimë figura kryesore e ndritjes, kultivimit dhe ruajtjes me xhelozi të historive dhe ngjarjeve më të rëndësishme të kombit tonë...

Shpreh mirënjohje për të gjithë kontribuesit që vepruan për të zbardhur këtë rast i cili në 126 vite, mbeti pezull i çdo veprimtari dhe atdhedashësi që nga Rilindja Kombëtare e deri më sot.

Me këtë akt të ndritjes së një pjese të historisë më të dhembshme dhe krenare të kombit tonë, realizojmë amanetin e rilindasve, të cilët e përkrahën fuqishëm Gjasim Qiriazin në misionin e shenjtë të arsimit të gjeneratave pasuese.

Ne sot po ritakohemi me Gjasimin, njërin prej rrënjëve të trungut të familjes Qiriazit dhe jemi njerëzit më me fat që para nesh ndodhet atdhetari i epokës më të lavdishme të historisë sonë.

Ky pikëtakim ka mundur të jetë edhe në një tjetër vend dhe jo këtu, por zëri i Qiriazëve dhe bashkëkohanikëve të Gjasimit si: Nikolla Naço, Pandeli Sotiri, Abdyl Frashëri, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Mihal Grameno, Kristo Dako etj.. na ftuan këtu, për të realizuar Amanetin e madh të babait Dhimitër Qiriazit dhe nënës Maria, që është mos'harrimi i bijëve më të mirë të kombit.

Sa e heshtur dhe e qetë në shikim të parë duket vend'përjetësia e Gjasimit, por e vërteta dhe madhështia reflektohet te gjuha që kuptojnë dhe flasin brezat pasues. Bëjmë të pamundurën që të rivendosim komunikimin me një pjesë të së kaluarës sonë të lavdishme, ku Qiriazët ishin foleja e iluminizmit, pa të cilën nuk do ta kishim më vonë zhvillimin tonë kulturor e arsimor. Duke qenë protagonistë të ngjarjeve me karakter mobilizues, Qiriazët, ku merrte pjesë edhe Gjergji, u bënë shembull i energjive të pashtershme në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Rruga e filluar nga Gjasimi, do të vazhdohej nga Gjergji dhe dy motrat – Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit.

Të gjithë këta së bashku krijuan mozaikun e ndritshëm të ndërgjegjësimit kombëtar, duke na bartur nga epoka e errësirës dhe paditurës, në epokën e dritës, të diturisë dhe të përparimit tonë si komb. Emërues i përbashkët i angazhimit të Tij, ishte përpjekja për të sjellë dituri ndër shqiptarët në gjuhën e tyre amtare. Ai ua kujtonte prindërve përgjegjësinë e lartë për edukimin e fëmijëve të tyre në gjuhën amtare.

“NUK KA TURP MË TË MADH TË QËNDROJMË NË ERRËSIRË NË NJË KOHË KUR DRITA SHKËLQEN RRETH E RROTUSH NESH. NEVOJË E NGUTSHME E KOMBIT JANË LETRA, PENA DHE DIJA NË GJUHËN AMTARE, PA TË CILAT ËSHTË E PAMUNDUR PËRPARIMI NË RRUGËN E DREJTË ”, shkruante Gjasimi në revistën “Letrat e Vëllazërisë”.

Gjendemi pranë gur – lapidarit, i cili shënon hapin e fundit në jetën e Gjasim Qiriazit, por tani e tutje gur - lapidari, zbuluar nga misteri i harreses të qëllimshme, mund të shërbejë si pikë referimi i ndërgjegjësimit dhe inkurajimit tonë, sepse vetëm ata që çmojnë vlerat e së kaluarës meritojnë të shijojnë frytet e së ardhmes.

Vendpërjetësia e Gjasim Qiriazit, në qytetin e Astraion Surius, Strumës Ilire dëshmon qartazi se çdo hap i Maqedhonisë, i takon kulturës dhe historisë Pellazgo - Ilire dhe pasaardhësit e kësaj toke lidhen padyshi me Dardanët !

Shumëkush pas këtij fjalimi dhe rasti do të parashtrijë pyetjet:

- Si doli varri i Gjasimit Qiriazit nga vendlindja Manastiri në Astraion Surius, Strumën-Ilire ?!

- Si u shua gjuha, kultura dhe historia e këtij vendi, në të cilin Gjasimi nga Manastiri ligjeroi me shqipen e letrave të Tij ?!

- Në cilat vend'prehje të këtyre varrezave fshihet thesari i gjuhës dhe kulturës iliro-shqiptare të këtij vendi ?!

- Nëse Paionët ishin fis Ilir dhe shtrirja e tyre arrinte deri në pjesën e Astraion Surius, Strumës Ilire, shtrohet pyetja banorët e këtij vendi a janë shqiptar ?!

\* Këtyre dhe mijëra pyetjeve do të duhet t'u japim përgjigje në të ardhmen gjithësecili që pretendon se është autokton në këto vise.

Dhe për fund e pafund të kësaj ngjarje te rendesishme le të jetë:

I përjetshëm kujtimi, për të gjithë atdhedashësit e përjetësuar në kohëra dhe vise të ndryshme të atdheut e jashta tij!

Prej sot eshtrat e Gjasimit do të pushojnë qetësisht e paqëtishtë në gjirin e kujtesës dhe zemrave tona.

Lavdi jetës dhe veprës së Gjasimit, Gjergjit, Parashqevit dhe Sevasti Qiriazit e të gjithë atdhetarëve e dëshmorëve të atdheut.

Faleminderit për prezencën për të gjithë ju që na u bëtë shokë në këtë ditë të shënuar të kombit tonë që nga Kërçova, Tetova, Kumanova, Kosova, Shqipëria e mbarë hapsirat Shqiptare.

Falenderit mediave të cilat na ndjekin hap pas hapi për të treguar dhe dëshmuar se ku janë gjurmët tona.

Edhe njëherë, faleminderit shumë!

## PËRKUJTOHEN DY PERLAT E MUZIKËS SHQIPTARE – NEXHMIJE PAGARUSHA DHE HANIFE REÇANI

*Shkup, 16.11.2020* – Manifestimit kulturor-shkencor “Ditët e Alfabetit”, vazhdoi në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup (ITShKSh), duke përkujtuar dy perlat e muzikës shqiptare – Nexhmije Pagarusha dhe Hanife Sejfullah Reçani.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, në fjalën e tij tha se Nexhmije Pagarusha dhe Hanife Sejfulla Reçani, janë emblema të emancipimit tonë kombëtar, por edhe treguesi më real i arritjeve të tyre në saje të talentit dhe përkushtimit ndaj këngës. “Që të dyja krijuan identitetin e tyre vokal dhe interpretues, prandaj jo ratësisht këngët e tyre janë të pavdekshme. Ato edhe sot dëgjohen me ëndje dhe ky është tregues më i mirë i rezistimit të vlerave të mirëfillta muzikore ndaj qiçit dhe tallavasë. Ndonëse që të dyja vijnë nga treva të ndryshme shqiptare, ato megjithatë sjellin mozaikun e koloritit të pasur të këngës shqipe dhe si të tilla ato mund të konsiderohen edhe si begati kulturore që mbajnë gjallë dhe frymëzojnë brezat e rinjë në kultivimin e vlerave krijuese mbi tabanin e trashëgimisë sonë të pasur muzikore”, theksoi Asani.

Më pas, studiuesja Rreze Kryeziu nga Universiteti i Prishtinës, përmes video-konferencës referoi për ikonën e muzikës shqiptare, Nexhmije Pagarusha, duke u ndalë në ca dromca nga jeta dhe vepra e saj e bujshme muzikore dhe artistike. Lidhur me veprimtarinë muzikore të Pagarushës, dhe veçanërisht për këngën e njohur “Baresha”, u lexua kumtesa e studiuesve Ermal Mehmeti dhe Jeta Starova-Mehmeti.

Rreth veprimtarisë së bujshme muzikore të këngëtares së njohur popullore Hanife Sejfulla Reçani nga Gostivari, referuan studiuesit Bekim Ramadani nga Universiteti “Fadil Sulejmani” – Tetovë dhe Agim Poshka nga Universiteti i Evropës Juglindore, si dhe shkrimtari dhe publicisti Lulzim Haziri. Ata theksuan rëndësinë e kësaj figure të madhe të muzikës shqiptare, veçanërisht në trevat shqiptare të Maqedonisë, për të cilën deri më tani është bërë shumë pak në aspekt të ndriçimit të vlerave të saja muzikore dhe artistike.

Të gjitha referimet gjatë këtij aktiviteti, sikurse edhe të gjitha aktivitetet e radhës së këtij manifestimi kulturor-shkencor, do të botohen në vëllimin e dytë të edicionit të veçantë “Ditët e Alfabetit”.

Për shkak të gjendjes aktuale me pandeminë, aktivitetet e sivjetme po zhvillohen duke respektuar protokollet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe kryesisht pa praninë e publikut të gjerë!





**Skender ASANI**

*Drejtor i ITShKSh – Shkup*

## **NEXHMIJE PAGARUSHA DHE HANIFE REÇANI – DY PERLA QË E BËJNË TË PAVDEKSHME KËNGËN E MIRËFILLT SHQIPE**

Ditët e Alfabetit vazhdojnë sot me një sesion tematik kushtuar dy perlave të muzikës shqiptare -Nexhmije Pagarushës dhe Hanife Sejfulla Reçanit. Kur jemi përcaktuar për këtë temë kemi pasur parasysh tre faktorë:

E para – depërtimi i zërit të gruas në një shoqëri patriarkale, ka qenë sfidë dhe të gjithë ato që kanë provuar ta rrëzojnë këtë mur refuzimi janë ballafaquar me paragjykime dhe stigmatizime nga më të ndryshmet.

E dyta – a është i mundur suksesi i gruas pa ndihmën e burrave? Një kohë të gjatë ka ekzistuar një mendësi e gabuar se garantues i suksesit të një gruaje patjetër duhet të jetë burri.

E treta – afirmimi i gruas shqiptare në një dimension më të gjerë publik, ka shënuar shkallën e përparimit të shoqërisë.

Duke i sublimuar të tre këta faktorë, mendja na shkon tek Naim Frashëri i cili me të drejtë thoshte se gruaja duhet të jetë më shumë e ditur se burri. Për ta zbërthyer këtë thënie mjafton të përkujtojmë faktin se gruaja-nëna është shtylla e edukimit në familje dhe sa më e ditur të jetë nëna-gruaja, aq më i edukuar bëhet fëmija, rrjedhimisht edhe shoqëria.

Dy perlat e muzikës shqiptare – Nexhmije Pagarusha dhe Hanife Sejfulla Reçani, sigurisht që janë emblema e emancipimit tonë kombëtar, por edhe treguesi më real i arritjeve të tyre në saje të talentit dhe përkushtimit ndaj këngës. Mund ta nënkuptojmë faktin se fama e tyre nuk ka qenë e izoluar nga përpjekjet dhe angazhimet e një rrethi më të gjerë profesionistësh e mbështetësish të talentit të tyre, të cilët kanë luajtur rol të rëndësishëm në ngritjen dhe afirmimin e tyre, por të gjitha këto do të binin në ujë nëse Nexhmije Pagarusha dhe Hanife Sejfulla Reçani nuk do i përkushtoheshin me zell mjeshtrisë së këndimit. Që të dyja krijuan identitetin e tyre vocal dhe interpretues, prandaj jo ratësisht këngët e tyre janë të pavdekshme. Ato edhe sot dëgjohe me ëndje

dhe ky është tregues më i mire i rezistimit të vlerave të mirëfillta muzikore ndaj kështjës dhe tallavasë.

Ndonëse që të dyja vijnë nga treva të ndryshme shqiptare, ato megjithatë sjellin mozaikun e koloritit të pasur të këngës shqipe dhe si të tilla ato mund të konsiderohen edhe si begati kulturore që mbajnë gjallë dhe frymëzojnë brezat e rinj në kultivimin e vlerave krijuese mbi tabanin e trashëgimisë sonë të pasur muzikore, siç janë dy perlat Nexhmije Pagarusha dhe Hanife Sejfulla Reçani.

## Rreze KRYEZIU - BREZNICA

*Fakulteti i Arteve – Dega e Artit Muzikor, Universiteti i Prishtinës*

# NEXHMIJE PAGARUSHA, NJË FENOMEN I PAPËRSËRITSHËM

**(Të dhëna biografike, origjina, arsimimi dhe performimi)**

Kultura muzikore në Kosovë ka evidentuar fuqinë e madhe transformuese të saj. Situatat e vështira politike, sociale e ekonomike nëpër të cilat kaloi Kosova padyshim prekën edhe atë si pasqyra më reale e tyre. Pikërisht, shqiptarët e Kosovës duhej të ndanin fatin me popujt e tjerë të shtetit të atëhershëm Jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore, nga viti 1945. Si pjesë integrale e këtij zhvillimi, u krijuan rrethana të reja ekonomike, politike, sociale dhe kulturore të cilat mundësuan zhvillimin e kulturës muzikore si një segment i rëndësishëm i jetës së përgjithshme kulturore. Para kësaj periudhe, nuk kishte institucione muzikore qofshin ato profesionale apo jo, nuk kishte artistë, kompozitorë, instrumentistë apo këngëtarë shqiptarë të cilëve u ishte krijuar hapësira të shfaqeshin publikisht. Artet në përgjithësi kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë impakt të jashtëzakonshëm edhe në vet shtet ndërtim, sidomos gjatë dhe pas luftës së fundit në Kosovë (1990) një luftë e cila bëri që për dhjetë vjet detyrimisht të braktiset jeta kulturore dhe edukativo - arsimore e shqiptarëve.

Në tërë këto faza, gratë performuese vokale e instrumentale kanë dhënë një kontribut të veçantë e me një rëndësi më të madhe është ajo e cila me plotë meritë e mori epitetin e bilbilit të Kosovës, Nexhmije Pagarusha. Të shkruash mbi jetën dhe aktivitetin performues të Nexhmije Pagarushës nuk mbetet brenda kornizave të të dhënave biografike të një artisteje. Me anë të saj ne mund të kuptojmë një periudhë të rënduar historike të një populli të shtypur midis Ballkanit,<sup>1</sup> për një grua e cila mundi paragjykimet, frymëzoi artistët pasardhës por më e rëndësishmja inicoi emancipimin e gruas shqiptëtare.

Në anën tjetër, ajo dhe potenciali i saj vokal i jashtëzakonshëm dëshmuar se kishim të bëjmë me një artiste shembull, frymëzim edhe për krijuesit e këngës shqipe në periudha të gjata kohore. Nexhmije Pagarusha funksionalizoi skenën muzikore shqiptare. Sot, vazhdon të mbetet fenomen i papërsëritshëm.

---

<sup>1</sup> Shaban Maxharraj dhe Elvira Berisha, *Nexhmije Pagarusha – Monografi* (Prishtinë: Integra, 2019), 13.

Kur flasim për një artiste grua, e kemi të pamundun t'i shmangemi problematikave me baza gjinore të cilat e rënduan dhe po vazhdojnë t'a rëndojnë atë edhe në kohën të cilët po jetojmë, dhe në këtë drejtim jo pak ndikuan edhe rrethanat sociale të popullit tonë. Por, megjithatë, nëse mbështetemi tek metoda komparative atëherë kuptojmë se “bërja e muzikës” performimi i grave në Evropën perëndimore deri në vitin 1850 kryesisht përqendrohej në shtëpi.<sup>2</sup> Në përgjithësi si një “arritje” e grave në muzikë, u konsiderua ajo në shekullin e 18-të kurse në shekullin e 19-të gradualisht rritej numri i zonjave të shkolluara. Në fakt, vetëm pas Luftës së Dytë Botërore përqindja e grave në profesionet si ai i muzikës filloi të rritet në të gjithë botën dhe gjithashtu në Kosovë (1950, 50.7%; 1960, 57.1%).<sup>3</sup>

Në Kosovë, një numër i vogël i grave ishin pjesë e aktiviteteve muzikore (pas vitit 1950) dhe atë në suaza të ansambleve amatore. Performuesja e parë ishte pikërisht Nexhmije Pagarusha. Më vonë, numri i grave në skenën muzikore vendore u rrit, por ato u prekën nga rrethanat politike dhe shoqërore, ku ishin të detyruara të heqin dorë nga arsimimi dhe aktivitetet e tyre muzikore. Sot, gratë në muzikë, në Kosovë janë udhëheqëse të institucioneve, të jetës koncertale, duke tejkaluar tabutë dhe vështirësitë që dikur kishin përjetuar.

Kosova e pasluftës si vend vazhdon të ketë shumë probleme bazuar në barazinë gjinore. Sidoqoftë, gratë në muzikë (njëra prej tyre edhe unë) sot gjenden në rrethana të përmirësuara në lidhje me angazhimin profesional dhe jetën e performancës muzikore. E për këtë padyshim që ndër meritat më të mëdha i ka pikërisht Pagarusha, përfaqësuese e udhërrëfyese e gruas shqiptare në muzikë.

Nexhmije Pagarusha është njëra nga asetet më të mëdha të cilin e posedon kultura shqipëtare. Këngëtare, aktore, soprano e soliste e këngëve popullore të stilizuara dhe atyre zbavitëse. Repertoari i saj ka përfshirë edhe një numër ariesh nga literatura operistike botërore interpretimi i të cilave e krahasoi atë me Sodefisti e Maria Callas.<sup>4</sup> Ishte një grua e cila përpos talentit, me vehte kishte guximin, lirinë të cilat do ta karakterizojnë atë tërë jetën.

Ajo u dallua si artististe, aktiviste e përformuese e më shumë se 150 këngëve e melodive.<sup>5</sup>

<sup>2</sup> Grup autorësh, “Woman in Music”, Oxford Music Online - Grove Music Online Dictionary ([http://www.oxfordmusiconline.com/public/page/Women\\_in\\_music](http://www.oxfordmusiconline.com/public/page/Women_in_music)). (Qasur, 20 Tetor, 2020).

<sup>3</sup> Grup autorësh, “Woman in Music”, Oxford Music Online - Grove Music Online Dictionary, ([http://www.oxfordmusiconline.com/public/page/Women\\_in\\_music](http://www.oxfordmusiconline.com/public/page/Women_in_music)). (Qasur, 20 Tetor, 2020).

<sup>4</sup> Shaban Maxharraj dhe Elvira Berisha, *Nexhmije Pagarusha – Monografi*, 51, 119.

<sup>5</sup> Engjëll Berisha, “Hartimi i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës”. (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2009-2012), fq. 38 – 39.

## Të dhëna biografike, origjina dhe arsimimi

E bija e mësuesit patriot Vejsel Pagarushës, Nexhmije Pagarusha ka lindur në fshatin Pagarushë të Malishevës (Republika e Kosovës) në Maj të vitit 1933.<sup>6</sup> Fëmijëria e saj nuk ishte aspak e lehtë. Humb nënën kur ishte në moshën tre vjeçare çka ndikoi shumë edhe në formimin e personalitetit të saj në të ardhmen.<sup>7</sup> Shkollimin fillor e përfundoi në mes të fshatit të saj dhe qytetit të Prizrenit. Me insistimin e madh të babit të saj krahas shkollimit të përgjithshëm, ajo filloi të ushtroj profesionin e këndimit edhe pse në rrethana provinciale. Shkollimin e mesëm do ta vazhdojë në Prishtinë, vend ku dhe konsiderohet t'i ketë dhuruar asaj formësimin artistik. Shkollimin profesional muzikore e ndoqi për tre vite në Beograd (shkollim për këndim profesional) por si rezultat i rrethanave jo të volitshme, ajo u detyrua t'i ndërpresë ato.

Vitet e rinisë së Pagarushës lidhen edhe me periudhën kur zhvillimi i kulturës muzikore në Kosovë morri një hov sa i përket themelimit të institucioneve edukativo-arsimore por edhe atyre performuese<sup>8</sup> pjesë e të cilave shumë shpejtë do të bëhej edhe ajo.

## Aktiviteti koncertal dhe teatral

Ishte mësuesja e saj e muzikës, Melihate Hasani e cila kishte spikatur në talentin e Nexhmijes. Me insistimin e saj, Pagarusha u bë pjesë e një regjistrimi në asokohe Radio Prishtina, anëtare e të cilës do të bëhej nga viti 1948. Është ky institucion i cili po “investonte” në krijimin e një artisteje shqiptare me karrierën më të ndritshme ndonjëherë.

Paraqitja e saj publike evidentohet të ketë qenë në vitin 1950 si soliste në bashkëpunim me një nga shoqëritë kulturore artistike të Kosovës “Ivo Lolla Ribar” dhe shumë shpejtë arriti në atë e cila konsiderohej mjaft sfiduese për artistët e kohës, Radio Beogradi (1951).<sup>9</sup> Kjo i dha epitetin e solistes së parë në kuadër të Radiove të ish Jugosllavisë. Paralelisht me ngritjen e saj në karrierën individuale, ajo mori epitetin e gruas e cila po hapte rrugë për gratë e tjera në shoqërinë kosovare e më gjërë. Kishte filluar t'i përcaktonte vetes edhe misionin sensibilizues e vetëdijesues të gruas performuese dhe jo vetëm.

<sup>6</sup> Shaban Maxharraj dhe Elvira Berisha, Nexhmije Pagarusha – *Monografi*, 33-39.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Engjëll Berisha, *Studime dhe vështrime mbi muzikën* (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2004), 28.

<sup>9</sup> Shaban Maxharraj dhe Elvira Berisha, Nexhmije Pagarusha – *Monografi*, 33-39.

E cilësuar si Yma Sumac e ish Jugosllavisë<sup>10</sup>, Nexhmije Pagarusha frymëzimin e merrte pikërisht nga ajo, edhe pse vazhdimisht e potencoi që një soprano si Sumac nuk do të lindte më. Megjithatë, ky epitete konsiderohet t'i ketë dhënë Pagarushës motiv e frymëzim edhe më të madh për të vazhduar karrierën e saj, jo të lehtë e e shoqëruar me paragjykime nga shoqëria e cila e rrethonte atë.

Moment i rëndësishëm për karrierën e saj do të jetë takimi me kompozitorin dhe themeluesin e shkollës kompozuese në Kosovë, Rexho Mullaj (1923-1982)<sup>11</sup>, më të cilin më vonë do të ndante jetën, do të krijonte familjen por edhe i cili pjesën më të bukur të krijimtarisë së tij (këngëve) ja dedikoi pikërisht asaj.

Nexhmije Pagarusha me zërin e saj të bukur, dhunti e natyrës, me impostim natyral e ambitus të gjërë me elemente koloraturë pa vibracione orientale, u duartrokit aq shumë herë për shkëlqimin e vërtetë të saj në skenë. Këndoi me një profesionalizëm të theksuar në të gjitha aktivitetet e muzikës në masnifestime e të gjitha festivalet jo vetëm në Kosovë e vende të tjera të ish Jugosllavisë por edhe në qendra të ndryshme europiane duke afirmuar me lartësi artistike e dinjitoze muzikën shqiptare popullore dhe atë origjinale.<sup>12</sup>

Repertori/programi i saj është shumë i gjerë e i larmishëm, nga këngët e popullarizuara shqiptare si *Ani mori nuse, Kur më del në derë, Mora testin, Po të pres tek dega e fikur, Kënga e Rexhës, Ti moj bukuroshe, Sa hije të paska shamija* e deri tek ariet nga opusi krijues operistik i kompozitorëve të mëdhenjë të periudhës së klasicizmit e romantizmit muzikor (Beethoven, Tchaikovsky, Pucinni etj.).<sup>13</sup> Debutimi i saj me arie nga opera "*Madame Butterfly*" nga mediati dhe kritikët e kohës u konsiderua si arritja më e madhe ndonjëherë në karrierën e Pagarushës.

Këngët të cilat lanë gjurmë të përhershme në karrierën e saj por edhe të cilat mbetën me rëndësi antologjike në kuadër të fondit të muzikës artistike në vend janë ato të kompozuar nga Rexho Mullaj. Janë ato këngë të cilat arriti t'i këndojë bukur e në lartësi të mëdha. Ishin këto këngë të stilizuara, këngë për zë, kor dhe orkestër si: *Lulëzoi fusha, lulëzoi mali, Zambaku i bardhë, Një lule*.<sup>14</sup>

Më e rëndësishmja mbetet *Baresha* me tekst nga Rifar Kukaj, këngë e cilësuar xhevahir, e pasuruar me koloratur duke e ruajtur gjithmonë elementin

<sup>10</sup> Po aty, 51.

<sup>11</sup> Engjëll Berisha, *Studime dhe vështrime për muzikën*, 224.

<sup>12</sup> Engjëll Berisha "Hartimi i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës", 38 – 39.

<sup>13</sup> Engjëll Berisha "Hartimi i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës", 38 – 39.

<sup>14</sup> Engjëll Berisha, *Studime dhe vështrime për muzikën*, 224-230.

folklorik të muzikës shqiptare. Kjo këngë me kërkesa aq të mëdha të teknikës vokale u sollë në mënyrë profesionale e me shumë emocion nga Pagarusha. Deri më sot, askush nuk arriti ta sjellë atë me aq origjinalitet sa vet ajo.

Zëri i Nexhmije Pagarushës ka krijuar dhe vazhdon të krijoj shumë reagime. Zëri i saj u konsiderua "magjepës", me një kontroll të jashtëzakonshëm. Shpesh Nexhmije Pagarusha u analizua edhe për dukjen e saj dhe kjo nuk i pëlqeu aspak. Sidoqoftë, brenda koncepteve dhe fjalorëve botëror që aktualisht kemi në dispozicion, fjalor mbi gratë të cilat i takojnë jetës publike, ato shpesh e gjejnë veten si objekt të vështrimit të vlerësimit dhe kritikës. Për këngëtarët kjo zhvillohet në sferën vizuale, si dhe në atë zanore. Por ishte shtrirja vokale, saktësia interpretuese dhe loja skenike të cilat në një kohë u vlerësuan shumë dhe i dhanë asaj vendin e merituar.

Karriera e saj prej artisteje nuk përfundon vetëm me këndimin. Kombinimi i zërit të saj, fizikut dhe aftësisë interpretuese në skenë zgjoi interesim të madh tek filmbërësit. Nexhmije Pagarusha arriti të njihej edhe si aktore e shkëlqyeshme. Kjo mund të evidentohet në filmat si: Tre vetë kapërcyen malin, Vallja e çmendur, E kafshoja terrin, Fluturimi i micakut etj.<sup>15</sup>

Koncertoi nga Shqipëria (koncertim të cilin e cilësoi si një nga momentet më të veçanta të jetës së saj, viti 1979 e ftuar nga Radio Televizioni Shqiptar), Bullgaria e deri në Berlin e pothuajse në të gjitha qendrat kulturore të Europës peremdimore. Në të gjitha reprezentoi një kulturë të një populli të harruar i cili me tërë pretendimet e kundërp pretendimet të cilat mund t'i ketë sot, e harroi Nexhmijen duke e lënë në mëshirën e fatit të saj, dhe për një periudhë jo shumë të shkurtër.

Fituese e të gjitha shpërblimeve të cilat ofroheshin aso kohe në vend e në kuadër të festivaleve të cilat realizoheshin në ish Jugosllavi. Primadonë e cila nuk kishte nevojë të sforcohej për të arritur notat e larta në saktësi maksimale. Muzikën e transmetonte ashtu siq e përjetonte, me emocione të thella.

Pagarusha asnjëherë nuk arriti të ndihej e vlerësuar ashtu siq e meritonte. Nexhmije Pagarushës nuk i ishte regjistruas as edhe një CD e cila do të dokumentonte një aritste të madhe, të pakrahasueshme, për pasardhësit e saj. Tek në moshën 80 vjeçare dhe atë pa mbështetje institucionale një CD u realizua. Ajo deri në vitet e fundit e jetës së saj, aq sa u ndje e dashtun poaq edhe e refuzuar nga njerëzit e saj. Jeta, Kosova i ka dhënë asaj goditje të shumta, të pamerituara. Të imagjinosh një artiste të këtyre përmasave do të përfundonte

<sup>15</sup> Engjëll Berisha "Hartimi i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës". (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2009-2012), fq. 38 – 39.

pothuajse në varfëri të plotë, jo vetëm në aspektin financiar por edhe atë shpirtëror. Megjithatë, shkëlqimin e ditëve të saj më të mira nuk do të mund ta zbeh askush, as historia, as paragjykimet e as ato pak iniciativa të cilat temë kryesore kanë trajtimin e jetës dhe aktivitetit të saj. Aktiviteti i Nexhmije Pagarushës është njëri nga dëshmuarit e denjë i një periudhe jashtzakonisht produktive në vend. Sot, rikthimi në kujtesë e i vazhdueshëm i saj do të mundësojë jo vetëm studimin e mëtutjeshëm dhe evidentimin e një artisteje të madhe por edhe përcaktimin e rolit dhe rëndësisë në raport me kulturën e përgjithshme në vend. Padyshim, mund të kemi edhe interpretime të ndryshme, por për dokumentime të tilla asnjëherë nuk është vonë.

Karriera e Nexhmije Pagarushës na evidenton një artiste të madhe, një artiste të kompletuar e të papërsëritshme. Detyrë për ne është të kremtojmë aftësinë dhe zgjuarsinë e saj dhe tërë atyre të cilët kontribuan e sakrifikuan shumë për të ruajtur indentitetin kulturor. Në këtë rast, të kremtojmë mbi jetën dhe veprën e njërit nga asetet më të mëdha të kulturës sonë, znj. Nexhmije Pagarusha. Nexhmije Pagarusha mbetet primadonë e muzikës popullore dhe asaj zbavitëse.

### **Literatura e shfrytëzuar**

Berisha, Engjëll. *Kultura muzikore*. Prishtinë: Libri shkollor. 1998.

Berisha, Engjëll. *Studime dhe vështrime për muzikën*. Prishtinë: Academy of Science and Arts of Kosova. 2004.

Berisha, Engjëll. *Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Kosovës. 1997.

Berisha, Elvira dhe Maxharraj, Shaban. *Monografi - Nexhmije Pagarusha*. Prishtinë: Integra. 2019

Shupo, Sokol. *Art Music in the Balkans*. Tirana: ASMUS. 2001

Shupo, Sokol. *Biographical Dictionary of Balkan Composers*.-Tirana: ASMUS. 2005.

### **Burime nga interneti**

Grup autorësh, "Woman in Music", Oxford Music Online - Grove Music Online Dictionary. [http://www.oxfordmusiconline.com/public/page/Women\\_in\\_music](http://www.oxfordmusiconline.com/public/page/Women_in_music). (qasur, 20 Tetor, 2020).

**Agim POSHKA**

*Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë*

## **HANIFE SEJFULLA REÇANI, MESAZHI EMANCIPUES I ZONJËS NGA GOSTIVARI**

### **Jetëshkrimi artistik:**

Origjina e familjes të znj. Hanife Sejfulla Reçanit është nga Kukësi, një origjinë lumjane që ajo e kujtonte me shumë krenari nëpër intervista. Babai, xhaxhai dhe motra luanin në çifteli dhe dajre dhe këndonin bashkë e gati çdo mbrëmje si një mini-orkestrinë muzikore.

Megjithatë znj.Reçani është rritur dhe shkolluar në Gostivar dhe fillimet e saj muzikore i ka në programet shkollore të zonës së Pollogut. Në një intervistë dhënë për Radio Shkupin ajo do të thoshte: “Kur mendova se me martesë talenti do shfryhet si një fluskë sapuni, vlerën morale ma dha burri”. Paralelisht me mbështetjen familjare, një mbështetje i vjen në atë kohë edhe nga z.Lorenc Antoni që gjykoj se talenti i zonjës Reçani duhet të evidentohet në radio njësoj si talenti i zonjës Nexhmie Pagarusha dhe znj.Shahindere Bërlajolli që sapo kishin filluar karrierën muzikore.

Në momentet kur zonja Hanife hezitonte të shkojë në Prishtinë për të bërë regjistrimin e parë edhe se ai ishte i garantuar nga z.Lorenc Antoni zonja Reçani kujton mbështetjen e burrit të saj z.Feim Reçani duke i thënë: “Oj lumjane, populli ynë shkon përpara e ti do të shkosh prapa”. Këto fjalë bindëse i dhanë shumë zemër zonjës së re 20 vjeçare nga Gostivari t'i rikthehet këngës me gjithë qenien e saj.

Në një intervistë të dhënë Radio Shkupit në vitet 80 përballë gazetares Kujtime Kica, znj.Reçani kujton që:“.. kënga mua sikur më ushqente, se e kishim në gjen,, si e vogël kujtoj me mirënjohje z.Xhemal Pozharanin dhe Talat Afçen e më vonë edhe zotit Mehmedali Hoxhan si disa nga mbështësit kryesorë për mua dhe znj.Hidajete Vishka të prezantohem në programet për filloristë në atë kohë.

Ndryshimin dramatik për Hanife Sejfulla Reçanin e bën kompozitori shkupjan Lorenc Antoni, një figurë shumë e rëndësishme për kulturën shqiptare të asaj periudhe.

Kjo ishte një përmbledhje e shkurtër për jetëshkrimin e znj.Reçani e mundësuar edhe nga arkivi i radio Shkupit dhe intervistat e znj.Kujtime Kica dhe znj.Zuhra Sabedini.

Në vazhdim po prezantojmë një analizë për disa tipare muzikore që dallojnë znj. Reçani në karrierën e saj të gjatë muzikore me rreth 150 këngë në 50 vite.

## Gjuha dhe interpretimi

Gjuha e përdorur në këngët por edhe në intervistat ka një tendencë të vazhdueshme për t'iu afruar gjuhës standarde të asaj kohe. Natyrisht ka disa turqizma që janë të natyrshme në zonën e Gostivarit dhe Tetovës por edhe tipike për muzikën lirike të Shqipërisë së mesme të zonës së Elbansanit nëpërmjet krijimeve të Jusuf Myzyrit që ishin frymëzim për të gjithë krijuesit e asaj kohe, por edhe zonave tjera të muzikës së Shqipërisë së mesme si zona e Tiranës ku bashkëkohëse të zonjës Reçani janë znj.Hafsa Zyberi dhe znj.Fitnete Rexha.

Diksioni dhe shqiptimi i fjalëve në këngët e zonjes Reçani janë për tu adhuruar. Për ata që janë marrë me këndim besoj e din që teknologjia sot të krijoj mundësinë që të mundesh të editosh ose permirëesosh çdo detaj dhe cdo frymemarje te kenga e regjistruar në formë digjitale. Por në kohën e Hanife Sejfullai Recanit dhe Nexhmie Pagarushes kënga shkonte prej fillimi deri në fund pa patur mundësi përmirësimi dhe kërkonte qe çdo notë dhe frazë të jetë e saktë, dhe nese analizoni interpretimet e zonjes Recani ato kanë shqiptim dhe diksion të qartë dhe kuptohen deri në detaj të gjitha frazat dhe shprehjet.

Në muzikën e sotshme shpeshherë shohim një ngatërrim të tingujve fonetik “Q” dhe “Ç” ose “Gj” dhe “Xh”. Për fat të mirë te zonja Recani te kenga “Hanem, Hanem” fjala penxhere kujtohet 12 here dhe asnjehere nuk eshte shqiptuar gabimisht. Poashtu janë prezente fjalë të pazakonshme si “niqaja”, “gjerjgefi”, “jabanxhi” e disa të tjera që kanë realizim fonetik shumë të saktë. Kjo performancë e shkëlqyer tregon edhe për një nivel intelektual të znj.Reçani dhe bashkëpunëtorëve të saj në rrafshin e gjuhës shqipe. Nga arkivi i këngëve të Radio Shkupit dhe atyre që janë në youtube, mund të konkludojmë që zonja Hanife Sejfulla Reçani mund të ju mbaj lirisht leksione për shqiptim dhe diksion këtij brezit të ri të muzikanteve që janë popullor sot. Kjo është sepse muzika nuk është vetem teknike këndimi, por edhe emocion i bazuar në vlera

kulturore por edhe intelektuale dhe të njohësh mirë gjuhën tënde përpara se të flasësh ose të këndosh në publik është privilegj por edhe përgjegjësi intelektuale që dukshem nuk i mungonte znj.Reçani. Kjo ndjehet edhe në intervistat e regjistruara në Radio Shkup ku gjuha është e rrjedhshme dhe e pasur me mbiemra por edhe metafora.

## Vokali dhe trajtimi i këngës

Nëse analizojmë të dhënat vokale të znj.Reçani mund të konstatojmë që ajo është bartëse dinjitoze e këngës dhe vlerave të shqiptarëve në Maqedoni që pastaj edhe më shumë u forcua me hapjen e Radio Prishtinës, Tv Prishtinës, Radio Shkupit dhe më vonë edhe Tv Shkupit. Edhe pse nuk kishte studiuar për solo këndim dhe në një farë mënyre ishte autoditakte që ka nisur këngën në moshën 12 vjeçare, në interpretimin e zonjës Reçani shohim që përveç vijave standarde muzikore të kompozimit kemi edhe mjaft vokaliza ose lule, dëgjojmë vibrato të përdorura në momente kyçe të këngës. Poashtu në disa raste kemi edhe forma glisando që nuk janë tipike për këngët e kësaj zone por janë mjaft mirë të përshtatura. Edhe se zëri ka nota të ngrohta muzikore me tone të urta mallëngjimi dhe nostalgjie në interpretim, nga analiza e shumicës të këngëve të znj.Reçani shohim që ka elemente të një rubato nostalgjike që realisht nuk është përdorur aspak edhe se kishte potencialet e duhura. Jane keto teknika zëri që në literaturën botërore njihen shumë mire por në muziken tone popullore fatkeqësisht as nuk emërtohen si teknika por përdoren me shumë mjeshtëri edhe ngjallin mjaftë emocione. Këto teknika nuk kanë munguar as në vokalin autentik të znj.Reçani.

## Temat e trajtuar në këngë

Temat e trajtuara në këngët e zonjës Reçani janë kryesisht lirike e në momente edhe me nota mërgimi por emancipuese mbi të gjitha. Figura e femrës në këngët që janë interpretuar nga zonja Reçani i japin dinjitet figurës së vajzës, gruas dhe nënës. Këtu kemi edhe tekste për vendlindjen si "Po shkon vajza përreth Vardarit" ose "'Prej Tetove në Gostivar", "Fusha e Korabit" që hapur përshkruajnë dashurinë ndaj trojeve shqiptare në Maqedoni.

Ndër këngët që lidhin lirikën shqiptare të kësaj zone me mërgimin janë krijime si kënga "Pse më je idhnu?", megjithatë është një element i ri në këtë ekuacion që bashkon lirikën, mërgimin dhe dashurinë ndaj prindërve, dhe kjo

është edhe kënga më e njohur e quajtur “Bien Tri Dahire”. Një këngë lirike që në thelb është e mbushur me nota të errëta nostalgjie. Rrallë në kështu lloj kryevepra kemi të paraqitura në formë tekstuale këshillat konkrete të nënës për bijën kur do rikthehet në shtëpi pas ditës së martësës. Ky është një kompozim shumë i rrallë ku në këngë komunikojnë nëna dhe bija. Megjithatë, ky bashkëbisedim në vend që të reflektojë afërsi tregon me mjeshtëri një distancë të re që duhet të jetë midis këtyre dy personazheve i cili është i bazuar në traditë dhe doke. Disa nga vargjet më trishtuese janë:

“Kur të shkosh te burri moj bijë, tre ditë do rrish në këmbë edhe cullve (fëmijëve) do ju bësh temena” , por tabloja bëhet edhe më dramatike kur ligjerohet se “Kur të vish në shtëpi te nëna moj bijë, tani më do jesh mikeshë dhe kur do të hahet buk moj bijë te magjja nuk do mund të vesh dhe kur të pihet ujë moj bijë shtamën sun e prek”. Janë këto fjalë të vështira që një nënë ia thot vajzës, por njëkohësisht janë këto këshilla të një kohë kur të flasësh për të drejtat e gruas ka qenë një anomali. Përfshirja e këtyre temave nuk ka qenë një tabu për zonjën Reçani. Me mbështetjen e familjes dhe këtu mbi të gjitha kujtojmë bashkëshortin z.Feim, znj. Hanife Sejfulla Reçani gjatë gjithë jetës së saj dha mesazhe emancipimi për gruan shqiptare duke qenë ndër të rrallat gra që interpretonte në skenë por edhe në ahengjet familjare pa pikë hezitimi. Ajo nuk ishte vetëm Nexhmie Pagarusha e zonës tonë por ishte zonja e emancipimit për të gjithë ata që skenën e kishin një ëndërr por nuk e arritën kurrë. Ajo ishte zëri i shumë dashurive dhe pasioneve që kurrë nuk u realizuan për shkak të mendësive të prapambetura.

## Përmyllje

Nëse e analizojmë nga perspektiva e sotshme në kuptimin se çfarë do ishte një krijimtari ideale që do vinte në pah vlerat vokale të znj. Hanife Sejfulla Reçani, natyrisht që do kisha dashur të anashkalonim introduksionet e shpejta dhe shumë herë vetëm teknike në fillim të këngëve pas të cilave znj,Reçani do duhej të fillonte t'i japë këngës emocion. Pra vështirësitë me orkestrimet e asaj kohe shpesh nuk i jepnin vlerë këngës ose vokalit. Në shumicën e këngëve mungon një rubato në introduktet që do i jepte një natyrë më lirike e melankolike këngëve. Nëse do riorkestrroheshin këto këngë ato do mundeshin lirisht të konkurojnë edhe në tregun muzikor sot duke pasur parasysh që vokali kishte gjërësinë dhe ngrohtësinë e duhur të znj. Reçani.

Ky shkrim kishte për qëllim për të kujtuar një zonjë të cilën unë nuk e takova kurrë por kjo nuk është rëndësishme. E rëndësishme që atë edhe sot e njohim të gjithë në bazë të trashëgimisë muzikore që zonja Hanife Sejfulla Reçani ka lënë për neve. Ajo ishte shpeshherë zonja e vetme muzikante por interpretimi i saj jepte shumë vlerë shoqërisë, i jepte shenja emancipimi gruas nga Struga deri në Kumanovë në një kohë kur burrëria ishte virtyt krenarie boshe por edhe arsye për prapambeturi.

Roli i njeriut në shoqëri nuk është vetëm të mbijetojë, por edhe ta bëjë të ardhmen më të mirë për fëmijët e tij, ta bëjë edhe më të mirë shoqërinë ku ato fëmijë do jetojnë.

Znj. Hanife Sejfulla Reçani luajti guximshëm rolin e saj në këtë emancipim duke thyer tabutë që një grua mund të pushtojë skenën njësoj si edhe një burrë. Ku një grua mundet të shpreh gëzim dhe hidhërim nëpërmjet zërit të saj në këngë dhe të adhurohet pastër për artin e saj.

Sot, skena është plot me vajza dhe zonja dhe ky nuk është lajm i jashtëzakonshëm por një normalitet, megjithatë mos të m'harrojmë që ky normalitet është bërë i mundur nga zonja të nderuara emancipuese dhe të guximshme, dhe znj. Hanife Sejfulla Recani nga Gostovari i prin këtij emancipimi.

**Bekim RAMADANI**

*Universiteti "Fadil Sulejmani" - Tetovë*

## **HANIFE SEJFULLA REÇANI, ZONJA E MADHE E KËNGËS POPULLORE**

Bukuria e të jetuarit qëndron në të qenit vetja, në mosparashtrimin e kërkesave të tepruara, në komunikimin e përzemërt, në pranimin e ligjeve natyrore si prejardhje të fuqisë hyjnore, andaj njerëzit e mëdhenj janë të tillë sepse janë të zgjuar, sepse njohuritë e tyre bazohen në libra, në përvoja të pasura jetësore, dhe si rrjedhojë ata transmetojnë vepra, ide e thënie të rëndësishme. Ata janë të afërt, të përsjirtshëm, të sinqertë, ata janë njerëzorë. Tërë potencialin intelektual dhe shpirtëror ia dedikojnë njerëzimit dhe jo vetes, e as njeriut. A nuk ka qenë e tillë edhe artistja Hanife Sejfulla Reçani?! A nuk ka qenë ajo zonjë shtëpie me zemër bujare, nënë tipike shqiptare, grua e matur, e kulturuar, e sinqertë?! A nuk ka qenë ajo këngëtare e denjë?! Po, pra ka qenë e tillë sepse ka mbajtur qëndrim aktiv dhe mjaft serioz ndaj muzikës. Sjellja e saj në skenë ka qenë profesionale andaj ka shërbyer si model për interpretuesit që erdhën më vonë. Ajo ka qenë njeri artist, e kalitur nga jeta e vështirë, me plot të papritura. Dallgët e jetës kanë qenë të tmerrshme edhe për familjen e saj e cila, për shkak të tipareve të larta morale është dashur të ballafaqohet me kurthet e papritura të kohës. Fati i familjes së saj mund të krahasohet me këngën e Halil Gashit që vrau Beqir agën për të ruajtur nderin e motrës Hajri.

Diku nga mesi i viteve të tridhjeta të shekullit XX gjyshi i Hanifes, pra Ismail Keça nga Shkinaku (Grykë – Çajë) i Lumës, gjatë një zënke me disa ushtarakë serbë që shërbenin atë kohë në Shqipëri, bën vrasje të shumëfishtë duke mbrojtur në këtë mënyrë nderin e familjes së vet. Pas këtij akti detyrohet të fshihet andej e këtej, derisa vendos që, pas ca vitesh, të merr rrugën e mërgimit. Përmes ca lidhjesh tregtare ai me familjen e tij arrin që përmes Kosovës të futet në Serbi dhe të udhëtojë në drejtim të botës perëndimore. Mirëpo diku nga Pomoravja kupton për fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe për një kohë deri sa pret vendimin për hapat e mëtutjeshëm, në qytezën Svilajnac i lind mbesa Hanife. Në këto rrethana së bashku me djemtë e tij Sahitin dhe

Malën vendosin që të kthehen sërish në drejtim të jugut duke arritur kështu në Gostivar ku fillojnë jetën e re.<sup>16</sup>

Gjatë përpjekjeve të familjes së saj për të gjetur një vendbanim më të sigurt për jetë, Hanife Keça së bashku me prindërit kishte shkelur maje bjeshkësh e lartësi të shumta të relievit ballkanik, por kurrë nuk i kishte shkuar ndërmend se ndonjëherë do të shkelë edhe majat e larta të artit muzikor. E tillë është jeta. Piktori i madh italian Leonardo Da Vinçi thoshte: “Ndërsa po mendoja se kisha mësuar si të jetoj, unë kisha mësuar si të vdes”. (Thënie për vdekjen (85 thënie), a.d.) Dhe sintaksa e kësaj thënieje mund të rregullohet edhe ndryshe: “Sa më shumë që mësojmë për vdekjen, aq më tepër mund ta jetojmë jetën”. Dhe kjo do të thotë që të bësh një hap para të tjerëve: ta shikosh me një dioptri më të madhe kodrën, hënën, ylberin, yjet... të përpiqesh për të kryer me sukses vokacionin, profesionin, misionin. A nuk ishte e tillë zonja Hanife Sejfulla Reçani e cila që në fëmijërinë e hershme kishte filluar ta ndërtojë rrugën e suksesit. Në gjakun e saj ndihej aroma e traditës muzikore të familjarëve të saj që gjatë mbrëmjeve tuboheshin nëpër odat e ngrohta përplot gjallëri duke bashkëbiseduar, duke kënduar, duke luajtur lojëra popullore, nga më të ndryshmet.

Gjyshi, Ismaili që mjeshtër për lojë me çifteli, babai Sahiti gjithashtu luante në çifteli, ndërsa xhaxhai në lahutë. Motrat e saj, Fatimja e Xhemilja, si dhe vajzat e xhaxhait Lemja dhe Sevdija, kishin zë bilbili dhe i binin dajres. Vëllezërit Bajrami, Halimi<sup>17</sup>, bashkë me djalin e xhaxhait Hakikun këndonin gjatë përcjelljes së gjyshit me çifteli. Talenti i motrave nuk mundi të promohej më, shkakun se u martuan nëpër ambiente ku nuk kultivohej kënga. Hanifja u martua në moshë fare të re,<sup>18</sup> diku si 17 vjeçare, për profesorin e nderuar të gjimnazit të Gostivarit, Feim Sejfullai-Reçani,<sup>19</sup> të cilin e pat përkrahësin më të madh gjatë gjithë jetës. Talenti i saj u zbulua herët, si nxënëse e klasës së dytë apo të tretë, gjatë manifestimit të këngëve dhe valleve të pionierëve në podiumin e vendosur në rrafshin e Leunovës dhe Niqvirovës, komuna e Mavrovës. Si 12 vjeçare, bashkë me shoqen e saj nga Gostivari Hidajete Vishka, të cilat u veçuan nga mësuesi i tyre i parë, i ndjeri Xhemail

<sup>16</sup> Këto të dhëna më kanë mbetur në kujtesë nga bashkëbisedimi me profesorin Ismail Hoxha gjatë majit të vitit 1998 në Fakultetin e Muzikës në Tetovë.

<sup>17</sup> Halim Keça (17.6.1937 - 19.6.2019) ka qenë po ashtu një këngëtar që ka realizuar goxha incizime në Radio Shkupi gjatë viteve të gjashtëdhjeta të shek. XX. (Keça, 2012) (Keça, Këngë për Halil Gashin, 2019) (Keça, Hipi hoxha ne minare, 2019) (Keça, Valle e Gostivarit me çifteli, 2019)

<sup>18</sup> Në datën 5 korrik 1956.

<sup>19</sup> Fehim Sejfullai - Reçani (15.4.1930, Reçan - 16.8.2017, Gostivar), ka qenë mësimsdhënës i lëndëve: 1. Gjuhë shqipe dh letërsi 2. Latinisht.

Pollozhani, së bashku edhe me mësuesen dibrane Lamika Bollçishta Kërliu, morën pjesë në organizime të ndryshme në Mavrovë, ku Hanifja hodhi hapat e parë si këngëtare. Përveç kësaj, Hanife Sejfulla Reçani dallohej si një vajzë shembullore dhe e shkëlqyer në mësim, gjë e cila i ndihmoi të krijonte portretin e saj si artiste, qysh në moshë fare të vogël. (Kolari, 2018).

Pastaj edhe gjatë kohës sa ka ndjekur gjimnazin e ulët ajo ka qenë aktive në jetën kulturore falë kontributit të mësimdhënësve Hadi Imami nga Struga, pastaj të Muzafer Avçes me të motrat Myeserin dhe Nezafetin, kurse një rol të madh në formësimin e saj ka pasur edhe mësimdhënësi i muzikës Shaban Stafaj me të cilin ka pasur një bashkëpunim të gjatë dhe shumë frytdhënës.

Zëri i hollë dhe melodik i Hanifes së njomë përherë e ka shoqëruar zërin e bilbilave të Pollogut piktoresk (Fejzullai, 2001, f. 59), por në fillimvitet e gjashtëdhjeta ajo kishte arritur ta formësojë dhe ta kultivojë teknikën e këndimit si dhe individualitetin e saj solistik me një ngjyrë shumë të veçantë muzikore. Tashmë, “interpretimi i saj ishte karakteristik dhe ngërthente në vete një notë të natyrshme melankolizmi”<sup>20</sup> (Fejzullai, 2001, f. 30)

Ishte kjo një periudhë kur letrat radhiteshin në dobi të saj, një periudhë kur Lorenc Antoni<sup>21</sup> duke vjelë materiale etnomuzikore nëpër zona të ndryshme të shqiptarëve të Maqedonisë, kishte arritur në Gostivar dhe me rekomandim të disa miqve kishte trokitur në derën e zotit Feim Sejfullai. Ky takim duhet të ketë qenë vendimtar për rrugëtimin e mëtejshëm muzikor të zonjës Hanife e cila përkundër dilemës së vështirë<sup>22</sup>, sërish i ishte nënshtruar autoritetit të padiskutueshëm të Lorenc Antonit dhe gjykimit plot urtësi të bashkëshortit të saj i cili i ishte drejtuar me këto fjalë: “Krijimtaria folklorike e të gjithë kohërave dëshmon qartë se fytyrat historike me përmasa madhore vërshojnë me forcë të jashtëzakonshme në ndërgjegjen krijuese të një kombi e bëhen në një periudhë të caktuar fokus nga ku arti merr një ndriçim të veçantë dhe shënon shkallë të reja zhvillimi... Në këtë stil e me këtë rrjedhë, jo të imponuar, duke qenë sintezë artistike e rrethanave historike ti do të krijosh repertorin e këngëve tua, që me përmbajtjen e tyre do të lënë vrugë të thella nostalgjie në

<sup>20</sup> Shkrim gazetaresk i Jusuf Gërvallës në gazetën “Flaka e vëllazërimit” me titull “Prezantim impresiv i mysafirëve gostivaras” me rastin e koncertit të ShKA “Besa” në sallën e kinemasë APJ në Prishtinë.

<sup>21</sup> Lorenc Antoni (23.9.1909, Shkup – 21.10.1991, Prishtinë) ka qenë kompozitor, dirigjent dhe etnomuzikolog i shquar.

<sup>22</sup> Në këtë kohë kishte dy fëmijë të vegjël: Teutën (9.6.1957) dhe Ilirin (14.9.1959). Djalin e tretë, Arbenin, e ka lindur në datën 8.6.1969.

zemrat e bashkëkombësve duke mbetur dëshmi e thellë e autobiografisë dhe traditës së popullit nëpër gjenerata...” (L. Turkeshi dhe K. Kica, fv. 27-28)

Shumë shpejt fillon bashkëpunimin me orkestrën e Radio Prishtinës në krye të së cilës ishte violinisti i shquar Isak Muçolli<sup>23</sup>, pastaj me këngëtarët: Nexhmije Pagarusha, Nafise Smajku, Liljana Çavolli, Nazmije Hoxha etj., duke arritur drejt majave të suksesit. Në vitin 1970 shpallet këngëtarja më e mirë e vitit në Radio-Prishtinë, kurse viteve në vijim ajo bëhet tepër e famshme në një shtrirje më të madhe gjeografike.

Përmes Talat Afçes dhe Ismail Hoxhës<sup>24</sup>, Hanife Sejfulla Reçani ka depërtuar edhe në studion e Radio Shkupit ku ka incizuar këngët “Për midis pazarit Durrësit” dhe “Cucë lumjane”, dhe jo vetëm kaq. Ajo është njohur aty edhe me ngjyrën tingullore të sazeve, të një formacioni me ngjyrë tipike orientale që për vite me radhë ka shoqëruar këngëtarët shqiptarë, dhe jo vetëm.

Në gjeneratën e artë të këngëtareve nga Maqedonia ku përveç zonjës Hanife merrnin pjesë edhe Gonxhe Manaku, Mirvete Bellova, Violeta Turkeshi, Shahindere Bërlajolli, Fikrije Vejseli, Ajshe Rrushiti, Fatbardha Ago, Qerimane Imami, Sanije Muhidini, pastaj Mirdita Hani-Doko, Lirije Sherifi, Bukurije Munishi, Xhemile Jashari, Gëzime Hajrullahu etj., mbretëronte një optimizëm revolucionar. Të gjitha ishin dhënë pas këngëve popullore sikur blea që thith nektarin e luleve. Qëllimi i tyre ishte tepër fisnik, andaj kjo është arsyeja pse karriera e tyre është ndërtuar pa asnjë njollë. Të gjitha ishin të edukuara në frymën e bashkëpunimit, të kolektivizmit, të organizimit institucional, të interesit të përgjithshëm. E tillë ishte edhe Hanife Sejfulla Reçani që dha kontribut të çmuar në themelimin e ShKA “Besa” në vitin 1971.

Repertori i saj, përveç muzikës folklorike përfshin edhe këngë të traditës së vjetër dhe të re qytetare të cilat i ka promovuar me sukses dhe i ka ngritur në një nivel shumë të lartë përmes incizimesh nëpër radio e televizione lokale, regjionale e nacionale, përmes koncertesh, turnesh e festivalesh kombëtare e ndërkombëtare. Kudo që është shfaqur është shpërblyer me duartrokitje frenetike. Publiku i saj ka qenë i përbërë nga njerëz të të gjitha moshave.

<sup>23</sup> Isak Muçolli (20.5.1940, Bajçinë, Podujevë – 18.11.2015, Prishtinë) ka qenë violinist në orkestrën simfonike të RTP-së dhe anëtar i Filarmonisë dhe Operës së Kosovës. Ai është dëshmuar edhe si kompozitor dhe përpunues i qindra këngëve popullore.

<sup>24</sup> Ismail Hoxha (25.7.1934, Ladorisht, Strugë – 2.9.1999, Shkup) ka qenë pedagog dhe kompozitor. Ka qenë nismëtar i themelimit të disa institucioneve të rëndësishme kulturore. Një kohë ka punuar edhe si redaktor i programit muzikor në Radio-Shkupi, kurse një kohë edhe si mësimpldhënës në Fakultetin e Muzikës në UT.

Ka marrë çmime, shpërblime, mirënjohje dhe dedikime të shumta në shenjë nderimi për punën e frytshme në fushën e muzikës popullore. Në datën 29 qershor 2016, në Akademinë Solemne për shënimin e Ditës së Komunës së Gostivarit, Hanife Sejfulla Reçani është shpallur qytetare nderi e Komunës së Gostivarit, kurse në datën 21 nëntor 2016 ajo është dekoruar me Medaljen Presidenciale të Meritave nga ana e kryetarit të Kosovës.

Zonja e madhe e muzikës sonë të vjetër qytetare, e cila përmes sopranos lirike ishte në gjendje të ngjallë edhe gëzimin edhe pasionin, edhe pikëllimin edhe trishtimin, tërë jetën ia kushtoi këngës. “Në maj të viti 1975 kishte dhënë një intervistë për gazetën “Flaka e vëllazërimit” tek kishte thënë se nuk ka këngë popullore që nuk e di. (Maxharraj, 2017) “Hanife Sejfulla Reçani nuk ishte vetëm kënga, por më shumë se kaq. Ishte një institucion, ishte zëri i shpresës së njerëzve që kur ndjeheshin të rraskapitur nga sistemet, të dërmuar nga varfëria e skamja, arratiseshin diku me këngën e saj magjike dhe ajo i kthente në jetë për të vazhduar përmes këngës së saj.” (Salihu, 2017) Këndoi me zemër të pastër, me shpirt të pasur, andaj ishte dhe mbeti, hiç më pak se një Artiste e Madhe.

Zëri i saj i ka mbushur me gëzim, me prehje shpirtërore adhuruesit e këngës shqipe, sepse interpretimi i saj ishte original, i bukur, i veçantë, ishte në harmoni me melosin burimor. Zëri i saj do të mbetet i përjetshëm në kujtesën e dëgjuesve të cilët ditën e fillonin me valët e Radio Prishtinës dhe të Radio Shkupit, do të mbetet i pashlyeshëm në jetën e gjeneratave që u rritën dhe që jetuan me jehonën e këngëve të saja. Hanife Sejfulla Reçani do të mbetet ikonë e muzikës së pastër shqiptare në tërë dimensionin jetësor, e paharrueshme me këngët: “Piku molla kuqe”<sup>25</sup>, “Dil aty ku dole mbram”<sup>26</sup>, “Bien tri daire moj nanë”<sup>27</sup>, “Çorapët me vija”<sup>28</sup>, “Shkova n’krrue me mbush’ uje”<sup>29</sup>, “Oj shamia e zezë”<sup>30</sup>, “Kur do t’shkojsh termah moj cuco”<sup>31</sup>, “Me gëzim po shkoj në punë”<sup>32</sup>, “Këndojnë dy bilbilat, o, sabah në sabah”<sup>33</sup>, “Moj fusha e Korabit”<sup>34</sup>, “Fesi i çikës plot gylpana”<sup>35</sup>, “Qe ku vin moj nan’ ushtria e

<sup>25</sup> (Reçani H. S., Piku molla e kuqe, 2010)

<sup>26</sup> (Reçani H. S., Dil aty ku dole mbram, 2010)

<sup>27</sup> (Reçani H. S., 2015)

<sup>28</sup> (Reçani H. S., 2011)

<sup>29</sup> (Reçani H. S., Shkova n'krrue me mush uje, 2018)

<sup>30</sup> (Reçani H. S., Oj shamia e zeze, 2018)

<sup>31</sup> (Reçani H. S., Kur do t'shkojsh termah, 2018)

<sup>32</sup> (Reçani, 2018)

<sup>33</sup> (Reçani H. S., Këndojnë bylbylat, 2018)

<sup>34</sup> (Reçani H. S., Moj fusha e Korabit, 2018)

mbretit”<sup>36</sup>, “Karajfil në kashte”<sup>37</sup>, “Çou moj Mahmudi”<sup>38</sup>, “Ani po shkon vasha rreth Vardarit”<sup>39</sup>, “Kënga e Hasimes”<sup>40</sup>, “Hanëm, hanëm”<sup>41</sup>, “Kur dola te porta”<sup>42</sup> etj.<sup>43</sup>

Meloditë e këngëve të saja janë të paharruara, përplot lirikë, me variacione ritmike dhe harmonike, këngë të pasura në kuptimin e tempit dhe të dinamikës, këngë me modulime, këngë që kjo entuziaste i ka kultivuar për ta dëshmuar afërsinë me kohën kur ato janë krijuar, pra, me të kaluarën, me adetet, me zakonet, me traditën e pasur dhe të larmishme të paraardhësve të saj. Në këngët e saj nuk ka shtrembërime dhe nuanca të huaja, andaj me plot të drejtë themi se ato e meritojnë vëmendjen edhe të publikut të zgjuar edhe të studiuesit të mirëfilltë të folklorit muzikor.

Hanife Sejfulla Reçani ishte këngëtare me intonacion të pastër, me diksion të saktë, me ndjeshmëri të theksuar në vargun melo-poetik. (Ramadani, 2017)

Hanife Sejfulla Reçani arriti që, mes tjerash, t’i thyejë edhe tabutë duke bërë hapa të rëndësishëm në emancipimin e femrës shqiptare e cila vuante nga paragjykimet e shoqërisë dhe të ambientit rrethues. Ajo me sjelljen e guximshme dhe të vendosur hapëroi përtej kohës, bëri revolucionin kulturor duke i dhënë jetës publike më tepër laramani dhe seriozitet, më tepër ndjeshmëri dhe kualitet. Ajo e bëri këtë sepse ishte grua punëtore, me zemër fisnike dhe me mendje artisteje. E ka dashur familjen<sup>44</sup>, vendlindjen, i ka dashur miqtë, por mbi të gjitha e ka dashur muzikën. Secilës këngë të kënduar i ka dhuruar pjesë të qenies së vet, i ka dhuruar ndjeshmërinë e përzemërt dhe ngrohtësinë e vërtetë njerëzore... (Ramadani, 2017)

Hanife Sejfulla Reçani nuk u pasurua nga muzika, por muzika u pasurua përmes saj. Ajo nuk ishte thjesht një qenie biologjike, por biologjia e saj ishte tepër artistike. Sa ishte në këtë botë, ajo nuk këndoi për të bërë famë, por ja që fama i këndon asaj akoma me fuqi të plotë.

<sup>35</sup> (Reçani H. S., Fesi cikes plot gjylpana, 2018)

<sup>36</sup> (Reçani H. S., Qe ku vijn' oj nan' ushtaret, 2018)

<sup>37</sup> (Reçani H. S., Karajfil ne kashte, 2018)

<sup>38</sup> (Reçani H. S., Cou moj Mahmudi, 2018)

<sup>39</sup> (Reçani H. S., Po shkon vasha rreth Vardarit, 2018)

<sup>40</sup> (Reçani H. S., Kenga e Hasimes, 2018)

<sup>41</sup> (Reçani H. S., Hanëm, hanëm, 2015)

<sup>42</sup> (Reçani H. S., Kur dola te porta, 2018)

<sup>43</sup> Disa nga këto këngë të sipërpërmendura janë melografuar dhe janë paraqitur si bashkëngjitje të këtij shkrimi.

<sup>44</sup> Familja ka qenë zemra e saj, ndërkaq ilaçi i zemrës nipërit dhe mbesat: Labinoti, Valoni dhe Vetoni - fëmijët e Teutës; Siandra dhe Florinda - fëmijët e Ilirit; Sarah – fëmijë i Arbenit.

## BIBLIOGRAFIA:

- Fejzullai, G. (2001). *Monografia e ShKA "Besa" 1971-2001 - Hanife Sejfullai*. Gostivar.
- Keça, H. (2012, 8 28). *Hajredin Pasha*. Retrieved from Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=QoLN4Dinp34>
- Keça, H. (2019, 3 10). *Hipi hoxha ne minare*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=OSfEvevCePs>
- Keça, H. (2019, 3 10). *Këngë për Halil Gashin*. Gjetur në Youtube: [https://www.youtube.com/watch?v=7P7f\\_UW8iB8](https://www.youtube.com/watch?v=7P7f_UW8iB8)
- Keça, H. (2019, 3 10). *Valle e Gostivarit me çifteli*. Gjetur në Youtube: [https://www.youtube.com/watch?v=aa3QEQ\\_e2ec](https://www.youtube.com/watch?v=aa3QEQ_e2ec)
- Kolari, A. (2018, Janar 3). *Hanife Reçani, zëri i këngës së pavdekshme*. Gjetur në Koha - e përditshme informative: <https://www.koha.mk/hanife-recani-zeri-i-kenges-se-pavdekshme/> L. Turkeshi dhe K. Kica. (a.d.). Fortunat e kohës në këngë. *Magazina*, 26-28.
- Maxharraj, S. (2017, 11 18). "Bilbili i Pollogut", zëri unik i muzikës shqipe. *Koha ditore*.
- Ramadani, B. (2017). Artistja që hapëroi përtej kohës së vet. *Shenja*.
- Reçani, H. S. (2010, 4 29). *Dil aty ku dole mbiram*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=IP9N0tYN6Ng&t=11s>
- Reçani, H. S. (2010, 4 27). *Piku molla e kuqe*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=r3I2pXVp8Rk>
- Reçani, H. S. (2011, 8 25). *Çorapët me vija*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=6RPISt9uWeY>
- Reçani, H. S. (2015, 11 16). *Bien tri daire, moj nano*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=qwr2hYjBqj0>
- Reçani, H. S. (2015, 3 31). *Hanëm, hanëm*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=Tk9Nj5KDOEQ>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Cou moj Mahmudi*. Gjetur në Youtube: [https://www.youtube.com/watch?v=a\\_071\\_lcA2k](https://www.youtube.com/watch?v=a_071_lcA2k)
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Fesi cikes plot gjylypana*. Gjetur në Youtube: [https://www.youtube.com/watch?v=BiPR\\_olvwg4](https://www.youtube.com/watch?v=BiPR_olvwg4)
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Karajfil ne kashte*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=WD-wehxLwNI>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Kendojne bylbylat*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=sK3Ev4vasXA>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Kenga e Hasimes*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=Nv21lfcoKJ4>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Kur do t'shkojsh termah*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=77E1IyBrXY8>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Kur dola te porta*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=BOieBEbUVfU>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Me gëzim po shkoj në punë*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=1FI3yktW1CY>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Moj fusha e Korabit*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=vkhl70cHTs>

- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Oj shamia e zeze* . Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=1bXidUCSMIM>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Po shkon vasha rreth Vardarit*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=IHka6Fm6EYQ>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Qe ku vijn' oj nan' ushtaret*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=nw4w-hil9P8>
- Reçani, H. S. (2018, 2 11). *Shkova n'krue me mush uje*. Gjetur në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=MxocNOtuOCA>
- Salihu, U. (2017, 11 17). *Perla e këngës shqiptare nuk është më.Lamtumirë Hanife Sejfulla Reçani o zë i pastër i muzikës shqiptare*. Gjetur në Fakti ditör: <http://www.faktiditor.ch/perla-e-kenges-shqiptare-nuk-eshte-me-lamtumire-hanife-sejfulla-recani-o-ze-i-paster-i-muzikes-shqiptare/>
- Thënie për vdekjen (85 thënie)*. (a.d.). Gjetur në thenie.org: <https://thenie.org/per/vdekje/>

## Bashkëngjitjet

### Bien tri daire (Hanife Sejfulla Reçani)

Moderato

Melografimi: Bekim Ramadani

Bi-en tri da - i - ret moj na - në te tri - at\_ me - bo - -

6

- - - - - oj', a se din moj\_

9

na - na\_ i - me se un'\_ ne - sër\_ shkoj.

### Çorapët me vija (Hanife Sejfulla Reçani)

Presto

Melografimi: Bekim Ramadani

Ço - ra - pët me\_ vi - ja\_ mo - ri nan', nuk du burr'\_ zot - ni - e\_ oj\_ na -

5

ne, of, of, nuk du burr'\_ zot - ni - e\_ oj\_ na - ne.

### Kur do t'shkojsh terma moj cuce (Hanife Sejfulla Reçani)

Allegro

Melografimi: Bekim Ramadani

1. Kur do t'shkojsh ter - ma moj cu - co mlo - hu me çar - shaf,

2. Dja - li qi mka da - shtun mu - e nu - se ka for - cu,

5

mos të t'shof - e dja - li cu - co qi\_ t'ka\_ dasht!

i - sha - llah i vdes a - jo e kthe - het më merr\_ mu.

## Çou moj Mamudi

(Hanife Sejfulla Reçani)

♩=240

Melografimi: Bekim Ramadani

Ço' moj Mah - mu - di, haj moj de - li - je, haj se t'kan ardh'

6 sho-qet me t'vu\_ ka - nën\_ o! S'mun-dem oj na - në,

11 s'mun-dem oj me\_ nejt, un'\_ jam e s'mut oj tu\_ vde - kun

16 oj, me-rre ba - ne\_ ga-ti mot-rën\_ tje - tër\_ o!

## Fesi i çikës

(Hanife Sejfulla Reçani)

Moderato

Melografimi: Bekim Ramadani

7 Fe - si\_ çi - kës\_ plot gyl - pa-na plot gyl - pa - na, fe - si\_

13 çi - kës\_ plot gyl - pa-na plot\_ gyl - pa - na, haj\_ me\_ la - lën\_

17 \_ për\_ li - mo-na për li - mo - na, haj\_ me\_

la - lën\_ për li - mo-na për\_ li - mo - na!

## Pse je idhnu

(Hanife Sejfulla Reçani)

♩=110

Melografimi: Bekim Ramadani

6 Pse je idh-nu ti me mu - e o mo-ri ve - tull holl', pse m'je i - dhnu

11 ti me mu - e, o mo-ri ve-tull holl'. Nan' e bab' i lash' për ty - e

14 mo - re dyl - be - ro, nan' e bab' i

lash' për ty - e, ti me mu nuk fo - le of a - man.

## Piku moll' e kuçe

(Hanife Sejfulla Reçani)

Melografimi: Bekim Ramadani

**Presto**

9 Pi - ku moll' e ku - qe, pi - ku ra n'za - bel - e,

17 ku e pa - tëm be - sën, o A - li dyl - ber - e,

25 ku e pa - tëm be - sën, o A - li dyl - ber - e?!

## Këndojnë dy bylbylat (Hanife Sejfulla Reçani)

Melografimi: Bekim Ramadani

**Vivo**

5 Kën-dojn' dy byl - by - lat o sa-bah në sa - bah,  
 9 a e din be qu-ni vo - gël se jam pa ni - qah?  
 a e din be qu-ni vo - gël se jam pa ni - qah?

## Qe ku vijn' oj nan' ushtarët (Hanife Sejfulla Reçani)

Melografimi: Bekim Ramadani

**Moderato**

10 Qe ku vijn' o mojn' ush - tri - ja e mre - ti - it, di-sa kja - shin mo  
 16 na - ne di - sa knoj - shin - in, di - sa  
 kja - shin mo na - ne di - sa knoj - shin.

## Hej moj dukane (Hanife Sejfulla Reçani)

Melografimi: Bekim Ramadani

**Vivace**

11 Hej moj du - ka - ne moj du - ka ne, pu-na mbar' de -  
 Hej pu-na mbar desh - ta me t'tha ne, dul ni gjar - pën  
 17 shta me t'tha - ne hej, hej, hej, pu na mbar'  
 me na ngra - ne hej, hej, hej, dul ni gjar -  
 de - shta me t'tha - - ne.  
 pën me na ngra - - ne.

**Ermal MEHMETI,**

*ITShKSh – Shkup*

**Jeta STAROVA-MEHMETI,**

*Fakulteti Pedagogjik / UKIM - Shkup*

## **NEXHMIJE PAGARUSHA DHE “BARESHA”**

*“Unë i kërkoj notat që dashurohen!”*

*Wolfgang Amadeus Mozart*

Në të gjithë popujt, në popujt mesdhetarë dhe mbase veçmas në Ballkan, folklori muzikor paraqitet si një paradigmë themelore, e cila shënon zhvillimin e kulturës muzikore dhe artit muzikor. Duhet të theksohet se aty ku procesi i zhdukjes së folklorit njëkohësisht është edhe i përparuar, tiparet themelore të tij mbeten të mishëruara në artin e muzikës dhe shënojnë ngjyrën e tij të veçantë. Kjo është edhe arsyeja pse ekzistojnë dallime domethënëse në karakterin dhe mënyrën e shprehjes së muzikës midis popujve të ndryshëm.

Në përgjithësi, në fushën e muzikës shqiptare dhe kulturës muzikore në përgjithësi, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe vende të tjera ku jetojnë shqiptarët, folklori muzikor do të luajë një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm. Duhet të theksohet se të gjitha veprat që u krijuan, dhe të cilat ishin të bazuara në muzikën popullore, nuk hynë sa duhet në karakteristikat tonale, por zakonisht mbeten në nivelin e ritmit, dhe linjës melodike të këngës shqipe.

Në përpunimin e folklorit shqiptar, veçanërisht në Kosovë, u përdorën harmonitë në shkallat mazhor dhe minor, mbi të cilin bazohet muzika klasike dhe romantike e Evropës Perëndimore<sup>45</sup>. Duke kuptuar domethënien thelbësore të kësaj melodie, një numër i konsiderueshëm kompozitorësh dhe muzikologësh shqiptarë kanë studiuar dhe përpunuar këtë pjesë të këtij folklori, i cili është shumë karakteristik dhe i larmishëm. Duhet të theksohet se kompozitorët, të cilët krijuan pas luftës së dytë botërore, sipas traditës evropiane

---

<sup>45</sup> Akil Koci, “Elementi siptarskog muzickog folkloru u delima nasih kompozitora”, Zbornik, Rad XIV Kongresa Saveza folklorista Jugoslavije u Prizrenu, Beograd, 1974.

perëndimore, do të gjejnë materiale të shkëlqyera për veprat e tyre, d.m.th. do të kenë burimin e pashtershëm të melodisë popullore në krijimin e pjesëve origjinale të temave popullore.

Ekziston një potencial në folklorin muzikor origjinal, i cili ka interpretuesin e tij i cili provokon pritshmërinë emocionale të pothuajse çdo dëgjuesi, si dhe intuitën në vetë kompozitorin dhe hollësinë për të formuar krijimin ritmik dhe të plotë. Ekzistojnë besime të argumentuara nga të gjitha anët, si dhe studimet për muzikën kanë treguar se ky folklor është i bazuar në themele të ngurta, si një paradigmë me ndikim krijues.

Duke mbajtur vëmendjen e një prej kompozimeve të kultit, rrespektivisht kënga "Baresha", e kompozitorit nga Kosova Rexhep (Rexho) Mulliqi, duhet së pari të theksojmë veprën e kompozitorëve Lorenc Antoni, Krist Leka, Vinçenc Gjini, Esad Rizvanoli, Zeqirja Ballata, Akil Koci, Severin Kajtazi etj. Shembujt më të mirë të kësaj janë: "Koret shqiptare", "Suita Kosovare", "Në Prizrenin e bukur", "Lojë koncerti" dhe kompozime të tjera. Këto kompozime karakterizohen nga përpunimi i mirë harmonik, dhe fryma dhe atmosfera e muzikës popullore, si dhe përpjekja e vazhdueshme për harmoninë latente, Lorenc Anthoni mblodhi 4,000 këngë popullore nga e gjithë Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, ku jeton popullata shqiptare. Ai ka botuar tre libra me këto këngë, ka shkruar disa libra, dha një kontribut të madh në melodinë dhe muzikën shqiptare për tu bërë i njohur gjerësisht.

Përveç veprimtarisë së tij të lavdishme si komozitor në fushën e teatrit dhe filmit, Rexho Mulliqi do të mbahet mend për harmonizimin e 150 këngëve të ndryshme popullore, shqiptare.

Më pas vijnë veprat: Fantazia Simfonike, "Ujëtyrët e Prizrenit", Legjenda e Violinës dhe Pianos, pastaj kantata "Vdekja e Heroit", "Poema për ta", pastaj kompozimet vokale për korin "Vjeshta" (1 ), "Kosova", "Suite e vogël" dhe të tjerët. Megjithatë, mes tyre, si në punën dhe jetën e Rexho Mulliqit, vendin qendror do ta zërë "Baresha". Ai përpunon dhe stilizon mbi 20 këngë popullore, ndër të cilat dallohen: "Një lule", e shkruar për solo sopran, kor dhe orkester, "Lulezoi fusha lulezoi mali", për dy solistë, kor dhe orkester dhe "Zambaku i bardhë", po ashtu për kanto, kor dhe orkester. Në këtë sërë këngësh si dhe në të tjerat është kënga "Baresha", si kulm i invencionit të Rexho Mulliqit. Karakteristike në këtë këngë janë elementet kolorite brënda melodise me nje diapazon të gjërë, gjë që nuk e bën të lehtë interpretimin e kesaj kënge.

Rexhep Mulliqi shpesh e përsëriste frazën, si motiv për jetën: muzikë, si dashuria e parë dhe e fundit! Por kishte një kohë kur Rexhep Mulliqi, përveç

dashurisë së tij për muzikën, kishte edhe një dashuri tjetër: duke punuar për Radio Prishtinën, ai u bë i afërt dhe ra në dashuri me këngëtares të re e të talentuar Nexhmije Pagarusha. Vetëm ajo me zërin e saj të mrekullueshëm dhe të bukur do të jetë frymëzuesi kryesor për të që të kompozojë veprën e tij të famshme, të krijuar vetëm për të, "Baresha".

Sot pretendohet se dy burime mund të merren parasysh për kompozimin e "Baresha": zëri i shkëlqyer i Nexhmije Pagarushës, dhe vendlindja magjike e kompozitorit. Ai lindi dhe u rrit në afërsi të Bjeshkëve të Nemura, ndër peizazhet me ngjyra, ku baresha është frymëzimi dhe simboli i bukurisë femërore.

Baresha, pra, ishte një Nexhmije e ëndërruar dikur, larg një jete rinore dhe baritore nga fëmijëria në vendlindje. Dasma e Rexhep Mulliqit dhe Nexhmije Pagarushës ndodhi një ditë, por lidhja e qëndrueshme me "Bareshën" mbeti. Kjo këngë ka një strukturë të pasur dhe komplekse brenda zhanrit të saj. Është e qartë se kompozitori me këtë vepër dëshironte të realizonte një projekt të jetës së tij.

Duhet të theksohet se elementet muzikore dhe ndjeshmëritë mund të gjenden në dy nga simfonitë e Mulliqit. Më vonë, ai do të krijonte një variant orkestral të veprës "Baresha", dhe kështu, kjo përbërje do të bëhej një paradigmë dhe kriter për standardet për kompozimin e këngëve në frymën e melodisë popullore, por edhe për krijuesit e tjerë.

Duhet të theksohet se kompozitori Rexho Mulliqi dhe Nexhmije Pagarusha, krijuesit e legjendës "Baresha", karakterizohen gjithashtu nga kultura e lartë muzikore klasike, e cila nuk mbetet pa një reflektim në kompozimin e veprës "Baresha". Nexhmija interpretoi kompozime gjithashtu edhe nga kompozitorët e mëdhenj të historisë së muzikës siç janë: Beethoven, Verdi dhe klasikë të tjerë që ishin afër kompozitorit Mulliqi. Ajo është e krahasuar me këngëtarët e famshëm të kohës, përfshirë edhe këngëtares franceze Zhyliet Greko. Gjatë karrierës së saj muzikore, ajo këndoi mbi 150 këngë<sup>46</sup>.

Mulliqi mbështetet me shkathtësi dhe krijimtari në format klasike, të mbushura me zgjidhje harmonike, në të cilat folklori dhe muzika popullore janë të depërtuara në mënyrë mbinaturale, si një vlerë e përhershme. Në këtë kontekst, vepra "Baresha" është shembulli më i mirë i kësaj: valeritë estetike sublime të ruajtura në këndimin popullor, bazuar në forma të ngurta muzikore, të kontrolluara përmes klasikëve të përjetshëm dhe të ofruar për të

<sup>46</sup> Shaban Maxharraj, Elvira Berisha, Nexhmije Pagarusha, monografi, Prishtinë, 2019.

realizuar një nga zërat më të bukur, sopranon magjik, "Kumrija e Kosovës" Nexhmije Pagarusha. Të rralla janë sinteza kaq të shkëlqyera muzikore në letërsinë dhe historinë e muzikës botërore, të ofruara, të zgjedhura dhe të krijuara nga vetë jeta.

Në interpretimet instrumentale shumë të pasura të "Bareshës", violina mbizotëron, më shpesh si një instrument solo në interpretimet orkestrale. Nuk është rastësi që Rexho Mulliqi e ngulit në veprat e tij, veçanërisht në "Baresha", shpirtin e violinës. Që ne rininë e tij, Mulliqi ka qenë shumë i lidhur me violinën. Në kohën e okupacionit fashist, Rexho Mulliqi luante në violinë, dhe muzikantët italianë që e dëgjonin në atë kohë e quanin "Paganini i vogël". Performancat e paharruara orkestrale instrumentale të veprës "Baresha" me Shkelzen Doli në aranzhmanin e Gerti Druga mbeten të paharruara.

Performanca e violinës së Isak Mucolli mbetet e paharrueshme në interpretimet instrumentale antologjike të Bareshës. Arben Hoxha dhe Vendim Thaqi, interpretuan këngën "Baresha" në dy kitara me sukses në Festivalin Ndërkombëtar të Kitarës 2017 në Tiranë.

Pëllumb Qerimi interpreton këngën "Baresha" në kitarë elektrike. Egziston një gamë e gjerë e performancave të "Bareshës" në instrumentet muzikore popullore: për shembull, Oltion Vata interpreton në çifteli, ka një interpretim instrumental të "Bareshës" në mandolin, versionet instrumentale të "Bareshës" janë përshtatur për vallëzime, muzikantë të rinj bëjnë improvizime në instrumente të ndryshme. E gjithë kjo tregon se sa i thellë është potenciali krijues muzikor i kompozimit "Baresha" të Rexho Mulliqit.

Zakonisht në veprat e natyrës muzikore dhe muzikologjike, siç është vepra muzikore "Baresha", nga kompozitori Rexho Mulliqi, e cila ishte një sfidë e madhe për ne për përvojën e tij të re krijuese, sikur të mos ketë asnjëherë përfundim, një vepër muzikore sfiduese sikur edhe vetë koha. Gjithçka shkrihet në jetën dhe veprën e kompozitorit të madh shqiptar në një simfoni, në muzikën që ai krijon, jeton dhe ndahet me tjetrin (në këtë rast "Baresha" (ai himni i përjetshëm i Kosovës, i cili u këndua në mbledhjen e parë parlamentare të Republikës së Kosovës) me Nexhmije Pagarushën, me të tjerët, në dridhjet shpirtërore të të cilave zbulohen shënimet e vërteta, më të forta se ato të shkruara. Nëse ne kemi arritur në kërkimin tonë për tingujt unikë të "Bareshës", nëse i kemi afuar atyre, si një jehonë më të gjerë kemi arritur të paktën pak në misionin tonë ...

## Bibliografi:

1. Koci, Ail, „Drug Kiosk simfonija” dodatak u 2 LPY „Rexho Muliqi”, Udruzenje estradnih umetnika Kosova, Muzicka produkcija RT, Prishtina, 1983.
2. Hodzic, akad. Zuvada, „Omaz Muliqi”, Plavski knjizevni susreti, Plav, 11 avgust, 1983.
3. Koci, Akil, Portrete të kompozitorëve shqipëtar në Jugosllavi, Prishtinë, 1988.
4. Koci, Akil, „Vibracione të shpirtit shqiptar”, (Vë1) „Liberarum Haemus), Bukuresht, 2008.
5. „Musique classique et Musique populaire”, symphozik.info, 90, dossier, html, 04.04.2014.
6. Luma, Erhan, Rexho Muliqi, punim, 2017.
7. Maxharraj, Shaban dhe Berisha, Elvira, Nexhmija Pagarusha, monografi, Prishtinë, 2019.

## NË “DITËT E ALFABETIT”, RINJOHJA E BALLKANOLOGES OLIVERA JASHAR NASTEVA

*Shkup, 17.11.2020* – Në kuadër të manifestimit kulturor–shkencor “Ditët e Alfabetit” në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITShKSh), dita e sotme iu kushtua ballkanologes Olivera Jashar Nasteva. Ajo ishte figurë poliedrike shkencore, e cila rridhte nga një familje e njohur e kohës – gjyshi i saj Jashar beu ishte përfaqësues i Shkupit në Lidhjen e Prizrenit, kurse babai Emin beu pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit.

Në fillim, drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, tha se Olivera Jashar Nasteva ishte një thesar i madh kulturor dhe shkencor, produkt i familjes së njohur shkupjane Kumbaraj, e cila familje kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, me theks të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe kulturës. “Dorëshkrimet e shumta dhe me shumë interes që i kemi në dispozicion, të cilat kanë të bëjnë me gjuhën dhe kulturën shqipe, nga studiuesit tanë do të sistemohen dhe botohen së shpejti në një edicion të veçantë. Kontributi i saj do të përjetësohet dhe nuk do të harrohet asnjëherë”, theksoi Asani.

Më pas, profesori shumëvjeçar në Universitetin “Kirili dhe Metodi” të Shkup, studiues i temave të ndryshme didaktike, pedagogjike, albanologjike dhe historike, Avzi Mustafa, i cili ishte edhe student dhe më vonë kolegë i profesoreshës në fjalë, referoi në temën: “Olivera Jashar Nasteva, pedagoge e shkëlqyer, shkencëtare e papërsëritshme dhe humaniste e veçantë”.

Ndërsa, Dimitar Pandev – profesor shumëvjeçar në Universitetin “Kirili dhe Metodi” – Shkup, studiues, linguist dhe ballkanolog i njohur, i cili për disa vite ka qenë edhe asistent i prof. Oliverës, në Fakultetin e Filologjisë pranë Universitetit të Shkupit, ndau kujtime nga puna me të dhe aktivitetet e shumta shkencore të saj në katedrat universitare, në Akademinë e Shkencave dhe Arteve, etj.

Studiuesi dhe këshilltari shkencor, Qemal Murati, autor i dhjetëra veprave shkencore nga lëmi i albanologjisë, i cili me një zell të veçantë është duke lëvruar edhe në fushën e ballkanologjisë, u paraqit me temën: “Olivera Jashar-Nasteva - figurë qendrore e ballkanologjisë shkencore”.

Hidajete Azizi – studiuese dhe bashkëpunëtore e lartë shkencore në ITShKSh-Shkup, e cila po merret në mënyrë mjaft serioze me probleme të caktuara të gjuhësisë, dhe veçanërisht lidhur me interferimet mes shqipes dhe gjuhëve ballkanike, referoi në temën “Kontributi i Olivera Jashar-Nasteva për ballkanologjinë”.

Dhe në fund, Zeqirija Ibrahim – studiues dhe bashkëpunëtor i lartë shkencor në ITShKSh-Shkup, i cili preokupim kryesor e ka gjuhën standarde shqipe, por edhe krahasimet mes shqipes dhe maqedonishtes, u paraqit me temën “Olivera Jashar Nasteva, si fat i njeriut ballkanik”.

Të gjitha punimet e prezantuara do të botohen në edicionin e radhës të “Ditëve të Alfabetit”. Dita e nesërme e këtij manifestimi i kushtohet arkeologes së njohur - Exhlale Dobruna-Salihu.

Për shkak të gjendjes aktuale me pandeminë, aktivitetet e sivjetme po zhvillohen duke respektuar protokollet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe kryesisht pa praninë e publikut të gjerë!



Avzi MUSTAFA

*Studiues*

## OLIVERA JASHAR-NASTEVA – PEDAGOGE E SHKËLQYESHME, SHKENCËTARE E PAPËRSERITUR DHE HUMANISTE E VEÇANTË

*"Bota ka nevojë për shkencë dhe shkenca ka nevojë për gratë. Njerëzimi nuk mund të injorojë gjysmën e gjinisë së tij krijuese-gratë"*

*- Irina Bokova*

Kam nderin dhe kënaqësinë time që m'u dha rasti të bëj një përpjekje sado pak modeste për të shkundur paksa pluhurin e kohës mbi një grua me akribi shkencore e humane, paksa të harruar, për të mos thënë aspak të dukshme. Fjalën e kam për prof. Olivera Jashar-Nastevën.

Olivera Jashar-Nasteva ishte dhe mbetet një nga studiueset më me zë dhe e pazëvendësueshme, sepse ajo i takon atij brezi intelektualësh, pesha e rëndësia e të cilave tashmë janë të njohur, kjo për shkak të veçantisë së tyre. Të rrallë janë hulumtuesit si Olivera Jashar-Nasteva, që punën e vet me përkushtim dhe me seriozitet e ka realizuar paralelisht në dy fusha, pedagogjike dhe shkencore.

Ajo ishte pedagoge e shkëlqyeshme, shkencëtare e papërsëritur dhe humaniste e veçantë. Sekretet e pavdekshmërisë së Olivera Jashar-Nastevës nuk qëndron vetëm te mendimet e saj të thella gjuhësore, por edhe personaliteti dhe modestia e saj e dyfishon interesin dhe dashurinë për mendimet e saj.

Të gjithë ata që kanë pasur qoftë edhe kontaktin më të vogël, nuk mund ta harrojnë kurrë, sepse ajo posedonte virtyte që rrallëkush mund t'i ketë. Këtë si duket e kishte trashëgim nga gjyshi Jashar, përfaqësuesi i Shkupit në Lidhjen e Prizrenit, dhe nga babai i saj. Olivera ishte e bija Emin beut të Shkupit, i cili në vitin 1908 si përfaqësues i Klubit të Shkupit, kishte marrë pjesë në Kongresin e Manastirit me të drejtë vote. Atëbotë ky bej e mbrojti abecënë latine për shqipen.

Me largimin nga kjo botë në botën e amshueshme të akademik Olivera Jashar-Nastevës, po kalojnë tashmë 20 vite që ajo po qëndron në heshtje të

pamerituar. Për këtë personalitet të madh shkencor nuk u tha më asnjë fjalë dhe ajo nuk u kujtua thuajse aspak për këto 20 vjet – as nga Fakulteti i Filologjisë e as nga Akademia Shkencave të Maqedonisë.

Ajo së pari shquhet si profesoreshë e diplomuar në paralelet e para në gjuhën shqipe në Shkollën Normale “Nikolla Karev” të Shkupit, ku ligjëronte gjuhën maqedonase e pastaj në Shkollën Normale “Zef Lush Marku” në Shkup, ku e ligjëronte gjuhën frënge. E vetmja grua dhe një ndër të parat femra e diplomuar. Për nevojat e nxënësve shqiptarë ajo i bëri edhe disa përkthime dhe mori pjesë në përpilimin e plan-programit të parë të lëndës së gjuhës shqipe.

Nevoja, por edhe suksesi i arritur në studime, në vitin 1963 e sollën të punojë si asistente në Katedrën e Gjuhës Maqedonase të Fakultetit Filozofik të Shkupit, ku edhe i mori të gjitha gradat shkencore dhe arsimore. Ajo e ligjëronte Linguistikën e përgjithshme për të gjithë studentët që i studionin gjuhët në këtë fakultet. Pastaj, në vitin 1972, kur pranë Fakultetit Filologjik duhej të hapesh Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, ajo bashkë me prof. dr Petro Janurën, u bë themeluesja e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Shkupit. Aty, krahas Linguistikës së përgjithshme, i ligjëroi lëndët: Dialektologjia e gjuhës shqipe dhe Historia e gjuhës shqipe. Me pas ajo u angazhua edhe për hapjen e Katedrës së Gjuhës Turke, ku ishte edhe shefja e parë e kësaj katedre.

Gjithashtu bashkë me Blazhe Koneskin, Bozhidar Vidoevskin dhe Petar Ilievskin e themeluan sektorin e gjuhësisë në Akademinë e Shkencave të Maqedonisë në Shkup.

Koha dhe mungesa e saj fizike nuk ia ka humbur aspak asaj imazhin pozitiv dhe vlerën në shkencë. Përkundrazi, ajo më shumë se kurrë kërkohet dhe citohet për të dëshmuar mendimet e plota shkencore në fushën e gjuhësisë. Në shkencë jeta e saj studimore ka ecur në hap më zhvillimet bashkëkohore të epokës kur ajo jetoi. Dhe, të ecësh në një hap me kohën botërore, kjo është një meritë e veçantë kur bëhet fjalë për një studiuese, sidomos për një lingviste në një epokë kur duhej të peshohej çdo gjë ose të thuhej ashtu siç e kërkonte ideologjia. Në këtë drejtim ajo na jep shembullin e një punëtoreje dhe një gruaje më fisnike – se si duhet të jetë një shkencëtare e mirëfillte duke i pasur parasysh këto fakte. Është për t’u habitur se si ishte e mundur që edhe në periudhat më të zymta dhe të ndjekura për çdo shkronjë ajo mbeti objektive në shkencë. Atë e mbronte objektivja. Ndonëse hakmarrja ndaj sa nuk kishte të ndalur – asaj nuk ia botuan as edhe një libër shkencor derisa nuk u ndryshua sistemi.

Kështu librin e pare ia botojnë ish studentët dhe kolegët e saj nga Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me titull “Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike” në SHB “Logos-A” të Shkupit. Megjithatë vepra e saj citohet gjithandej në të gjitha punimet shkencore të njerëzve më eminentë të gjuhësisë ballkanike pranë gjuhëtarëve të mëdhenj, si: Idriz Ajeti, Eqrem Çabej, Jani Thomai, Rexhep Ismajli, Besim Bokshi, Shaban Demiraj, Viktor Fridman, Bllazhe Konneski, Bariqi, Desnickaja, Topolinska, Usikova, Henri Hemp, Mikloshiqi, Majeri, Vaigandi, Selishçevi, Skoku etj. Kjo shkencëtare, në mënyrë objektive, si në diakroni ashtu edhe sinkroni, i studionte dhe i analizonte fenomenet gjuhësore. Siç shprehej akad. Idriz Ajeti, “Ajo kishte një gjuhë specifike dhe kishte aftësinë që temat shumë të ndërlikuara gjuhësore t’i bëjë të kuptueshme për të gjithë. Sidomos kur bëhet fjalë për gjuhët ballkanike, ajo ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme për studimet e krahasuara të gjuhëve ballkanike”.

Të flasësh ose të shkruash për portretin e Olivera Jashar-Nastevës ose për veprën shkencore të saj është e pamundur të mos shkruash edhe për virtytet e saja njerëzore të një personaliteti të rrallë, të vlerësuar jo vetëm me parametrat tonë, por të të gjithëve që e njohën dhe patën punë me të. Të gjithë ata që e kanë njohur nga afër, ruajnë për të nderimin më të madh, sepse atë e dallonte objektiviteti, çiltërsia, modestia dhe gatishmëria për bashkëpunim e ndihmë.

Kjo zonjë e madhe humane e shkencore në lëmin e linguistikës mbetet një gjigande e mendimit linguistik. Opusi i saj shkencor llogaritet në mbi 200 zëra bibliografikë, të botuar edhe në gjuhë të huaja në revistat shkencore botërore. Ajo trajtonte tema nga interferenca gjuhësore, gjuhët në kontakt, lidhjet gjuhësore, diglosinë e bilinguizmin, onomastikën, toponiminë dhe artikuj ku përfshiheshin segmente leksikore terminologjike etj., të gjitha të analizuar sipas metodave më bashkëkohore të studimit të gjuhësisë.

Nga opusi i saj shkencor me një akribi shkencore hulumtoi dhe, ashtu siç thotë prof. Idriz Ajeti, “në aspektin ballkanologjik në Maqedoni bart një barrë të konsiderueshme... në fushën e studimeve të ndërsjella kur merr e këqyr gjithë atë numër studimesh”. Kur fliste mbi gjuhën shqipe në relacion me gjuhët ballkanike, e sidomos për toponiminë, ajo i mbeti konsekuente vetëm të vërtetës shkencore pa marrë parasysh se në çfarë shtate presioni do të ndodhej.

Punimin e parë shkencor e nisi me temën “Fjalët shqipe në gjuhën e fshehtë maqedonase”. Pastaj erdhën punimet: “Ndikimi i maqedonishtes në gjuhën shqipe”, pastaj “Skënderbeu te Grigor Përliçevi” në Prishtinë, “Skënderbeu në

letërsinë maqedonase” në Palermo, “Besa në gjuhët e Ballkanit në Bukuresh “,”Fjalorët e Gjorgje Pulevskit dhe paralelet shqipe në të” etj., që do të thotë se interesi i saj ishte shumë madh për studime leksikologjike e sidomos me historinë e leksikologjisë.

Prof. Olivera, me intelektin e saj të çuditshëm, në shumë kumtesa e referate nëpër shumë simpoziume e kongrese e mbrojti pikërisht atë që do të thoshte shkencë. Akad. Oliverën e njohën dhe për të shprehen interes shume institucione e katedra, ku ajo ftohej të mbajë ligjërata, si në: Napoli, Paris, Krakov, Moskë, Ankara, Çikago etj.

Në vitin 1983 akademik Olivera Jashar Nasteva zgjidhet anëtare e rregullt në Akademinë e Shkencave të Maqedonisë, ndërsa pas dy viteve zgjidhet edhe anëtare e Akademisë së Shkencave të Turqisë. Përveç kësaj, në shumë akademi të tjera ajo vepronte si bashkëpunëtoare në sektorin e gjuhësisë. Me autoritetin e saj shkencor ajo arriti të jetë udhëheqëse e Komitetit Nacional për studime të Evropës juglindore.

Për personalitetin dhe veprat e Olivera Jashar-Nasteves janë thënë dhe thuhën shumë fjale miradije nga njerëzit e shkencës e të pendës, sepse ajo ishte një monument që ecte rrugës dhe e kishte tejkaluar kohën në të cilën jetonte. Ajo do të mbetet e pranishme edhe në të ardhmen. Emri i saj do mbetet ndër dijetaret dhe intelektualet e cila dashuronte dhe jetonte me problemet e zbulimit të së vërtetës. Ajo jetonte me studentët, kolegët e me lingvistiken. Ndërkaq tani lingvistika dhe ne jetojmë me atë.

**Qemal MURATI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **DY FJALË PËR OLIVERA JASHAR-NASTEVA – DIJETARE E RRALLË E BALLKANOLOGJISË SHKENCORE**

Akad. Olivera Jashar-Nasteva, dijetare me formim të shquar ballkanologjik, e diplomuar në romanistikë, njohëse e shkëlqyer e sllavishteve, e shqipes, e turqishtes dhe e disa gjuhëve të tjera, pa dyshim zë një vend të merituar edhe në albanologjinë shkencore. Ajo ka prekur dhe ka hulumtuar me kompetencë edhe probleme dhe mistere të gjuhës shqipe dhe ka arritur rezultate të përfillshme në kërkimet filologjike shqiptare, që e bëjnë atë të jetë një figurë e nderuar në albanologji.

Akad. Olivera Jashar-Nasteva ishte bijë e Emin Beut, pjesëmarrësit në Kongresin e Manastirit (1908). Shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Shkup, maturoi në Beograd më 1941. Studimet i filloi pas Luftës në Beograd, kurse i mbaroi në Shkup, kur më 1945 diplomohet në Grupin e Gjuhës dhe të Letërsisë Frënge në Fakultetin Filozofik.

Gjatë kohës së studimeve dhe pasi kishte diplomuar punoi si profesoreshë e gjuhës frënge dhe e gjuhës maqedonase në disa shkolla të mesme të Shkupit. Në vitin 1959 zgjidhet asistente në Katedrën e gjuhëve sllavojugore dhe ballkanike. Në qershor të vitit 1962 mbron disertacionin e doktoratës më temë *Turski leksički elementi vo makedonskiot jazik (Elementet leksikore turke në gjuhën maqedonase)*. Dy vjet më vonë, më 1964, zgjidhet docent për lëndën e Historisë së gjuhës maqedonase, Profesor inordinar më 1969, Profesor ordinar më 1975. Për shumë vjet ligjëroi edhe kursin e gjuhësisë së përgjithshme për studentët e shkallës së dytë dhe të tretë. Në vitin 1979 zgjidhet anëtare me korrespondencë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, kurse më 1983 anëtare e rregullt e kësaj Akademie (MANU).

Interesimi shkencor i akademikes Nasteva përqendrohet në disa fusha: ndikimi i turqishtes dhe i gjuhëve të tjera ballkanike në leksikon dhe idiomatikën e maqedonishtes dhe teoria e gjuhësisë kontrastive në rrafsh më të gjerë, historia e gjuhës maqedonase dhe nivelet sociolinguistike të zhvillimit të saj dhe historia kulturore e maqedonishtes në shek. 19, organizimi i fondit

leksikor të maqedonishtes, kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike etj. Bibliografia e punimeve të saj studimore arrin fondin prej 150 zërash bibliografikë, studime të përfillshme që rrokin një spektër të gjerë tematik, shumica syresh me reflektime edhe për shqipen dhe për problematikën shqiptare. Në këtë fushë studimore vlen të përmendim kontributet me vlerë për albanologjinë të akad. Nasteva: *Razvojot na dijaleknata leksika vo uslovi na jazično mešanje (vrz osnova na turski-makedonski i tursko-albanski kontakti vo Gostivarsko)*, "Makedonski jazik", Skopje, 1980; *Razvojot na dijaleknata leksika vo uslovi na jazična interferencija (Bogatenjeto na albanskite, romanskite i turskite govori vo SR Makedonija)*, "Makedonski jazik", Skopje, 1983; *Vlijanieto na makedonskiot jazik vrz albanskite i turskite govori vo Makedonija*, "Makedonski jazik" XIII, 2, str. 147-164; *La phraseologie macedonienne dans le contexte balcanique* (Frazeologjia maqedonase në kontekstin ballkanik) – në bashkautorësi me B. Koneskin dhe B. Vidoeskin, ku shembujt frazeologjikë jepen edhe në përqasje me shqipen, te *Prilozi (Contributions)*, MANU, 1981; *Za rečnicite na Gjorgji Pulevski i albanskata paralela vo niv*, "Prilozi" IX, MANU, Skopje, 1984; *Za Skenderbeg kaj Grigor Prličev*, te Simpoziumi për Skënderbeun, 9-12 maj 1968, Prishtinë, 1969. Në lëmin e *dialektologjisë sociale* akad. Olivera Jashar-Nasteva e bën objekt të vetin kërkimor elementin e shqipes në gjuhët e fshehta të maqedonishtes: *Albanski zborovi vo makedonskite tajni jazici*, Makedonski jazik IV, 1953, nr. 3, nr. 4, 5-6. Argotë e maqedonishtes, siç ka vënë re Nasteva, "vlojnë" me fjalë shqipe, sikurse dhe argotë e gjuhëve të tjera ballkanike. Punimet studimore të akad. Olivera Jashar-Nasteva, si për metodologjinë shkencore dhe si për thellësinë mendimore dhe objektivitetin, mund të thuhet se janë model e drejtimdhënëse për të gjithë filologët që do t'i referohen problematikës ballkanike. Ajo hedh dritë të re edhe në albanologji. Në kërkimet e veta ballkanistike, – sikurse pohonte linguisti Dimitar Pandev, - O. Jashar-Nasteva nisej gjithmonë nga folësit e thjeshtë të gjuhëve ballkanike dhe jo nga mitet e legjendat e indishtes dhe greqishtes së vjetër antike e paraantike, pra nga faktet reale, jo nga ato irrealia.

E pajisur mirë me njohjen teorike dhe me përdorjen praktike të shqipes dhe të gjuhëve të tjera ballkanike, njohuritë dhe erudicionin e saj që zotëronte në albanologji dhe në ballkanologji kjo dijetare e rryer ua shpërndau edhe studentëve të Degës së Albanologjisë në Fakultetin Filologjik të Shkupit, ku prej shumë vjetësh ligjëroi kursin e dialektologjisë shqiptare dhe gjuhësinë e përgjithshme.

Kontribut të veçantë Nasteva ka dhënë sidomos në lëmin e studimeve të elementit të huazuar nga turqishtja në gjuhën dhe në letërsinë popullore të maqedonishtes. Në këtë fushë ajo kishte mbrojtur temën e disertacionit të doktoratës *Turski leksički elementi vo makedonskiot jazik*, 1962. Ky punim i thelluar studimor botohet si monografi më vete në vitin 2002 (ah, sikur të kishim një monografi të tillë edhe për elementin leksikor të turqishtes në gjuhën shqipe!). Në këtë vazhdë boton edhe një radhë studimesh me vlerë dhe të vëllimshme për kalket: *Makedonski kalki od turskiot jazik*, “Makedonski jazik”, Skopje, 1962/63, f. 109-172; *Turski elementi vo jazikot i stilot na makedonskata poezija*, MANU, Skopje, 1987. Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë (MANU) akad. Nasteva ishte udhëheqëse e projektit *Rečnik na turcizmi vo makedonskiot jazik (Fjalor i turqizimeve në gjuhën maqedonase)*, ku me dorën e saj të sigurt, ky fjalor pa dyshim paraqet një vepër themelore jo vetëm për këto dy gjuhë, por edhe për ballkanologjinë. Për kontributin e madh që u kishte dhënë kërkimeve turkologjike në truallin e Maqedonisë dhe të Ballkanit, akademikja Olivera Jashar-Nasteva në vitin 1991 zgjidhet anëtare e Akademisë Turke të Shkencave (Turk Dil Kurumu).

Si njohëse e mirë e gjuhëve ballkanike dhe e turqishtes, nga fusha e dialektologjisë akad. Nasteva boton një punim studimor model “*Turskiot govor vo Gostivarskiot kraj*” (te “Gostivarskiot kraj” (Makedonskiot, albanskiot i turskiot govor), Gostivar 1970), me akribi të thellë shkencore, për interferimet ndërgjuhësore të folësve të idiomës turke të Gostivarit. Në sistemin foljor të këtij ligjërimi, ajo evidenton se format pyetëse nuk formohen me partikulën pyetëse *mi* (khs. *geldi mi?* “dojde li”, *verdën mi?* “dade li”), por këtë e hasim rregullisht me: *a geldi?* (dali dojde?), *a verdën?* (“dali dade”), *a çersën?* (“dali pieš”). Te këta shembuj shihet se partikula shqipe (*a?*), për dallim nga ajo turke (*mi?*), përdoret përpara foljes. Nasteva mendon se këtu nuk është çështje vetëm e huazimit të një fjale zyrtare, por e një dukurie më të thellë, pra kemi një ndërtim të ri që është formuar sipas modelit shqiptar (khs. shq.: *a erdhe?*, *a pi?*, *a punon?*) (f. 295). “*Huazimi i një lidhëse do të thotë më shumë se huazimi i një fjale, sepse ajo dëshmon për huazimin e modelit të strukturës së huaj mendimore të fjalorit*” (Blazhe Koneski). Në thelb, këtu nuk mund të flitet për një interferim të shqipes në të folmen turke të Gostivarit, por për një substrat shqiptar të mbartësve të këtij ligjërimi, të cilët e ndërkëmbyen gjuhën e tyre amtare me turqishten, ashtu si në Rekën e Epërme të Gostivarit ku shqiptarët ortodoksë e ndërkëmbyen shqipen e tyre me maqedonishten dhe

filluan të ndihen më pas si “maqedonas”. Në këtë pikëpamje, rajoni i Gostivarit paraqet një zonë vërtet interesante të ndërkëmbimeve linguistike ballkanike.

Akad. Olivera Jashar-Nasteva ishte shkencëtare dhe pedagoge model, që reflektoi gjithë urtësinë dhe objektivitetin prej dijetareje. Ajo ishte një *Institut më vete ballkanologjie* – siç ma ka thënë edhe vetë gojarisht: me rrënjë atësie shqiptare, amësie sllave dhe burrërie vllehe. Në kontaktet disahovesh që kam pasur me akademiken Olivera Jashar-Nasteva, të cilën pata fatin ta kisha anëtare të Komisionit për mbrojtjen e disertacionit të doktoratës në Prishtinë (1989), patëm diskutuar edhe nevojën dhe mundësinë e botimit të veprës së saj të përzgjedhur në gjuhën shqipe dhe mora pëlqimin se do të ishte në nderin e saj që vepra madhore të botohej edhe në këtë gjuhë. Albanologjia ia ka borxh shkencëtares së mirënjohur ta ketë në objektivat dhe në sirtarët e vet. Ajo shumë herë e ka mbrojtur albanologjinë nga sulmet meskine të politikës pseudoshkencore sllave, sidomos në fushatën e tërbuar kundërshtqiptare pas vitit 1981, kur edhe qarqet filologjike akademike maqedonase u vunë në shërbim të ideologjisë etatiste maqedonomadhe dhe me një patologji të pashembullt hysterike dekretinin që toponimet shqipe të përdorëshin me forma sllavomaqedonase! Akademikja Olivera diti ta ndajë mirë linguistikën nga politika, një gjë që pakkush e bën edhe sot në këto hapësira tonat ballkanike, përveç shkencëtarëve të rrallë të racës.

Akad. Olivera Jashar-Nasteva pati botuar nëpër revista prestigjioze, ballkanike e ndërkombëtare, qindra artikuj studimorë të vëllimshëm dhe substancialë, me standard linguistik intelektual të rrallë, por ajo nuk botoi për të gjallë të saj asnjë vepër a vëllim të veçantë, nuk u rrëmbye pas titujve dhe numrit të veprave – të cilat sigurisht se do të ishin të shumëvëllimshme.

Për personalitetin e lartë dhe të pakompromis njerëzor të kësaj dijetareje të shquar, flet edhe ky ky fakt që ma pati rrëfyer vetë profesoresha Nasteva gojarisht. Një botues i njohur maqedonas, asokohe i kishte ofruar botimin e veprave të plota akad. Olivera Jashar Nastevës në shkëmbim që ajo ta ndihmonte në avancimin e titullit shkencor, porse ajo e kishte refuzuar ashpër e prerë dhe e kishte nxjerrë jashtë nga kabineti i saj në Akademi.

Akad. Nasteva me autoritetin e saj intelektual hijerëndë, por shumë e afërt në bashkëbisedim, “i mbulonte të gjithë” – siç më pat thënë në një rast prof. Besim Bokshi. Ajo nuk u kursye t’i ndihmonte të rinjtë ta gjenin rrugën e tyre të drejtë në shkencë kur ata ndodheshin në një udhëkryq. Por që e pamëshirshme dhe nuk u hapte rrugë diletantëve të thekur që pretendonin të merrnin tituj shkencorë pa dije e pa mund – siç kanë vërshuar sot në këtë

kohë “epidemie doktoraturash” gjithandej. Si doktorant i saj, ndihem tepër i privilegjuar që kam pasur fatin ta kisha këtë Klasike të mendimit anëtare të Komisionit vlerësues, ku të dëgjonin pjesëmarrësit e pranishëm nga goja e saj sesi bëhet një mbrojtje disertacioni – kurse tani kam nderim të them dy fjalë homazhi për këtë individualitet të veçantë e *konkuistadore*, që ka pushtuar territore shkencore ballkanike e ndërkombëtare.

Disa punime studimore të kësaj linguisteje të rendit të parë u përkthyen dhe u botuan edhe në gjuhën shqipe, si te *Gjurmime albanologjike, Gjuha shqipe, Shqyrtime albanologjike* etj. Shtëpia botuese Logos-A e Shkupit ndërmori të botonte një përmbledhje punimesh studimore të kësaj linguisteje të shquar *Kontaktet linguistike në hapësirat ballkanike* (1998), të përkthyer në gjuhën shqipe, e cila u mirëprit në rrethet shkencore dhe studentore. Kësaj vepre i prin një recension me peshë i akad. Idriz Ajetit, i cili ngre lart dhe e vlerëson autoren Nasteva si “figurë qendrore të ballkanologjisë shkencore”. Kjo vepër gjuhësie është nga ato të rrallat në të cilën çështjet komplekse ballkanologjike shtjellohen ashtu thjesht, ashtu qartë dhe përgjithësisht ashtu në mënyrë shkencore, sa e bën atë burim referencial të dorës së parë.

Për akad. Olivera Jashar Nasteva, dijetare elitare e formatit të liguistit Blazhe Koneski, - në shumë punime dhe bashkautore me të, - kemi bërë pak ose aspak. Asaj ia kemi për borxh t’ia botojmë një vepër më të plotë shkencore për kontributin në fushën studimore albanologjike, të mësojmë nga vepra e saj metodologjinë shkencore dhe ta rikujtojmë e nderojmë përhera, siç po bëjmë edhe sot në këtë Konferencë në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

**Hidajete AZIZI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **OLIVERA JASHAR-NASTEVA – MË SHUMË SE NJË BALLKANOLOGE E SHQUAR**

Të shumtë janë emrat e personaliteteve, dijetarëve, studiuesve e veprimtarëve të cilët me meritë janë bërë pjesë e aktiviteteve të deritanishme të manifestimit kulturor-shkencor “Ditët e Alfabetit”. Me rastin e përkujtimit të Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe, i cilësuar si një ndër ngjarjet më madhore në historinë e popullit shqiptar, këtë vit manifestimi “Ditët e Alfabetit” ka për temë qendrore figurën e gruas dhe rolin e saj në shoqërinë shqiptare. Në mesin e shumë grave të shquara, ndër të cilat s’do mend se do të jetë e pranishme para së gjithash Parashqevi Qiriazi, e vetmja grua që mori pjesë në Kongresin e Manastirit dhe një nga figurat kryesore të iluminizmit shqiptar e nismëtare e edukimit dhe emancipimit të gruas shqiptare, do të jetë e pranishme edhe njëra ndër dijetaret e hulumtueset më të shquara të linguistikës e të ballkanologjisë. Ky fakt më bën ta ndiej veten të nderuar dhe të privilegjuar meqë në mesin e gjithë këtyre burrave të pranishëm këtu, unë po paraqitem para jush jo vetëm në cilësinë e një gjuhëtareje, por edhe në cilësinë e një gruaje, për të shprehur këndvështrimin tim për një grua, për një bijë, nënë, bashkëshorte, por mbi të gjitha, për një studiuese të përkushtuar, siç është akademik Olivera Jashar-Nasteva.

Njeriu, sa është gjallë vlerësohet ose jo, ndërsa pasi të marrë rrugën e amshimit, kujtohet, qoftë për anën njerëzore të tij, qoftë për diturinë dhe punën e tij. E *“dituria është dashuri dhe dritë dhe vizion”* (Helen Keller). Sot jemi këtu për ta kujtuar, për ta rinjohur e për ta vlerësuar një njeri jo vetëm të ditur, por edhe të suksesshëm dhe me një vullnet të çeliktë. Vince Lombardi ka thënë: *“Dallimi mes njeriut të suksesshëm dhe të tjerëve nuk është mungesa e fuqisë, as mungesa e diturisë, por mungesë e vullnetit”*. Megjithëse dijetaren e mirënjohur ballkanologe, akademik Olivera Jashar-Nastevën, nuk e kam pasur fatin ta njoh nga afër, mbështetur në biografinë e saj, në punën e bërë me shumë seriozitet dhe në bagazhin aq të pasur të veprimtarisë së saj hulumtuese shkencore, të cilën na e la amanet në shkrimet e saj, do ta marr të drejtën që nga këndvështrimi i një gjuhëtareje ta cilësoj si një studiuese të

përkushtuar e të jashtëzakonshme. Ndërkaq, mbështetur në përshtypjet e studentëve, bashkëpunëtorëve e miqve të saj, të cilët e kujtojnë mbi të gjitha si një personalitet me shumë virtyte, nga të cilat veçojnë sjelljen e mirë e modestinë, do ta marr të drejtën ta vlerësoj si një personalitet të fortë, sepse *“sjellja e mirë (siç thotë poeti i njohur Khalil Gibran) është virtyt i të fortit”*. Thuhet që *“dituria flet, por urtësia dëgjon”*. E kur gërshetohen të dyja këto në një, s’do mend se përkujtimi fiton në peshë. Dhe sigurisht që nuk mjafton vetëm të përkujtohen personalitete të këtilla. Në këso rastesh, privilegji të cilin e ndiejmë të gjithë ne që jemi zotuar të flasim për këto personalitete, do të duhej të ndihej njëkohësisht si detyrim yni për t’i dhënë hapësirën e merituar dhe për të mësuar nga këto modele të rralla të shkencës. Ndërsa, në cilësinë e një ish-studenteje e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Fakultetin Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup, e ndiej për detyrim të rikujtoj që themelimi i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare dhe i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Turke ndodhi pikërisht si rezultat i përkushtimit dhe punës së palodhshme të kësaj veterane të shkencës e të arsimit. Mendoj që kjo edhe është arsyeja kryesore pse i detyrohemi kësaj figure të shquar. Të ndihmohet një komb që të ngrihet, të vësh gur në themelimin e një tempulli të dijes, do të thotë të prekësh përjetësinë, të bëhesh burim i mirësisë, e cila nuk shteron kurrë por vazhdon të ndjehet për çdo ditë, vit pas viti, te të gjithë ata breza që shkëlin e formësohen në këtë tempull. Ky akt, si një vlerë e vërtetë e humanizmit, është regjistruar në historinë e zhvillimit të arsimit shqip dhe turk në Maqedoninë e Veriut, dhe si i tillë lë gjurmë të pashlyeshme në këtë histori. Edhe sot e gjithë ditën, dyert e këtij tempulli, të cilat së bashku me studiuesin dhe veprimtarin e njohur Petro Janurën i hapi kjo dijetare dhe ku krahu për krahu me të ushtroi punën si pedagoge, vazhdojnë të jenë të hapura. E, siç thotë filozofi i madh Konfuci: *“Vlera e mësuës dhe pësja e qiellit nuk maten kurrë”*. Prandaj i ishin falënderues studentët e saj, bashkëpunëtorët e miqtë e saj shqiptarë e turq, prandaj sot i jemi falënderues edhe ne si Institucion shkencor shqiptar. E, kur të gjitha këto epitete, i bart mbi supë një personalitet i botës akademike, me titull akademik, atëherë kemi para vete një model për t’u lakmuar.

Kjo kumtesë ka për qëllim të vë theksin në angazhimin e saj hulumtues shkencor në fushën e ballkanologjisë. Ky angazhim ka në thelb kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike. Ajo ka bërë dhe ka dhënë shumë për këtë fushë sa atraktive, po aq edhe e ndërlikuar. E kush mund të na ofronte më shumë prurje dhe të hynte në labirintet e gjuhëve ballkanike më mirë sesa një

ballkanase me plotëkuptimin e fjalës, siç ishte Olivera Jashar – Nasteva, e cila i njihte mirë jo vetëm gjuhët ballkanike: shqipen, maqedonishten, turqishten, serbokroatishten, rumanishten, vllahishten, por edhe gjuhët evropiane, atë frënge e italiane!? Origjina e saj e përzier; kultura familjare e shoqërore; formimi arsimor dhe ushtrimi i profesionit të pedagogut në Katedrën e Gjuhës Maqedonase dhe të Gjuhëve Sllavojugore, në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare, në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke; të gjitha këto e bëjnë një ballkanase të vërtetë dhe e ndihmojnë dukshëm në orientimin e ballkanologjisë.

Në fokus të interesit të saj shkencor është ndikimi i ndërsjellë i gjuhëve që fliten në Ballkan, me theks të veçantë i gjuhës maqedonase, turke e shqipe. Trajtimi i gjuhës shqipe zë një hapësirë të konsiderueshme në studimet e saj. Madje edhe artikulli i parë i saj i botuar titullohet “Fjalët shqipe në gjuhën e fshehtë maqedonase”.<sup>47</sup> Ky artikull i hap rrugën një sërë botimesh nga fusha e ballkanologjisë dhe jo vetëm, me theks të veçantë në kontaktet dhe ndikimet e gjuhëve që fliten në Maqedoninë e Veriut. Edhe libri, të cilin në shenjë respekti e falënderimi ia botuan ish-studentët e saj dhe bashkëpunëtorët e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Fakultetit Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup, titullohet “Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike”. Shkrimet të cilat janë përmbledhur në këtë libër, janë vetëm një pjesë e krijimtarisë së saj të bujshme hulumtuuese shkencore, përgjithësisht e orientuar në studimet krahasimtare të gjuhëve ballkanike.

Në vazhdim do të veçojmë vetëm disa nga segmentet më të rëndësishme për gjuhët në kontakt, si ndikimi i ndërsjellë i këtyre gjuhëve; fenomeni i diglosisë e i bilinguizmit; paraqitja e tipareve të përbashkëta gjuhësore që i bëjnë këto gjuhë pjesë të Bashkësisë Gjuhësore Ballkanike; vendi i këtyre gjuhëve në këtë bashkësi e mjaft segmente të tjera të cilat Olivera Jashar-Nasteva i trajton imtësisht në këtë vepër. Mbështetur në gjuhën e gjallë popullore, e cila është një burim i pashtershëm dhe shumë më i pasur se gjuha e shkruar, para së gjithash konstatohet ndikimi i theksuar i maqedonishtes, në veçanti në sferën e leksikut, në të folmet e gjuhëve të tjera që fliten në Maqedoninë e Veriut, për periudhën e pas çlirimit (kohën e komunizmit), atëherë kur sipas autores “*huazimi u bë shumë më intensiv*”. Në këtë drejtim nuk janë me interes vetëm faktet gjuhësore që dalin në pah si rezultat i hulumtimeve të thella dhe i vjeljes së materialit dialektologjik në terren, por

<sup>47</sup> Olivera Jashar-Nasteva, “Албански зборови во македонските тајни јазици”. Македонски Јазик – Скопје, 1953.

edhe rrethanat shoqërore, politike, kulturore e historike në të cilat u zhvilluan këto gjuhë e ndikuan te njëra-tjetra. Me të drejtë autorja thotë që *“Huazimet ... janë edhe dokument për studimin e historisë së kaluarës si të maqedonasve, ashtu edhe të shqiptarëve e të turqve që jetojnë në simbiozë...”*.<sup>48</sup> Megjithëse edhe sot e gjithë ditën ndikimi i maqedonishtes në gjuhët e etnive të tjera që jetojnë në Maqedoninë e Veriut është shumë i thellë jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në të shkruarën, për kohën për të cilën flet autorja, ky ndikim do të jetë i theksuar në të gjitha sferat, si në sferën administrative, gjyqësore, shkollore, shëndetësore, ushtarake, kulturore e sportive, edhe për faktin e rrethanave shoqërore politike në të cilat maqedonishtja në cilësinë e gjuhës zyrtare, e gjuhës së medias dhe e procesit edukativ-arsimor kishte një rol tejet të rëndësishëm përkundër mungesës së theksuar të zhvillimit të arsimit e të mediave në gjuhët e etnive të tjera. Në këto rrethana maqedonishtja ndikoi dukshëm në zgjerimin e leksikut dialektor të gjuhëve të tjera jo vetëm përmes huazimeve nga leksiku i maqedonishtes, por edhe përmes huazimeve nga leksiku internacional ku maqedonishtja paraqitet si ndërmjetëse. S’do mend se këto faktorë kanë ndikuar tej mase që huazimet, për të cilat studiuësja Nasteva thotë që në masë të madhe kanë ruajtur edhe përbërjen fonetike e formën morfologjike për shkak të bilinguizmit të theksuar, të lëshojnë rrënjë thellë në këto gjuhë.

Një rëndësi të posaçme studiuësja Nasteva u kushton edhe kontakteve të këtyre gjuhëve sipas kriterit të hapësirës. Në këtë drejtim konstatohet ndikimi i shqipes mbi të folmet e maqedonishtes veçanërisht në rajonin e Maqedonisë Perëndimore ku ky kontakt qe më intensiv, si rrjedhojë e të cilit ndikimet vërehen jo vetëm në rrafshin leksikor por edhe në atë fonetik e morfologjik. Një vend të veçantë studiuësja Nasteva i kushton edhe ndikimit të turqishtes në këto gjuhë, duke u ndalur veçanërisht në kryqëzimet e përzierjet leksikore turko-maqedonase që kanë krijuar edhe lloje të ndryshme të hibrideve e që dalin si rezultat i simbiozës së gjatë gjuhësore dhe i bilinguizmit të shpeshtë. Në radhët e këtyre hibrideve zënë vend edhe ato elemente gjuhësore të cilat nga gjuha e folur kanë kaluar në onomastikë, respektivisht në patronimi e top-onimi. Nga këndvështrimi i një studiuëseje që e njihte mirë maqedonishten, turqishten dhe shqipen, do të kishte qenë me një interes të madh për studimet onomastike në këto gjuhë po të trajtohej edhe prania e elementeve

<sup>48</sup> Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*. Logos-A, Shkup, 1998, f. 14.

fjalëformuese (sufikseve) të maqedonishtes dhe mënyra e depërtimit të tyre në sistemin patronimik të shqiptarëve.

Për shkencën e linguistikës në përgjithësi, por edhe për disiplinën e ballkanistikës në veçanti, dukuria e diglosisë dhe e bilinguizmit ka një interes të posaçëm. Ballkanologia Olivera Jashar-Nasteva, duke qenë vetë dëshmitare e rrethanave në të cilat janë aktive këto dukuri në një bashkësi shumëetnike e shumëgjuhësore siç është Maqedonia e Veriut, prek deri në imtësi faktorët të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e diglosisë dhe të bilinguizmit kolektiv, i cili krahas substratit ballkanik, është një faktor i rëndësishëm në lindjen dhe përhapjen e ballkanizmave. Ballkanizmave u qaset si nga aspekti diakronik, ashtu edhe nga aspekti sinkronik. Mbështetur në një literaturë të pasur që trajton çështje nga më të ndryshme të gjuhëve anëtare të Bashkësisë Gjuhësore Ballkanike, trajton edhe vendin që zë gjuha maqedonase në këtë bashkësi gjuhësore, duke vënë në dukje afrimin e theksuar të maqedonishtes me gjuhët ballkanike josllave dhe largimin gradual të saj nga gjuhët sllave. Hulumtimet e bëra për gjuhët ballkanike që fliten në territorin e Maqedonisë së Veriut përfundojnë me konstatimin se *“Ballkanizmat në leksikun maqedonas në pjesën më të madhe të rasteve janë huazime të drejtpërdrejta që kanë hyrë përmes gjuhës së folur, në kontaktet e përditshme, sidomos përmes popullatës dygjuhëshe dhe shumëgjuhëshe, të vendit dhe asaj fqinje”,*<sup>49</sup> dhe se *“Pjesa më e madhe e ballkanizmave leksikore që gjenden në gjuhën maqedonase e kanë origjinën nga rajoni jugperëndimor i Maqedonisë”.*<sup>50</sup>

Prurjet e Olivera Jashar-Nastevës për studimet krahasimtare të gjuhëve ballkanike janë tejet të rëndësishme. Krijimtaria e saj hulumtuese shkencore shënon një ndihmesë dhe një vulë të pashlyeshme sidomos në studimin e leksikut dialektor të gjuhëve që fliten në Maqedoninë e Veriut në kushtet e interferencës gjuhësore, si rezultat i së cilës studiuesja konstaton krijimin e huazimeve të shumta leksikore, hibrideve e sintagmave të tëra dhe të shprehjeve e formulave frazeologjike të cilat *“reflektojnë botëkuptimet që kanë qenë të përbashkëta edhe për popullatën ballkanike sllave, edhe për popullatën ballkanike josllave”* dhe të cilat, siç thotë kjo dijetare, *“...flasim jo vetëm për dukuri dhe procese linguistike, por edhe për kryqëzime dhe përzierje më të thella psikologjike, që janë manifestuar përmes materies gjuhësore”*<sup>51</sup>

<sup>49</sup> Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*. Logos-A, Shkup, 1998, f. 138.

<sup>50</sup> *Po aty*, f. 139.

<sup>51</sup> Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*. Logos-A, Shkup, 1998, f. 182.

Për ta përfunduar, dua të them që Olivera Jashar-Nasteva jeton dhe do të jetojë për aq kohë sa vepra e saj do të jetë një nga referencat kryesore për ballkanistikën. Përveç kësaj, ajo do të kujtohet edhe si një grua fisnike, e fortë, e paluhatshme, shëmbëlltyrë për një kohë kur rreth vetes nuk kishte shumë gra të tjera të kalibrit të saj.

**Zeqirija IBRAHIMI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **OLIVERA JASHAR NASTEVA SI FAT I NJERIUT BALLKANIK**

Kur flasim për akademik Olivera Jashar Nastevën, vetë emri i saj imponon një sërë pikëpyetjesh dhe çështjesh, sepse – para se ajo të ishte ballkaniste – emri i saj shënjon identitetin e saj ballkanik. Nëse këtë do ta shtynim më tej, do të thoshim se Kratili kishte të drejtë kundrejt Platonit, në kohën antike, kur thoshte se emrat kanë një lidhje natyrore me sendet që i shënojnë. Së paku emri i akademik Olivera Jashar Nastevës është në favor të Kratilit.

Secili gjuhëtar i hapësirës sonë, por jo vetëm, kur e lexon emrin e saj, ky është asociacion i shumëfishtë: ballkanologe, e bija e beut të fundit dhe arketipi i identitetit ballkanik. Ajo është si shenja e baladave shqiptare të rinjohjes, ku mjafton një shenjë për ta rilidhur marrëdhënien.

Ndonëse emri i saj është i njohur në krejt institucionet më serioze lingvistike të rajonit dhe përtej, duhet ritheksuar se ajo nuk mbiu nga asgjëja, por – shprehur me fjalor ekonomik – ishte prodhim i një përpjekjeje shekullore familjare për iluminimin e popujve të kësaj hapësire. Ajo është mbesa e Jashar bej Kumbaraxhit, pjesëmarrës i Lidhjes së Prizrenit si delegat i Shkupit, si dhe e bija e Emin bej Kumbaraxhit, pjesëmarrës i Kongresit të Manastirit, po ashtu si delegat i Shkupit. Dhe, ajo si pasardhëse e këtyre personaliteteve, nuk kishte si të jetë ndryshe. Ajo është ndër kontribuueset më të rëndësishme të themelimit dhe mirëmbajtjes së Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Shkup, që për vite të tëra ka qenë çerdhja e vetme e mbrojtjes së shqipes në shkollën tonë në Maqedoninë e Veriut.

### **“E kujt është kjo ballkanologe?”**

Në analogji me pyetjen që e shtron Adela Peeva në emisionin dokumentar *“E kujt është kjo këngë?”*, ku secili nga popujt ballkanikë pretendon se ajo këngë i përket atij, edhe ne mund ta shtrojmë pyetjen *“E kujt është kjo ballkanologe?”*. Kur ajo shkruan për shqiptarët dhe për shqipen, si dhe kur mban leksione për gjuhën standarde shqipe, të bën të betohesh se ajo është ndër albanologët më të rëndësishme që i kemi (pasur) ne. Kur e sheh dukë

ligjëruar në universitetet turke dhe disertacionin e saj për turqizmat në gjuhën maqedonase, ajo të duket si një turkologe që ia kanë lakmi edhe studiuesit më të zellshëm të turkologjisë. Si e lindur në Beograd dhe e lidhur me gjuhët sllave, qoftë edhe për nga prejardhja e nënës, ajo do konsiderohej si një sllaviste dhe e lidhur pandashëm me gjuhët sllave. Ndërkaq, kur ajo flet për gjuhët romane, që ishin gjuhët që ajo i studioi me themel, ajo del si një romaniste e plotë. Aq më shumë që familja e saj e re do të ishte mes arumunësh. E tillë është Olivera Jashar Nasteva. Ajo është arketipi i *njeriut ballkanik (homo balkanicus)* ose tharmit i vetë identitetit ballkanik.

Megjithatë, ashtu si në romanet e Luan Starovës, ku identiteti inkluziv ballkanik del të jetë gati një relik, i tillë është pak a shumë edhe fati i ballkanologes sonë. Në kohën kur edhe gjuhësia u ndërtua dhe vazhdon të ndërtohet mbi premisa të nacionalizmit, të vetmit që nuk zënë vend janë gjuhëtarët si Olivera J. Nasteva, që – me punën e tyre herë-herë utopike – përpiqen ta ndërtojnë “gramatikën universale” të Ballkanit. Duke mos qenë pronë vetëm e një përkatësie, fati i tyre është se ata mbeten të dashur dhe të mohuar, njëherazi, gati nga të gjithë. Personalitetet e tilla i vlerëson secili, por meqë nuk mund t’i përfshijë në gardhin e vet etnik, rëndom mbeten “të askujt”. Kjo edhe mund të jetë arsyeja që ajo nuk e ka marrë ende vendin e saj të merituar as në sllavistikë, as në turkologji, as në albanologji, e as në romanistikë. Madje, shprehur me teorinë e Maria Todorovës, ajo mund të jetë një idealiste që – përkundër perspektivës eurocentriste ndaj Gadishullit – shpreson dhe punon që identiteti ballkanik të jetë një vlerë e shtuar e Europës, që ia vlen të kultivohet.

## Ballkanologia Oliver Jashar Nasteva

Nëse të tjerët nuk e kuptojnë rëndësinë e komunikimit të njerëzve, kulturave dhe botëve të tyre, këtë nuk ka mundësi të e mos e rrokin gjuhëtarët. Veçanërisht ata që kanë formim gjuhësor e kulturor përtej “kufirit” të tyre.

Olivera Jashar Nasteva, duke pasur formim të pjekur gjuhësor si lingviste, si dhe përvojën e njohjes së gati të gjitha gjuhëve ballkanike (nuk kemi informacion a e ka njohur greqishten), ajo ishte në gjendje t’i detektojë të gjitha interferimet e gjuhëve ballkanike.

Në librin e vetëm të botuar deri tash në gjuhën shqipe, “*Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*” (Logos-A, Shkup, 1998), që në fakt është përmbledhje e një pjese të kumtesave të saj, ajo flet për tema si: *Ndikimi i gjuhës maqedone*

*në të folmet shqipe dhe turke në Maqedoni; Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmet shqipe; Kryqëzime dhe përzierje leksikore turko-maqedonase; Zhvillimi i leksikut dialektor në kushtet e interferencës gjuhësore; Dyfishimi në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e tjera ballkanike; Gjuha maqedonase dhe gjuhët e tjera ballkanike; Vendi i gjuhës maqedonase në bashkësinë gjuhësore ballkanike; Vështrimi i leksikut të huaj në të folmet maqedonase etj.*

Siç mund të shihet edhe nga këto tema e, veçmas, nga thellësia e trajtimit të tyre, ajo duke ecur në gjurmët e Mikloshiçit, Waigandit, Skokut, Selishçevit e Shaban Demirajt, i zbulon interferencat gjuhësore ballkanike, që janë zhvilluar dhe zhvillohen nga kontakti mes gjuhëve të Gadishullit. Edhe ajo, si ballkanologët e tjerë, e pranon dhe, madje, e afirmon *lidhjen gjuhësore ballkanike*, që është krijuar nga gjuhët që mund të mos jenë të afërta nga aspekti tipologjik e, madje, edhe gjenealogjik, por që kontakti fizik u ka krijuar tipare të përbashkëta, që i tipizojnë si një *lidhje gjuhësore*, e cila studiohet në disiplinën e *gjuhëve në kontakt*.

Në këtë kontekst, përveç trajtesave leksikore, ajo i qaset edhe fenomenit tipik ballkanik të *rimarrjes* (ajo e quan *dyfishimi*), që është prezantuar gjerësisht edhe nga prof. Shaban Demiraj, si edhe nga studiuesit e tjerë të *lidhjes gjuhësore ballkanike*.

Në librin e përmendur, të botuar në gjuhën shqipe, është dhënë edhe bibliografia e punimeve të saj, që fillojnë që nga viti 1953, për të përfunduar diku në vitin 1998 (ajo ndërroi jetë më 2000), një listë e gjatë prej 135 njësisish, të botuara në revistat më prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare.

## Shkupi si “maternitet” i ballkanologjisë

Kur flasim për veprën e Akad. Olivera Jashar Nastevës, duhet të themi se – përkundër shumë studimeve të saj – të deklamuar në tubime të ndryshme shkencore në ish Jugosllavi dhe në vende të ndryshme europiane, vepra e saj e parë është botuar në vitin 1998 në gjuhën shqipe në Shkup nga SHB “Logos-A”, nën përkujdesjen e studentëve të saj, ku si redaktor i përgjithshëm është prof. Avzi Mustafa, ndërsa libri hapet me një recension të prof. Idriz Ajetit. Dhe, për koincencë, po kjo shtëpi botuese më 1994 e kishte botuar edhe veprën monumentale të ballkanologjisë nga një autor shqiptar, pra “Gjuhësia ballkanike” e prof. Shaban Demiraj, që po atë vit u botua edhe maqedonisht.

Kjo na shtyn të konstatojmë se nëse diku akoma ruhet ama primordiale ballkanike, ky vend duhet të jetë Shkupi. Fakti se në Shkup botohen këta dy

autorë e bën Shkupin një “maternitet” që e lind dhe e ushqen ballkanologjinë dhe, përmes këtyre dy protagonistëve të kësaj disipline, “Logos-A” dhe Shkupi mund të jenë botuesi dhe qyteti unik dhe tipik që kujdesen për studimin e kësaj *lidhjeje gjuhësore* dhe zhvillimin e kësaj fushe të gjuhësisë.

Nëse këtë argumentim do ta kishim shtyrë më tej, për të dëshmuar se ka institucione që akoma kujdesen për konservimin e identitetit ballkanik, mund të themi se i tillë është edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, që – pas shumë vitesh qëkur Akad. Oliver J. Nasteva i mungon botë sonë – po e organizon këtë akademi përkujtimore dhe promovuese për nder të saj. Në të vërtetë, ky është institucioni i vetëm në shtetin tonë dhe i rrallë në Gadishullin tonë, që ka departament të veçantë hulumtues të ballkanologjisë dhe, madje, çdo vit organizon konferencë shkencore të ballkanologjisë, në të cilën marrin pjesë studiues eminentë të ballkanologjisë nga vendi, rajoni dhe bota, qofshin ata historianë, gjuhëtarë, studiues të letërsisë, folklorit, muzikës, antropologjisë, etnologjisë etj.

Prandaj, nëse për diçka do të ishte e lumtur Akad. Olivera Jashar Nasteva, është se sot në qytetin ku ende ekziston shtëpia e familjes së saj është edhe një institucion shkencor shqiptar që, si miniaturë e identitetit ballkanik, e vazhdon traditën e studimeve ballkanike.

## EXHLALE DOBRUNA - SALIHU, NJË JETË KUSHTUAR ARKEOLOGJISË

*Shkup, 18.11.2020* – Dita e katërt e manifestimit "Ditët e Alfabetit" në ITShKSh-Shkup, iu kushtua iluministes së kohëve tona - Exhlale Dobruna Salihut, arkeologe e njohur, një metaforë e sakrificës për arsimin e lartë shqip në vendin tonë dhe sinonim i suksesit të Universitetit të Tetovës.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se profesoresha Exhlale dha një kontribut të çmuar në mbarëvajtjen e punës së UT-së që nga themelimi. "Ajo punoi atëherë kur ishte më së vështiri të punohej aty, vetëm e vetëm të arsimoheshin dhe edukoheshin gjeneratat e reja në frymën e shkencës së vërtetë kombëtare. Jemi të nderuar që sot e kemi me ne profesoreshën Exhlale, e cila më së miri e ka argumentuar shkencërisht lidhjen e pandërprerë ilire-arbërore-shqiptare të Shkupit dhe provincës së Dardanisë. Prandaj ajo zë vend të merituar në arkeologjinë shqiptare", theksoi Asani.

Bedri Muhadri – studiues nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, tha se Exhlale Dobruna rrjedh nga një familje atdhetare gjakovare, e cila kishte kultivuar arsimin dhe kulturën ndër gjenerata të tëra. Ajo i ka bërë shërbim të madh studiuesve të arkeologjisë shqiptare, meqë përmes veprave të saj e njohim më së miri historinë dhe arkeologjinë e Dardanisë.

Zana Hoxha – arkeologe dhe hulumtuese shkencore në degën e Historisë pranë Institutit Albanologjik të Prishtinës, përmes një video-prezantimi paraqiti një vështrim të gjerë të hulumtimeve shkencore arkeologjike të prof.Exhlale Dobruna-Saliu.

Historiani Besnik Rameti – hulumtues shkencor në ITShKSh, u ndal në disa nga veprat e prof.dr.Exhlale Dobrunës, parë nga rëndësia e tyre në rrafshin historik kombëtar, por edhe në kontributin e dhënë në arsimin e lartë shqip në Maqedoni.

Kurse, arkeologu Sali Islami – asistent hulumtues shkencor në ITShKSh, ritheksoi rëndësinë e studimeve arkeologjike të prof.Exhlales, të cilat janë pikë reference për studiuesit e rinj. Ai në veçanti theksoi kontributin e saj në studimin e artit skulpturor, përkatësisht plastikën dekorative në trevat e Dardanisë.

Në fund, të pranishmëve iu drejtua edhe vetë prof.dr. Exhlale Dobruna-Saliu, e cila u shpreh shumë e kënaqur për organizimin e manifestimit "Ditët

e Alfabetit”, dhe falënderoi Institutin për nderin dhe respektin e treguar ndaj punës dhe veprës së saj.

Ndryshe, dita e nesërme në kuadër të këtij manifestimi, i kushtohet një figure poashtu të madhe të Shkupit dhe mbarë njerëzimit, Gonxhe Bojaxhiut - Shën Tereza.



**Zana HOXHA**

*Instituti Albanologjik i Prishtinës*

## **VEPRIMTARIA SHEKENCORE E PROF.DR. EXHLALE DOBRUNA-SALIHU, ME FOKUS NE “SAXA LOQUUNTUR”**

Është nder dhe kënaqësi për mua të prezantoj veprimtarinë shkencore të arkeologës së parë shqiptare në Kosovë, prof. dr. Exhlale Dobruna-Salihu, e cila në fushë të arkeologjisë së antikitetit kushtuar dardaneve dhe trevës së Dardanisë është e spektrit të gjerë, ku me një varg punimesh dhe simpoziumesh në vend dhe jashtë tij në gjuhën kroate, angleze dhe gjermane, trajton çështje të ndryshme. Si focus në këtë punim do të flas për veprën e saj “Saxa loquuntur”. Pas një pune shumëvjeqare kërkimore-shkencore në teren dhe institute e muzeume arkeologjike në vitin 2016 në Prishtinë doli vepra e radhes, voluminoze, “*Saxa loquuntur*”(Gurët flasin).

Kjo vepër është një përmbledhje komplekse e punimeve të antikitetit, të botuara vetëm në gjuhën shqipe në revista të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë, si dhe të simpoziumeve të mbajtura në trojet shqiptare e të botuara në publikimet e trevës përkatëse, të cilat për temë studimi kanë pikërisht monumentet e gurit të të gjitha tematikave dhe kategorive: mbivarrore, të kultit, të nderit dhe arkitetkturore të një treve të gjerë ilire. Si pjesë integrale e veprës janë tri harta dhe materiali i pasur fotografik i ndërlidhur me tekst si dhe përmbledhjet në një rën nga gjuhët botërore të secilit punim. Arsyja e kesaj përmbledhjeje punimesh qendron ne ofrimin e mundësisë së studiuesve të arkeologjisë dhe të lexuesve tjerë të shkencës dhe kulturës të interesuar për këtë lëmi, që ky material të jetë më lehtë i qasshëm.

Kjo vepër, bazuar në trevën nga e cila janë trajtuar monumentet – me një pjesë të mirë të botuara për herë të parë – ku prin ajo dardane, është e ndarë në tre kapituj: I. *Monumentet e pjesës qendrore të Dardanisë (Kosoves)* II. *Monumentet e tërë Dardanisë* III. *Monumentet e trevave të tjera ilire*. Atyre iu praprin *Ecuria arkeologjike në Kosovë* dhe përfundojnë me *Ecurinë arkeologjike gjithëshqiptare*.

Duke filluar nga *Ecuria Arkeologjike në Kosovë (13-29)*, autorja na ofron të dhënat për punën në fushën e arkologjisë antike të kësaj treve që nga fillet e

saj në gjysmën e dytë të shek. XIX nga studiuesit e huaj dhe me radhë vendorët, para dhe pas luftës së fundit në Kosovë, përmes një analize të sfidave, mangësive rezultateve dhe perspektivës së mëtejshme.

**Kapitulli i parë** (31-287) fillon me punimin "Ndarja administrative e Kosovës në kohën romake" me qendrat kryesore antike, të dhëna edhe në hartë. Pason "Tipogjia e monumenteve mbivarrore të kohës romake në Kosovë", që është punimi i parë i autores, i cili u shkoqit nga magjistratura, si dhe i pari dhe i vetmi deri tash i realizuar për Kosovën nga ky aspekt. E veçanta e tij qëndron edhe në sistemimin e tij në tabelë. Është i publikuar edhe në revistën *Iliria* të Tiranës në shqip dhe fëngjisht.

Në punimet e tjera një vend me rëndësi zënë ato me monumente të studiura dhe publikuara për herë të parë nga e gjithë Kosova, duke filluar nga stela e gjetur në Pogradec të Gjilanit më 1980, ajo ushtarake nga Xërxa gjatë viteve '90 me emrin ilir *Andius* të legjionarit të ri i cili i takonte shtresës senatoriale, të pazakontë për moshën e tij dhe, me radhë shkrimet e tjera. Në mesin e tyre një vend të veçantë e zënë sidomos ato të trevës së Suharekës, ku autorja menjëherë pas luftës mbledhjen e monumenteve të zbuluara rastësisht e filloi mu nga këtu, ku doli edhe shtatorja e gruas dardane për herë të parë në Kosovë, që gjendet në kopertinë të librit, shtatorja e tpit "togatus" në kohë të fundit, e cila paraqet ekzemplar të vetëm në Dardani, altari i kultit me kapitelin e bukur të humbur e të rekonstruktuar nga autorja në bazë të fotove, si dhe elementet e shumta arkitekturore. Për hulumtim të monumenteve njëkohësisht vizitoi disa herë edhe dy treva të tjera: atë të Klinës, ku do veçuar bazamentet dhe kapitelët e Zllakuçanit, dhe trevën e Istogut, në të cilën tash vonë në Vrellë u gjet relievi i Liberit me shoqërues (*thiasos*), për t'u publikuar menjëherë nga autorja si një unikat në Dardani. Gjithashtu nuk la anash edhe trevat e tjera: atë të Prizrenit, ku do veçuar gjetjen e monumentit të bukur të demtuar dhe pa mbishkrim në Zhur, që mund të jete fjala për cipus mbivarror, trevën e Vushtrisë, ku në Strofc hasi në një postament të punuar në mermer të ngjashëm me atë të monumenteve të Ulpianës dhe në Duboc në pjesë shtyllash mermermeri të bardhë, si dhe trevën e Kaçanikut me monumentin me figurën e kalorësit, që në Kosovë paraqet rastin e dytë. Përmes mbledhjes së këtij materiali, të cilën të shumtën e realizoi me mjete vetanake, që pasoi me botimin e tij në dy punime, na bëri të mundur njohjen e shumë monumenteve të tematikave gjithëpërfshirëse anë e mbanë Kosovës. Nga monumentet e ruajtura në muzeume na ofroi ato nga Muzeu i Prizrenit, ato nga koleksioni i Shtëpise së Kulturës në Istog, të publikuara së bashku një një punim dhe,

sidomos ekzemplarët e rrallë nga Muzeu i Kosovës: shtatoren e gruas nga Ulpiana, relievin e nimfes nga Municipi DD dhe veçanërisht altarin e Deas Daradane nga Vendenisi të publikuar edhe në *Iliria* të Tiranës, si dhe dy ekzemplarë shumë të veçantë, një kokë gruaje të importit grek të nivelit të lartë artistik me frizure të stilit „*nodus*“, të greket „*korymbion*“, që paraqet monumentin më të hershem dhe, grupin statuar të Venerës me dy erosë, të gjithë po ashtu të përfshirë në një punim. Si tërësi të veçanta i përbëjnë dy grupe të tjera punimesh: të njëri grup pason studimi i monumenteve të tri trevave veçmas: të Llapit, të Gjakovës dhe të Mitrovicës, kjo e fundit e pasuruar edhe me gjetjet e reja në Municipin DD dhe një altari në fshatin Vllahi kushtuar Jupiterit me epitelin „*Cohortalis*“, funksioni i sakte i të cilit ende nuk mund të dihet të grupi tjetër pason trajtimi i monumenteve të importit nga Azia e Vogël me të dhëna të reja dhe i atyre të pordhimit lokal, në veçanti i tri poezive epigrafike në gjuhën latine (*carmina epigraphica*) për herë të parë të perkthyer në shqip nga autorja. Kapitulli mbaron me punimet „Studimi i varrit nëntoksor (kriptës) të antikitetit të vonë nga Vrella e Istogut“, që në fakt ka të bëjë me një kishez. **Kapitulli i dytë** (289-515) fillon me punimin „Për dardanët dhe Dardaninë në bazë të materialit arkeologjik“ të ilustruar me hartën e kësaj treve me qendrat antike, që është reagim ndaj publikimit „Iliri i Albanci“, SANU, Beograd 1988 rreth shtrembërimit të fakteve për tri çështje kryesore dardane. Këtu autorja e vë në spikamë rëndësinë e monumenteve të gurit, të cilat, me motivet e tyre dekorative dhe figurative, shumë qartë i dokumentojnë të tri këto çështje kyçe: përkatësinë etnike ilire të dardanëve, shtrirjen territoriale të tyre dhe prejardhjen ilirie të shqiptarëve, e rrjedhimisht autoktoninë e shqiptarëve edhe në trevën e Dardanisë.

Këtë në veçanti autorja e ka dëshmuar të një grup punimesh të monumenteve mbivarrorë, siç janë bust-portretet e shumta të realizuara në artin autokton, ilir, në traditën e punimit në dru nga mjeshtrit popullorë, auto-didaktë, ku të gratë janë theksuar elementet e veshjes vendase. Të motivet e kultit, të cilat janë më të shumta, gjenden ato, të cilat tek ilirët kanë qenë mjaft të përhapura që nga parahistoria: astrale, të lidhura me besimin e vazhdimësisë së ekzistencës së shpirtit në mes yjeve dhe i gjarpërit, i cili si shtazë kultive zente një vend me rëndësi. Të dy këto simbole edhe sot hasen në kryqet e varreve të disa zonave të banuara me shqiptarë. Përkitazi me kultet, në një tërësi janë inkuadruar punimet në të cilat studjohen monumentet e këtij karakteri si me paqaritje figurative, ashtu edhe me mbishkrime. Në njërin

punim janë trajtuar “ Perënditë e plleshmërisë dhe të vegjetacionit”, ku një vend me rëndësi e zënë monumentet e Dionisit-Liberit, perëndisë së hardhisë së rrushit, nën të cilin mëshifet një perëndi e vjetër ilire. Këtu autorja, ka veçuar sidomos kater monumente: dy altarët epigrafikë nga territori i Naisit ku së bashku me Liberën mbajnë epitetet e “gëzimit” dhe dy pllaka: njera me Ariadnen (Liberen) nga Barova ne territorin e Skupit dhe tjetra nga Vrella, ku, i paraqitur në grup në një çast dëfrimi dhe gëzimi, dëshmon se kjo perëndi në të gjithë Dardanië nderohej edhe me këtë tipar. Në punimin tjetër kanë zënë vend “Perënditë e pyllit”: Diana nga treva e Skupit, e veshur me dalmatikë, për të dëshmuar se edhe në Dardani nderohej kulti i Dianës ilire, si dhe altari i zbuluar rishtas **nga Ulpiana** me përkushtimin e formës së rrallë të nimfave të quajtura silvestra, që paraqet rastin e vetëm në Dardani. Në punimin e radhës, në kuadër të publikimit të gjetjes më të re të altarit të perëndisë trakase, Zbeltiurd, në Kosovë, trajton edhe përkushtimin tjetër epigrafik të gjetur në Kaçanik dhe te tri **pllakave** figurativeve nga Naisi dhe Timak minusi, duke ofruar dëshmi se kjo perëndi me një numer të vogël monumentesh nderohej edhe në Dardani. Një punim, ku po ashtu një rol e luajnë perënditë, ia ka kushtuar një çështjeje tjetër; këtu bazuar në monumentet e trinisë hyjnore të mjekësisë, si dhe të një monumenti mbivarror kushtuar një mjeku ushtarak dhe gjetjeve të pajisjeve mjekësore në varrim e një mjeku vendas në Shkup, të cilat autorja i ka studiuar në detaje, e ka trajtuar “Mjekësinë në Dardani”. Një çështje të një natyre krejt tjetër e ka studiuar edhe në punimin në të cilin e trajton “Motivin e dorës në monumentin nga Skupi”, ku, bazuar në prejardhjen semite dhe praninë në pllakat e varrit të hebrenjve, të pranishme edhe në Kosovë, përfundon se ky monument dëshmon praninë e hebrenjve që herët në trevën dardane. Një tërësi më vete përbëjnë dy punime të përafërta tematikisht: njëri “Përhapja e Krishtërit në Dardani”, që paraqet të dhënat e shkruara dhe ato materiale që nga martirizimi i Florit dhe Laurit deri te bazilikat e hershme krishtere në rrënoja apo të mbuluara nga ato sllave; tjetri “Mbi ndërtimet dhe rindërtimet urbane të Justinianit I në trevën dardane”, ku, po ashtu, duke u bazuar në të dhënat e autorëve të kohës së këtij perandori dhe të monumenteve të gurit – rrënojave arkitekturore të Justianës së Parë, - që mendohet se mbetje e akropolit të tij është muri ballor në anën veriore dhe verilindore të kalase së Shkupit i ndërtuar nga gurët e Skupit antik, si dhe të mbetjeve arkitekturore të Justianës së Dytë në qytet dhe kastrumit jashta mureve, autorja gjerësisht është koncentruar në këto dy qendra. Kapitulli mbaron me punimin “Mbrotjtja e monumenteve të luajshme arkelogjike”.

Në **Kapitullin e tretë** (517-610), ku trajtohen monumentet e trevave të tjera ilire, autorja temë kryesore studimi i ka monumentet karakteristike të ilirëve të të dy tematikave. Nga ky aspekt punimet i ka ndarë në dy tërësi. Njërën e përbëjnë dy punime ku zënë vend monumentet mbivarrore me dy tipa kryesorë: cipusë dhe urna, të cilat janë shprehje e ruajtjes së identitetit. Tërësia tjetër e punimeve objekt studimi ka kultet, duke u përqëndruar në punimin “Diana ilire”, e cila paraqet njërën ndër perënditë kryesore të Pantheonit ilir. Për karakterin autokton të saj autorja ofron dëshmi ikonografike nga provinca e Dalmacisë, ku paraqitet me veshje ilire, shaminë e madhe mbi kokë dhe fustanin e tipit të fustanellës, si dhe dëshmi gjuhësore nga provinca e Panonisë, ku del me emrin vendas Thana. Gjurmët e kultit të saj i gjejmë të gjalla edhe sot të shqiptaret, ku rron si Zana. Kapitulli përfundon me punimin e radhes “Mbi emigrimin ilir gjatë antikitetit”, kryesisht në Daki, ku me një interes të veçantë janë dy pllaka relievo me mbishkrim, të përkushtuara nga dardanët, në të cilat për herë të parë doli perëndesha dardane e kompletuar figurativisht dhe epigrafikisht, që edhe shërbeu për identifikimin e shtatores së gruas nga Medina me Dean Dardane.

Duke e përmbyllur me *Ecurine arkeologjike gjithëshqiptare* (611-619), autorja e shtron si çështje me rëndësi qasjen e re arkeologjike të mbarë kësaj hapsire.

Si konkludim, shprehet recenzenti *Prof. Dr. Shefki Sejdiu*, mund të themi se vepra *Saxa loquuntur* (“Gurët flasin”) e arkeologes Prof. Dr. Exhlale Dobruna-Saliu, ku një pjesë e mirë e monumenteve publikohen dhe trajtohen për herë të parë, të cilat autorja i ka hulumtuar falë tokës dardane dhe përçark asaj të trevave të tjera ilire që i kanë ruajtur me shekuj, bën vërtetë që të flasim e shkruajmë se kjo vepër motivon dhe inkurajon edhe më tepër që Dardaninë dhe më gjerë, tërë territorin ilir edhe më tej ta hulumtojmë dhe njohim.

Në fund, do të theksonim se, kjo vepër si e tillë, me një interpretim shkencor të monumenteve të marra në shqyrtim dhe literaturë të pasur të karakterit botëror, si dhe përgatitje teknike sipas normave ndërkombëtare, sa do të jetë në shërbim të studiuesve të arkeologjisë, aq do të jetë edhe në shërbim të opinionit të gjerë e të interesuar për këtë lëmi.

**Bedri MUHADRI**

*Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë*

## **EXHLALE DUBRUNA DHE ARKEOLOGJIA DARDANE**

Prof. dr. Exhlale Dobruna-Saliu është emër i njohur në qarqet intelektuale në të gjitha hapësirat shqiptare, si autore e veprave, artikujve të shumtë me karakter studimor dhe publicistik në revista shkencore dhe gazeta ditore, pjesëmarrëse dhe kontribuese në veprimtari të shumta dhe të larmishme shkencore, arsimore dhe social-kulturore, në tubime, tryeza dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ku me të drejtë sot po nderohet nga Instituti i Trashigimisë Shpirtrore e Kulturore të Shqiptarëve –Shkup. Znj. Exhlale Dobruna-Saliu, bija e një prej familjeve më të njohura patriotike dhe intelektuale nga Gjakova e cila nga gjiri i saj nxorri ekonomistë, juristë, kimistë, inxhinierë, arkitekë, historianë, mjekë, profesorë, luftëtarë, edukatorë, dashamirës të dijes, të cilët kanë transportuar dhe shpërndarë libra që nga Gjeçovi dhe deri në ditët e sotem. Është normale dhe e logjikshme që njëra ndër figurat më të spikatura të brezit të sotëm të kësaj familje, si dhe arkeologja e pare e diplomuar në Kosovë të na sjellë rezultate serioze për shkencën shqiptare.

Veprimtaria shkencore e E. Dobruna-Saliu në fushën e arkeologjisë së antikitetit, të cilën ia ka kushtuar dardanëve dhe trevës së Dardanisë gjatë periudhës romake, është e spektrit të gjerë, ku pos skulpturës, që e ka specializim të ngushtë, trajton edhe çështje të tjera arkeologjike nga kjo periudhë, si epigrafi, onomastikë, kulte, etnografi etj.

Veprat e prof. Dobruna-Saliu janë fryt i një pune studimore të kujdeshme shumëvjeçare, ku na paraqet ndriçimin e shumë aspekteve të jetës ekonomike, shoqërore, etnike dhe të religjionit në trevat e Dardanisë.

Exhlale Dobruna-Saliu u ka bërë një shërbim të madh studiuesve të arkeologjisë shqiptare, pasi ka sjellë rezultatet e një pune të gjatë, sistematike e hulumtuese, ku lexuesit me anë të librave dhe shkrimeve të shumta të saj do të kenë mundësinë të pasurojnë njohuritë e tyre për artin skulpturor dhe të veprimtarisë kulturore-artistike në përgjithësi në Dardani gjatë kohës romake, por ajo mbi të gjitha vë në pah përmbushjen e një detyre morale ndaj shkencës shqiptare dhe atyre që do studiojnë më detajisht këtë periudhë kohore.

Mjafton që t'ia hedhësh sytë burimeve muzeore e literaturës që ka shfrytëzuar ajo, do bindesh për seriozitetin në punë të kësaj autoreje dhe për vlerat reale të veprimtarisë së saj kërkimore-shkencore. Libri i prof. Exhlale në dy vëllime *“Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës Romake: Sepulkrale dhe e kultit”* i botuar në Prishtinë nga Instituti Albanologjik i Prishtinës më 2003, është një monografi bazë për çdo studim të mëtejshëm të monumenteve, jo vetëm të Dardanisë antike, por edhe më gjerë, do ta vlerësonte prof. dr. Marin Zaninovic nga Fakulteti Filozofik i Zagrebit. Monografia ka 1029 faqe, është i ndarë në dy pjesë dhe në 12 kapituj, duke shtjelluar lëndën në mënyrë sistematike, si: shfrytëzimi, interpretimi dhe analiza e burimeve, por edhe duke u mbështetur në metodologji shkencore-bashkëkohore, sipas një renditjeje kronologjike, me sqarime dhe plotësime përcjellëse, me foto që flasin, tabelat, hartat, treguesin e emrave, shkurtesa etj.

Librin e bëjnë me peshë të rëndësishme disa faktorë kyç, duke filluar me zhvillimin urbanistik të trevave të Dardanisë, duke pasuar me studimin e materialit, i cili është realizuar sipas principit të ndarjes së monumenteve të secilit grup tematik në kategoritë përkatëse, të cilat më parë është trajtuar tipologjia, e pastaj analiza e hollësishme e motiveve dekorative dhe e paraqitjeve figurative. Gjatë analizës prof. Exhlale ka bërë përpjekje, të kontaktojë prejardhjen dhe krahasimin e tyre me ato të ngjashme në monumentet përkatëse të trevave dhe provincave të tjera romake. Profesoresha ka arritur të nxjerrë rezultate dhe konstatime të vlefshme, të cilat i ka vënë në pah edhe gjatë trajtimit të secolës kategori të monumenteve plastike sipas grupit tematik përkatës brenda të dy pjesëve të veçanta, prandaj edhe ka përmbledhur atë më të rëndësishme, duke e dhënë fjalën përfundimtare.

Prof. Dobruna-Salihu në studimet e saja serioze ka arritur të konstatojë se ashtu si në provincat e tjera romake, edhe në trevën dardane në rastin e takimit me civilizimin romak bëhen ndryshime edhe në fushë të kulturës dhe të artit, që ka kontribuar edhe në zhvillimin e artit të plastikës në gur. Sipas prof. Exhlale në këtë kohë zënë fill monumentet plastike të tematikave dhe kategorive të ndryshme, ku vendin kryesor e zënë ato sepulkrale dhe të kultit, të cilat, siç kemi parë, paraqiten në numra të mëdha dhe janë të shpërndara në të gjitha trevën. Andaj studiuesja Dobruna –Salihu e argumenton rëndësinë për studimin e artit antik në përgjithësi dhe atij plastik në veçanti të kësaj treve, meqë me analizën e tyre ikonografike dhe stilistike mund të ndiqet zhvillimi i artit në fushë të plastikës, si njërit ndër drejtimet kryesore të artit gjatë kohës romake.

Gjatë trajtimit të materialit të pasur në dy librat voluminoz "*Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës Romake: Sepulkrale dhe e kultit*" prof. Exhlale ka vërejtur se në krijmtarinë e kësaj fushe të artit në gur nuk ka ndikuar vetëm arti skulpturor romak, por edhe ai grek dhe lindor, ashtu që përveç ndikimeve nga Italia e Veriut, këtu kryqëzohen edhe ndikimet nga Greqia dhe Lindja (nga Azia e Vogël dhe me një pjesë të vogël edhe nga Siria), të cilat te ne kanë ardhur përmes dy rrugëve : të tërthortë nga provincat fqinje dhe të drepëdrejtë me anë të ushtarësh e veteranësh dhe civilësh, andaj profesoresha duke i studiuar të gjitha këto komponente në kombinim me elementet vendase, lokale, ka ardhur në përfundim se është krijuar arti karakteristi i plastikës së kësaj treve.

Mendoj se mënyra e zgjedhur për të hartuar këtë monografi do të zgjojë kureshtjen te lexuesi dhe studuesit e gjeneratave të ardhme, pasi autorja ka bërë një harmonizim dhe ridimensionim të problemeve në tërësi të artit në periudhën romake, të cilat ajo i sheh të kushtëzuara nga faktorët e natyrës së ndryshme: gjeografike, në një anë, dhe ekonomiko-shoqërore, në anën tjetër.

Hulumtuesja e zellshme prof. Dobruna-Salihu, me një punë të palodhshme, ka realizuar në një shkallë të lartë shkencore, monumentet plastike në trevën dardane duke vënë bazat dhe hapur dyert kërkimeve të reja në këtë sferë studimore, të cilat e përbëjnë: Titullët (pllakat), Stelat, Medaljonet, Altarët, Cipunët, Sarkofagët, Skulptura të plotë, Pllakat (relievet). Në bazë të rezultateve të arritura konkludojmë se nuk kemi të bëjmë me një përpjekje të rëndomtë për të shkruar, por me një vepër serioze që e plotëson dhe pasuron këtë fushë të dijes.

Botimet dhe veprimtaria kërkimore-shkencore e prof. dr. Exhlale Dobruna-Salihut është një sukses i madh jo vetëm individual i autores, por edhe për veprimtarinë shkencore dhe edukative ku ajo dha kontributin e saj, si në fillimet e karrierës te Instituti i Historisë-Prishtinë, pastaj Instituti Albanologjik i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Prishtinës dhe ai i Gjakovës. Të rejat që sjell, interpretimet origjinale, janë me vlerë të padiskutueshme, që do të shërbejnë si burime për studiuesit e arkiologjisë dhe historisë së kohës së vjetër dhe do t'i krijojnë mundësi brezit të ri të njohë ngjarjet e njërës prej periudhave më interesante të historisë së trevave tona.

**Besnik RAMETI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **NJË STUDIUESE QË I FLET DHE I SHKRUAN NËNTOKËS DARDANE**

Të shkruash për biografinë dhe bibliografinë e Prof. dr. Exhlale Dobruna - Salihu, është nder për mua sepse gjithë jetën e vet të studimit dhe hulumtimit ajo ia kushtoi arkeologjisë si shkencë, posaçërisht duke hulumtuar mbi lashtësinë e Dardanisë dhe Ilirisë gjatë periudhës romake.

Profesoresha Exhlale Dobruna - Salihu punën shkencore e kryen me përkushtim dhe pasion të veçantë, për çdo gjë që lidhet me arkeologjinë, që nga skulptura e deri te artefaktet të tjera, të cilat janë dëshmi e kërkimit sistematik në këtë fushë hulumtuese arkeologjike mbi territorin e Dardanisë.

Prof. Dr. Exhlale Dobruna - Salihu u lind në Gjakovë më 1 dhjetor të vitit 1949, shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në vendlindje, ndërsa studimet i vazhdoi në Universitetin e Zagrebit, Departamenti i Arkeologjisë pranë Fakultetit të Filozofisë, ku dhe në vitin 1972 diplomoi. Në vitin 1975, po ashtu në Universitetin e Zagrebit iu dha titulli magjistre e shkencave të arkeologjisë, duke mbrojtur temën: “Monumentet sepulkrale antike të Ilirisë së jugut”. Pas një pune të palodhshme hulumtuese në fushën e arkeologjisë, në Universitetin e Zagrebit, Departamenti i Arkeologjisë pranë Fakultetit të Filozofisë, më 25.05.1995 mbrojti temën e disertacionit të doktoraturës: “Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake”, para komisionit në përbërje nga: Prof.dr. Marin Zaninoviç, Prof.dr. Nenad Cambi dhe Prof.dr. Nives Majnariç - Pandjiç.

Në vitin 1973 ajo u punësua në Institutin e Historisë në Prishtinë, ndërsa nga viti 1977 e deri në vitin 2014 punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Sektorin e Arkeologjisë, me titullin këshilltare shkencore. Nga viti 1995 deri në vitin 2001 ligjëroi në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik - drejtimi Histori. Kurse tani ligjëron në Departamentin e Antropologjisë kulturore në Fakultetin e Filozofisë në Prishtinë.

Si arkeologe e periudhës së antikitetit, veprimtaria shkencore të cilën ua kushton dardanëve dhe trevës së Dardanisë gjatë kohës romake, është e spektër i gjerë, ku pos skulpturës, trajton edhe çështje të tjera arkeologjike

nga kjo periudhë. Nga kjo fushë e studimeve ka botuar një numër të madh të punimeve shkencore në revistat e njohura shkencore të vendit dhe jashtë tij, si dhe ka marrë pjesë në shumë tubime shkencore në trojet shqiptare dhe ato ndërkombëtare, në Evropë dhe në Amerikë. Specializim të ngushtë e ka plastikën (skulpturën) e antikitetit, por gjithashtu merret edhe me çështje tjera arkeologjike nga koha romake si epigrafi, entologji, onomastikë, kulte etj. Në fushën e këtyre hulumtimeve dhe studimeve ka botuar një numër të madh të librave, punimeve shkencore, artikujve etj.

Punimet më të rëndësishme të botuara nëpër revista shkencore janë: "Tipologjia e monumenteve sepulkrale të periudhës romake në Kosovë" (1977), "Tipat e monumenteve sepulkrale tek ilirët" (1980),

"Plastika dekorative dhe figurative e stelave mbivarrore të periudhës romake në Kosovë" (1984), "Plastika e kultit në Dardani" (1989), "Sargofagët e gurit me dekorime në relief gjatë periudhës romake në Dardani" (1992), "Mbi dardanët dhe Dardaninë në bazë të materialeve arkeologjike" (1995), "Mbi besimin në jetën e amshueshme në pjesën qendrore të Dardanisë në bazë të monumenteve sepulkrale" (2005), "Qasja e re në arkeologjinë kosovare dhe gjithëshqiptare" (2015), etj.

Gjithashtu prof. Dobruna - Salihu me një përkushtim të madh në fushën e hulumtimit shkencor, i finalizoi veprat shkencore: "Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake - Sepulkrale dhe e kultit" - botuar në dy vëllime (2003, 2005), nga Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Ndërsa, në vitin 2016 e botoi veprën me titull: "Saxa loquuntur - Gurët flasin", po ashtu nga Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Vepra "Gurët flasin" paraqet një punë tejet serioze në fushën e arkeologjisë, që autorja ia kushton territorit të Dardanisë, që përfshin më tepër pjesën qendrore të saj (Kosovën). Vepra është e mbështetur në dëshmi materiale të gjetura në rajonin e Dardanisë, duke shkruar për etnogjenezën, kufijtë dhe vendbanimet dardane, duke u mbështetur tek autorët antik dhe të gjithë ata të cilët kanë shkruar për antikitetin në Ballkan. Mjaft të dhëna interesante aty gjejmë edhe për qytetet dhe vendet në lashtësi si Nishin (Naisus), Shkupin (Scupi), Velesin (Vilazorën), Malin Sharr (Scardus Mons), etj.

Veprimtaria e saj hulumtuese - shkencore në fushën e arkeologjisë ka një vlerë të madhe në mbarë trojet shqiptare. Ndër arkeologet e para shqiptare në Kosovë, ajo ka dhënë një kontribut të madh, pa kursyer fare kohën dhe mundin që të jetë në shërbim të shkencës arkeologjike, por edhe për edukimin e brezave të rinj në këtë fushë.

Një kontribut të jashtëzakonshëm ajo dha që nga hapja e Universitetit të Tetovës, duke ligjëruar lëndën e Arkeologjisë në Fakultetin Filozofik - drejtimi i Historisë, që nga viti 1995 e deri në vitin 2001, duke qenë jo vetëm se njëra ndër profesoreshat e para të këtij universiteti, por edhe si një pedagoge shembullore e cila i edukoi disa gjenerata historianësh të rinj në fushën e arkeologjisë.

Profesoreshës Exhlale Dobruna - Salihu iu ndanë edhe shumë mirënjohje dhe dekorata si në vend dhe ato ndërkombëtare, për meritat e saj profesionale e jetësore.

Për fund, profesoreshës së nderuar i urojmë shëndet, jetëgjatësi dhe të na befasojë me vepra të reja!

**Sali ISLAMI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **PËR MONOGRAFINË “PLASTIKA DEKORATIVE DHE FIGURATIVE E GURIT NË DARDANI GJATË KOHËS ROMAKE – SEPULKRALE DHE E KULTIT I DHE II”**

Ndihem i privilegjuar të flas për veprimtarinë shkencore të arkeologes së parë shqiptare në Kosovë, prof. dr. Exhlale Dobruna-Saliu, e cila në fushë të arkeologjisë së antikitetit, pos studimeve dhe punimeve të shumta kushtuar dardanëve, si dhe pjesëmarrjes në simpoziume, ku, krahas skulpturës që e ka specializim të ngushtë, trajton edhe çështje të tjera nga kjo periudhë, si epigrafinë, onomastikën, etnografinë, etj., na i solli edhe dy publikime të veçanta të botuara nga Instituti Albanologjik në Prishtinë. I pari, të cilin do ta prezantoj këtu, “Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake – Sepulkrale dhe e kultit” në dy vëllime voluminoze e percjellë me një rezymë 100 faqeshe në anglisht u botua në vitet 2003-2005 dhe së pari u promovua në Universitetin e Pulës në Kroaci, ka të bëjë me tezën e doktoratës së punuar dhe mbrojtur në Universitetin e Zagrebit më 1995.

Duke u nisur nga fakti se një studim i tillë komplet nuk ishte bërë, këtë monografi ia ka kushtuar këtij studimi, duke u përqëndruar vetëm në shqyrtimin e plastikës sepulkrale (mbivarrorre) dhe asaj të kultit, të cilat këtu janë trajtuar në tërësi të veçanta në vëllimin e parë, meqenëse secila prej tyre paraqet një grup tematik më vete. Te secili grup është aplikuar analiza e hollësishme e motiveve dekorative dhe e paraqitjeve figurative. Gjatë kësaj analize ka arritë që, përbri interpretimit simboliko-religjioz të motiveve, të konstatojë prejardhjen dhe krahasimin e tyre me ato të ngjashme në monumentet përkatëse të trevave dhe provincave të tjera romake. Këtu në radhë të parë vijnë në konsiderim këto: në një anë, pjesa tjetër e Mezisë së Epërme, meqë kjo treve, edhe pse etnikisht paraqet një tërësi më vete, në kohën romake deri në fund të shekullit III në kuptimin administrativ paraqiste pjesë integrale të kësaj province dhe, në anën tjetër, provincat e banuara me ilirë (në rend të parë këtu është provinca e Dalmacisë, meqë ka hasë në më shumë ngjashmëri), duke marrë parasysh përkatësinë ilire të dardanëve. Pasataj vijnë

trevat dhe provincat e tjera të afërta dhe të largëta. Njëkohësisht ka bërë përpjekje që të vërtetojë praninë dhe zhvillimin e p u n ë t o r i v e vendëse për të dy grupet tematike së bashku, ku edhe është prodhuar numri më i madh i monumeteve të plastikës, sidomos ato të karakterit sepulkral. Kështu, në bazë të analizës së deritashme të tyre nga aspekti stilistiko-ikonografik, ka arritë që ta lokalizojë pjesën më të madhe të këtyre atelieve, ku më të hershmet i takojnë fundit të shekullit I, së cilave iu prin ajo e Skupit (Shkupit të sotëm), ndërsa më të vonshmet fundit të shek. III, për të perfunduar me një atelie të rangut të lartë nga çereku i parë i shek. IV në Naissus (Nish të sotëm). Në këto atelie, ku numri më i madh i kesaj plastike është nga guri gëlqeror, kryesisht ndihet dora e gurskalitësve vendas, pjesën më të madhe të të cilëve e përbëjnë ata pak të shkolluar dhe autodidaktë, ndërsa një pjesë të vogël ata të shkolluar mirë, apo të huaj, të cilët sidomos vepruan në ateliene e Naisit. Ndërkaq, plastika e kultit kryesisht u punua në mermer dhe pjesa më e madhe e asaj së realizuar në skulpturë dhe pllaka i takon importit - e para atij atik dhe nga Lindja të cilësisë së lartë, kurse e dyta nga trevat lindore fqinje e prodhuar në menyre serike. Pas analizës së materialit, në vëllimin e dytë, pason k a t a l o g u i monumenteve, ku ato janë sistematizuar sipas tematikës e kategorive dhe tipologjikisht sipas trajtës e llojit të dekorimit brenda kategorisë përkatëse, në bazë të principit gjeografik, me pikënisje nga kolonia Skupi, në pjesën jugore, deri te Timacum minus (Ravna), në veri. Materiali i tij ilustrues gjendet në fund dhe është i përbërë nga fotografitë (358 sosh) dhe katër harta të trevës së Dardanisë.

Kjo vepër, si e tillë, është fryt i punës shumëvjeçare, gjatë së cilës autorja ka hasur edhe në vështirësi. Për mbledhjen dhe njohjen sa më të mirë të materialit dhe verifikimin e tij, më parë është vizituar krejt kjo trevë, sidomos: e tërë Kosova, Maqedonia, Serbia, etj. Pjesa më e madhe e tyre ruhet nëpër muze, ku për numrin e monumenteve dallohen: Muzeu i Maqedonisë (Muzej na Makedonija) në Shkup dhe Muzeu Popullor (Narodni Muzej) në Nish. Një pjesë e vogël gjendet në institucionet tjera të karakterit të ngjashëm, apo të karakterit tjetër, si dhe në prona private, apo në vendgjetje. Me këtë rast ka marrë në studim edhe një pjesë të monumenteve ende të pabotuara, të cilat gjenden të ekspozuara në ndonjërin nga muzetë e cekura, ose edhe në prona private. Kështu, kjo vepër është pasuruar edhe me një numër të mirë monumentesh të panjohura deri atëherë, të cilat janë më të shumta në pjesën jugore dardane. Krahas mbledhjes së materialit, një pjesë të mirë të kohës ia ka kushtuar mbledhjes së literaturës për studimin e këtij materiali, për ç'arsye ka

qëndruar në institucione shkencore dhe biblioteka në qendrat e njohura të Ballkanit dhe në Itali. Në këtë rast veçon Muzeun Arkeologjik (Arheološki muzej) në Zagreb, në të cilin e ka kaluar një pjesë të mirë të kohës dhe, Institutin Arkeologjik Gjerman (Deutsches Archäologisches Institut) në Romë, në të cilën qendër ka qëndruar gjatë vitit 1987 si bursiste e qeverisë italiane, me ç'rast ka pasur mundësi të hulumtojmë edhe në institucione të tjera. Kështu që, kjo vepër, përmban edhe një literaturë të pasur që, padyshim, edhe më tej do të jetë në shërbim të gjeneratave të reja për trajtim të temave të ngjashme.

Në fund duhet thënë se trajtimi i plastikës së gurit në Dardani gjatë kohës romake është i rëndësishëm, jo vetëm për studimin e artit skulpturor në veçanti dhe të veprimtarisë skulpturore-artistike e kulturore në përgjithësi, duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve me rëndësi në fushë të artit në përgjithësi dhe të plastikës së gurit në veçanti të kësaj treve, por edhe për ndriçimin e shumë aspekteve të jetës ekonomike, shoqërore, etnike dhe të religjionit në këtë trevë, e në kuadër të kësaj edhe raportet e dardanëve ndaj elementeve dhe ndikimeve të huaja. "Me këto tipare paraqet nje vepër bazë për çdo studim të mëtejshëm të monumenteve, jo vetëm të Dardanisë antike, por edhe më gjerë" shprehet recenzuesi, prof. dr. Marin Zaninoviç.

Krejt në fund duhet thënë se prof. dr. Exhlale Dobruna-Saliu me punën dhe përkushtimin e saj, ka bërë që për neve gjeneratat e reja të jetë pikë reference, sidomos mbi Dardanët, duke shpresuar që mësimet, metodat dhe puna e sajë të vazhdojë të përmendet, e debatohet, si dhe të vlerësohet akoma më shumë në të ardhmen.

**Exhlale DOBRUNA-SALIHU**

*Arkeologe*

## **UNË KËTË VEPRIMTARI E BËJ ME SHUMË VULLNET PASI KA TË BËJË ME KULTURËN E TË PARËVE TANË**

### **-fjalë falënderimi-**

Ju përshëndes të gjithëve,

Me këtë ftesë më keni nderuar dhe gëzuar shumë! E falenderoj Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, dhe posaçërisht drejtorin Dr. Skender Asani, i cili edhe student ka qenë kështu si tash - i interesuar shumë për mësim, gjithnjë me pjesëmarrje të rregullt nëpër ligjërata.

Ju përgëzoj për këtë manifestim kulturor-shkencor "Ditët e Alfabetit", shënim me shumë rëndësi, që sivjet ka të bëjë me edicionin e dytë të tij "*Ditët e Alfabetit - 2020*"- kushtuar iluministëve shqiptarë - nocion shumë vlerësues që vë në spikamë kontributin e tyre në fushën e veprimtarisë përkatëse.

Me organizimin e këtij manifestimi keni bërë një punë shumë të mirë dhe të madhe. Më keni befasuar shumë dhe dëshiroj që të keni ende organizime të shkencës, kulturës... Ju folët shumë për veprimtarinë time në fushën e arkeologjisë, duke e vlerësuar mjaft lartë, që nga fjala e hapjes së Dr. Skender Asanit nga të dy aspektet, shkencor dhe arsimor, dhe me radhë studiuesit : Ma. Zana Hoxha nga Instituti Albanologjik-Prishtinë, Dr. Bedri Muhadri nga Instituti i Historisë-Prishtinë, Dr. Besnik Rameti dhe Sali Islami asistent i ri nga Instituti nikoqir-Shkup, që folën nga aspekti i gjerë shkencor. Për këtë të gjithëve u jam shumë mirënjohëse !

Me këtë rast më duhet të them se unë këtë veprimtari e bëj me shumë vullnet pasi ka të bëjë me kulturën e të parëve tanë. Kjo është puna ime, aty e gjej veten, ndiej kënaqësi dhe do ta vazhdoj tutje. Besoj që edhe ju që punoni në këtë Institut mendoni dhe veproni kështu. Ju pret ende një punë e madhe dhe dëshiroj që ta vazhdoni si tash. Kështu, këtij Instituti i dëshiroj çdo përparim, gjithçka më të mirën dhe në të ardhmen çdo herë të ketë një drejtor që e udhëheqë atë kështu si Dr. Skender Asani.

Edhe njëherë ju falenderoj shumë për këtë nderim - më keni bërë të ndihem ashtu si jam në të vërtetë!

## NJË VAJZË E BOTËS SONË DHE NJË NËNË E MBARË BOTËS – SHËN NËNË TEREZA

*Shkup, 19.11.2020* – Aktiviteti i pestë me radhë në kuadër të manifestimit kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITSHKSH-Shkup, iu kushtua njëres nga figurat më të mëdha të njerëzimit – Shën Nënë Tereza.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, theksoi iniciativat e ndërmarra kohën e fundit nga ana e Institutit, për ndriçimin dhe jetësimin e figurës së shkupjanes shqiptare Gonxhe Bojaxhiu. “Të parët në rajon hapëm departamentin për hulumtimin e trashëgimisës së Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Terezës, botuam vepra origjinale dokumentare për familjet katolike shqiptare të Shkupit, si dhe e kthyem gjuhën amtare të Gonxhes në Sheshin e Shkupit”, u shpreh Asani.

Një emër i njohur i letërsisë shqipe, autor i dhjetëra veprave letrare, studimeve e përkthimeve referenciale ku spikatë figura e Nënë Terezës, profesor i katedrave universitare në Kosovë, Gjermani e Kalabri, Anton Nikë Berisha, shpërfaqë disa dromca interesante nga jeta dhe vepra e Nënë Terezës. Ai nënvizoi se dimenzioni bamirës nuk është ai më kryesori që ngërthen personalitetin e Nënë Terezës, por flijimi dhe sakrifica e saj e pazakontë për të tjerët.

Publicisti Emin Azemi, u paraqit me temën “Reflektimi i figurës së Nënë Terezës në ndërtimin e kauzave civilizuese”, duke theksuar shumëdimensionalitetin e figurës së Nënë Terezës, jo vetëm se në rrafshim human, por edhe atë kulturor, arsimor, social, misionar, etj.

Referuesi tjetër ishte Demush Bajrami, i cili madje si aktivist i ri shoqëror dhe humanitar, ishte i burgosur për shkak të një aksioni bamirësie për të ndihmuar vëllezërit në Kosovë në vitin 1990, me SHHB “Nënë Tereza”. Aktualisht doktor i shkencave sociale dhe profesor në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, referoi në temën “Nënë Tereza, shembull unik i altruizmit njerëzor”.

Ndërsa, dita e nesërme i kushtohet një iluministeje të ditëve tona, studiueses së njohur të letërsisë shqiptare, akademikes Floresha Dado.





Anton NIKË BERISHA

*Studiues*

## PERSONALITETE TË SHQUARA PËR NËNËN TEREZE

Figurën dhe veprën e Nënës Tereze më së miri e shprehin dhe e përligjin veprimet konkrete të saj për njeriun, sidomos për të varfrit e më të varfërve, për të mjerët e të harruarit nëpër rrugë, për të cilët nuk kujdesej askush për arsye se merreshin si të “pavlerë” dhe “barrë e tepërt shoqërore” si dhe tekstet e ndryshme, tekstet e lutjeve dhe letrat, një pjesë e të cilave tashmë janë bërë publike.

Mirëpo, për njohjen e gjithanshme dhe thellësore të figurës dhe të veprës së Nënës Tereze rëndësi të veçantë kanë dhe mendimet dhe vlerësimet e bashkëpunëtorëve dhe të bashkëpunëtorëve, të njerëzve profesionesh të ndryshme, të artistëve e të shkrimtarëve, të politikanëve e të personaliteteve të shquara, që e takuan dhe e njohjen në veprime dhe në flijime konkrete.

Të merresh me mendimet që kanë shprehur të tjerët për Nënën Tereze, brenda tyre edhe me mendimet e personaliteteve të shquara botërore, domethënë të merresh me një lëndë tepër të gjerë, të thuash, të pafund. Për këtë arsye, në këtë kumtesë, që ka për qëllim ndriçimin e disa përbërësve kryesorë për qenësinë e figurës së Nënës Tereze e të veprës së saj, kam veçuar vetëm disa nga mendimet – vlerësimet e personaliteteve të shquara që mundësojnë njohjen më të thellët shpirtit të saj. Po e përmend këtë gjë për arsye se kam përshtypjen se një numër i madh i njerëzve tanë ende nuk e kanë kuptuar mirëfilli punën që bëri Nëna jonë Tereze dhe rëndësinë e veprës e të masazhit që ajo i la trashëgim njerëzimit.

Duke e vlerësuar lart punën për mbrojtjen e jetës dhe të dinjitetit të njeriut pa marrë parasysh prejardhjen, shtresën shoqërore dhe pasurinë materiale si dhe flijimin e saj për tjetrin, veçmas për më të varfrit dhe më të mjerët, Gjon Pali II, pati thënë: “Thellësisht e falënderoj Zotin që na dha këtë grua të besimit të patundshëm<sup>52</sup>”, e cila, si *Misionare e Dashurisë, misionare e*

---

<sup>52</sup> Giampaolo Mattei, *Io, Nirmala. La storia dell'“erede” di Madre Teresa di Calcutta*. 37 Collana Campioni. Ellenici, Leumann (Torino), 1999, f. 21.

*Të gjitha citatat në këtë kumtesë të përkthyer nga italishtja, gjermanishtja e kroatishtja, nëse nuk përmendet përkthyesi, janë të autorit të punimit.*

paqes, misionare e jetës<sup>53</sup>, “Dëshmonte gjithnjë mbrojtjen e jetës njerëzore, edhe atëherë kur porosia e saj nuk pëlqej. E gjithë jeta e Nënës Tereze ka qenë një himn për jetën. Takimet e saj të përditshme me vdekjen, me gërbulen, në AIDS-in dhe me çdo lloj të vuajtjes njerëzore e bënë dëshmitare të çmueshme të Ungjillit të jetës. Deri edhe buzëqeshja e saj ishte një “po” për jetën, një “po” e hareshme, e lindur nga besimi e nga dashuria e thellë, një “po” e pastruar në kënaqësinë e vuajtjes<sup>54</sup>”.

Papa Gjon Pali II theksoi sidomos besimin e palëkundur të Nënës Tereze në Hyjin dhe në Birin e tij Krishtin, që i dhanë forcën dhe vullnetin për t’i dashur e për t’u flijuar për të tjerët, për t’i dashur ata me dashurinë hyjnore; ishte lutja e vijueshme drejtuar Hyjit për t’u sjellë atyre hirin dhe dritën e Tij, sidomos të mjerëve dhe të braktisurve nga familja dhe shoqëria. Flijimin e saj konkret për të varfrit e më të varfërve, Nëna Tereze e mbështeti në përcaktimin e qenësishëm ungjillor: “Kush do(n) të jetë i madh midis jush do të bëhet shërbëtor i juaj” (Mk 10, 43).

Nëna Tereze i çmonte të gjithë njerëzit njësoi: krijesa të Zotit dhe flijohej për ta në të njëjtën mënyrë, prandaj thoshte: duaje tjetrin pa e ditur si e ka emrin. Për këtë përcaktim të saj, Gjon Palli II thoshte: “Rënkimi i Krishtit në kryq ‘Kam etje’ (Gjn 19, 28), që shpreh thellësinë e dëshirës së Hyjit njeri, ka hyrë në shpirtin e Nënës Tereze dhe ka gjetur një truall të pëlleshëm në zemrën e saj. Shuarja e etjes së dashurisë së Krishtit në njësim me Marinë, Nënë e Tij, që bërë qëllim i vetëm i jetës së Nënë Tereze dhe forcë e brendshme, që bënte të tejkalonte vetveten e të ‘shkonte me vrap’ nga një anë e botës në tjetrën me qëllim të veprimit për shpëtimin dhe shenjtërimin e të varfërve nga më të varfrit<sup>55</sup>”.

Sipas pasardhësit të Shën Pjetrit, Nëna Tereze e prirë dhe e përshkuar nga drita hyjnore, ishte shndërruar në Birin e Hyjit, Krishtin:

*“Në buzëqeshjen e Nënës Tereze, në fjalët e në veprimet e saj, Jezusi ka ecur (shtegtuar) edhe një herë tjetër nëpër rrugët e botës<sup>56</sup>”.*

<sup>53</sup> Papa Gjon Pali II thoshte: “(Nëna Tereze) e shpall Ungjillin me jetën e saj dhuruar krejtësisht të varfërve, po në të njëjtën kohë, kridhet në lutje”. Cituar sipas Madre Teresa, “*Il mio segreto: Prego*”. *Raccolta di preghiere*. Trattati dagli scritti di Madre Teresa a cura di Padre Giuseppe Giacomelli, Editrice Shalom, 2000, f. 17 – 18.

<sup>54</sup> Madre Teresa, “*Il mio segreto: Prego*”, vep. e përm., f. 22.

<sup>55</sup> Madre Teresa, “*Il mio segreto: Prego*”, vep. e përm., f. 18.

<sup>56</sup> Mendimin e Papës e mora nga libri i Maria Di Lorenzo, *Madre Teresa. Lo splendore della carità*. Paoline. 2° Edizione, Milano 2003, f. 125 – 126. Këto fjalë papa i tha në trevjetorin e ndërrimit të jetës së Nënës Tereze.

Pikërisht cilësitë e tilla të Nënës Tereze kushtëzuan që Gjon Pali II të thoshte një nga cilësimet më të rëndësishme për këtë bijë të popullit tonë:

*“Ta lavdërojmë këtë grua të vogël të dashuruar në Hyjin, kumtuese e përvuajtur e Ungjillit dhe mirëbërëse e palodhshme e njerëzimit (...) T’ia pranojmë mesazhin dhe ta ndjekim shembullin e saj<sup>57</sup>”.*

Nëna Tereze nuk qe shembull për dashurinë dhe flijimin për të varfrit vetëm gjatë jetës, po vepra dhe mesazhi i saj vazhdojnë të kenë po atë vlerë edhe pas ndërrimit të jetës së saj. Kështu në trevjetorin e ndërrimit të jetës së Nënës Tereze, Gjon Palli II pati thënë:

“Me kalimin e viteve kujtimi i saj bëhet më i gjallë se asnjëherë tjetër.

E kujtojmë me buzëqeshjen e saj, me sytë e saj të thellë, me kurorën e saj të rruzares, me dashurinë e saj konkrete, të gjallë, që e shpinte atje ku pak vetë kishin guximin të shkonin, ku mjerimi ishte aq i madh sa të fuste frikën.

Më bëhet se e shoh ende në shtegtimin nëpër botë duke i kërkuar të varfrit nga më të varfrit, përherë e gatshme të krijonte hapësira të reja të dashurisë, e mirëpritur nga të gjithë si një nënë e vërtetë<sup>58</sup>...”

Papa Gjon Pali II, e pati theksuar edhe prejardhjen e Nënës Tereze. Në vizitën historike që i bëri Shqipërisë, më 25 prill 1993, në Katedralen e Shkodrës ai pati thënë:

“Nuk mund të mos e përsënderes një njeri fort të përvuajtur, që ndodhet mes nesh. Është Nëna Tereze e Kalkutës. Të gjithë e dimë nga vjen, cili është Atdheu i saj. Atdheu i saj është këtu. Edhe në kohët e izolimit të plotë të Shqipërisë ishte kjo rregulltare e përvuajtur, kjo shërbyese e përvuajtur e më të varfërve që përçonte në tërë botën emrin e Atdheut tuaj.

Në personin e Nënës Tereze Shqipëria është nderuar gjithmonë<sup>59</sup>”.

Në të vërtetë, të dhënë se Nëna Tereze ishte shqiptare dhe se emrin e vajzërisë e kishte Gonxha Bojaxhiu, e thotë ajo vetë në Letrën e 7 shkurtit të vitit 1948 dërguar kardinal perfektit të Kongregatës së Shenjtë për besimtarët e Romës, në të cilën kërkonte lejen për të dalë nga rendi i Loretos, të shekullarizohej, në mënyrë që të merrej vetëm me të varfrit e më të varfërve, me jetimët dhe me të gërbulurit. Në këtë letër drejtuar Vatikanit, Nëna Tereze përmend prejardhjen dhe emrin e vajzërisë:

<sup>57</sup> Marrë nga: Madre Teresa, “*Il mio segreto: Prego*”, vep. e përm., f. 17 – 19.

<sup>58</sup> Maria Di Lorenzo. *Madre Teresa. Lo splendore della carità*, vep. e përm., f. 125 – 126.

<sup>59</sup> Fjalë të thëna në Katedralen e Shkodrës. Shih *Papa në Shqipëri. 25 prill 1993*, Radio Vatikan – Drita, 1995, f. 36.

“Kam hyrë në Institutin e së Lumes Mari Virgjër në tetorin e vitit 1928; më 1931 i kam bërë kushtet e para, ndërsa ato të përjetshme më 1937 në Darjeeling. Punoj në Indi (Bengala) nga viti 1931. Jam e lindur shqiptare, por kam jetuar me prindërit e mi në Jugosllavi<sup>60</sup>”.

Letrën, nisur kardinalit – perfektit të Vatikanit, Nëna e përfundon:

“Shërbëtorja e përvuajtur e Hirësisë suaj në Krishtin,

Motra Maria Tereze, IBVM,

Në vajzëri zonjusha Gonxha Bojaxhiu<sup>61</sup>”.

Për Nënë Tereze dhe rëndësinë e veprës së saj shprehu mendimin dhe kryeministresha e Indisë, Indira Gandhi. Ajo vinte në dukje se për Nënë Tereze rëndësishmja ishte dashuria dhe flijimi i jashtëzakonshëm për tjetrin, shërbimi për tjetrin, sidomos për ata që kishin nevojë; ishte lutja drejtuar Hyjit që e kushtëzoi gjithë veprimin dhe flijimin e saj. Indira Gandhi thoshte:

“Ja...Nëna Tereze, e cila nuk bën më të voglin diskriminim rreth ngjyrës, gjuhës dhe besimit. Ajo e bën jetësore të vërtetën se lutja është përkushtim (devotshmëri), është shërbim. Shërbimi është detyra e saj, është feja e saj, është shpëtimi i saj. Ta njohësh Nënë Tereze domethënë ta kuptosh përvujtërinë absolute dhe forcën e dashurisë<sup>62</sup>”.

Kryeministresha e Indisë theksoi për Nënë Tereze edhe këtë: “Është kështu e vogël, po asgjë s’është e vogël në të<sup>63</sup>”.

Nëna e shpaloste edhe vetë besimin e saj të thellë në Hyjin, por dhe cilësitë e shpirtit të saj, dhuratë e vetë Hyjit: “I dashur Jezus (...) Hyn dhe pushtojë tërë qenien time derisa e gjithë jeta ime të jetë një rrezatim i jetës sate. Shkëlqej në mua në mënyrën që çdo njeri që ta takoj ta ndjejë praninë Tënde në shpirtin tim. Bën që të vështrojnë e të shohin, jo mua, por vetëm Jezusin. Qëndro me mua e unë do të filloj të shkëlqej si Ti, të shkëlqej për të

<sup>60</sup> Madre Teresa, *Sii la Mia luce. Gli scritti più intimi della “Santa di Calcutta*. A cura di Brian Kolodiejchuk. Rizzoli, Milano 2008, f. 124.

<sup>61</sup> Madre Teresa, *Sii la Mia luce. Gli scritti più intimi della “Santa di Calcutta”*, vep. e përm., f. 125.

**Përkatesinë kombëtare Nëna e përmendi dhe me rastin e marrjes së shpërblimit Nobel për paqe në vitin 1979. Me atë rast u tha gazetarëve:**

“Nga gjaku jam shqiptare, shtetësinë e kam indiane. Për sa i përket fesë sime jam motër katolike. Sipas përkushtimit tim i përkas gjithë botës. E për sa i përket zemrës sime i përkas krejtësisht zemrës së Jezu Krishtit”. Cituar sipas Franca Zambonini, *Teresa di Calcutta. La matita di Dio*. Paoline 8° Edizione, Milano 2007, f. 160. Shih dhe Teresio Bosco, *I pensieri più belli di Madre Teresa*. Editrice Elle di Ci, Leumann (Torino) 1999, f. 5 dhe f. 59.

<sup>62</sup> Franca Zambonini, *Madre Teresa. La mistica degli ultimi*. 3° Edizione, Paoline Editoriale Libri, Milano 2003, f. 101.

<sup>63</sup> Franca Zambonini, *Teresa di Calcutta. La matita di Dio*, vep. e përm., f. 161.

qenë dritë për të tjerët; drita, o Jezus, do të jetë e gjithë e jotja, asgjë nuk do të jetë e imja; Ti do të shkëlqesh mbi të tjerët nëpërmjet meje<sup>64</sup>”.

Njësimi i këtillë i Nënës Tereze me Hyjin dhe dritën e tij, pati kushtëzuar që ajo të thoshte: *“Zemra ime është aq e pastër që unë mund ta shoh fytyrën e Zotit në vëllain tim, në motrën time, në zezaken, në lakuriqen, në atë të gërbulurën, në atë që është duke vdekur? Kjo është ajo për çka duhet të lutemi<sup>65</sup>”*.

Natyrisht dashuria e Nënës Tereze për tjetrin i kishte rrënjët në përcaktimin ungjillor: “Nëse e duam njëri – tjetrin, Hyji mbetet në ne dhe dashuria e tij në ne është e përkryer. Me këtë gjë e dimë se mbetemi në Të edhe Ai në ne: na e ka dhuruar Shpirtin e vet (...) Hyji është dashuri, dhe, kush mbetet në dashuri, mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të” (1Gjn 4, 11 – 16)<sup>66</sup>.

Artistja italiane me famë botërore, Sophia Loren, vinte në dukje dy nga qenësitë kryesore të Nënës Tereze: dashurinë dhe flijimin e pakursyer për tjetrin, sidomos për ata që nuk përfillehin dhe nuk çmoheshin nga të tjerët, cilësi që e bënin atë gruan më e bukur në botë:

”Sot të gjithë duhet të jenë të bukur. E të gjithë përpiqen të jenë të bukur. Për këtë gjë shfrytëzojnë marifete dhe kirurgjinë plastike. Diçka që të gjithë kanë nevojë, pse jo? Megjithatë, absolutisht nuk është e qenësishme. Bukuria e vërtetë është ajo që e kemi brenda. Nëna Tereze ishte e bukur. Ishte gruaja më e bukur e botës<sup>67</sup>”.

Shkrimtari, gazetari, regjisor i shquar dhe ushtarak i lartë anglez dhe rektor i universitetit të Edinburgut, Malcolm Muggeridge<sup>68</sup>, i cili nuk ishte i krishterë, në vitet ’70 të shekullit XX, shfaqti disa mendime me rëndësi për qenësinë e punës – veprimin të Nënës Tereze e të Misionareve të Dashurisë.

<sup>64</sup> Madre Teresa di Calcutta, *Il mio libro di preghiera*. A cura di Francesco Follo. Mondadori, Milano, 2002, f. 57 – 59.

<sup>65</sup> Gloria Germani, *Teresa di Calcutta una mistica tra Oriente e Occidente*. Paoline. Milano 2003, f. 65.

<sup>66</sup> *Shih për këtë dukuri dhe enciklikën e papës Benedetto XVI*, Deus caritas est. Lettera enciclica. Libreria Editrice Vaticana, V Ristampa 2006.

<sup>67</sup> José Luis González – Balado, *Madre Teresa. Ricordo e messaggio*. Edizioni San Paolo, Cinisello Balsamo (Milano), 200, f. 181.

<sup>68</sup> Malcolm Muggeridge (lindur në Londër më 1903) është autor i më së 20 veprave dhe i një varg filmash. Për disa vite ishte ushtarak i lartë në ushtrinë britanike, pastaj dy vjet rektor i Universitetit të Edinburgut (Skotlandë). Biseda e tij e njohur e bërë me Nënë Tereze në vitin 1970 për rrjetin televiziv të BBC, bëri një bujë të jashtëzakonshme në Angli dhe në vende të tjera të Evropës. Rreth kësaj bisede Muggeridge thekson: “Përgjigjet e Nënës Tereze qenë skajshmërisht të thjeshta dhe përsosshmërisht të sinqerta: aq sa pak u gjeta në vështirësi për ta vazhduar më tej bisedën”. Shih Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*. 3. ed. Ottobre, Edizione Pauline, 1974, f. 23.

Shih të dhënat për këtë autor në Malcolm Muggeridge, *Isis čovjek koji živi*. Preveo Dr. Tomislav Pervan. “Kršćanska sadašnjost”. Zagreb 1983, f. 5 – 6.

Vepra e tij “Të bëjmë diçka të bukur për Zotin<sup>69</sup>” dhe filmi i tij me të njëjtin titull, mundësuan njohjen e punës së saj e të motrave që Nëna i udhëhiqte me përkushtim hyjnor.

Duke vlerësuar punën e Nënës Tereze Muggeridge theksonte: “Do t’u takojë brezave (të ardhshëm) të përcaktojnë se Nëna Tereze ishte ose nuk ishte shenjtëreshë. Them vetëm se në kohë të errëta, ajo është një dritë që flakëron dhe ndriçon; në kohë të egra është një personifikim i gjallë i Ungjillit të dashurisë së Krishtit; në kohën që Zotin e duan të vdekur, ajo paraqet Hyjin që jeton midis nesh, plot e përplot me hire e të vërteta. Për këtë arsye, të gjitha ata që kanë pasur përparësinë e paçmuar që ta njohin ose të mësojnë për të, duhet t’i jenë mirënjohës për amshim<sup>70</sup>”.

Në vijim të ndriçimit të rëndësisë së veprës së Nënës Tereze, ky personatitet thoshte: “Kurrë nuk e kam provuar një ndjesi aq të përsosur të njëjtësisimit njerëzor ashtu si me Nënë Tereze midis të varfërve të saj. Dashuria e saj për ta, reflektimi i dashurisë së Zotit, i bën aty të gjithë të njëjtë si vëllezër e motra në kuptimin e një familje, megjithëse ndryshojnë dukshëm për cilësi intelektuale e kulturore, për bukuri trupore e për hijeshi<sup>71</sup>”.

Në bisedën “historike” për rrjetin televiziv të BBC me Nënë Tereze Malcolm Muggeridge<sup>72</sup> theksoi një nga çështjet më të qenësishme për të kuptuar mirëfilli jetën dhe veprimin e saj: “Duke e mohuar vetveten, ajo do ta gjejë vetveten<sup>73</sup>” dhe “Duke hequr dorë nga vetvetja, ajo bëhet e vetvetes<sup>74</sup>”.

Në vijim të ndriçimit të mëtejshëm të këtij përcaktimi të qenësishëm të Nënës Tereze, Muggeridge thotë: “Është e vërtetë: personat e përkushtuar tërësisht si Nëna Tereze s’kanë biografi. Duke folur në mënyrë bibliografike,

<sup>69</sup> Titulli në origjinalin anglisht: Malcolm Muggeridge, *Something Beautiful for God. Mother Teresa of Calcutta*. Harper & Row. New York 1971; shih përkthimin në italisht Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*. 3. ed. Ottobre, Edizione Pauline, 1974.

<sup>70</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 144.

<sup>71</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 18.

<sup>72</sup> Libri i tij me titullin “*Something Beautiful for God. Mother Teresa of Calcutta*” – *Të bëjmë diçka të mirë për Zotin*” për Nënë Tereze dhe për motrat e rendit *Misionaret e Dashurisë*, shërbeu si bazë për shumë autorë që shkruan dhe botuan më vonë libra për Nënë Tereze. Ishin mendimet - tekstet e Nënës Tereze që kushtëzuan citimin aq të shpeshtë të librit.

<sup>73</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 10.

<sup>74</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 11. Ky autor thekson edhe këtë: “Duke e mohuar vetveten ajo e gjeti vetveten, sipas virtytit të shndërrimit unik të Krishtit, përligjur në Kryqëzimin e në Ngjalljen, për të cilën në vdesim për të vazhduar të jetojmë”. Shih veprën e tij *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 10 – 11.

Papa Gjon Pali II thoshte: “Njeriu e gjen veten në mënyrën më të plotë duke e dhënë vetveten”. Shih Gjon Pali II me Vittorio Messorin, *Të kapërcehet pragu i shpresës*. Gjonlekaj Publishing Company, New York, 1998, f. 223.

atyre nuk u ngjet asgjë. Të jetosh për të tjerët, siç bën ajo dhe motrat e saj Misionaret e Dashurisë, domethënë t'i shmangësh të gjitha rrethanat në të cilat hyjnë Uni dhe vullnesa vetjake<sup>75</sup> dhe "Ajo, një motër, mjaft e brishtë, me pak rupie ne xhep, jo aq profesionale e jo e përshtatur në artin e bindjes, e mbushur vetëm me atë dashurinë e krishterë që e rrezaton rreth e përqark saj, që vërshon nga zemra e nga buzët e saj, ishte njëmend e gatshme të përcjellë Zotin e saj, e, sipas urdhrave të Tij, të çmojë çdo të braktisur fatkeq e të tillët që vdisnin buzë rrugëve thuajse ishte ai Vetë; të dëgjojë në çdo të qarë të fëmijës së braktisur, edhe në bubërrimën e dobët të një fetusit të abortuar, klithjen e Fëmijës së Betlemit<sup>76</sup>..."

Pra, Nëna Tereze e mohoi veten për të mirën e tjetrit, në veçanti për të varfrit e më të varfërve, siç theksonte Muggeridge:

*"Besimi i Nënës Tereze është i parrënueshëm dhe do të mbijetojë, për këtë jam i sigurt, pa marrë parasysh çfarë fantazie ose marrëzie mund të ndodhë në të ardhmen. Jeta e saj është tepër e qartë për t'u zhdukur; Zotynë, të cilin ajo e ndjek, i është shumë afër që të mund të ndahet. Kjo mund të dëgjohej në fjalët e saj dhe në jetën e saj të shikohet drita e Rrëshajës së parë, që vazhdon të shkëlqejë deri në ditën e fundit<sup>77</sup>".*

Sipas shkrimtarit anglez qëllimi kryesor i Nënës Tereze dhe i Misionareve të Dashurisë ishte të bënin diçka të bukur për Zotin, që është e lidhur ngushtë me - të bësh diçka të bukur për njeriun: "Të bësh diçka të mirë (të bukur) për Zotin është qëllimi i jetës së Nënës Tereze. Të gjitha gjërat që bëhen për Zotin, çfarëdo të jenë ato, bëhen të mira; e njëjta gjë ndodh me çdo shpirt njerëzor që e bën të veten këtë qëllim, cili do që të jetë, burrë ose grua. Duke e provuar në vete, në jetën e vet dhe me punën e vet, Nëna Tereze dhe Misionaret e Dashurisë përbëjnë një dëshmi të gjallë të fuqisë dhe të së vërtetës të asaj që Jezusi erdhi të predikojë. Drita e Tij shkëlqen në to<sup>78</sup>" dhe "Çdo ditë Nëna Tereze e takon Jezusin, së pari gjatë meshës, nga e cila nxjerr ushqimin dhe guximin; pastaj në secilin shpirt të çdo nevojtarit e të përvuajturit, që ajo e sheh dhe kujdeset për të. Është i njëjti dhe vetëm Jezusi në altar dhe në rrugë. Njëri pa tjetrin nuk ekziston<sup>79</sup>". Me një fjalë, Nëna Tereze dhe motrat e saj flijoheshin për të varfrit me dashurinë e Hyjit: "Ato duan t'i ofrojnë Zotit gjithçka... Kjo bindje dhe kjo dashuri është ajo që i nxit ta shprehin gëzimin. Kjo është

<sup>75</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 10.

<sup>76</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 17.

<sup>77</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 55 – 56.

<sup>78</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 123.

<sup>79</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 128.

arsyeja që ju i shihnin motrat përherë të hareshme. Nuk janë të detyruara të jenë të gëzueshme: janë të lumtura natyrisht për arsye se janë të vetëdijshme se kanë gjetur atë që kërkonin<sup>80</sup>”.

Meqenëse Muggeridge e shoqëroi Nënë në disa veprime të përditshme dhe i vizitoi shtëpitë e hapura nga Misionaret e Dashurisë për të varfrit dhe njerëzit me të meta fizike e mendore, tha: “Duke e shoqëruar Nënë Tereze për të parë këto aktivitete të ndryshme me qëllim që t’i filmonim – nga shtëpia e atyre që janë para vdekjes, e të gërbulurve e të fëmijëve të braktisur – vërejta se kalova nëpër tri faza. E para ishte e një tmerri të përzier e të mëshirës, e dyta e një dhembshurie të pastër dhe të thjeshtë dhe e treta e një ndjenje shumë më të lartë se dhembshuria, diçka që nuk e kisha provuar më parë: një vetëdije që këta njerëz para vdekjes dhe këta të mjerë, më shumë burra se gra, këta të gërbulur me krahë e duar të cinguar, këta fëmijë të padëshiruar, nuk ishin qenie të neveritshme, që të fusin tmerrin, ose të braktisur, por qenie të dashura e simpatike, si të ishin miq të moteve të shkuara, vëllezër e motra<sup>81</sup>”.

Fakti se kur Nëna Tereze takohej me njerëz rrezatonte dritën e Hyjit dëshmohej dhe nga fjalët e shkrimtarit Muggeridge: “Kurrë nuk e kam takuar një person që më ka bërë aq përshtypje sa ajo. Ka mjaftuar të kuvendosh me të shpejt dhe për pak çaste, për të pasur një kujtim të pashlyeshëm. Kam njohur persona që s’kanë mundur t’i mbajnë lotët kur kanë vërejtur se është nisur (larguar), edhe pse takimi mund të ketë zgjatur vetëm sa për të pranuar një buzëqeshje të saj, duke e pirë një gotë me çaj<sup>82</sup>”.

Duke e konkretizuar edhe më tej këtë cilësi të Nënës Tereze, Muggeridge shkruan: “Kur treni u nis, duke u kthyer prapa i vetëm, përjetova brenda përbrenda ndijimin që e gjithë bukuria dhe hareja e gjithësisë të kenë shkuar me të. Kisha përshtypjen se një pjesëz e përgjithshme e dashurisë së Zotit po përhapej në Nënë Tereze, duke u dhënë tipareve të saj të thjeshta një përndritje të qartë. Ajo jeton kështu e njësuar me Zotin e saj, e cila e përhapte rreth vetes të njëjtin nur të sjelljes së thjeshtë të Mjeshtrit, kumtarit të shpëtimit, kur turma e njerëzve e përcillnin të mahnitur nga Jerusalemi në Galile<sup>83</sup>”.

<sup>80</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 104.

<sup>81</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 49.

<sup>82</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 11.

<sup>83</sup> Malcolm Muggeridge, *Qualcosa di bello per Dio*, vep. e përm., f. 12.

Një grua ateiste, pas takimit me Nënë Tereze tha: “*Ja çka pashë kur e takova: e pashë Atë. U ndërrova përgjithmonë. Pashë në të atë që do të mund të isha, një vend ku Zoti jeton pa pengesa, i lirë të lëvizë e të shprehë qenien e vet. Ajo i la Zotit atë vend brenda saj dhe ua dëshmonte të tjerëve.*”

Po e mbyll këtë kumtesë me dy mendime të motrës Mary Nirmala Joshi, pasardhësja e parë e Nënës Tereze në drejtimin e Misionareve të Dashurisë.

I pari lidhet me përmasën konkrete dhe hyjnore të Nënës Tereze, gjatë kohës sa ajo ishte gjallë. Ajo thoshte:

“Varej (Nëna Tereze) krejtësisht nga provania hyjnore për të gjitha nevojat tona e për ato të të varfërve<sup>84</sup>... Më kujtohet se sytë e Nënës Tereze shikonin përtej kësaj bote. Nëna Tereze i qe dorëzuar në mënyrë të thellë, absolute, vullnesës së Zotit e, Zoti, e përdori si vegël për dashurinë e tij<sup>85</sup> (...) Zemra e Nënës digjej nga dashuria për Krishtin – Eukaristinë (në kungim), të cilit ajo ia kushtoi krejtësisht dhe paanësisht jetën e saj, me një besim të përzemërt në Të, e Ai e shndërroi (Nënën Tereze – v. ime) në Vetën e vet. Kështu, kur njerëzit e shihnin atë, në realitet e shihnin vetëm Krishtin<sup>86</sup>”.

Mendimi i dytë i Mary Nirmala Joshi lidhet me rëndësinë që Nëna Tereze e ka edhe pas ndërrimit të jetës, kthimit të saj në “shtëpinë e Atit”:

*“Dëshmia dhe mesazhi i saj janë bërë të çmueshëm për persona të çdo feje, si shenjë që Zoti edhe sot e do botën. Në pesë vitet e fundit pas vdekjes së saj shumë vetë i janë drejtuar asaj për të kërkuar ndihmë dhe kanë provuar dashurinë e Zotit përmes ndërmjetësimit të saj... Të gjithë të sëmurët, ata që vuajnë dhe gjithë ata që kërkojnë ndihmën e Zotit gjejnë tek Nëna Tereze një mike që ndërmjetëson për ta<sup>87</sup>”.*

---

*Bënte të mundur ta shihnin atë që do të mund të ishin. Kur fliste, të gjithë qetësoheshin. Mbërrinin njerëz me ankthe e kureshtarë, të lodhur e të vuajtur, e të gjithë qetësoheshin falë pranisë së saj të kredhur në lutje. Në të e shihnin Zotin. E shihnin Zotin në veten e tyre”. Shih Joseph Langford, *Il fuoco segreto di Madre Teresa*. Traduzione di Alessandra Borgonovo e Claudia Valentini. Rizzoli. Milano, 2009, f. 178.*

<sup>84</sup> Giampaolo Mattei, *Io, Nirmala. La storia dell'“ereda” di Madre Teresa di Calcutta*, vep. e përm., f. 27.

<sup>85</sup> Giampaolo Mattei, *Io, Nirmala. La storia dell'“ereda” di Madre Teresa di Calcutta*, vep. e përm., f. 21.

<sup>86</sup> Giampaolo Mattei, *Io, Nirmala. La storia dell'“ereda” di Madre Teresa di Calcutta*, vep. e përm., f. 27..

<sup>87</sup> Këtë mendim Mary Nirmala Joshi e tha në pesëvjetorin e ndërrimit të jetës së Nënës Tereze; cituar sipas Franca Zambonini, *Madre Teresa. La mistica degli ultimi*, vep. e përm., f. 116.

**Emin AZEMI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **REFLEKTIMI I FIGURËS SË NËNËS TEREZE NË NDËRTIMIN E KAUZAVE CIVILIZUESE**

Nëna Tereze si fenomen global, fillimisht nuk ishte perceptuar drejt, për shkak se elitat dhe oligarkitë botërore, nuk mund ta merrnin me mend se mund të jetë një njeri i vetëm, madje një grua, që do të arrijë të frymëzojë mbarë njerëzimin me veprimet e saj të heshtura por tepër domethënëse për kohën dhe kontekstin hapësinor e social.

Vetëm pasi ta kemi studiuar dhe analizuar figurën e Nënë Terezës, do ta kuptojmë se më e fuqishme se vepra e saj, ishte vet ndikimi që ushtronte kjo figurë në thyerjen e shablloneve mbi të mirën dhe të keqen, mbi përmasat hyjnore dhe tokësore të bamirësisë, mbi boshësinë e njerëzve të rrethuar me luks dhe pasurinë shpirtërore të skamnorëve dhe të vetmuarve.

Vetëm pasi ta kemi studiuar dhe analizuar figurën e Nënë Terezës, do të mund të vërejmë se fuqia e veprimeve të saj në pjesët më të harruar të globit, nxorën në pah kontrapunktin e një realiteti që lidhet me emrin dhe origjinën e saj, edhe atë në dy pozicione të ndryshme:

E para - Ajo, ndonëse vinte nga një vend ku zëri i gruas nuk artikulohej gjithaq në mesin e një mjedisi patriarkal, megjithatë arriti ta thyej këtë stereotip, duke lënë pas armata të tëra burrash me sjelljen dhe qëndrimin e saj; dhe E dyta - ajo, ndonëse i shërbeu një Kise e cila nuk ka vend për figura publike femërore, megjithatë Nënë Tereza e nxori nga anonimatit vlerën universale humane që mund të vijë edhe nga një grua.

Dimensioni universal i humanizmit të saj tash më ka eklipsuar çdo dimension tjetër të përkatësisë së saj etnike e fetare, për arsye se Nënë Tereza arriti të bëhet e shenjtë vetëm duke tejkaluar kufijtë e ngushtë etnik e fetar dhe duke u bërë kështu pjesë lëvizëse e ndërgjegjies kolektive globale.

Globalizimi i fenomenit Shën Tereza herët a vonë do të prodhojë një doktrinë të re, mbi të cilën do të mbështeten të gjitha kauzat civilizuese, edhe për faktin se njerëzimi aktualisht ndodhet në një udhëkryq si rezultat i paragjytimeve dhe përplasjeve qytetëruese, ku një doktrinë e tillë do të

kontribuonte së tepërmi në tejkalimin e hendeqeve me prefiks fetar, etnik, racor etj.

Pra, ne sot mund të kemi harruar ndonjë vepër të Nënës Tereze, por assesi nuk mund të harrojmë ndikimin e saj në mënyrën dhe konceptimin e mirësisë, e cila sipas Nënës Tereze ishte edhe një vullnet hyjnor në duart e njerëzve. Ajo ndjehet shumë e lumtur që një vullnet i tillë hyjnor i ishte transmetuar asaj në formë të një misioni për të qenë e dobishme aty ku mungon më së tepërmi dora e kujdesit dhe ngrohtësisë njerëzore.

Me fjalë të tjera përmasa hyjnore e këtij misioni tejkalon sjelljen e një bamirëse, për arsye se siç thoshte vet Nëna Tereze:

“Unë s’jam tjetër pos një lapës në duart e Zotit [...] Zoti shkruan duke na përdorur neve edhe pse jemi vegla të papërsosura. Zoti shkruan në mënyrë të mrekullueshme”. Nëna Tereze si fenomen dhe si vlerë univerzale nuk është prodhim konjunktural i ndonjë shteti a shoqërie të caktuar. Këtu qëndron edhe fuqia e madhështisë së saj planetare, sepse në gjithë veprën e saj ka vetëm një autorësi dhe ajo është vet Shën Tereza, e pa ndikuar nga kurrfarë ideologjie, as kurrfarë doktrine shtetërore. Vepra e saj është një manifest që nuk shkruhet me fjalë të thjeshta e të zakonshme. Ajo parasegjithash shkruhet me frymën e njeriut që kuptimin e gjallimit e ndërton jo mbi egon por mbi sakrificën e vetëflijimit të një nositi. Ose siç do të shprehet ajo me tone gati profetike:

“‘Do të jem shenjte’ do të thotë ta zhvesh vetveten nga çdo gjë që s’është e Zotit; t’i shkul nga zemra të gjitha gjërat e kësaj bote; të jetoj në varfëri dhe mënjanim; të heq dorë nga dëshirat, prirjet, tekat, idhujt e mi e ta bëj vetveten, me dëshirë, skllave të vullnetit të Zotit.”

Sado serioze e përkushtuese të jenë përpjekjet për studimin dhe analizimin e gjithanshëm të figurës së Nënës Tereze, megjithatë, ajo, me dimensionin e saj kompleks, do të mbetet edhe për një kohë të gjatë shkolla më e gjatë e njerëzimit.

Kur jemi te studimi dhe analizimi i figurës së Nënës Tereze, mund të themi se në botë nuk kanë munguar përpjekjet në këtë drejtim, kurse në hapësirën shqiptare ITSHKSH në Shkup është institucioni i vetëm që përmes një Departamenti të posaçëm i është qasur në mënyrë multidisiplinare jetës dhe veprës së Nënës Tereze, teksa profili kompleks i saj gjithnjë e më tepër po shndërrohet në objekt studimi e hulumtimi, për çka dëshmojnë edhe një varg projektesh e publikimesh në vitin që po e lëmë pas, e që nuk do të mungojnë edhe në vitet pasuese.

## Demush BAJRAMI

*Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë*

# NËNË TEREZA SHEMBULL UNIK I FLIJIMIT!

Kur përmendim emrin e Gonxhe Bojaxhiut na shkon mendja te jehona e veprës madhore të integruar në qëllimet e saj humane e të shartuara në tërësinë e personalitetit dhe kulturës njerëzore. Përgjithmonë e vlerësuar si një grua e jashtëzakonshme, altruiste dhe humaniste, unike, e thjeshtë, e gatshme për të ndihmuar dhe për t'u flijuar në çdo kohë për tjetrin, për njeriun e dhimbjeve e të ankthit. Kjo është madhështia e humanizmit të saj, formësuar dhe shprehur plotësisht në punën e saj që asgjë nuk mund ta lëkundë më. “Jeta është një punë emocionuese, por ajo bëhet edhe më emocionuese kur e jetoni për të tjerët”, thotë Helen Keller. E veçanta e Nënë Terezës, manifestohet në përpjekjet e saj për t'i mundësuar njeriut në nevojë të takojë personin dhe ndjenjën e tij, me mesazhin e saj dhe ashtu siç janë, t'i ndihmojë ata... “Dua të ofroj shpirtin të tjerë (motra të tjera A.B. pranë meje për të përmbushur së bashku veprën e njëjtë, për t'u shërbyer më të përvojaturve, më të mjerëve e të përbuzurve midis të varfërve. Me miliona janë ata që jetojnë, në kushte të neveritshme të mëkatit, në katunde dhe në qytete të Indisë pa ditur asgjë për Zotin e për Krishtin. Ne do t'i afrojmë ata te Krishti e Krishtin (do t'ua afrojmë) atyre”.<sup>88</sup>

Në të gjitha dimensionet e saj thelbësore, pra në mësimet, kremtet dhe jetesën e saj, bëhet fjalë për afërsi, për "njohje" me tjetrin, me të vuajturin e të përbuzurin, dukei vënë në shërbim të tjetrit të gjitha aftësitë fizike-mendore-shpirtërore të saj. “*Lumturia dhe gëzimi ynë është i pamundur pa lumturinë e njerëzve të tjerë*”. Kjo do të thotë që duke i bërë mirë tjetrit, në fakt po i bëjmë mirë vetes, sepse në atë moment e ndiejmë lumturinë e atij që i kemi bërë mirë. Vetëm kështu, Nënë Tereza do të arrijë të realizojë dhe konfirmojë integritetin e saj, të cilin për asnjë çast nuk lejoi që të reduktohet në ndërmjetësimin e thjeshtë të informacionit dhe njohurive materiale, por gjithnjë, mbi gjithçka, në tërësinë e personalitetit të saj, do ta vendosë dashurinë për tjetrin.

<sup>88</sup> Pjesë nga letra që N. Tereza i dërgonte Vatikanit, botuar në librin e Anton Nikë Berisha, Gonxhe Bojaxhiu- Nënë Tereza: “E desha tjetrin me dashurinë e Hyjit”, ITSHKSH, Shkup, f. 71.

Don Lush Gjergji, në librin e tij *“E kam për zemër popullin tem shqiptar”*, Prishtinë, 2019, ndër të tjera shkruan për Nënë Terezën: “Nga mendja e saj e ndritur dhe ngritur, nga zemra e saj e madhe—shprehje feje dhe dashurie për Zotin dhe për Njeriun vëlla e motër – fara që ajo e mbolli në mendjet dhe zemrat tona — ta mbajmë të gjallë jetën dhe veprën e saj mahnitëse për mbarë njerëzimin, si kujtim dhe frymëzim në vazhdimësi...Të mos ndalemi vetëm në nderim dhe admirim (të saj) por të kalojmë në imitim dhe dëshmi duke ushqyer përditshmërinë tonë me vlera dhe virtyte”.<sup>89</sup>

Nënë Tereza ishte në gjendje t’i mësojë njerëzit të gjykojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse, për të ndërtuar norma të përgjithshme etike dhe morale, veçanërisht duke ndjekur parimet dhe vlerat e besimit në Zot. Gjithkund, në çdo kohë dhe në të gjitha përballjet me problemet, shpresat dhe ankthet e njeriut e të shoqërisë në të cilën ata jetojnë. Në këtë frymë, Gonxhja mbarë botës do t’i ofrojë qartësi mbi integritetin njerëzor, në mënyrë që ata (njerëzit) të mund ta realizojnë me maturi dhe vetëdije jetën e tyre në familje dhe shoqëri.

## **Figura e Nënë Terezës, individualiteti dhe imazhi shoqëror...**

Sakaq, vepra e saj na përfron me rrënjët tona humane të trashëgimisë kulturore.Na bën më të ndjeshëm dhe më të dashur me të kaluarën dhe të tashmen, me shpirtëroren, etiken, kulturoren, shkencoren.

“Nënë Tereza, arbënorja e madhe me shpirt të gjerë, në fakt, ishte pjesë e rrënjëve të pemës së madhe të Arbërisë dhe të famshmëve të saj, pemë kjo që mbulon një pjesë të madhe të botës së krishterë, madje shkon edhe te karrigia e Shën Pjetrit. Porse, tanimë, edhe ajo është rrënjosur aty dhe po zë vendin si pjesë e shenjtërisë, si të rrënjëve të kombit arbëror ashtu edhe të Kishës”.<sup>90</sup>

Saherë, kur e shqiptojmë fjalën njeri, nuk mendojmë në njeriun vetëm si term jashtëzakonisht të përgjithësuar për të treguar karakteristikat dhe aftësitë universale e të qenësishme të të gjithë njerëzve. Ky koncept psikologjik, për më tepër se kaq, na tregon se njeriu, në të njëjtën kohë është qenie biologjike dhe shoqërore, aktivitetet jetësore të të cilit ndikojnë, duke lënë gjurmë të pashlyera në mjedis. Për të kuptuar më shumë se kaq, njeriu si

<sup>89</sup> Don Lush Gjergji, *“E kam për zemër popullin tem shqiptar”*, Prishtinë, 2019.

<sup>90</sup> Gjon Keka, *“Nene Tereza – Arbenorja e famshme e te gjitha koherave”*, botoi BOTART 2016, Tiranë, f. 67

individ shndërrohet në një përfaqësues të racës njerëzore, në një bartës specifik të të gjitha karakteristikave psikofizike dhe shoqërore të njerëzimit.

Personaliteti që mbjell paqe e dashuri midis njerëzve, konsiderohet të jetë rezultat i zhvillimit të një individi, mishërim i cilësive të veta njerëzore, duke qenë i ngulitur në trungun shoqëror të të qenit njeri. Pra, “njeriu, përveç individualitetit dhe subjektivitetit, ka edhe një personalitet themelor, që do të thotë: një marrëdhënie”.<sup>91</sup>

Rrugëtimi dhe vepra e saj, na dhanë e po na japin çdo ditë kurajë që të ballafaqohemi me sfidat që po krijon koha. Trajektorja e ecjes së Shën Terezës, do të bëhet shtysë e ngritjes së diversitetit të vlerave humane në një manual jetësor për të gjithë ne dhe gjeneratat që do të vijnë pas nesh.

“Tragjeditë personale dhe origjina e saj shqiptare e kanë ndihmuar Nënë Terezën të bëhet personaliteti fetar më me influencë në botë, i kohërave moderne. Krishterimi shqiptar i ka rrënjët në lashtësinë Ilire dhe qëndrimi i Kishës Katolike kundrejt shqiptarëve dhe sllavëve të jugut, ka shërbyer si mjet në formimin e jetës personale dhe fetare të Nënë Terezës”.<sup>92</sup>

Ashtu si Viktor Hygoi që “iku për të mbetur jo vetëm në bibliotekë, në mëndje dhe në përjetime, por edhe në të tashmen, si i përgjithmonshëm”<sup>93</sup>, – do të nënvizonte Albert Vataj”, ashtu edhe Shën Tereza me veprën e saj për të mirën, të drejtën dhe humanen ndaj njerëzve, u ngrit mbi individualizimin e fatit njerëzor përballë ngjarjeve shoqërore. “Për të (për Nënë Terezën –v.i), të varfrit nuk ishin vetëm miliona njerëzit, që në botë, kanë uri për bukë e për oriz. Të varfrit ishin edhe miliona të përjashtuarit, të braktisurit, të paprekshmit, njerëzit pa familje, ata që kanë etje për dashuri, dinjitet, paqe, drejtësi e shpresë; që nuk dinë të buzëqeshin më, sepse askush nuk i vështron më me ngrohtësi e nuk u jep një dorë, si vëllait”.<sup>94</sup> Po shërbehem me këtë narracion për të treguar botën në të cilën jetojmë dhe njëkohësisht për të kuptuar kështu individualitetin e Nënë Terezës. Prandaj, ky narracion na e bën të mundur vendosjen e një lidhje midis personazheve të veprave të Hygosë dhe jetës sonë të përditshme. Pra, “ajo dha dashuri dhe i dëshmoi botës shumë bujari që buron nga zemra e një gruaje Shqiptare. Viktor Hygo do të thoshte:

<sup>91</sup> Marko Vučetić *Horizont filozofijskog mišljenja*, Sveučilište u Zadru, 2019.

<sup>92</sup> Dr. Gëzim Alpion, “Nënë Tereza – Shënjtëresha dhe Kombi i Saj”, botoi Bloomsbury, Londër 2020, f. 89.

<sup>93</sup> <http://www.zemrashqiptare.net/news/35411/albert-vataj-viktor-hygo-pena-tragjike.html?skey=word=a>

<sup>94</sup> Marrë nga kontributi i Dominique Lapierre në librin “Nënë Teresa. Leader per missione”, i Roma Bose dhe Lou Faust, Shtëpia Botuese Gea, 2013, botuar në VATICANNEWS.VA, 26 gusht 2019.

“Në çaste të vështira lindën njerëz të mëdhenj”. Për prijësit tanë shekullorë, Nëna Terezë është dhe një diamant i çmuar që inspiron, ndrin shpirtrat e shqiptarëve të ndarë kudo ne Bote”.<sup>95</sup> Kjo do të thotë se si kuptimi i tyre, mund të shërbejë për të treguar dukuritë jashtë letrare, në këtë rast, jetën reale, që janë shprehje e arealit të dhimbjes dhe provë e kompleksitetit dhe peshës së rolit të saj në çdo hapësirë dhe në çdo kohë.

Sintagmat semantike si rebelimi, izolimi, vuajtja, skamja, dilemat morale dhe përçarja e personalitetit, janë tema, që shprehin kushtet në botën tonë historike e reale. Me karakteristikat, kuptimin dhe veprimet e saj, zë një vend të papërsëritshëm në historinë e njerëzore. Imazhi i Nënë Terezës përkon me imazhin e sotëm të jetës sonë reale, duke u munduar ta shohë njeriun si njeri, pa e dalluar dhe veçuar përkatësinë e tij fetare, racore e etnike.

“Kam jetuar një çast tejet të jashtëzakonshëm në një familje induiste me tetë fëmijë. Një zotëri erdhi në shtëpinë tonë e tha: “Nënë Terezë, njoh një familje me tetë fëmijë, që nuk ka ç’të hajë prej ditësh. Bëj diçka për të!”. Pa e zgjatur, mora ca oriz e u nisa. E i pashë fëmijët, e pashë në sytë e tyre ethet e urisë. Nuk e di nëse keni parë ndonjëherë sy të tillë. Po unë i shikoj tepër shpesh. Pashë edhe të ëmën që e ndau orizin e doli. Kur u kthye, e pyeta: “Ku shkove?”. M’u përgjigj thjesht: edhe ata kanë uri. Po kush ishin ata? Mësova se e kishte fjalën për një familje myslimane. Me të e kishte ndarë kafshatën e gojës. Nuk i solla më oriz atë mbrëmje, për ta shijuar me fund gëzimin, që buronte nga ndarja e ushqimit me të tjerët. E lexova gëzimin në sytë e fëmijëve të kësaj nëne, që s’kishte as një dorë oriz, por kishte kaq shumë dashuri për të dhuruar. Kështu, pra, dashuria nis pikërisht në shtëpi. E dëshiroj që edhe ju të dhuroni dashuri, ashtu si po ma dhuroni mua, gjë për të cilën ju jam shumë mirënjohëse”.<sup>96</sup>

Ndoshta, në nivelin më të gjerë të figurës shoqërore, ngjashëm si personazhet e Hygosë, që përfaqësojnë sfondin semantik të sintagmës së mendimit të tjetërsimit tragjik të njeriut modern në përgjithësi. Prandaj, më shumë se kurrë figura e Nënë Terezës sot ka një rëndësi të madhe, sepse me ndihmën e saj arrijmë të njohim individualitetin tonë, të krijojmë një imazh shoqëror dhe përcaktojmë realitetin në të cilin jetojmë.

<sup>95</sup> Gazeta dielli, shtator 2015.

<sup>96</sup> Pjesë nga fjalimi i Nënë Terezës, mbajtur në ceremoninë e dorëzimit të Çmimit Nobel për Paqe, në Oslo, më 10 dhjetor 1979, botuar në DIELLI, 10 dhjetor 2015.

## Shqyrtime përmyllëse

Tema e reflektimit etik, është një marrëdhënie e vazhdueshme ndërmjet moralit dhe moralitetit, kurse ndërthurja e një grupi rregullash që përcaktojnë veprimin dhe sjelljen e mirë e të keqe, janë ato që e bëjnë një individ të ndikojë tek njerëzit tjerë. Pikërisht, morali na mëson se si duhet të jetë veprimi ynë njerëzor dhe si duhet t'u nënshtrohemi atyre parimeve, në mënyrë që t'i rregullojmë marrëdhëniet tona ndërpersonale.

Nënë Tereza me veprimin dhe sjelljen e saj, tregoi se edhe jeta e tjetrit ka shumë kuptim, duke dërguar mesazhin e qartë se mund të jetë më mirë dhe ndryshe. Ajo i tregoi njerëzimit, fisnikërinë dhe mirësinë, kujdesin dhe gatishmërinë, sakrificën dhe flijimin... Nuk ka virtyte dhe gjëra më të mëdha për njeriun sesa të sakrifikosh dhe jetosh për tjetrin. Aq më tepër, kur aty gjen kuptimin e ekzistencës në dashuri dhe ndihmë. Ky është kuptimi i të jetuarit për të ndihmuar të tjerët dhe për të sakrifikuar për të tjerët. Atëherë kur ia dedikon jetën shpëtimit të të tjerëve.

Në fund të fundit, një personalitet nuk lind, por ai bëhet personalitet. Individualiteti human dhe shpirtëror i Nënë Terezës, e bën atë një personalitet të veçantë që ndryshon nga të tjerët – për më tepër ajo vjen midis nesh si një kombinim unik i karakteristikave mendore, fiziologjike, shoqërore dhe shpirtërore që shfaqen në sjellje, aktivitet dhe komunikim!

Tek individualiteti i Nënë Terezës, i hasim ato tipare të personalitetit që të gjithë njerëzit i kanë, por tek Nënë Tereza, ato kanë shkallë të ndryshme të çiltërsisë dhe kombinimeve, formave dhe trajtave njerëzore. Të gjithë këta elementë të personalitetit të saj, padyshim përcaktojnë thirrjen e saj në vetvete se njeriu duhet të pyesë veten se çfarë është i gatshëm të heqë dorë në favor të tjetrit, e ky tjetri, mund të jetë i njohur apo i panjohur. Ky reflektim është takimi i shpirtit të saj me të vërtetën, është flijimi i saj.

Sigurisht, ishte pikërisht Nënë Tereza ajo që ushqente e artikulonte denjësisht idetë e dashurisë njerëzore përmes punës së saj si humaniste. Është fat i madh për ne që patëm në gjirin tonë një Nënë kaq të madhe, një emër që shndriti dhe do të shndrisë me origjinalitetin dhe individualitetin e filozofisë së saj si shfaqje e frymës humane dhe më shumë se kaq: të transformojë plotësisht njeriun. E njeriu mund të rilindet dhe përtërihet, e nëse është sa duhet i fortë, bëhet i aftë të sakrifikojë dhe të flijojë.

## Referenca:

Pjesë nga letra që N. Tereza i dërgonte Vatikanit, botuar në librin e Anton Nikë Berishës, Gonxhe Bojaxhiu- Nënë Tereze: “E desha tjetrin me dashurinë e Hyjit”, ITSHKSH, Shkup.

Don Lush Gjergji, “E kam për zemër popullin tem shqiptar”, Prishtinë, 2019.

Gjon Keka, “Nene Tereza – Arbenorja e famshme e te gjitha koherave”, botoi BOTART 2016, Tiranë.

Marko Vučetić, *Horizont filozofijskog mišljenja*, Sveučilište u Zadru, 2019.

Dr. Gëzim Alpion, “Nënë Tereza – Shenjtëresha dhe Kombi i Saj”, botoi Bloomsbury, Londër 2020,

Marrë nga kontributi i Dominique Lapierre në librin “Nënë Teresa. Leader per missione”, i Roma Bose dhe Lou Faust, Shtëpia Botuese ‘Egea’, 2013, botuar në VATICANNEWS.VA, 26 gusht 2019.

Pjesë nga fjalimi i Nënë Terezës, mbajtur në ceremoninë e dorëzimit të Çmimit Nobel për Paqe, në Oslo, më 10 dhjetor 1979, botuar në Dielli, 10 dhjetor 2015.

Gazeta Dielli, shtator 2015. <https://gazetadielli.com/nene-tereza-paqja-arrihet-me-vepra-te-dashurise/>

<http://www.zemrashqiptare.net/news/35411/albert-vataj-viktor-hygo-pena-tragjike.html?skeyword=a>

## NJË AUREOLË E STUDIMIT TË LETËRSISË – FLORESHA DADO

*Shkup, 20.11.2020* - Në kuadër të manifestimit shkencor-kulturor “Ditët e Alfabetit”, sot – po ashtu në frymën e afirmimit të femrës shqiptare – u organizua një sesion për studiuesen e letërsisë nga Tirana, akad. Floresha Dado.

Me këtë rast drejtori i ITShKSh-së, dr. Skender Asani, në hapje të fjalës së tij, tha se: “Studiuesja Floresha Dado, me veprën e saj studimore të letërsisë shqiptare, tashmë i ka tejkaluar kufijtë e Republikës së Shqipërisë, madje edhe të Republikës Letrare Shqiptare dhe sot është një emër i nderuar me përmasa botërore të studimit të letërsisë, andaj kjo është një arsye më shumë që kjo ditë t’i kushtohet pikërisht veprës së saj”.

Për veprimtarisë hulumtuese të prof. Dado foli edhe studiuesi nga Tirana, prof. Ymer Çiraku, i cili si një studiues që nga afër e ka njohur ndjekur punën hulumtuese të prof. Floresha Dados, tha se ajo është ndër emrat më të rëndësishëm, nëse jo edhe më i rëndësishmi, që sot merret me studimin e letërsisë shqiptare dhe që e afirmon atë në përmasa kombëtare dhe jo vetëm.

Drejtori i Institutit Albanologjik nga Prishtina, Hysen Matoshi, në këtë rast tha se “Rezultatet e Floresha Dados janë produkt i dijeve të dëshmuara në fushën e teorisë ë letërsisë dhe të ndërlidhjes së tyre me paraqitjen e veprave letrare në kronologjinë historike, përkatësisht të dimensionit estetik me dimensionin historik”.

Prof. Agim Leka nga Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Shkup, tha se: “Floresha Dado nuk është më vetëm një studiuese e letërsisë shqiptare, por ajo është një fenomen në studimet e letërsisë, andaj mund të konsiderohet edhe si institucion në vete”.

I fundit mbajti fjalë shkrimtari Emin Azemi, shkrimtar dhe studiues i letërsisë, i cili tha se: “Floresha Dado është identiteti më përfaqësues i sistemit vlerësues në letrat shqipe, duke vendosur brenda këtij sistemi një mori normash të avancuara teorike e estetike mbi letërsinë dhe kompleksitetin e veprës letrare në tërësi”.

Akad. Floresha Dado, përmes një video-komunikimi nga Tirana, falënderoi Institutin për angazhimin e ndërmarrë, njëkohësisht duke bërë edhe një rezyme të shkurtër të interesimit të saj shkencor.

Manifestimi shkencor-kulturor “Ditët e alfabetit” vazhdon edhe nesër me një akademi shkencore, që po ashtu do të organizohet me personalitete të larta politike, me praninë e kryetarëve të akademive të Shkupit, Prishtinës dhe Tiranës, si dhe me praninë e studiuesve më të njohur të Kongresit të Manastirit.



**Skender ASANI**

*Drejtor i ITShKSh – Shkup*

## **FLORESHA DADO NA KA NDERUAR TË GJITHËVE ME VEPRËN E SAJ SHKENCORE**

### **-fjalë përshëndetëse-**

I nderuari drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, z. Hysen Matoshi, i nderuari Ylber Sela - drejtor i Agjencisë së Gjuhës Shqipe, i nderuari profesor Agim Leka, të nderuar kolegë.

Të flasësh për Floresha Dadon do të thotë të flasësh për majat e shkencës së letërsisë, të flasësh për një grua si Floresha Dado do të thotë të flasësh për një sakrificë të përgjithshme për shkencën shqiptare në përgjithësi.

Ne kësaj rradhe, edicionin e dytë të “Ditëve të Alfabetit” ia kemi kushtuar gruas shqiptare me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së të madhes Parashqevi Qiriazi me temë “Iluministet shqiptare”. Në ditën e parë kishim temë trajtimi veprimtarinë etnomuzikologjike me dy perlatë e muzikës shqiptare siç janë: Nexhmije Pagarusha dhe Hanife Sejfulla-Reçani. Pastaj vazhduam me ballkanologjen e mirënjohur të cilën për së pari herë e kemi trajtuar në një konference shkencore Olivera Jashari Nasteva, pastaj vazhduam më tutje edhe me të madhen Nënë Tereza, e cila vjen nga këto treva dhe së bashku me Parashqevinë jemi krenarë që nga trevat e sotme të Maqedonisë ne kemi prodhuar dy figurat të mëdha të cilat kanë dhënë shumë për të kaluarin tone historike në të gjitha sferat që bota na njeh, por kemi krijuar edhe orientimin euro-perendimor të shqiptarëve. Kjo don të thotë se trevat e sotme të Maqedonisë kanë dhan kontribute të jashtëzakonshme për orientimin e përgjithshëm të shqiptarëve drejtë euro-integrimeve të cilet i përket edhe populli shqiptar.

Floresha Dado shquhet për studimet e thelluara në histogramin e letërsisë dhe teorinë e letërsisë, dhe jorastësisht në prag të 22 Nëntorit, e kemi vënë si temë qendrore për t’u trajtuar nga studiuesit kjo figure e madhe e shkencës shqiptare. Jorastësisht kemi edhe referuesit të cilët me kompetencë do të thonë fjalën e tyre për veprimtarinë shkencore të të madhes Floresha Dado. Ajo na ka nderuar të gjithë neve, dhe kur ia kumtuam lajmin se Instituti ka

vendosur që një ditë t'i përkushtohet veprimtarisë së saj, ajo aq shumë dhe aq mirë e ka pritur sa që kishte emocione të jashtëzakonshme. Prandaj, neve na ka nderuar profesoresha me pranimin e saj që një ditë e këtij manifestimi t'i kushtohet veprimtarisë së saj shkencore dhe besoj që prurjet që do t'i sjellin referuesit rreth veprimtarisë së saj do të jenë një bazament solid për historinë e letërsisë dhe teorinë e letërsisë, ku Floresha Dado ka dhënë kontributin e saj të jashtëzakonshëm shkencor.

Faleminderit.

**Ymer ÇIRAKU**

*Universiteti i Tiranës*

## **TË PËRBALLESH ME SFIDAT LETRARE**

Është nder për mua që më jepet rasti të flas për aktivitetin shkencor të akademikes Floresha Dado. Ajo përfaqësohet tashmë, si një personalitet i shquar në fushë të studimeve letrare, profesore titullare prej më shumë se katër dekada vitesh në Departamentin e Letërsisë të Universitetin e Tiranës.

Sigurisht, që studimet e saj letrare, kryesisht ato të rrafshit teorik, janë tërheqja dhe kontributi i saj më i spikatur.

Karakteristikë e dallueshme e këtyre studimeve, është se ato marrin shkas dhe nxiten prej realitetit të letërsisë shqipe. Prandaj, mund të thuhet se në to, shpalosen jo thjesht dhe vetëm koncepte e sinteza teorike, por përcillet gjeografia/shtrirja dhe historia e larmishme e kësaj letërsie, me tërë spektrin stilistik dhe estetik - që ajo ka mbartur në rrjedhë të shekujve.

Po qe se do të bënim një karakterizim të kontributeve të sjella prej kësaj studiuëseje, ato do të kishin të bënin me: a. *larminë* dhe thellësinë e argumenteve të sjella, b. me *prirjen* për t'i përcjellë ato argumente me një stil të dukshëm polemist c. me *mbështetjen* e fortë e të sigurt teorike të tyre d. me *ligjërimin* sa shkencor - aq edhe me gjuhë të qartë, larg komplikacioneve abuziviste e po ashtu e. me *një qasje* të sigurtë ndaj sfidave teorike të trajtuara - por duke ruajtur përherë një diskurs shkencor me vizion të *hapur*, pra, shtjellim tezash me sens propozues dhe jo me prirje *imponuese* e *dogmatike*.

Këtë prirje e shfaq edhe vepra e saj më e fundit, ajo e sapo botuar, me titull: *POSTMODERNIZMI Poetikë e "antirregullit"*, në radhën e nëntë librave të saj të mëparshëm. Qysh në titull, e kuptojmë tërheqjen e studiuëses për t'u përballur me një dukuri sa komplekse, aq edhe të pastabilizuar ende në qasjen teorike ndaj saj, në nivel të letërsisë botërore e kuptohet, edhe asaj shqipe - që nuk mbetet pas këtyre rrjedhave letrare moderne.

Besojmë se libri zgjon interes, jo vetëm për lëndën e pasur letrare - ku hulumtohet me skrupulozitet (në vepra të Anton Pashkut, Rexhep Qosjes, Mehmet Krajës, Bashkim Shehut, Visar Zhitit, Agron Tufës, Fatos Kongolit, Virion Graçit dhe autorëve të tjerë) - por edhe për qasjen dilematike rreth problemit të përcaktimit të kufijve mes modernizmit dhe postmodernizmit. Si një kundërvënie estetike e të dytit (pra e postmodernizmit) - ndaj të parit (modernizmit), në fakt, ende mes studiuësve të shumtë nuk parashihen që të

ketë vlerësime fort të përcaktuara, apo fort të dallueshme mes tyre. E kjo, lidhet me vet kufijtë e lëvizshëm mes këtyre lëvizjeve mjaft të bujshme letrare, kryesisht të shekujve XX -XXI.

Autorja, duket se nuk mbetet në konstatime referenciale prej sudiuesve të tjerë të njohur - rreth këtij argumenti, pra të njohjes së një paqartësie e dallimi prerazi mes tyre, por e hulumton këtë dukuri (le ta themi figurativisht si një lloj *hermafrodití*-je apo *dytësije letrare*), duke u ndalur nëpër vepra konkrete, kryesisht ato në prozën shqipe romanore.

Me të drejtë, autorja e këtij studimi nënvizon konceptin e njohur se letërsia si akt krijimi, është/mbetet e pavarur nga përpunimi i mendimit teorik. Ajo nxitet veçse nga ndjeshmëria e autorit shkrimtar ndaj realitetit njerëzor dhe pastaj është vet letërsia, ajo që ndikon në përpunimin e mendimit teoriko-letrar. Por ndërkaq, në kohët e sotme, nën ndikimin e rrjeteve të një informacioni tejte kompleks e vërshues: teknologjik, filozofik, kulturor e shpirtëror, sigurisht, që edhe letërsia, nuk mund të mbetet në pozita të pastra autonomiste – por përcjell fluksin e ndikimit dhe orientimit estetik të saj - prej rrezatimit të këtyre lëvizjeve jashtëletrare mjaft intensive.

Janë me interes në këtë studim, vështrimi i poetikës posmoderne në disa specifika të dallueshme, sidomos ato që kanë të bëjnë me të ashtuquajturën prishje të kufijve gjinorë, ku vrehen kombinime e kolazhe zhanresh, që në fakt, sillen prej krijuesve (me sa duket) si një manierë - për të sjellë e potencuar në vepër, përparësi specifike prej seicilit zhanër. Apo evidentimi i kësaj poetike në shfaqjen e thyerjes së narracionit, si një ligjërimit energjik ky dhe shumë shtresor, që krijon efektin artistik të leximit të thellë, ardhur prej strukturës së njohur të palimpsestit.

Në vargun e studimeve dhe veprave monografike të karakterit teorik të autores, është edhe ai me titull "*Sfida teorike të historiografisë letrare*", i botuar këtu e dhjetë vjet më parë. Sigurisht, që mbetet një guxim shkencor marrja përsipër e shkoqitjes në rrafshin teorik - të një morie sfidash të natyrave të ndryshme, shkencore e jashtë shkencore, nga ato që kanë të bëjnë me gjetjen e rrugëve më të sigurta për hartimin e një historie të letërsisë. Studiuesja F.Dado e ka të qartë këtë ballafaqim të vështirë e delikat dhe pikërisht, mbase kjo, ka qënë edhe një arsye më shumë në vendimin e saj për t'u marrë me këtë argument. Një botim si ky, i llojit kritik, me parashtrim pikëpamjesh e debatesh letrare, gjykojmë se ka vlerë të dyfishtë: risjell një fond të gjerë modelesh konceptuale të historive të ndryshme të letërsisë, por ndërkaq, është edhe një grishje dhe ftesë për hartimin, ose më mirë, për shkrimin e historisë së letërsisë shqipe në nivel akademik, më se të pritshme e më se të realizueshme në kohët e sotme.

Theksuam shkrimin dhe jo rishkrimin e historisë së letërsisë shqipe, se në gjykimin tonë, çdo botim i këtij lloji - që sheh dritën e botimit, është në vetvete një histori e pavarur apo histori unike letërsie, sipas koncepteve të zgjedhura teorike. Një vepër do të quhej pastaj e kryer, e çertifikuar, për mirë apo me rezerva ndaj saj, nga vet lexuesi i saj. Një botim tjetër vijues i këtij profili, edhe pse mund të ketë të njëjtin objekt studimi, pra letërsinë shqipe (me po ata autorë përkatës), është dhe mbetet sigurisht një vepër e re. Në këtë kuptim, mund të thuhet se në traditën tonë historiografike letrare, kemi aktualisht një mori tekstesh e manualesh mbi historinë e letërsisë shqipe, të botuara e të qarkulluara në arealin kulturor shqiptar dhe jashtë tij, në disporën arbëreshe dhe në qendra të ndryshme albanologjike, me autorë shqiptarë dhe të huaj, të shkruara nga individë apo nga ekipe studiuesish, me destinacione parauniversitare, universitare, apo njohëse masive, të natyrës enciklopedike - drejtuar lexuesve të huaj, të hulumtuara këto procese letrare sipas rastit : mbi bazën e periodave historike, mbi formacionet letrare qarkulluese, mbi profilet/individualitetet e shkrimtarëve, sipas gjinive letrare etj.

E gjithë kjo tipologji botimesh të shumta, ka qënë objekt i një studimi mjaft të vëllimshëm nga autorja dhe për më tepër, krahas synimit paraqitës si informacion filologjik, ka qënë objekt për të hetuar tendencat dhe kontributin e kësaj trashëgimije, e cila, me një rrokje/vështrim të parë, mund të ngjajë modeste si vëllim e si tipologji, por që kur i hyn hulumtimit, e kupton se je duke u përballur me një pasuri komplekse e njëherësh me një sfidë të vërtetë.

Do ta quanim vlerë të çmuar të kësaj vepre, ngritjen e debateve dhe tezave shkencore mbi bazën e asaj çka sugjeron realiteti letrar e shkencor dhe jo e kundërta, siç ndodh në disa raste, kur studjuesi, ka ca ide e teza të vetat para-prake dhe sipas tyre, kërkon pastaj në mënyrë të sforcuar, modele ilustruese për ato teza, nëpër rrjedhat e proceseve letrare. Janë të shumta burimet e cituara rreth argumenteve të ndryshme, aq sa vepra, është edhe një bibliografi e pasur burimesh letrare, si dhe ka formatin e një antologjie pikëpamjesh të lloj-llojshme kritike. Kështu, vetëm në çështjen e periodizimit të letërsisë shqipe po të ndalemi, do të ndeshim të ballafaquara një mori pikëpamjesh, që e formulojnë këtë periodizim: mbi bazë qarqesh letrare, mbi bazë individualitetesh (nisur nga vështrimi i saj si *letërsi atipike*), mbi bazën e shtatë shkollave letrare, që nga tekstet filobiblike e deri tek ato moderne, mbi bazë rrymash letrare, mbi bazë periodash social-historike, mbi bazë diskursesh - që nga ai heroik e deri te ai historik etj.

Vihet re se autorja është e vëmendshme dhe jo preferenciale kundrejt autorëve të caktuar, kontribues në rrethin e dijeve letrare, duke dëshmuar kësajsoj etikë dhe mbështetje e vlerësim prej kolegu, vlera këto, që jo rrallë në

këto kohë, i shohim (për fat të keq) të jenë tronditur jo pak, modele qëndrimesh këto - të ardhura nga matanë lagjeve shkencore, ku debati, i përkorë dhe intelektual (ashtu si e ka kuptimin dhe qëllimin të jetë), është kthyer shpesh në grindje të pakontrolluara. Në vepër parashtrohen kontribute, teza, debate e polemika letrare të qarkulluarë nga studiues të ndryshëm e në kohë të ndryshme, duke i vlerësuar ato, për aq sa kanë mundur të ndriçojnë rrugët, nëpër të cilat është endur filli i letërsisë shqipe. Por autorja, nuk pajtohet me tendencat e debatit azgjësonjës, një debat ky që nuk prodhon veçse amulli dëshpëruese, duke dëshmuar kësaj se studiuesja është ndjekëse e të ashtuquajturës kritikë me *perspektivë* d.m.th. që pas çdo diskursi, sado kritik, të ndihet i projektuar modeli i afirmimit të një vlere të caktuar.

Rolin e historianit të letërsisë, studiuesja e vlerëson si mjaft delikat, sidomos në procesin e shqyrtimit dhe klasifikimit të letërsisë së traditës. Për të realizuar një studim serioz e objektiv, ai duhet që ta ketë mirë parasysh se duhet të njohë e të vlerësojë drejt një zinxhir *pritjesh* të veprave letrare, në kohë të ndryshme. Çdo vepër, nuk ka vlere në vetvete, ato shfaqen veçse në raport me lexuesin, prandaj edhe historiani i letërsisë, kërkohet që të jetë zëri i kualifikuar dhe njëherazi, të jetë sintezë e shumë receptimeve. Në këtë kuptim, studimi i tij mbi letërsinë e traditës, ka një qasje reagimi dyfish: ndaj *veprës letrare* (si pasojë e leximit ndryshe të saj, nën ndikimin e kodeve të reja të zbuluara), ndaj *historive paraprijëse* të letërsisë (nën ndikimin e horizontit të pritjes kundrejt asaj kohe të dikurshme). Kjo pozitë *sui generis*, është edhe misteri dhe bukuria e kësaj dijeje, që mban përherë gjallë shpirtin e kërkimit e të zbulimit të pandërprerë të kodeve dhe strukturave të reja artistike, mbi tekste që sigurisht, nga ana e tyre nuk ndryshojnë asnjëherë.

Vepra si "*Sfida teorike të historiografisë letrare*", ka jo vetëm peshën e një argumenti të rëndësishëm, që merr përsipër të shqyrtojë procesin letrar, por edhe të ketë rolin ndihmues e kontribues për hartimn real të një historie të pritshme akademike të letërsisë shqipe, një vepër që vazhdon të ndihet si shumë e munguar. Pra, edhe këtu, shihet koncepti i kritikës me *perspektivë* i kësaj studiueseje, e cila, me sa duket, udhëhiqet nga ai urdhër i kahershëm e gati hipnotik edhe për dijetarin e letërsisë: *Unë kam një endërr...*

Koleges dhe mikes sonë të nderuar Prof. Floresha Dados, i urojmë të sjellë për lexuesin punë të tjera të vyera. Në personalitetin e saj akademik dhe njerëzor, janë të shenjuara kontribute e vrytute të çmuara, të cilat, meritojnë mirënjohjen tonë pa kufi ndaj saj.

**Hysen MATOSHI**

*Instituti Albanologjik i Prishtinës*

## **FLORESHA DADO – STUDIMI ATIPIK I LETËRSISË**

Epigonizmi nuk është dukuri që haset vetëm në krijimtarinë letrare. Nuk kemi vetëm shkrimtarë kopista, sikundër i quante epigonët dikur Dom Lazër Shantoja. Epigonizmi ka përfshirë edhe studimet tona letrare, veçmas shkrimin e historisë së letërsisë shqipe. Duke ndjekur modele të caktuara dhe duke rithënë të thënat për kronologjinë letrare shqipe, jo një herë para nesh zbulohet a më mirë të themi rizbulohet e njohura, pasohen shkolla studimesh të letërsisë, modele shkrimi në fushën e dijeve letrare, pikëpamje të cilat, në saje të ripërsëritjes ciklike, pothuajse janë shndërruar në fetishe.

Një klime të këtillë të mbizotërimit të klisheve është vështirë t'i shmangesh. Të paktë janë autorët të cilët përbëjnë një zë më vete në shkrimin e historisë së letërsisë shqipe. Ndër ta shquhet akademikja Floresha Dado, e cila që nga monografia kushtuar Andon Zako Çajupit e deri te vepra e fundit “Posmodernizmi poetikë e “antirregullit” ka dëshmuar kapacitetet e larta njohëse, veçmas ato teoriko-letrare, si një identitet i veçantisë së saj studimore.

Është e kuptueshme që kontributet e saja, që shtrihen në një periudhë prej më se gjysmë shekulli, të mos mund të përfshihen në një format të këtillë kumtimi që, përtej një vlerësimi kritik shkencor, përmban edhe mirënjohjen për gjithë punën vigane të pedagoges në auditorët e universiteteve, të ligjërueses së kumtimeve të paraqitura në aktivitete shkencore, të dijetares së sintezave të mëdha monografike, në të cilat shtrohen dilema dhe ofrohen zgjidhje për një varg preokupimesh historiko-letrare, teoriko-letrare dhe të kritikës sonë letrare. Prandaj për mua është një nder i posaçëm që, në kuadër të aktivitetit shkencor “Ditët e Alfabetit”, që e organizon Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, të them disa fjalë për një aspekt të kontributit të Akademikes Floresha Dado në fushën e historishkrimit letrar. Kërkesave të vijueshme, të dëgjua në mesin e specialistëve të letërsisë dhe jo vetëm të tyre, për rishkrimin e Historisë së Letërsisë Shqiptare, Floresha Dado u është përgjigjur me një monografi që e trajton këtë çështje në rrafshin teorik, përkatësisht si sfidë teorike. Mungesa e formimit të mjaftueshëm teorik

e debatuesve lidhur me Historinë e Letërsisë Shqiptare sigurisht që shpie në debate amatore, do të konstatonte autorja që në hyrjen e veprës së saj, ndaj me të drejtë e ka orientuar diskutimin e saj në rrafshin teorik kah çështjet sikundër janë: ato të karakterit metodologjik, çështjet e kriterëve të hartimit të Historisë së Letërsisë, të periodizimit, të evolucionit të strukturave formale të letërsisë, të raportit të letërsisë me historinë etj. Pra, çështja e hartimit të Historisë së Letërsisë Shqiptare, e cila ndonjëherë e banalizuar skajshëm duke e kthyer në çështjen se cilët autorë duhet të hiqen prej dhe cilët duhet të shtohen në të, është mjaft komplekse dhe gjithsesi lidhet me aspekte të konceptimit të vetë asaj që e quajmë histori e letërsisë, kriteret mbi të cilat bazohet ajo etj. Megjithëse nuk e fetishizon teorinë e letërsisë, pra nuk e konsideron një konstantë a një dogmë, Floresha Dado e sheh zgjidhjen tek formimi teorik i studuesve përballë subjektivizmit të interpretimit eseistik e kritiko-letrar të letërsisë.

Pa asnjë dyshim një çështje kyçe në procesin e historiografisë letrare është edhe periodizimi i letërsisë, është të themi projekti mbi të cilin punohet një histori letërsie. Në krye të herës, do theksuar se periodizimi për Floresha Dadon është sfidë, në mos edhe kryesfidë, e historiografisë sonë. Ndonëse ka sjellë gati të gjitha modelet ekzistuese të periodizimit të letërsisë sonë, nuk i ka vënë vetes detyrë të mohojë apo të lartësojë praktikën e deritanishme të periodizimit në mesin tonë. Përpjekja e saj ka qenë një përshkrim analitik i secilit nga periodizimet me peshë në historiografinë tonë letrare. Në këtë pikëpamje, për këtë problematikë mjaft komplekse, ka formësuar projektin e saj teorik të modelimit të letërsisë, zgjidhjen e saj, që në vend të shkëputjes ndërmjet grupimeve koherente letrare kërkon lidhjet ndërmjet tyre, duke kërkuar linjën e brendshme të Todorovit ndërmjet të përgjithshmes dhe të veçantës, letërsisë si tërësi dhe veprave letrare si krijime të veçanta.

Edhe pse kjo vepër është e konceptuar si teorike, autorja i është shmangur rrezikut të identifikimit të saj si një dogmë, si diçka qëndron krejtësisht jashtë praktikave dhe rrethanave konkrete, ngase në mjaft raste i referohet konkretisht një Historie Letrare Shqiptare, të shkruar të a të rishkruar. Ndonëse zgjidhjet teorike funksionojnë në rrethana të përgjithshme, konkretizimi ndjehet gjithandëj veprës, por në raste të caktuara edhe theksohet pa ngurrim. Sipas saj për hartimin e një historie të letërsisë shqiptare është e domosdoshme që specialistët të kenë parasysh këto tri aspekte:

Natyrën e letërsisë si lloj arti,

Specifikat estetiko-letrare të letërsisë shqiptare dhe

Rrjedhën historiko-kulturore e vendit tonë.

Do të thosha të vendeve tona, përkatësisht të hapësirave etnike në të cilat zhvillohet letërsia shqipe.

Rezultatet e Floresha Dados në këtë kontekst janë produkt i dijeve të dëshmuara në fushën e teorisë së letërsisë dhe të ndërlidhjes së tyre me paraqitjen e veprave letrare në kronologjinë historike, përkatësisht të dimensionit estetik me dimensionin historik. Përgjithësimet teorike janë ana e fortë e studimeve të saja në historiografinë tonë letrare përballë prirjeve dominuese për një qasje biografike dhe përgjithësisht pozitiviste në raport me autorë, me vepra e periudha të caktuara letrare. Gama e gjerë e burimeve teorike, përzgjedhja e tyre kritike, vënia e referencialitetit shumëplanësh dituror letrar në funksion të qartësimit të idesë dhe të vizionit të saj përbëjnë një terren të qëndrueshëm mbi të cilin e ndërton konceptin vetjak studimor.

Pavarësisht nëse i referohemi si përgjithësim mendtor i përvojës, si tërësi e parimeve, si tërësi e ligjeve shkencore, apo si gjykim abstrakt, teoria shënon nivelin më kulmor të gjykimit të njeriut. Po kështu diskutimi i çështjeve në rrafshin teorik shënon qasjen më serioze për zgjidhjen e tyre parimore. Them që historishkrimi i letërsisë sonë në veprën e Floresha Dados “Sfida teorike të historiografisë letrare” tashmë ka një traktat të mirëfilltë shkencor, i cili, edhe nëse nuk i zgjidh të gjitha çështjet lidhur me historiografinë letrare, them se i identifikon mjaftueshëm ato.

Floresha Dado mund të merrte mbi vete barrën e pjesës, por ajo në vend të saj ka zgjedhur të merrej me tërësinë, mund të merrte në shqyrtim konkretën, por ka zgjedhur të përgjithshmen, mund t’i fliste të sotmes, por zgjodhi t’i fliste të nesërmes.

**Agim LEKA**

*Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Shkup*

## **FENOMENI FLORESHA DADO!**

I nderuar drejtor i institutit, z. Skender Asani,

E nderuara z. Floresha Dado, akademike,

Të nderuar profesorë dhe mysafirë të tjerë të pranishëm në këtë tubim festiv me shkas!

Me marrjen e ftesës për të referuar i vura vetes një qëllim jo të vogël – të sqaroj diçka rreth fenomenit F. Dado, në kuadër të konceptimeve të shkencës së letërsisë. Duke përdorur nocionin “fenomen” më besoni se e di saktë se çfarë them, ç’domethënie ka e çfarë shënjon kjo fjalë dhe, t’jeni të sigurt se thuhet pa teprime e për shumë arsye. F.D. nuk është se vetëm shkroi vepra të rëndësishme teorike letrare, nuk është se vetëm ligjëroi për të njëjtat çështje nga katedra universitetesh të ndryshme, nuk është se debatoi në dhjetëra konferenca shkencore, por, nga të gjitha këto më e rëndësishmja është se ajo lë gjurmë të thella e të pashlyeshme, duke krijuar një shkollë të tërë të veten teorike letrare, një rreth bashkëmendimtarësh, ndjekës të veprës së saj, të cilët me krenari, jo vetëm që vazhdojnë shtigjeve të saj, por do vijjnë duke i thelluar kërkimet, e me këtë kontributi shumëfishohet dhe merr përmasat e një dukurie, e, pse mos ta themi, me profilin e saj të lartë intelektual F.D. përfiton attribute të një institucioni të fuqishëm më vete.

Dado filloi të publikojë në mesin e viteve '80 të shekullit të kaluar, kur në Shqipërinë socialiste dominonte kritika marksiste, ndërsa në Kosovë, që nga vitet '70 kishin marrë udhë metoda më të reja teorike letrare, së pari të importuara nga Parisi e Zagrebi, e më vonë edhe nga qendra të tjera evropiane. Kritikët e rinj shqiptarë që vepronin në trojet shqipfolëse të ish-Jugosllavisë, duke e luftuar dhe refuzuar kritikën e zvetënuar marksiste, i zbatonin metodat më të reja kritike letrare, kryesisht strukturalisten dhe ngapak semiotiken, duke u mjaftuar me analiza brendatekstuale, të privuara nga historizmi dhe kontekstualizimi jashtëletrar.

Mirëpo, kritikët më në moshë vazhdonin ta kultivojnë metodën marksiste, e cila, për dallim nga ajo e Shqipërisë, nuk e kërkonte përherë “ideshmërinë socialiste” në krijimtarinë artistike. Megjithatë, edhe kjo kritikë mbetej shabllonike dhe pa shpirt krijues, por tashmë jo dogmatike, e mbështetur kryesisht

në interpretimet e të majtëve evropianë të Perëndimit. Ata mendonin se është gjetur një formulë e suksesshme ndërmjet shoqërisë dhe letërsisë: ashtu si shoqëria edhe mendimi për letërsinë, po edhe vetë letërsia, do të zhvillohet mbi njohjet e mendimit marksist, e kjo u jepte një komoditet dhe vëtkënaqje, duke u mjaftuar të gjejnë vetëm shkallën e sasinë sa një vepër është më shumë e tjetra më pak realiste.

Ndërkaq në Shqipëri për gati pesë dekada mbeti në fuqi kritika marksiste - leniniste, e bërë sipas shembullit sovjetik, duke u vënë në shërbim në mase të madhe të punës ideologjike propagandistike. Duke i bastarduar dhe keqinterpretuar burimet e filozofëve klasikë marksistë ata kritikën letrare në shumë raste e shndërruan në deklarata, të frymëzuar nga kuorume politike dhe udhëzime / direktiva partiake, praktikisht duke administruar dhe duke i bërë jehonë doktrinë ideologjike. Sipas gjuhës dhe stilit, ndërkaq, kjo metodë më shumë ishte publicistike, populiste, pa aparaturë kritike, shpesh pa valorizime estetike.

Pas rënies së komunizmit si sistem e si regjim qeverisës në shumë vende evropiane, ku bënte pjesë edhe Shqipëria, vjen në skenë pluralizmi politik, që solli edhe pluralizmin në shumë sfera të jetës, e në mënyrë të veçantë dhe, me rëndësi për ne, në fushën e krijimtarisë artistike dhe të qasjeve apo metodave për interpretimin e tyre. Tani del në skenë F. Dado, e cila duke e kundërshtuar doktrinarizmin, po edhe favorizimin e një metode të vetme, cilado qoftë ajo, bën kthesa radikale dhe metodën interpretuese nga ajo skematike, sterile, e aprioristike, që e trashëgoi, e vë në binarë të një sistemi, që nënkupton qasje të argumentuar, të një saktësie të theksuar gjatë përshkrimit të të gjitha aspekteve të problemit, duke iu përmbajtur gjithnjë parimeve mbi të cilat funksionon mendimi i shëndoshë teorik letrar.

Në çerekun e fundit të shekullit të kaluar me tekstet e F.D. më në fund erdhën ndryshimet e shumëpritura për qasje dhe interpretim konstruktiv të veprave letrare. Ajo tashmë fuqishëm është përcaktuar që çështjeve teorike letrare t'u shkojë gjer në fund, duke i qëmtuar, sistemuar, analizuar dhe interpretuar si askush më parë në qendrat studimore shqiptare, qofshin universitete apo institute. Për gjysmë shekulli do të gërmojë e klasifikojë dokumente e dukuri letrare, të cilat për nga kompleksiteti medoemos kërkojnë dhunti, edukim sistematik, intuitë, invencë, dhe tërë atë që është e nevojshme për çdo lloj krijimtarie. Dhe të gjitha këto F.D. i posedon, duke e ndihmuar që atë stivë të madhe të fakteve artistike të dijë si ta vërë në rend dhe ta bëjë të

kuptueshme edhe për atë që nuk është fort specialist dhe nuk është shumë i udhëzuar për t'i kuptuar mirëfilli problemet teorike letrare.

Duke bërë pjesë tek grupi i shkencëtarëve të cilët qartë e përcaktojnë fushën e trajtesës, kahjet dhe qëllimet e hulumtimit, me mjete analitike shumë të sakta, arrin ta përshkruajë fleksibilitetin dhe thellësinë e çdo teksti letrar. Për këtë ndërmarrje sigurisht që nevojiten dije dhe instrumente të përshatshme dhe, të gjitha këto, F.D. i posedon.

Në korniza më të gjera botërore F.D. si studiuese paraqitet në një kohë kur nuk ndodhin dhe praktikisht nuk ka më nevojë të ndodhin zbulime revolucionare për kërkim, por e rëndësishme bëhet që këto mjete dhe shkolla teorike të njihen mirë, të përvetësohen dhe, që është më e rëndësishmja, të praktikohen, të zbatohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Krejt kjo duhet bërë duke respektuar pluralizmin e metodave, pa favorizuar asnjërën në mënyrë të veçantë, e duke marrë parasysh atë koncept që e ndihmon më së miri të zbërthehet një veprë e caktuar letrare.

Me sa e di, F.D. është nga studijuesit e rrallë tek ne të cilët në punën e vet e ka bashkuar teoricienin letrar me lexuesin e vëmendshëm të tekstit artistik. Me sa e njoh, jo vetëm kaq: ajo është edhe një dëgjuese shumë, shumë e vëmendshme, një dhunti kjo, që është e domosdoshme për të realizuar komunikim të shkallës sipërore.

Si profesoreshë, ligjëruese jashtëzakonisht e informuar, personë, pra, e cila pikëpamjet e veta i shpreh drejtpërdrejt para dëgjuesve të vet, pra para studentëve, për një gjysmë shekulli ka krijuar një stil të vetin debatues. Nëse i përmbahemi përcaktimit klasik të Bufonit "Stili është baras njeriu", natyrshëm e marrim lirinë të bëjmë edhe ne një përëqasje të skemës me një analogji: "stil debatues është baras me Floresha Dado". Duke qenë i vetëdijshëm se nuk është tani momenti më i përshtatshëm për t'u përmedndur të gjitha veprat dhe të bëjmë recension për to, e shoh si të domosdoshme të përmend tre tituj librash të dalë nga dora e akademik Dados, e ato janë:

1. Teoria e veprës letrare – Poetika;
2. Letërsi e painterpretuar: qasje teorike ndaj realizmit socialist;
3. Sfida teorike të historiografisë letrare;

vetëm sa për t'u kofirmuar ato që u thanë si cilësime të diskursit teorik letrar të FD, po edhe për ta vënë në dijeni publikun për peshën dhe rëndësinë që kanë librat e saj, të cilat merren me çështjet më kryesore teorike letrare, marrëdhëniet ndaj poetikës dhe retorikës, pastaj raportin e teorisë ndaj disiplinave të tjera, veçanërisht të kritikës letrare, por edhe ndaj historisë së letërsisë.

Duke mos dashur të bëj rangim për nga rëndësia, sepse u tha edhe më lart se çdo botim i profesor Floreshës ka peshë e rëndësi, libri *Teoria e veprës letrare* është për mua më i preferuari dhe referenca kryesore në punën time profesionale, kur tok me specialistët e ardhshëm të filologjisë, ua mësoj sekretet e marifetet se çfarë e bën një vepër të jetë njëmend letrare, cilët janë ata përbërës që e mbajnë në këmbë, ku mund të prishet e si ndreqet, thjesht si funksionon dhe si ndikon mbi ata që vijnë në kontakt me të.

Për dallim nga "Letërsi e painterpretuar" ku F.D. ka hapur fushë të re problemore në trajtimin e marrëdhënieve ndërmjet teorisë së letërsisë dhe kritikës letrare, të vrojtuar nga perspektiva e një leximi të ri të letërsisë së ashtuquajtur socrealiste, e për dallim nga "Sfida teorike të historiografisë letrare" ku e trajton relacionin e teorisë me historinë e letërsisë, dhe nevojën për rishkrimin e një historie të re të letërsisë kombëtare, tek vepra *Teoria e veprës letrare* specialistja Dado e vë teorinë si disiplinë përballë poetikës, duke i kapërthyer të gjitha çështjet dhe faktorët që e përbëjnë procesin krijues.

Duke analizuar historinë e nocionit "poetikë" (sot më shumë të njohura si "metoda kritike" ose "modele interpretuese"), F.D. i vë në dukje rrënjët e teorisë së letërsisë, relatat të cilat i vendos ajo me retorikën dhe stilistikën antike, më pas raportin e saj ndaj traditës, si dhe me sfidat me të cilat ajo përballlet sot. E ngre edhe çështjen e rolit të poetikës për shkencën e letërsisë në përgjithësi dhe deri në ç'masë ajo është ose mund të jetë normative, që sipas saj është inherente ndaj veprës.

Duke e shqyrtuar ecurinë e orientimeve kryesore metodologjike F.D. në këto libra ka krijuar një pasqyrë të qartë, në aspekt informativ shumë të begatë, duke ofruar një qasje e model krejt të ri, ngritje pikëpyetjesh po edhe dhënie përgjigjesh për tema, për të cilat shumë kush ka menduar se tashmë janë të absoluara apo të demoduara dhe nuk ka nevojë më për rishikim. Mirëpo, Dado guximshëm e me kompetencë e demanton këtë bindje të gabuar, duke hapur mundësi të reja për t'i trajtuar problemet.

Në artikullimin e pikëpamjeve të këtilla teorike rol të rëndësishëm kanë luajtur ndjekja intensive, konceptimet dhe literatura relevante teorike (por edhe përkthimi i saj, që e bën vet studijuesja), krejt në përputhje me kërkesat e arsyeshme dhe në harmoni me sfidat e disiplinës në fjalë, por edhe të momentit kur janë shkruar librat.

Me qasjen origjinale, me gjuhën dhe stilin, F.D. bëri që *Teoria e letërsisë* nga një projekt delikat, abstrakt e hermetik të bëhet e kuptueshme, e kapshme, jashtë labirinteve (veçanërisht ato që u paraqitën gjatë shek XX) kur tek pak të

lexuarit shkaktonte o rezistencë, o mosbesim, o bezdi a kotësi. Me mënyrat e saj, pa e thjeshtëzuar teorinë deri në banalitet, por edhe pa e ndërlikuar pa nevojë me kuazimetoda dhe terminologji të paqartë, duke iu shmangur mjeshtërisht diskurseve sterile që e bënin artefaktin të huaj dhe e privonin nga magjia, provokacioni dhe enigmatikja, bëri që F.D. sot të konsiderohet si shembull paradigmatic i konceptimit funksional të metodologjisë shkencore letrare.

Me tiparet që i karakterizojnë – e këto janë para së gjithash analitika, argumentimi, erudicioni dhe aktualiteti – këto libra i vënë themelet e shkencës shqiptare për teorinë e letërsisë, po vlejnë edhe si kontribut shumë i rëndësishëm për filologjinë shqiptare në përgjithësi. Ky kontribut do të duket edhe gjatë sajimit të një numri të madh termash, gjegjësisht gjatë standardizimit të tyre në kornizat e terminologjisë teorike të gjuhës shqipe. Prandaj trajtesat e saj teorike shkencore lexohen dhe kuptohet fare qartë dhe pa shpjegime plotësuese. Nacionet që i përdorin Dado kanë kaluar përmes një rruge të gjatë praktikimi dhe, si të tilla, janë kristalizuar në kode të etabluara terminologjike.

Shembujt që i merr F.D. nga letërsia për ta vërtetuar teorinë e saj nuk janë të shumtë në numër, mirëpo janë shumë ilustrativë dhe të përdorur me efekt të madh. Andaj librat e saj teorikë-letrarë nuk janë të rëndësishëm e të dobishëm vetëm për specialistët, por edhe për publikun më të gjerë. Sepse, siç thotë teoricienti i njohur, Mishel Rifater, “asnjë teori nuk ka vlerë të kujtohet nëse nuk qëndron fortë mbi themele të dukurive për të cilat thotë se dëshiron t’i shpjegojë”, e ato janë vetë veprat letrare.

F.D. e di se teksti letrar nuk është njësi që mbyllet dhe izohet në vetëvete, me shumë tipare të tij ai përfshihet në tërësi më të mëdha: në opusin e autorit ose epokës, në një zhanër të caktuar, deri tek konteksti i letërsisë dhe kulturës kombëtare, gjegjësisht letërsisë dhe kulturës në përgjithësi. Po në të njëjtën kohë (e kjo është vetëm ana tjetër e të njëjtit proces) e tërë kultura dhe kujtesa e saj, indirekt, reflektohet në çdo tekst veç e veç. Prandaj nuk është për t’u habitur që F.D. shërbimin ndaj letërsisë shqiptare nuk e ndan asnjëherë nga përkushtimi ndaj kulturës dhe popullit të vet të cilit i përket.

Duke e përgëzuar profesoreshën për punën kolosale që ka bërë, me anë të së cilës është vënë në pah se identiteti njerëzor e shoqëror, megjithatë, ndërtohet dhe vërtetohet, para së gjithash, përmes gjuhës në përdorimin e saj estetik, uroj që këtij vargu veprash t’i shtohen edhe shumë të tjera, të cilat do t’i konsiderojmë si një trashëgimi tepër e çmuar që do t’ia shtonte vlerat kulturës sonë kombëtare në përgjithësi!

**Emin AZEMI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **FLORESHA DADO - IDENTITETI MË PËRFAQËSUES I NJË SISTEMI VLERËSUES NË LETRAT SHQIPE**

Të flasësh për pak minuta, siç po provojmë tani, për punën voluminoze shkencore mbi 40-vjeçare të një studiuese të letërsisë, siç është akademikja Floresha Dado, është një mision i vështirë, për të mos thënë i pamundur, sepse çka do që të themi, dhe sado që të zgjatemi në fjalët tona, sërish do të ngelë shumë çka jashtë observimit dhe trajtimit adekuat të fondit të saj të begatshëm libror.

Por, për t'i ikur këtij kurthi që ngre koha e kufizuar, do të mundohem të paraqes vetëm disa nga përshtypjet telegrafike mbi opusin shkencor të kësaj studiuese, duke u ndalur në disa prej kulmeve të krijimtarisë së saj. Në radhë të parë, duhet saktësuar se Floresha Dado është një prej emrave më kompetent në botën e studimeve letrare shqiptare, duke pasuruar përvojën tonë me prurje serioze në fushën e historiografisë letrare dhe teorisë së letërisë, si dy sfida që ajo i ka mbarështruar me mjaft sukses në disa prej botimeve të saj, duke filluar nga monografia mbi Andon Zako Çajupin, e deri te studimet tematike mbi Letërisinë e painterpretuar, që i kushtohet kryesisht letërsisë së ashtuquajtur të realizmit socialist, për të cilin emërtim Floresha Dado ka rezervat e saj dhe ajo më tepër parapëlqen letërsinë socialiste, si emërtim që do ti shkonte kësaj shkollë letrare të periudhës së monizmit, si dhe veprat tjera, të një korpusi pak a shumë të përbashkët tematik, ku gjithsesi shquhet, ndoshta një nga më të rëndësishme, ajo me titull Sfidat teorike të historiografisë letrare, pastaj Identifikimi i poetikave në planin teorik dhe historiko-letrar, Teoria e veprës letrare-Poetika, Proza nëpër teknikat poetike, Intuitë dhe vetëdije kritike, Letërsi në 'kurth': Eseistika e Kadaresë dhe më e reja Postmodernizmi - poetikë e 'antirregullit'.

Floresha Dado, i takon profilit të studiuesve që kreativitetin e saj prej gjurmuese me shije të hollë të proceseve teorike- letrare, e ka dëshmuar në dy fusha komplementare: në procesin arsimor/edukativ dhe në atë shkencor, fillimisht në cilësinë e pedagoges shumëvjeçare të teorisë së letërsisë dhe

historiografisë letrare dhe në atë shkencore, si autore dhe kontribuese e projekteve dhe studimeve të bëra në kuadër të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë.

Duke qenë për shumë vite pedagoge në katedrën e studimeve universitare, Floresha Dado, gjithë angazhimin e saj intelektual e shkencor, vëmendjen e kishte përqëndruar në ngritjen e një infrastukture moderne të studimeve letrare mbi bazat e njohurive teorike, si kusht pa të cilin ishte i pamundur operimi me njohuritë përcjellëse, por tepër të domosdoshme, siç janë historiografia letrare, kritika letrare, eseistika, publicistika letrare etj.

Prandaj jo rastësisht ajo edhe disa nga titujt më të rëndësishëm të veprave të saj i identifikon me preokupimin e saj kryesor, duke përqëndruar gjithë korpusin e saj tematik në problematikat që janë derivate të observimeve teorike-letrare.

Në këtë korpus tematik gjithësi bëjnë pjesë veprat Teoria e veprës letrare – poetika, ku autorja me një qasje mjaft argumentuese përkufizon problematikat e Teorisë në raport me praktikën e analizës letrare dhe me poetikën, si dhe raportin e Poetikës me gjininë letrare, gjegjësisht me veprën apo lexuesin, duke shkoqitur parimet themelore të studimit të letërisë dhe sistemin letrar përmes vështrimit diakronik e sinkronik. Objekt i analizës së saj është edhe Teoria e romanit si dhe problemet metodologjike mbi interpretimet, të trajtuara bashkë me Kuptimin mbi kompozicionin, Narracionin dhe aspekte të ndërtimit të tij, Dialogun në poetikën e ligjërimit, ku autorja përqëndrohet më tepër në ndërtimin e figures, duke marrë për bazë figurën në përfytyrimin naimian, figurën në konceptin artistik të Ismail Kadaresë si dhe Kodet e krijimit të figures në romanet e Vath Koreshit.

Një tjetër interesim që përvjohet në observimin terotik të Floresha Dados është edhe raporti në mes të Intuitës dhe vetëdije kritike, një kompozitë kjo kuptimore që shenjon edhe një nga titujt e veprave të saj, e cila është e organizuar në katër korpusë të tematike: *Vështrime teorike*, ku autorja merr në shqyrtim studimin e letërisë sipas teorive letrare moderne, si dhe problemet metodologjike e konceptuale mbi letërisë e sotme dhe romantizmin shqiptar në sfondin e letërsive ballkanike, deri tek struktura narrative dhe dialogu në poetikën e ligjërimit.

*Autorë dhe vepra* është korpusi i dytë tematik i kësaj vepre, pastaj vie *Kritika e Kritikës dhe Vështrime kulturologjike*, tema këto që përvijojnë një logjikë mjaft koherente interpretimi nga ana e Floresha Dados.

Sfida teorike të historiografisë letrare, Identifikimi i poetikave në planin teorik dhe historiko-letrar si dhe Proza nëpër teknikat poetike, ndonëse në shikim të pare të renditura sipas një disonance semantike, megjithatë përbëjnë trekëndshin tematik e problemor të Floresha Dados, ku gjithsesi nxjerr krye qasja moderne e saj në interpretimin e teorisë së tekstit dhe profilet e nduardurta të autorëve, në periudha të ndyrshme të formimit të tyre teoriko-letrar.

MBI TË GJITHA BIE NË SY INSISTIMI I SAJ PËR NJË SISTEM INTERPETIMI SHKENCOR TEK VEPA IDENTIFIKIMI I POETIKAVE NË PLANIN TEORIK DHE HISTORIKO-LETRAR, ku dioptria e gjykimit kritik shikohet përmes aspektit të zhvillimit historiko-letrar në bashkëveprim me fushën e trajtimeve të karakterit teorik-letrar. Përpos dukurive letrare, individualiteteve artistike e veprave konkrete, të shikuara në prizmin e zhvillimit diakronik dhe sinkronik të letëprisë shqipe, në këtë vepër një vend me rendësi zënë edhe PROBLEMATIKAT E MODERNITETIT NË LETËRSINË MIDIS DY LUFTËRAVE

Koncepti i modernitetit, si filozofi social-ekonomike, sipas Floresha Dados, mbetet larg shoqërisë shqiptare dhe si i tillë ai është vetëm një ide e parea-lizuar në mendjen e individëve që jetonin në shoqëri të tjera të zhvilluara dhe për rrjedhojë ajo me të drejtë ajo shtron pyetjen: Sa moderniteti estetik erdhi natyrshëm në rrethanat shqiptare dhe sa ishte impretim shpirtëror i një vetëdije arsitike evropiane, duke iu qasur veprave të Konicës, Lasgushit, Nolit e Migjenit, të cilat mëtonin të jenë prodhim i dilemës se a është çdo gjë e re patjetër moderne. Këtë dilemë, Floresha Dado mundohet ta zgjidh duke iu referuar një mendimi të Gidensit sipas të cilit nuk është e vërtetë se moderniteti shkon përkrah së resë për hir të së resë, por me presupozimin e pasqyrimin në masë të shumëfishtë të refleksivitetit, i cili përfshin reflektimin mbi vet natyrën e reflektimit.

Duke u mbështetur në këtë paradigmë, Floresha Dado analizon marrëdhënien midis lirisë së instiktit krijues në raport me arsyen krijuese, duke marrë si shembull prozën e Konicës, prozat poetike të Koliqit, disa poezi dhe tregime-skica të Migjenti, disa poezi të Lasgushit, krijime këto ku shfaqet reflektimi i një përjetimi të vaçant të aktit krijues

Duke vendosur një distinkcion semantik midis Modernitetit dhe modernizmit, autorja qartëson në veprën e saj se moderniteti ka sjellë në letërsi ndryshimin e kodeve tematike dhe prirjen për ndyrshime të vazhdueshme. Pra, sipas saj, tipare të modernizmit (jo të modernitetit) në letërisë tonë,

lidhen me stilin letrar, i cili synon tejkalimin e traditës dhe sjelljen e formave të reja.

Siç e shpjegon edhe në disa intervista, Floresha Dado pasi kishte analizuar aspekte terrorike-letrare të veprës së Ismail Kadaresë, kishte vërejtur se një pjesë e krijimeve të tij, që ishin më tepër persiatje midis fiksionit dhe mendimit diskursiv, kishin ngelur jashtë orbitës së interesimit të saj më të thelluar, prandaj ajo kishte vendosur që t’iu rrekej kësaj natyre të shkrimeve të Kadaresë. Kjo edhe për faktin se siç e shpjegon ajo në parathënien e librit *Letërsi në 'kurth'*: *Eseistika e Kadaresë*: “Kisha lexuar, në intervale të ndryshme kohore, një pjesë të mire të shkrimeve esestike të këtij shkrimtari të shquar. Por, ndonëse kishin hyrë në perceptimin tim si krijime mjaft interesante, përsëri vëmendja rendëte drejt prozës artistike... Nuk e kisha kuptuar se kjo rendje e njëkahshme, pa u ndalur sa duhet edhe tek eseistika, ishte gabim i madh, ishte sikur ta copëtoje individualitetin e tij krijues në dy pjesë: njera e ndritshme, kurse tjetra kalimtare.”

Ajo e pranon se nuk kishte qenë e ndërgegjshme se ç’thesar do të duhej të gërmonte, sepse ajo po ndodhej para një minere të pasur me metale të çmuara, të cilat kishin ngelur disi të mënjanuar nga mosvëmendja e studiuesve dhe kritikëve të ndryshëm.

Floresha Dado e pranon se po zbulonte një Kadare të ri, teksa kishte përfunduar së eksploruari minierën e tij esistike, pasi që siç thotë ajo ‘po i futemi një sferë të jashtëzakonshme të njohjes, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, të mendimit dhe imagjinatës së tij’.

Në studimin mbi esistikën e Kadresë, Floresha Dado mundohet të mos acarojë marrdëhëniet në mes të Kadaresë shkrimtar dhe Kadresë mendimtar, por përkundrazi të gjejë një mirëkuptim të brendshëm, pasi që sipas saj, vetëm pasi të kemi depërtuar në magjinë e eseve kemi rizbuluar vlera të tjera të këtij krijuesi – mendimtar të jashtëzakonshëm.

Vepra e fundit e Floresha Dados, dhe ndoshta më sfiduese në aspektin e thyerjes së metodave të hulumimit dhe interpretimit shkencor, është *Postmodernizmi - poetikë e 'antirregullit'*, titull ky i cili në vetvete sikur sugjeron një game krejt tjetërsh këndvështrimesh mbi procesin letrar, i cili kësaj radhe vendoset në një kontekst zhvillimesh jo vetëm letrare, por edhe filozofike e sociologjike.

Kjo vepër, e pasiur me një aparaturë të ngjeshur shkencore me burime e referenca autorësh e veprash të viteve të fundit, nga 2-3 gjuhët me të njohura të Perendimit, mëton të shpjegojë, me terma e saktësime konkrete, paraqitjen

e estetikës së postmodernizmit në letërisë shipe, sidomos në roman. Sipas Floresha Dados, kjo paraqitje, nuk mund ishte vetëm një kuriozitet, apo imitim, por më shumë se kaq – ishte lindje e një ndërgjegjeje dhe intuited të re krijuese dhe një marrëdhënie jo zakonshme me lexuesin.

Përfitimet nga ky studim serioz i Floresha Dados mund të jen të shumta, por spikasin dy më kryesoret: lexuesi mundet më lehtë të kap fillin e problemeve që lidhen me postmodernizmin, duke krahasuar pikëpmajet e autorëve të huaj dhe atyre shqiptarë që kanë shkruar mbi këtë drejtim letrar dhe autorët shqiptarë që në procesin e tyre krijues mbështeten në modelte posmodernizmit, nuk do të jetojnë në iluzionin se po zbulojnë një ishull të ri në botën e tyre imagjinare, për arsye se para tyre kishte pasur autorë të tjerë europianë e amerikanë, të cilët postmodernizmin e kishin provuar si stacionin e fundit të eksperimentimit letrar.

Nëse i referohemi konstatimit të studiueses Linda Hutcheon (Hëtçeon), thotë se Postmodernizimi, – përkundër modernizmit, – është raport i ndërlikuar rrjedhimesh, dallimesh dhe varësish, atëherë e kemi të qartë se pse Floresha Dado e ka vendosur postmodernizimin në dioptri më të gjerë, si në rrafshin diakronik, ashtu edhe në atë sinkronik, por edhe në raportet që kanë midis vetes drejtimet e tjera letrare: realizimi, modernizmi si dhe shkolla të tjera letrare.

Në fund të librit, autorja ngre 13 dilema për të bërë debatin sa më intrigues, duke shtruar me këtë rast 13 teza në formë pyetjesh. Për ta ilustruar pak a shumë vizionin e autores mbi këtë problematikë, po veçoj pyetjen e 8-të, a shfaqet postmodernizmi në romanin tonë si frymë apo si formacion poetik? Sipas Floresha Dados tek disa autorë si Rexhep Qosja, Mehmet Kraja, Bashkim Shehu, Fatos Kongoli, Visar Zhiti, Zija Çela, Agron Tufa, Agim Leka postmodernizmi në radhë të parë është frymë, ose një realitet i brendshëm i realiteteve shqiptare, ndërkohë që tek disa autorë të tjerë si Anton Pashku, Virion Graçi, Gazmend Krasniqi, Ardian Kyçyku, e ndonjë tjetër, sipas Floresha Dados postmodernizmi në romanet e tyre paraqitet më tepër si prirje e një formacioni të ri poetik.

Kurse sa i përket tipologjizimit të romancierëve, ajo dallon dy grupe posmodernistësh shqiptarë. Në njërin anë kemi Rexhep Qosjen, Virion Graçin, Gazmend Krasniqin, Ardian Kyçykun, të cilët në romanet e tyre janë gjatë gjithë kohës postmodernistë, ndërkohë që tek Fatos Kongoli, Zija Çela, Mehmet Kraja, Vath Koreshi, Bashkim Shehu, Mira Meksi, Besnik Mustafaj, në romanet e tyre, përpos poetikës postmoderniste operojnë edhe me narracion klasik.

## **Përmyllje**

Floresha Dado është identiteti më përfaqësues i sistemit vlerësues në letrat shqipe, duke vendosur brenda këtij sistemi një mori normash të avancuara teorike e estetike mbi letërsinë dhe kompleksitetin e veprës letrare në tërësi.

**Floresha DADO**

*Akademike, studiuese e letërsisë*

## **VEPRAT E MIA KANË NË THEMELE MENDIMIN TEORIK LETRAR**

**-fjalë falënderimi-**

Përshëndetje miqtë e mi!

Është një emocion i veçantë për mua që t'u drejtohem nëpërmjet kësaj videoje dhe të shprehë kënaqësinë dhe nderimin që ndjej me këtë aktivitet kushtuar krijimtarisë time! Do ishte shumë më mirë që të ishim takuar bashkë, të kishim diskutuar për problematikat e punës time shkencore, megjithatë ja që kjo kohë është e vështirë dhe na pamundësoi shumë gjëra.

Fillimisht dua t'ju falënderoj që të gjithëve, në mënyrë të veçantë profesor Skender Asanin - drejtorin e Institutit, dhe të gjithë bashkëpuntorët e tij të cilët kanë organizuar këtë cikël konferencash shumë interesante, shumë të rëndësishme që nderojnë veçanërisht figurat e grave që kanë dhënë kontribute të shquara në jetën tyre në fusha të ndryshme. Ndjem shumë e nderuar për këtë vlerësim që më keni bërë. Gjithashtu dëshiroj të falemenderoj të gjithë ata kolege të cilët flasin për krijimtarinë time - jam mirënjohese për vlerësimet dhe çdo gjë që ata thonë lidhur në këtë krijimtari.

Sigurisht puna ime shkencore është e shtrirë në disa dekada. Ka qenë një punë e gjatë, mbushur me një pasion shumë të madh për punën shkencore.

Aktiviteti im shkencor është ndarë, si të thuash, në dy institucione shumë të rëndësishme shkencore të vendit tonë, në Akademinë e Shkencave dhe në Universitetin e Tiranës. Dhe, gjatë këtyre viteve kam arritur që të bëj një varg studimesh, të botoj disa vepra, dhe njëkohësisht duke pasur mundësi këto njohuritë e mia t'ia përcjell studentëve në auditorë, apo në konferenca të ndryshme të kem diskutuar me kolegë të ndryshëm.

Dëshiroj të them që pavarësisht se e nisa punën si historiane e letërsisë dhe kurorëzimi i së cilës në vitet e para ishte monografia kushtuar Andon Zako Cajupit, në të vërtetë pasioni im u përqëndrua dhe u kanalizua në fushën e teorisë së letërsisë. Atëherë kur unë kuptova se nuk mund të bëhesh studiuese e mirë, nuk mund të bëhesh mësuese e mirë e letërsisë, nuk mund të

bëhesh kritike e mirë e letërsisë, nëse në themele të koncepteve të formimit tënd, nuk është teoria e letërsisë, kjo bëri që një varg veprash të cilave unë i kam kushtuar problematikave të ndryshme, kanë në themele pikërisht mendimin teorik letrar. Duhet të them që preokupimi im ka qenë në disa nga çështjet kryesore që kanë shqetësuar mendimin kritik letrar, mendimin shkencor, siç është për shembull problemi i historiografisë letrare, e ku dijmë që diskutohet akoma edhe sot e kësaj dite, që duhet shkruhet një histori e re e letërsisë dhe cilët janë kriteret, cilat janë problematikat të cilat do ta bënin një ndërmarrje serioze, jo thjeshte subjektive dhe me ngjyra paksa - paksa amatore. Kjo është arsyeja që në veprën time “Sfida teorike të historiografisë letrare”, unë kam ngritur disa çështje shumë të rëndësishme teorike që duhet diskutuar midis studiuesve. Po ashtu ne e dimë të gjithë, që një problematikë shumë e mprehtë, e diskutueshme ka qenë dhe çështja e realizimit socialist, dmth diskutohet shumë ç’ ishte kjo letërsi. E parë në aspektin teorik jam përpjekur që në veprën time “Letërsi e pa interpretuar” të ngrej disa çështje, sfida për diskutime midis teoricientëve dhe midis studiuesve të letërsisë. Pra qëllimi nuk ka qenë të vlerësoj a është e mirë apo e keqe kjo letërsi, por në aspektin teorik të shpjegoj se cili qe devijimi dhe dëmi i madh që iu shkaktua artit në përgjithësi dhe veçanërisht letërsisë nisur nga parimet e realizmit socialist. Dhe, në këtë vepër sigurisht kam hedhur disa çështje, disa sfida për t’u diskutuar. Dëshiroj të ju them se është në konceptin tim që gjithmonë në studimet e mija të ngrejë problematika. Unë nuk jam zgjidhje përfundimtare, por unë shtroj sfida, shtroj çështje që kërkojnë debat dhe diskutim midis specialistëve. Poashtu një problematikë shumë e diskutueshme ka qenë dhe mbetet – ç’është kjo letërsia e sotme, meqë diskutohet shumë për letërsi moderniste, postmoderniste, e të tjerë. Kështu që, vepra ime e fundit që doli këtë vit “Postmodernizmi - Poetikë e ‘antirregullit’”, është një vepër që sigurisht nuk trajton se ç’është postmodernizmi dhe modernizmi, këto janë koncepte që janë përpunuar nga historia, nga teoricientë e shkencëtarë bashkëkohorë edhe të shekullit të kaluar. Por unë nisur nga këto koncepte teorike jam përpjekur të ngrejë disa problematika, siç është për shembull, a është letërsia a sotme vërtetë postmoderniste ose si shkon fati në përgjithësi i kësaj letërsie, ose cili është raporti i kësaj letërsie me lexuesin, sa e ndërton një marrëdhënie të vërtetë me lexuesin ashtu siç letërsia e ka në thelbin e saj, a do të zhduket postmodernizmi në letërsi edhe letërsinë tonë, etj. etj. Mendoj se kjo ashte vepra ku unë kam hedhur mjaft çështje për diskutime, mjaft çështje të cilat kërkojnë një debat, nxisin një debat, por që fund të fundit

krijojnë përshtypje më të sakte për zhvillimin e letërsisë shqiptare në këto 30 vitet e fundit.

Në interesimet e mia kanë qenë sigurisht edhe problemet të tjera të rëndësishme, për shembull eseistika e Kadaresë. Nuk është shkruar asnjëherë për këtë fushë të rëndësishme, dhe kur kam lexuar të gjitha esetë e Ismail Kadaresë, përpara meje doli pyetja se mos ndoshta ai është më i shquar si eseist se sa si romancier, sepse korpusi i tij eseistik është i jashtëzakonshëm. Dhe, në këtë korpus, sigurisht se trajtimi që i kam bërë unë është me çështjet teorike, sepse është tjetër gjë është kritika letrare, pra të japësh një mendim të pëlqen ose s'të pëlqen një vepër, dhe është tjetër gjë në një trajtim teorik letraretë ngresh çështje të diskutueshme që lidhen me thelbin e letërsisë, që lidhen me atë që dallon letërsia nga eseistika, apo që dallon romanin për shembull nga realizmi klasik nga romani modernist apo postmodernist, e tjerë e tjerë. Pra preokupimet e mia, të dashur miq, kanë qenë gjithmonë që të prek çështjet teorike dhe mbi bazën tyre pastaj e kemi shumë më të lehtë t'i japim gjykimet për zhvillimet që ndodhin në fushën e letërsisë. Sigurisht, në aktivitetin tim shkencor ka një pjesë të rëndësishme dhe referimet që kam bërë në konferenca të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, ku gjithmonë kam prekur problematika që lidhen me zhvillimin e letërsisë shqiptare, me dilemat e kësaj letërsie, me planet krahasimtare me letërsitë e tjera, etj. Kjo është një problematikë shumë e gjerë që unë e kam përmbledhur në dy vëllime të mëdha me studime, artikuj të ndryshëm kritikë - letrar, teorik, historiko - letrar, etj.

Unë do të thosha se projektet e punës shkencore sigurisht nuk kanë përfunduar. Kam disa projekte të tjera, por për fat të keq tash është një kohë që na ka stresuar, që na ka ngurtësuar disi, dua ta pranoj këtë gjë, dhe si të thuash, vrullet tona krijuese nuk janë ato që kanë qenë më parë. Por, sigurisht kjo gjë do kalojë, do kalojë shumë shpejtë, dhe në projektet e mia do të ketë sigurisht trajtime që do të ngjallin debat, do ngjallin interes, do të kërkojnë komunikimin tonë si studjues të letërsisë. Unë mezi e pres këtë komunikim dhe e vlerësoj jashtëzakonisht kontributin që mund të japin që të gjithë në çështjen teorike. Më lejoni në fund të ju përsëndes, t'ju falënderoj nga zemra për gjithçka, dhe shpresoj që së shpejti ne do takohemi jo më online, por do të takohemi në aktivitete shkencore fizike që zhvillohen Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe në vendet e tjera ku ka shqiptarë! Unë uroj një kohë të lehtë, një kohë më të bukur, më të suksesshme, dhe gjithë të mirat në jetën tuaj! Ju faleminderit!

## AKADEMI SHKENCORE PËR KONGRESIN E MANASTIRIT

*Shkup, 21.11.2020* – Me një Akademi shkencore, vazhduan aktivitetet e manifestimit kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITSHKSH-Shkup.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se jam shumë i nderuar që sot po ju drejtohem për t’ju dëshiruar mirëseardhje në Shtëpinë e Dytë të Alfabetit, pra në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. “Mund të jetë koincidence, por bukuria qëndron pikërisht në këso koincidence. Alfabeti i shqipes, që u ndihmua aq shumë prej misionarëve amerikanë, u vulos më 22 nëntor 1908, ndërsa Instituti ynë u themelua pikërisht më 22 nëntor dhe tash është i vendosur në objektin e ish Ambasadës Amerikane në Shkup”, u shpreh Asani.

Talat Xhaferi, kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke uruar për Festën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, theksoi nevojën që në të gjitha institucionet të shtohet vëmendja dhe vetëdija ndaj përdorimit korrekt të gjuhës standarde shqipe.

Arafat Shabani, zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës, përgëzoi Institutin për zhvillimin e këtyre veprimtarive, si shembull mjaft i mirë se si duhet të edukohen gjeneratat e reja në frymën e respektit ndaj ngjarjeve dhe figurave të rëndësishme kombëtare. Ai shfaqti shpresën që nga shtatori i ardhshëm, Abetarja e unifikuar të bëhet realitet në të gjitha shkollat e trevave shqiptare.

Ardit Bido, drejtor i Arkivit qendror të Shtetit shqiptar, theksoi se Kongresi i Manastirit është një ngjarje e madhe unifikuese kombëtare, dhe për të janë duke u zhvilluar një sërë manifestimesh edhe në Tiranë, Prishtinë, Preshevë, Ulqin e gjetiu. Ai u shpreh i lumtur që ITShKSh këto ditë e botoi përmbledhjen me dokumente të Parashqevi Qiriazit, të cilat ndodheshin në AQSH-Tiranë.

Ylber Sela, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve, tha se të gjitha zhvillimet mua personalisht më bëjnë jashtëzakonisht krenar si shqiptar, por aq më tepër edhe si drejtor që kam fatin ta udhëheq Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës Shqipe, e cila çdo ditë e më tepër jep ndihmesën e vet në zbatimin zyrtar të kësaj gjuhe, e cila shkruhet pikërisht me ato shkronja që u zgjodhën si model në Kongresin e Alfabetit më 1908 në Manastir.

David Hosaflook, drejtor i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, u ndal sidomos në çështjen e varrezave protestante, dhe veçanërisht lidhur me varrin e Gjerasim Qiriazit në Strumicë.

Studiuesi Xhevat Lloshi, paraqiti një kumtesë lidhur me problemet gjuhësore të shqiptarët në të shkruar, në kohën kur po brumosej Alfabeti i gjuhës shqipe.

Ditën e nesërme aktivitetet e manifestimit kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit”, kulmojnë me përkujtimin e Zonjës së Parët të Alfabetit – Parashqevi Qiriazit. Me atë rrsat, do të promovohet libri me dokumente “Ditari i Parashqevi Qiriazit”, si dhe filmi dokumentar për në UNESCO.







**Skender ASANI**

*Drejtor i ITShKSh – Shkup*

## **TË PARËT TANË NA LANË ALFABET, NDËRSA NE DUHET TË LËMË VEPRA**

I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi,

I nderuari zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës, z. Arafat Shabani,

Të nderuar studiues dhe ju që po na ndiqni përmes rrjeteve sociale,

Jam shumë i nderuar që sot po ju drejtohem për t'ju dëshiruar mirëseardhje në Shtëpinë e Dytë të Alfabetit, pra në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Mund të jetë koincidence, por bukuria qëndron pikërisht në këso koincidence. Alfabeti i shqipes, që u ndihmua aq shumë prej misionarëve amerikanë, u vulos më 22 nëntor 1908, ndërsa Instituti ynë u themelua pikërisht më 22 nëntor dhe tash është i vendosur në objektin e ish Ambasadës Amerikane në Shkup.

Të nderuar të pranishëm,

Ne jemi në përfundim e sipër të edicionit të dytë të manifestimit kulturor-shkencor “Ditët e alfabetit” dhe, ashtu si gjithnjë në nëntorin e abecesë, ndjehemi të ngazëllyer që nesër mund të festojmë bashkërisht ditën kur shqipja jonë u bë me alfabet të saj.

Besoj se jeni të informuar, ndonëse ky edicion kaloi në masa sigurie për shkak të pandemisë, por dua t'ju informoj se këtë vit Ditët e Alfabetit iu kushtuan iluministëve shqiptare. Ia filluam me Nexhmije Pagarushën e Hanife Sejfullah Reçanin, si dy zëra mbase më të rëndësishëm të traditës sonë muzikore, vazhduam me gjuhëtarën Olivera Jashar Nasteva, mbesën e Jashar bej Shkupit të Lidhjes së Prizrenit dhe bijën e Emin Bej Kumbaraxhit të Kongresit të Manastirit, një ditë ia kushtuam prof. Exhlale Dobruna Saliut – arkeologes së madhe të Kosovës, por jo vetëm, të enjten u nderuam me emrin e Nënës Terezë, dje folëm për akad. Floresha Dadon – studiuese e njohur e letërsisë, për të ardhur sot në këtë akademi shkencore, e për ta kurorëzuar manifestimin me nderimin për rilindësen nga Manastiri, Parashqevi Qiriazi.

Kundruar edhe vetëm kështu, mendoj se pak a shumë ia kemi dalë që gjithkund ku preket alfabeti shqip, të nxjerrim nga një personalitet kulturor e shkencor të gruas shqiptare, me shpresë se të gjitha këto treten dhe frymëzohen në figurën e Parashqevisë, që ne e kemi emërtuar “Zonja e Parë e Alfabetit”.

Shumë të nderuar të pranishëm,

Kur sot po e organizojmë këtë akademi tradicionale shkencore, ndjej detyrim t’ju falënderoj të gjithëve që sot jeni këtu dhe t’ju them se prania juaj është nder dhe mirënjohje për ne për të vazhduar në këtë detyrë.

E nëse më lejoni të them dy gjëra për Kongresin e Manastirit, do të thosha se ky kongres është faqja tjetër e Lidhjes së Prizrenit dhe sintetizimi më i saktë i përpjekjeve iluministe të rilindësve tanë për ndriçimin e kombit. Shqipëria e ka Vlorën e pavarësisë, Kosova e ka Prizrenin e Lidhjes, ndërsa shqiptarët në Maqedoninë e Veriut e kanë Kongresin e Manastirit. Andaj, në frymën e marrëdhënieve të mira ndërshtetërore që kultivohen sot, unë kam shpresë se ne shqiptarët dimë të bashkëpunojmë mes vete, por edhe me të bashkëjetojmë edhe më kombet e tjera dhe të komunikojmë me empati edhe me kombin maqedonas, si dhe të punojmë bashkërisht për një ardhmëri më të mirë dhe europiane të gjithë rajonit.

Të parët tanë na lanë alfabet, ndërsa ne duhet të lëmë vepra. Nëse sot i falënderojmë ata për punën e tyre, do të duet ta dimë se edhe neve nesër do të na falënderojnë ose do të na gjykojnë për atë që e kemi bërë sot.

Unë ju faleminderit për praninë tuaj sot, me çka përveç respektit që keni shfaqur ndaj nesh, e keni nderuar edhe festën e alfabetit dhe ngjarjen e madhe të Kongresit të Manastirit.

Uroj që kështu të takohemi çdo vit dhe gjithnjë të kemi mundësi të komunikojmë e të kremtojmë.

Ju faleminderit.

**Talat XHAFERI**

*Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut*

## **PËR GJUHËN DHE ALFABETIN, TË GJITHË TË JEMI VIGJILENTË!**

I nderuar zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës, z. Shabani,  
I nderuar drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, z. Asani,

I nderuar drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve, z. Sela,

I nderuar drejtor i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, z. Hosaflok,

Të nderuar ambasadorë,

Zonja dhe zotëri,

Kam nderin që në emrin tim personal dhe në emër të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të shpreh nderimet dhe urimet e mia të përzemërta me rastin e festës së 22 Nëntorit, 112-vjetorit të Kongresit të Manastirit ku edhe u bë unifikimi i alfabetit shqip dhe që kremtohet si festë e pranuar kombëtare e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Njëherazi, dua të përuroj edhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve për vazhdimin e traditës së organizimit të këtij manifestimi ku nderohen dhe respektohen fytyrat dhe kontributi i shqiptarëve në fusha të ndryshme të jetës shoqërore ndër shekuj. Më vjen mirë që Manifestimi fillon me homazh për Gjerasim Qiriazin dhe përfundon me promovimin e librit për Parashqevi Qiriazin dhe, nuk mund të ishte ndryshe. Sepse, ato të dy, natyrisht edhe shumë intelektualë të tjerë nga të gjitha anët e botës ky frymonin shqiptarët, u tubuan në Kongresin e Manastirit që nga përbërja dhe nga çështjet që i diskutoi dhe zgjidhi, konsiderohet si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike dhe kulturore të shqiptarëve. Pas një pune të palodhshme nëntëditore, dolën me produktin më të çmuar për një popull - Alfabetin e njësuar me të cilin do të vazhdohej të shkruhet, lexohet dhe përhapet gjuha, kultura, zakonet, veçoritë dhe tradita folklorike e shkruar dhe e kënduar, e cila deri atëherë është përcjellë me shkronja të huaja të alfabeve të huaja. Por, ajo që është më e rëndësishme, alfabeti me të cilin lindi dhe e filloi rrugëtimin e vet lufta kombëtare e pavarësisht kulturor në

rrafshin botëror, ishte mbështetje e fortë e identitetit kombëtar dhe e pavarësisht politik të popullit shqiptar. Ai rrugëtim kaloi nëpër shumë sfida, vështirësi, mohime dhe nënvlerësime por, kjo nuk e ndali kumbimin e këngës mallëngjyese të Nexhmije Pagarushës, Hanife Sejfulla Reçanit dhe shumë solistëve të shquar shqiptarë. Kjo nuk i ndali as studiuesit e shquar albanologë dhe letrarë, kjo nuk e ndali as penën e shkrimtarëve shqiptarë të njohur botërisht, i nderuari Ismail Kadare, Luan Starova dhe të tjerë. Përkundrazi, ishte gjuha për përkthimin autentik të veprave të tyre madhështore me të cilat u rrit dhe u përhap vlera letrare shqiptare. Dhe, jo vetëm ajo letrare. Vlerat dhe virtytet, humanizmi dhe solidariteti, eupatia dhe mirëkuptimi nuk ishin të panjohura as për Shën Nënë Terezën - vajzën e botës sonë dhe nënën e mbarë botës, siç e kanë përshkruar aq bukur nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve dhe që na bën aq krenarë në rrafshin botëror.

Të nderuar të pranishëm,

Çdo periudhë kohore i bën betejat e veta, dhe i kremton fitoret e mëdha apo edhe të vogla, të cilat janë vetëm një gurth i vogël në përfundimin e themelit të ruajtjes, zhvillimit por edhe të përditësimit të gjuhës e cila është materie e gjallë, e cila mund edhe të bjerë nën ndikime të ndërkombëtarizimeve dhe përparimit të pandalshëm teknologjik dhe gjithëpërfshirës. Por, duhet të jemi vigjilent, secili në pjesën e vet të fushëveprimit. Këtu, së pari kam ndërmend veten dhe përfaqësuesit tjerë të diapazonit politik që aktualisht jemi ose do të bëhen në të ardhme pjesë e pushtetit legjislativ dhe që mund të ndryshojmë, plotësojmë dhe përmirësojmë mbështetjen ligjore për ruajtjen e gjuhës standarde. Këtu kam ndërmend institucionet që janë themeluar për të mbikëqyrë dhe për të asistuar apo për të ndëshkuar institucionet që nuk e zbatojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve ashtu siç është i miratuar. Por, këtu kam ndërmend edhe mediet e shkruara dhe të botuara, punonjësit në administratë, punonjësit në arsim që me shembullin e vet të kontribuojnë në ngritjen e gjeneratave të reja që do e duan, ruajnë, respektojnë dhe flasin gjuhën e standardizuar shqipe. Dhe, natyrisht, Akademitë e Shkencave dhe Arteve. Jeni institucionet ku është tubuar potenciali intelektual i çdo shteti dhe keni mundësinë të bashkëpunoni, të këmbeni përvoja dhe të ndihmoni njëri tjetrin, që të jepni shembull se si respekti i ndërsjellë dhe bashkëpunimi i sigurt mund të prodhojë vetëm vlera që do të jenë në favor të qytetarëve tanë, të shteteve tona dhe të rajonit në përgjithësi.

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni me këtë rast të përuroj edhe fituesit e Çmimit shtetëror 22 Nëntori, i nderuari Prof. dr. Xhevat Lloshi dhe kritiku letrar akademik Ali Aliu, për kontributin e tyre të palodhshëm në studimin e gjuhës shqipe dhe krijimtarinë e begatshme letrare.

Të nderuar, uroj të kremtojmë edhe shumë përvjetorë të ardhshëm, gjithsesi, në kushte shumë më të volitshme shëndetësore që do të lejojnë kremtimin me prezencë shumë më të madhe. Deri atëherë, uroj të jeni me shëndet të mirë dhe Ju falënderoj për vëmendjen.

**Arafat SHABANI**

*Zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës*

## **ABETARJA E UNIFIKUAR TË BËHET REALITET!**

I nderuari drejtor ITSHKSH , z.Skender Asani,  
I nderuari kryetar i Kuvendit të RMV,z.Talat Xhaferi,  
I nderuari drejtor i Institutit për studime shqiptare dhe protestante -  
Tiranë z. David Hosaflook,  
Të nderuar të pranishëm,

Ndjehem tepër i nderuar, që në cilësinë zëvendës ministrit të Ministrisë së  
Arsimit dhe Shkencës kam rastin të përshëndes evinimentin, Akademinë  
Shkencore “112 vjet nga Kongresi i Manastirit” .

Organizatori i sivjemë i shënimit të Kongresit të Manastirit, Instituti i  
Trashigimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut  
në Shkup, me të drejtë në manifestimin tradicional “Ditët e Alfabetit-2020”  
gjatë aktiviteteve disaditëshe me pietet të veçantë i kujtojë personalitetet e  
shquara iluministe që lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë dhe kulturën  
tone kombëtare, si Zonja e Parë e Alfabetit-Parashqevi Qiriazi, Nëna e mbarë  
botës- Shën -Nënë Tereza, dy perlat e muzikës shqiptare Nexhmije Pagarusha  
dhe Hanife Sejfullai- Reçani, ballkanologen Olivera Jashar Nasteva, arkeologen  
Exhlale Dobruna-Salihu, dhe studiuesen e letërsisë, Floresha Dado. Veprim-  
taria dhe angazhimi i tyre duhet të jetë shembull për gjeneratat e ardhëshme,  
se si duhet kontribuar për kulturën shoqërore të një populli.

Historia e Alfabetit është shkruar, mësuar dhe kujtuar nga të gjitha brezat e  
shqiptarëve, në të gjitha sistemet e historisë sonë. Megjithatë, asnjëherë nuk  
është mjaftueshëm të flasësh e kujtosh vlerën e mbledhjes që hapi kahjen e  
arsimit kombëtarë.

Kongresi i Manastirit, Kongresi i unifikimit të një alfabeti të gjuhës shqipe  
është tubimi i dijetarëve dhe mendimtarëve shqiptarë më 14 nëntor deri më  
22 nëntor të vitit 1908 në Manastir, në qendrën e atëhershme të Vilajetit për  
përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Letërsia shqipe shkruhej në alfabete  
te ndryshme. Mendimi sublimues ishte se shkronjat jolatine nuk ishin të  
përshtatshme për mbarësinë e shqipes- bashkimit gjuhësor kombëtar. Kjo bëri

që shoqëria më aktive dhe e mirënjohur “Bashkimi” në Manastir, ta thirr Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njësuar. Një alfabet i njësuar do të ishte edhe fillimi i letërsisë mbarë shqiptare.

Nga ana tjetër, të nderuar të pranishëm, pamëdyshje, ngjarja që u mbajt në Manastir, vlerësohet si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve në fillim të shekullit XX. Sepse, në këtë kongres u morën vendime të rëndësishme për çështjen e alfabetit por edhe për ato politike që çuan në ngritjen shkallës identitare, kulturore dhe arsimore. Si rrjedhojë e angazhimit të figurave të shquara poullore, pasoi bashkimi i mëtutjeshëm në luftën për çlirimin kombëtar.

Sot në Maqedoni, 22 nëntori është festë shtetërore për shqiptarët. Ajo festohet në mënyrë zyrtare, nga të gjitha institucionet e shtetit, nga të gjitha shkollat dhe universitetet shtetërore e private shqiptare. Është një e arritur do të thoshim për këtë pjesë të popullit shqiptarë, nëse kihen parasysh telashet e shumta që e kanë karakterizuar statusin e tij që qindvjetëshin e fundit.

Dhe krejt në fund, të nderuar të pranishëm, duke përgëzuar për Ditën e Alfabetit, kam kënaqësi të veçantë që me këtë rast të paralajmëroj shpresën dhe dëshirën e kahmotshme të nxënësve shqiptarë: Abetarja e unifikuar të bëhet realitet! Ajo shpresojmë të jetë në përdorim, në të gjitha shkollat shqipe, nga shtatori i ardhshëm, përkatësisht nga viti ardhshëm shkollor.

Faleminderit!

**Ylber SELA**

*Drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe - Shkup*

## **KONGRESI I MANASTIRIT - NJË TESTAMENT KULTUROR E QYTETËRUES I SHQIPTARËVE**

Të dashur miq!

Të rralla janë ngjarjet historike të cilat, jo vetëm që nuk harrohen e nuk zbehen fare nga kujtesa jonë kolektive, por, sa më shumë që kalon koha, bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, më frymëzuese dhe më ndërgjegjësuese për të gjithë ne. Pa dyshim, këtu bën pjesë edhe Kongresi i Alfabetit, ose Kongresi i Manastirit, i cili sivjet i mbush 112 vjet, si një ngjarje që shënoi kthesë të madhe dhe vendimtare në historinë kulturore të shqiptarëve dhe që e hapi edhe rrugën e konsolidimit shtetëror më 1912.

Së pari, ky kongres është vetvetiu histori, për arsye se populli shqiptar për herë të parë arriti të formësohet në aspektin kulturor duke zgjedhur rrugën e duhur në udhëkryqin e ndërlikuar të historisë, thjesht duke u përcaktuar për modelin alfabetik që do ta përdorte, pra atë latin të cilin e përdorte gjithë Europa, ku gjeografikisht bëjnë pjesë edhe shqiptarët. Në këtë mënyrë ndodhi rikthimi i natyrshëm në gjirin e vet kulturor e qytetërues.

Së dyti, Kongresi i Alfabetit është vetvetiu një simbolikë e veçantë, për arsye se, që nga ajo ditë, kur mbizotëroi fryma e unitetit shqiptar, u bë udhërrëfyes edhe për shumë beteja të tjera të mëvonshme, duke shërbyer si shembull pozitiv se si mund të bëhen shumë gjëra të mëdha me anë të mirëkuptimit e bashkimit. Prandaj, edhe më tej vazhdon të mbetet simbolikë themelore e shqiptarëve, duke u bërë edhe referencë aktuale për arritjen e qëllimeve kulturore, arsimore, shkencore, politike e kombëtare.

Së treti, Kongresi i Manastirit është një testament kulturor e qytetërues i shqiptarëve, të cilin e lexojnë dhe e analizojnë të gjitha brezat duke reflektuar në mënyrë pozitive e racionale. Sigurisht, edhe ne kemi fatin e madh që të flasim e të japim ndihmesë në këtë aspekt, si dhe ta përcjellim frymën e tij tek ata që do të vijnë pas nesh.

Së katërti, Kongresi i Alfabetit na rikthen në kohë dhe në hapësirë, jo vetëm për ta përkujtuar në mënyrë nostalgjike si ngjarje, por edhe për t'u rikthyer

fizikisht në qytetin e Manastirit si vatër e rëndësishme e Rilindjes sonë Kombëtare dhe për të dëshmuar kujdesin dhe mirënjohjen tonë ndaj tij, për t'i bërë sfidë harresës dhe shpërfilljes në këtë kohë marramendëse. Dhe si i tillë, Manastiri mbetet krenari kombëtare.

Natyrisht, të gjitha këto mua personalisht më bëjnë jashtëzakonisht krenar si shqiptar, por aq më tepër edhe si drejtor që kam fatin ta udhëheq Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës Shqipe, e cila çdo ditë e më tepër jep ndihmesën e vet në zbatimin zyrtar të kësaj gjuhe, e cila shkruhet pikërisht me ato shkronja që u zgjodhën si model në Kongresin e Alfabetit më 1908 në Manastir.

Uroj që kjo ngjarje të mbetet testament i përjetshëm kombëtar. Pa shkronja, nuk ka gjuhë. Pa gjuhë, nuk ka komb. Duhet ta kemi të qartë se vetëm me këto shkronja dhe me këtë gjuhë, ne do të quhemi shqiptarë në kuptimin thelbësor.

Ju falemnderit!

**Xhevat LLOSHI**

*Studiues, Tiranë*

## **PËRKUJTIMI I KONGRESIT TË MANASTIRIT**

Për ngjarjen madhore të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, për Kongresin e Manastirit, tashmë është folur dhe është shkruar shumë, ashtu si e meriton vendi që ai zë në historinë shqiptare. Megjithatë, përkujtimi i tij çdo herë na jep mundësinë të plotësojmë diçka, të sjellim ndonjë dokument të ri, të bëjmë një interpretim tjetër, dhe sidomos të shquajmë, se çfarë na mbetet prej tij si mësim i vyeshtë edhe për ditët tona.

E para gjë që vlen të theksohet është se ai përbën një kurorëzim të Rilindjes Kombëtare, përmbylljen e një periudhe të gjatë përpjekjesh dhe arritjesh për lëvrimin e shqipes, por jo në kuptimin e mbylljes, të përfundimit. Përkundrazi, me të u hap rruga për hapat e tjerë në përpunimin e shqipes, siç e dëshmojnë Komisia Letrare e Shkodrës, vendimet e Kongresit të Lushnjës e deri te Kongresi i Drejtshkrimit. Në këtë kuptim ai ishte një akt i orientuar nga e ardhmja. Dhe në këtë të ardhme ngjarja kulmore për kombin do të ishte Shpallja e Pavarësisë. Vetëm katër vjet më pas u ngrit shteti modern shqiptar. Domethënia e Kongresit të Manastirit atëherë është kjo: ai përbente një hap tjetër krahas luftës së armatosur, kryengritjes së përgjithshme dhe përpjekjeve në arenën ndërkombëtare për njohjen e kombit shqiptar. Mësimi i parë prej këndeje është, se në çdo fushë të veprimtarisë sonë politike, shoqërore dhe kulturore na duhet të orientohemi drejt interesave dhe kërkesave të shtetit shqiptar, për konsolidimin dhe mbrojtjen e tij

Për ta rrokur këtë domethënie të madhe të këtij Kongresi na vlen përgjigja në këtë pyetje: Me çfarë alfabeti do të shkruhej dokumenti i shpalljes së pavarësisë? Ai u shkrua me alfabetin e Kongresit të Manastirit. Gjithsesi, nuk mund ta kapërcejmë këtë pyetje pa sqaruar se çfarë fshihej prapa saj, përse shtrohej ajo? Ajo shtrohej sepse nuk kishte një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Atëherë në sfondin e domethënies së mësipërme, mungesa e shkronjave të përbashkëta për shqipen donte të thoshte, se puna nuk ishte thjesht për diçka teknike, për natyrën e disa germave dhe të matricave të shtypshkronjave. Puna ishte për kapërcimin e një pengese kundrejt përbash-

kësisë së shqiptarëve. Zgjidhja e çështjes së një alfabeti unik shndërrohej në ndërtimin e një hallke të unitetit kombëtar. Njëjtësia e alfabetit simbolizonte njëjtësinë e një populli kudo në viset e tij dhe në vendet e tjera. Njësia e gjuhës letrare dhe e kulturës është kusht i padyshimtë për shtetin shqiptar.

Ka një fakt, për të cilin është diskutuar shumë dhe ka mbetur pezull deri më sot. Ky fakt është, se në Vendimet e Kongresit në të vërtetë u paraqitën dy variante. Nuk është rasti këtu për ta ndjekur këtë dhe për të dëshmuar se si dhe përse fitoi ai alfabet që kemi sot. Ne do ta pranojmë këtë fakt dhe do të nxjerrim prej tij një përvojë tjetër. Kur është puna për probleme të mëdha me rëndësi historike nuk përbën ndonjë të keqe, se paraqiten zgjidhje alternative. Ndërkaq, për alternativat kusht i detyrueshëm është që t'i shërbejnë së ardhmes dhe njësisë së kombit e të shtetit shqiptar.

Rruga për të ardhur te një alfabet i gjuhës shqipe ka qenë e gjatë, kurse kjo do të thotë se shqipja është shkruar prej shumë shekujsh, pavarësisht prej llojit të shkronjave. Madje do të shtoja këtu, se në trojet e shqiptarëve të sotëm kultura e shkrimit njihej që prej shekullit VII para erës së re, në fillim me shkronjat greke dhe më vonë me shkronjat latine. Emra ilirë ishin gdhendur mbi gurët e varreve me ato shkronja që nga shek. V para e.r. Se çfarë domethënie historike ka ky fakt, mjafton të përmend, se në ato kohëra për asnjë nga vendet veriore të Europës nuk njihet që të kishte shkrim në trojet e tyre.

Arritjet e rëndësishme historike kërkojnë një rrugë të gjatë për të mbërritur te ato. Gjatë kësaj rruge të alfabetit për shqipen nëpër shekuj ka pasur edhe disa shfaqje të rastësishme, që nuk kanë krijuar ndonjë traditë. Kështu, Arnold fon Harfi i shënoi ato nja pesëdhjetë fjalë të shqipes me alfabetin latin, por të përshtatur për gjermanishten. Evlija Çelebiu më 1662 i dha fjalët shqipe me alfabetin e osmanishtes; kështu do të bënin më pas edhe letrarët orientalistë shqiptarë. Më 1822 Johan Shmidt, duke u nisur nga gjermanishtja për fjalët shqipe, në doracakun e tij të bashkëbisedimeve gjithashtu përdori alfabetin e gjermanishtes. Arumunët Nikolla Tërpoja (1735) dhe Teodor Kavalioti (1770) përdorën alfabetin e tyre të arumanishtes edhe për shqipen. Dorëshkrimin e tij Marko Boçari (1809) e bëri sipas alfabetit të greqishtes, duke shtuar edhe ndonjë shkronjë prej latinut. Konsulli francez Fransua Pukëvili ato pak fjalë të shqipes, që i ka shkruar vetë, i ka dhënë me alfabetin e frëngjishtes, gjithnjë me përshtatjet përkatëse. Më 1814 William Martin-Leake-u i paraqiti fjalët e shqipes me alfabetin latin, të përpunuar për anglishten. Nuk ka nevojë të renditen autorët e tjerë të huaj të shek. XIX, ndërsa këto dëshmojnë se për

shkrimin e shqipes kanë qenë të interesuar edhe dijetarë e udhëtarë të huaj. Ndërkaq, këtu do të shtoja edhe një fakt tjetër.

Një ngjarje e veçantë ndërhyri në këtë rrugë në fillim të shek. XIX, kur Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (BFBS) vendosi të bënte një përkthim shqip të Dhiatës së re. Kur e nisi përkthimin më 1820 Vangjel Meksi, çështja e parë që i doli ishte alfabeti i shqipes. Nuk dihet nëse ai ndoqi ndonjë traditë të mëparshme në dorëshkrimin e tij, por duket se hartoi vetë një alfabet për shqipen me shkronja të greqishtes dhe duke përfshirë ndonjë shkronjë latine.

Pas një diskutimi të gjatë edhe me shqiptarët në Korfuz, përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike Joniane, I. Lowndes-i (I. Laundzi), në nëntor 1825 i dha dorën e fundit alfabetit të shqipes. Atëherë vajti në shtypshkronjën e Korfuzit dhe e shtypi të plotë në një faqe me leximin e shkronjave dhe me shembujt shqip përkrah. **Ky është i pari alfabet i plotë i shqipes së re i shtypur.** Për shkak të rëndësisë së tekstit të gjerë të përkthyer shqip, ai alfabet është marrë me ndonjë ndryshim nga filologët e huaj, nga J. R. Von Xylander-i, F. Bopp-i e J. G. Von Hahn-i dhe deri te G. Meyeri. Më pas, lidhur me përkthimet e K. Kristoforidhit, është përfshirë në këtë lëmë edhe përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike në Stamboll, Alexander Thomson. Po e paraqes këtë faqe të historisë së alfabetit tonë, sepse ajo vërteton, që përveç shqiptarëve, për zgjidhjen e çështjes se si shqipja do të paraqitej me shkrim kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe studiues të huaj, prandaj kur do të vinte dita e zgjidhjes përfundimtare, ajo është mbështetur edhe në ndihmesat e ardhura nga shkenca europiane.

Natyrisht, meritën kryesore e kanë pasur shqiptarët, duke nisur me librin e parë shqip të Gjon Buzukut më 1555 dhe me traditën e autorëve pasues të tij. Edhe përpjekjet si ato të Dhaskal Todrit, të N. Veqilharxhit dhe më pas të Hasan Tahsinit për të sajuar alfabetet origjinale, ndonëse ishin të paracaktuara për të dështuar, sepse nuk përputheshin me ecurinë e alfabeleve për gjithë gjuhët europiane, përsëri ishin përpjekje për të zgjidhur problemet e pasqyrimin me shkrim të tingujve të shqipes në mënyrë sistematike e të plotë. Shkurt, Kongresi i Manastirit kishte mbështetjen e një tradite të gjatë në përpunimin e alfabetit, traditë në të cilën kishin dhënë ndihmesat e tyre autorë, shkrimtarë, gazetarë, dijetarë shqiptarë dhe një varg të huajsh. Me këtë shpjegohet, përse Kongresi dha një alfabet me baza të vërteta shkencore, një alfabet të qëndrueshëm, që shërben për bukuri edhe në kohën tonë të mjeteve elektronike.

Ideja për një mbledhje të përfaqësuesve nga vise të ndryshme të Shqipërisë dhe të besimeve të ndryshme, që të diskutonin për alfabetin e shqipes,

tashmë ishte pjekur në gjysmën e dytë të shek. XIX, domethënë edhe përpjekjet e përbashkëta e të organizuara të shqiptarëve për alfabetin kanë pasur traditën e tyre. Në nëntor 1869 u ngrit në Stamboll Komisioni për caktimin e një alfabeti të përbashkët. Për arsye të njohura, ai dështoi. Një provë tjetër u bë më 1872, por sërish nuk u arrit në një zgjidhje përfundimtare. Ndërkaq, çështja e një alfabeti të vetëm të shqipes kishte marrë edhe një përmasë ndërkombëtare, jo vetëm sepse e vunë në qendër të vëmendjes së tyre autoritetet osmane, por edhe institucione me peshë si Shoqëria Biblike Britanike dhe, pak më vonë, edhe përfaqësues të rëndësishëm të Perandorisë Austro-hungareze e të disa fuqive të tjera fqinje. Kur A. Tomsoni vuri në lëvizje ambasadorin britanik në Stamboll, çështja e alfabetit të shqipes iu paraqit qeverisë osmane nga fuqia më e madhe e kohës.

Ngjarjet e vrullshme të vitit 1878 i dhanë një shtytje të jashtëzakonshme lëvizjes shqiptare, e cila kishte hyrë në një fazë të re me Lidhjen e Prizrenit. Ngritja e Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip ishte pjesë e kësaj rrjedhe të re. Alfabeti i saj për këtë arsye me të drejtë mund të quhet edhe alfabeti i Prizrenit. Hap pas hapi alfabeti i Stambollit fitoi një përhapje të gjerë, por nuk ia arriti që të mbetej i vetmi alfabet kombëtar. Rrjedhimisht, shekulli i ri e gjeti shqipen me një larmi shkronjash, e cila në rrethanat e hapjes së shkollave shqipe, e lulëzimit të letërsisë dhe të zgjerimit të shtypit e të botimeve, përbënte pengesë për bashkimin kombëtar, madje ajo ushqente edhe shpresat e forcave të huaja, se do ta ndalnin përparimin e ndërgjegjes kombëtare dhe do ta orientonin atë sipas interesave të tyre me alfabetet e tyre. Mungesa e një alfabeti të përgjithshëm shndërrohej në një mungesë jo të vogël për bashkimin kulturor të shqiptarëve, që ishte pjesë përbërëse qendrore e lëvizjes gjithëkombëtare. Këtë e ndienin konkretisht të gjithë ata që shkruanin e botonin libra, gazeta e tekste shkollore. Me këtë shpjegohet diskutimi i gjallë që u përvijua pikërisht për alfabetin në atë fund shekulli. Njësimi i alfabetit ishte bërë imperativ historik.

Qëndrimet dhe pikëpamjet e shprehura nga figurat kryesore të letrave shqipe në fillim të shek. XX i kam paraqitur në librin për Gjergj Qiriazin. Së bashku me emrat e delegatëve në Kongres kemi kështu një shumicë zërash, që tregojnë se për alfabetin e përgjithshëm të shqipes ishte bërë, siç do ta shpreheshim sot, një konsultim i gjerë kombëtar dhe prej tij erdhi vendimi përfundimtar, i cili përbënte një nga hapat e rëndësishëm në rrugën e përgatitjes së shtetit të ri shqiptar. Për çështjet që diskutoi, që zgjidhi e që vendosi, e gjithashtu si një nga tubimet më përfaqësuese nga përbërja e pjesëmarrësve,

Kongresi i Manastirit vlerësohet si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike, kulturore e gjuhësore të shqiptarëve në fillim të shekullit XX. Ai ishte fillimi më i mbarë për shtetin shqiptar dhe e nguliti frymën e tij për të ardhmen. Jo rastësisht shumë prej pjesëmarrësve të tij ishin ndër ata që ngritën flamurin më 1912 dhe emrat e tyre do të mbeten të gdhendur në histori pikërisht si shkronjat e abëcësë që ata miratuan.

David HOSAFLOOK

*Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante - Tiranë*

## KU JANË ESHTRAT E GJERASIM QIRIAZIT, GJERGJ QIRIAZIT DHE GJON CIKOS? TË PANJOHURAT PËR VARREZAT PROTESTANTE NË KORÇË, MANASTIR DHE STRUMICË

Më 14 nëntor 2020, java përkujtimore “Ditët e Alfabetit 2020” u nis me një udhëtim homazhi në Strumicë, te varri i atdhetarit, iluministit dhe predikuesit ungjillor Gjasim Qiriazit. Pranë tij ndodhet varri i bashkëpunëtorit të tij të ngushtë në shërbim të Shoqërisë Biblike, Gjon Ciko. Gjetja e këtyre varreve, sidomos i atij të Gjasimit, ishte një zbulim i papritur për një figurë kaq të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Natyrisht lindën shumë pyetje përnjëherësh: Si u zbuluan? Pse u gjetën kaq vonë? Kur dhe ku u varrosën? Nga na dolën varret në Strumicë? A janë vërtet aty eshtrat e Gjasim Qiriazit? Ku është varrosur vëllai i tij, Gjergj Qiriazit, nismëtari kryesor i Kongresit të Manastirit? Këto janë vetëm disa nga pyetjet që trajtohen në këtë punim, me synim që enigma të kthehet në histori dokumentare.




*Gjasim Qiriazit, Gjergj Qiriazit, Gjon Ciko*

Këto pyetje gjejnë përgjigje kur kuptohet identiteti fetar i familjes Qiriazit, Gjon Cikos etj. Protestantizmi, njohur edhe si “besimi i krishterë ungjillor”,

hyri me hov në trojet shqiptare që nga viti 1816.<sup>97</sup> Kudo në botë ku depërton, protestantizmi përhapet fillimisht me përkthimin e Biblës në gjuhën e popullit, dhe, nëse duhet, me lëvrimin e gjuhës së shkruar – *abetare, fjalorë, shkolla*. Investimi kryesor i protestantëve në viset shqiptare nuk ishte në ndërtimin e objekteve të kultit, por për botimin e Librit të Shenjtë dhe për predikimin e Ungjillit në gjuhën amtare. Siç vëren prof. Xhevat Lloshi: “Besimet e tjera janë përhapur mes shqiptarëve në disa rrethana, që kanë të përbashkët këtë tipar: ato kanë ardhur në gjuhë të huaja dhe në kushtet e sundimeve të huaja në këto vise... Mjaft ndryshe është rrjedha e protestantizmit, ... [i cili] nuk lidhej me ndonjë periudhë sundimi ... [dhe] është përhapur në gjuhën shqipe”.<sup>98</sup>

Mirëpo, sapo filloi të zgjerohej, komuniteti protestant-ungjillor në Shqipëri u përball me një dilemë – *ku do të varroseshin të vdekurit e tyre?* Në Perandorinë Osmane, protestantët kishin marrë statusin e një mileti të veçantë, që nga viti 1847, sipas një urdhri të Vezirit të Madh, Reshid Pasha. Tri vite më vonë, sulltan Abdyl-Mexhidi nxori një ferman posaçërisht në favor të subjekteve të tij protestante.<sup>99</sup> Në ferman cilësohej që protestantëve do t’u jepeshin varrezat e tyre, dhe ato duhet të mbroheshin. Në të njëjtin vit, sulltani dha një hektar tokë në lagjen Feriköy të Stambollit për varrezat protestante, varrezë ku flenë edhe sot disa misionarë që kanë lidhje të drejtpërdrejta me shqiptarët, si p.sh. amerikani Elias Riggs dhe skocezi Aleksandër Tomson.



Fermani i sulltanit, 1850

<sup>97</sup> A depërtoi më herët? Kjo pyetje trajtohet te: Hosaflook, David. *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816–1908*. Shkup: ITSHKSH, 2019, f. 51–60.

<sup>98</sup> Lloshi, Xhevat. “Një faqe e re për historinë fetare të shqiptarëve”, te: Hosaflook, David. *Lëvizja Protestante*, vep.cit, f. vii.

<sup>99</sup> Për kopjen origjinale të fermanit shih: SALT Istanbul: Records of the American Board of Commissioners for Foreign Missions (<https://archives.saltresearch.org/handle/123456789/46525>). Shih, gjithashtu: “Translation of the Firmân of His Imperial Majesty Sultân ‘Abd-El-Mejîd, Granted in Favor of His Protestant Subjects”, *Journal of the American Oriental Society* 3 (January 1, 1853): 218–220. Shih edhe: Hosaflook, David. “Protestant Writings About the Official Recognition and Protection of Protestant Subjects in the Ottoman Empire (1839–1856)”, 2<sup>nd</sup> International Congress of Ottoman Studies (OSARK), 17–20 October 2018, Tirana.

Gjerasim Qiriazzi lindi dhe u rrit në Manastir,<sup>100</sup> u shkollua në Institutin Kolegjial dhe Teologjik në Samokov dhe predikoi ungjillin në Shkup, Stamboll, Selanik, Samokov, Krushevë, Kosovë dhe Manastir. Kur dëguesit e tij ishin kryesisht maqedonas, ai u predikoi atyre maqedonisht. Por dëshira e tij kryesore ishte t'u predikonte shqiptarëve, në gjuhën shqipe, kështu ai u zhvendos në Korçë dhe aty predikoi për katër vjet (1890–1893).

Në vitin 1892, Gjerasimi me disa të tjerë themeluan Vëllazërinë e Ungjillorëve, një komunitet protestant shqiptar, themeluar nga shqiptarë, me një kanun në gjuhën shqipe, një periodik në gjuhën shqipe (*Letra e Vëllazërisë*) dhe me dy qëllime të caktuara: 1) “të përhapurit e Ungjillit”; dhe 2) “të përhapurit e shkronjave shqipe në Shqipëri”.<sup>101</sup> Me themelimin aq të hershëm të një komuniteti fetar shqiptar, çuditet njeriu pse dëgjon ende sot, nga studiues të njohur, se shqiptarët kanë *vetëm katër* besime tradicionale kombëtare (bektashi, katolik, mysliman, ortodoks). Në nëntor të vitit 2020, për shembull, studiuesi i njohur zviceran dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Vjenës, Oliver Jens Schmitt, bëri këtë gabim. Ai shkroi një artikull rreth 8700-fjalësh me titull “Zoti në Shqipëri”, në të cilin ai i përmend protestantët (“neoprotestantë”, sipas tij) si një “risi në Shqipëri”, të ardhur vetëm pas vitit 1991, një fenomen po aq i panjohur ndër shqiptarët sa “islamikët radikalë të cilët vënë në dyshim figurat simbolike kombëtare si Skënderbeu ose Nënë Tereza”.<sup>102</sup> Por me Gjerasim Qiriazin, Gjon Cikon dhe protestantë të tjerë, vërehet se komuniteti protestant ungjillor shqiptar është shpallur 30 vjet përpara shpalljes së Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe përpara themelimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Për më tepër, protestantizmi u njoh zyrtarisht

<sup>100</sup> “Gjerasimi ishte ende fëmijë kur i ati e shiti shtëpinë në [fshatin] Tërnovë dhe u shpërngul në Manastir” (Kuanrud, Xhon. *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*. Shkup: ITSHKSH, 2016, f. 24).

<sup>101</sup> “Kanonizma e Vëllazërisë Ungjillorëve në Korçë” (15 nëntor 1892, AQSH, F 65, D 209).

<sup>102</sup> Artikulli i Schmitt-it është përmbledhje e vlefshme e historisë së fesë në Shqipëri dhe u botua nga Ambasada Gjermane në Shqipëri, bashkë me një ese brilante fotografish, nga fotografja e njohur Jutta Benzenberg (ku paraqiten edhe disa imazhe të protestantëve). Shih: <https://ausstellungen.deutsche-digitale-bibliothek.de/>

religionen-albanien/#s40/1 (lexuar më 19 nëntor 2020). Është për të ardhur keq që në një artikull aq të mirë mungon një besim tradicional që u vlerësua nga rilindës, si vëllezërit Frashëri, Mit'hat Frashëri, Grigor Cilka, Ismail Qemali etj., edhe që sot trajtohet gjerësisht nga studiues shqiptarë dhe të huaj, si Xhevat Lloshi, Skender Asani, Ferit Duka, Muhamet Mala, Persida Asllani, Nathalie Clayer, Giovanni Cimbalo, John Quanrud etj.

edhe në ligjet për fenë të qeverisë së Ahmet Zogut, në vitin 1923<sup>103</sup>, si dhe në ligjet bashkëkohore në Shqipëri<sup>104</sup>, Kosovë<sup>105</sup> dhe Maqedoni të Veriut.<sup>106</sup>

Kur protestantizmi u përhap në Korçë në vitin 1890, u përball me kundërshtime të ashpra. Një korçar me emrin Kristo Sulidhi, i cili ishte fotografi i parë i Korçës, u kthye në besimin protestant dhe, si pasojë, u shkishërua nga Kisha Greke. Por papritmas atij i vdiq i biri. Për këtë ngjarje, Sevasti Qiriaz-Dako dëshmon: “Prifti nuk pranoi t’i bënte varrimin nëse z. Sulidhi nuk mohonte çdo lidhje me Shoqërinë Biblike ... dhe nëse nuk pranonte të ripagëzohej. Ky incident bëri që im vëlla të blinte një copë tokë për varreza në një vend të bukur në rrëzë të një kodre të vogël, që mbante emrin e Shën Elias”.<sup>107</sup>

Sevastia vazhdoi duke thënë se kisha e turpëroi Sulidhin në çastin e tij të trishtimit, aq sa ai pranoi të pendohej në një ceremoni publike – kështu mund të varrosej i biri. Sulidhi gjeti shumë përkrahje nga populli dhe, pas disa muajsh, u pendua dhe u kthye përsëri me ungjillorët.<sup>108</sup> Por kjo ngjarje i nxiti protestantët për të blerë tokë në Korçë. Pas blerjes, qeveria vendore nxori pengesa për përdorimin e tokës si varrezë.<sup>109</sup> Gjatë përpjekjes për të marrë leje, Gjerasimi përdori edhe humor të hollë me qeveritarët osmanë të Korçës. Sipas tij, ata kishin dijeni për një komplot nga grekët për ta vrrarë, ndaj iu lut që të zgjidhnin njëherë e mirë çështjen e varrezave, sepse: “Nëse do të më

<sup>103</sup> “Statuti legal i komuniteteve fetare”, Ligji Nr. 432, datë 05.06.1923, në Qarkoren Nr. 12359, 24.06.1923, 542. <http://licodu.cois.it/?p=415> (lexuar më 19 nëntor 2020).

<sup>104</sup> Ligji nr. 10 394, datë 10.3.2011, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësisë Fetare ‘Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë’ për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 34, datë 7.4.2011, <http://www.legjislacio.ni.gov.al/?q=node/355> (2 janar 2015). Ligji u bazua në vendimin nr. 902, të Këshillit të Ministrave, të datës 10 nëntor 2010, ku rekomandohej marrëveshja.

<sup>105</sup> Shih ligjin nr. 02/L-31, të Kuvendit të Kosovës, “Për lirinë fetare në Kosovë”, datë 13.7.2006. Neni 5.4 i këtij ligji nuk përmend specifikisht ndonjë komunitet fetar, por përpara se të ratifikohej, më 24.8.2006, neni 5(4) u amendua për të përcaktuar komunitetet fetare të njohura zyrtarisht në Kosovë: “Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Ortodokse Serbe, Kishën Katolike, Bashkësinë e Besimit Hebre dhe Kishën Evangjeliste”. Faqja e internetit, e përmendur më sipër, sqaron: “Vërejtje: Ligji është i aplikueshëm së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2006/48, të datës 24.8.2006”. Ligji i amenduar nr. 02/L-31 është botuar në Fletoren Ligjore Fetare të Kosovës, [www.gazetazyrtare.com](http://www.gazetazyrtare.com) (2.1.2015).

<sup>106</sup> Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, Amendamenti VII, neni 19: “Македонската православна црква, како и Исламската верска заедница во Македонија, Католичката црква, Евангелско-Методистичката црква, Еврејската заедница и другите верски заедници и религиозни групи се одвоени од државата и се еднакви пред закон”.

<sup>107</sup> Qiriaz-Dako, *Jeta ime*, 114; shih edhe: A. Thomson to Gerasim Kyrias, 26 July 1890. Krhs.: Luarasi, *Gjerasim Qiriaz*, 45 (“Vorrezat e Shëndëllisë”).

<sup>108</sup> American Board of Commissioners for Foreign Missions (ABCFM) *Missionary Herald*, 1891, 137.

<sup>109</sup> Gerasim Kyrias (14 October 1892), *Missionary News from Bulgaria*, 12 December 1892, nr. 42, 3.

ndodhë diçka, është mirë që të na i keni siguruar përfundimisht varrezat, që të mos ndesheni me një hall edhe më të madh, kur grekët të mos pranojnë të më varrosin në varrezat e tyre!”<sup>110</sup> Gjerasimi po thoshte se mungesa e varrezës protestante mund të përbënte një problem politik për qeverinë vendore osmane.

Çështja u dërgua për shqyrtim në Stamboll ku, në parim, duhej të pranohej, pasi varrezat për protestantët ishin miratuar me anë të fermanit të sulltanit të vitit 1850.<sup>111</sup> Mirëpo, në përgjigjen që u kthye, thuhej se komuniteti protestant në Korçë duhet të zyrtarizohej, pastaj të lëshohej leja për varreza. Gjerasimi u ankua për këtë përgjigje, sepse në Maqedoni varrezat protestante ishin miratuar në katër vende. Së paku, shkroi Gjerasimi, duhej të nxirrej një urdhër që i lejonte protestantët që të varroseshin mes turqve ose grekëve.<sup>112</sup>

Deri më tani nuk është vërtetuar që të jetë varrosur ndonjë besimtar protestant në tokën e blerë në Korçë nga Gjerasimi, por dimë që vllehtë i kanë përdorur këto varreza me leje të përkohshme, të dhënë nga protestantët, për të vdekurit e tyre, të cilët nuk u pranuan as ata në varrezat e Kishës Greke. Kur vllëve do t’u miratoheshin varrezat, eshtrat e të vdekurve të tyre do të zhvarroseshin, por kjo gjë nuk ndodhi kurrë, prandaj ata vazhduan t’i varrosnin të vdekurit në varrezat e protestantëve.<sup>113</sup> Më 1912, kishte rreth gjashtëdhjetë varre të tyre.<sup>114</sup>

Në një intervistë të kryer me priftin e kishës ortodokse vllahe “Kisha e metamorfozës së Shpëtimtarit” (apo “Shën Sotiri”), prifti, i ndjeri atë Dhimitraq Veriga, na dëshmoi se e kishte parë me sytë e tij dokumentin zyrtar në të cilin dëshmohej se ungjillorët ua shitën varrezat familjes së Papa Llambro Ballamaçit, kështu varrezat kishin kaluar në pronësi të vllëve.<sup>115</sup> Por ky dokument ka humbur gjatë çështjes së ndërlikuar të sekuestrimit të

<sup>110</sup> Po aty.

<sup>111</sup> Për të dhëna të tjera të komunikimeve zyrtare midis Manastirit dhe Stambollit, lidhur me çështjen e varrezave, shih: Gerasim Kyrias to A. Thomson, 4 March 1893, 20 March 1893, 31 May 1893, Alexander Thomson Correspondence Inward (ISSHP-ATCI). Gjerasimi kërkoi që A. Tomsoni të angazhonte Thanas Sinën për të folur me Naim Frashërin për t’i kërkuar ndihmë.


<sup>112</sup> Gerasim Kyrias to A. Thomson, 12 June 1893, ISSHP-ATCI.

<sup>113</sup> Phineas Kennedy dhe Gjergj Qiriazi ishin të shqetësuar të zgjidhnin çështjen e pronësisë së varrezës dhe bashkëpunuan me konsullin austriak për këtë (Phineas Kennedy to W.W. Peet, 18 November 1911, ISSHP).

<sup>114</sup> Phineas Kennedy to W.W. Peet, 5 March 1912, ISSHP-EJ.

<sup>115</sup> Për kalimin e kësaj toke flet Sevasti Qiriazi-Dako në jetëshkrimin e saj, ku dëshmon se toka ishte dhuratë: “Dy vjet më parë [rreth vitit 1936, DH] ia kemi dhuruar [në origjinal, “donated”, DH] këtë copë toke kishëzës së Shën Elias, pasi, qoftë lëvdur Zoti, ajo nuk na duhet më” (*Jeta ime: jetëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriazi-Dako*, Shkup: ITSHKSH, 2016, f. 114).

varrezave nga qeveria komuniste, rreth vitit 1955, e cila i prishi varret dhe ndërtoi mbi to një kënd lojërash për fëmijë. Rreth vitit 1991, shteti i ri paskomunist e shiti tokën dhe pronarët e rinj filluan ndërtimet. Kisha vllahe u ankua; ndërtimet u pezulluan, por vetëm përkohësisht. Gjatë sheshimit të tokës u zbuluan eshtra të cilat u bënë copa-copa nga buldozeri dhe nuk mund të zhvendoseshin. Eshtrat mbetën aty, të betonuara poshtë themeleve të një diskoteke. Pronësia e tokës ka kaluar disa herë, e sot objekti sipër ish-varrezës njihet si “Bar Omega” apo “Bar Klaudio”, që ndodhet mbrapa kishës vllahe “Kisha e metamorfozës së Shpëtimtarit”. At Dhimitraq Veriga e vlerësoi këtë histori si një tragjedi makabre.<sup>116</sup>



Bar “Omega” ose “Klaudio” dhe Kisha e metamorfozës së Shpëtimtarit, Korçë

Gjerasim Qiriazhi u sëmur në qershor të vitit 1893, pas tërmetit të madh të Korçës. Familja e tij u mundua për ta çuar në një vend me klimë më të mirë (si Selanik apo Korfuz), që të shërohej, por ai vdiq në Manastir më 2 janar 1894.<sup>117</sup> Ku e varrosën? Që nga themelimi i Institutit për Studime Shqiptare

<sup>116</sup> At Dhimitraq Veriga (prifti i ndjerë i kishës ortodokse vllahe “Kisha e metamorfozës së Shpëtimtarit”, [Shën Sotirit], në Korçë), intervistë e incizuar me David Hosaflook, 5 korrik 2016 (At Dhimitraq Veriga vdiq më 5 shtator 2016) (<https://soundcloud.com/iaps-albania/interview-with-priest-dhimitraq-veriga>). Më 4 qershor 2016 u intervistua edhe kopshtari i moshuar arumun i kishës, Aleko Sholla, i cili dha një dëshmi të ngjashme.

<sup>117</sup> Për sëmundjen dhe vdekjen e Gjerasimit shih: Kuanrud, Xhon. *Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës*. vep. cit., f. 195–201 (kapitulli me titull “Lamtumirë”).

dhe Protestante më 2014, ky ka qenë një ndër misteret që kemi dashur të zbulojmë, jo vetëm për Gjerasimin, por edhe për Gjergj Qiriazin.

E dinim se Motrat Qiriaz, Sevastia dhe Parashqevia, janë varrosur së bashku në varrezat e Sharrës<sup>118</sup>, jashtë Tiranës, por varret e tyre gjendeshin me vështirësi. Në vitin 2016, unë, prof.dr. Xhevat Lloshi dhe dr. John Quanrud shkuaam aty për t'i vizituar varret. Punonjësit nuk e dinin se ku ndodheshin. Ngatërresa kishte tri arsye: së pari, vendndodhja sipas regjistrit dhe ajo në realitet nuk përputheshin. Pas shumë kërkimeve, punonjësja e gjeti emrin e Sevasti Dakos dhe na drejtoi tek adresa e shkruar në regjistër: *Parcela 52, Radha 3, Nr. 5*. Por varri nuk ishte aty. Pas shumë kërkimesh, e gjetëm varrin te *Parcela 6, Rreshti 1, Varri 15* (dhe iu lutëm punonjësve që t'i korrigjonin regjistrat). Së dyti, mbiemrat e tyre ishin shkruar në gur si *Qerjazi*, jo *Qiriaz*. Së treti, e gjetëm pllakën e gurit të zhvendosur, të përmbysur, midis ca rrënojave gurësh dhe mermerësh, të padukshme për vizitorët.



*Gjetja dhe rivendosja e pllakës së gurit të Sevasti Qiriaz-Dakos dhe Parashqevi Qiriazit, Varrezat e Sharrës, Tiranë, 3 qershor 2016. Shih edhe pllakat dhe gurët e thyer (djathtas), ku ishte përmbysur pllaka e motrave.*

Profesor Lloshi reagoi ndaj këtyre parregullsive me një ton shumë të prerë, duke vënë në dukje mosrespektin e këtyre “nënave të kombit” dhe nuk u largua pa marrë premtimin e kujdestarëve se do ta rregullonin varrin me çimento. Një vit më vonë, familja Dako e bëri të ri varrin e tyre dhe sot është mjaft dinjitoz, me tri shtylla dhe një libër prej mermeri ku shkruhet “ABC Manastir 1908”. Shtyllat mbajnë këto mbishkrime:

Sevasti Qiriaz Dako 1870 1949, dekoruar nga presidenti i Republikës Nderi Kombit.

<sup>118</sup> Sipas mbesës së Sevastisë, Viktoria Dako Rulit, “Sevastia u varros në ‘Shtish Tufinë’, në veri të Tiranës, por në vitin 1964 varrezat u prishën, se do të ngriheshin pallate banimi, ... kështu eshtrat e Sevastisë u transferuan në varrezat e Sharrës” (te Shtojca 1 të librit: *Jeta ime*, vep. cit., f. 289).

Parashqevi Qiriazhi 1880 1970, dekoruar nga presidenti i Republikës Nderi Kombit.

Kanë hapur shkollën e parë shqipe të vashave në Korçë dhe kanë luftuar për emancipimin e gruas shqiptare. Kanë organizuar Kongresin e Manastirit<sup>119</sup>. Kanë marr pjesë në Konferencën e Paqes në Paris. Kanë luftuar dhe ndikuar fuqimisht në shpalljen e pamvaresisë së Shqipërisë.



<sup>119</sup> Në fakt, Gjergj Qiriazhi ka organizuar Kongresin e Manastirit, jo motrat Qiriazhi. Sevastia nuk ishte e pranishme, por Parashqevia mori pjesë dhe e ndihmoi Gjergjin.

Ndërkohë, varri i Gje-  
 rasimit mbeti i pazbuluar  
 nga ne. Studiuesi John  
 Quanrud kishte vajtur në  
 Manastir në vitin 1992, kur  
 po shkruante biografinë e  
 Gje-rasimit.<sup>120</sup> Aty Quanrud-  
 i vizitoi varrezën e vogël  
 protestante, e cila ndodhet  
 pranë pikës arkeologjike  
 dhe turistike “Heraclea



*Homazh në Tërnovë të Manastirit, për Gjergj Qiriazin, 2008*

Lyncestis”, dhe pranë varrezës katolike. Varreza ishte në gjendje të keqe. Quanrud-i e gjeti gurin e varrit të Gjon Cikos në gjendje të mirë, por nuk gjeti asnjë gjurmë të varrit të Gje-rasimit.<sup>121</sup> Në Manastir, Quanrud-i u takua me një pastor protestant, pastor Aco Mitev, si dhe me Hristo Kirjas, nipin e Kristo Qiriazit (vëllait më të vogël të Gje-rasimit dhe të Gjergjit). Por as pastor Mitevi, as H. Kirjas nuk ishin në dijeni të ndonjë dokumenti për vendndodhjen e varrit të Gje-rasimit, as nuk e kishin parë ndonjëherë.<sup>122</sup> Hristo Kirjas transmetoi një gojëdhënë që, ndoshta, Gjergji ishte varrosur në fshatin Tërnovë, pranë prindërve të tyre Dhimitër dhe Maria, në varrezat e Kishës Ortodokse “Shën Dhimitër”.<sup>123</sup> Për këtë arsye, në vitin 2008, me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit, disa besimtarë nga Kisha Ungjillore e Korçës vajtën në Tërnovë për një homazh te varri i Gjergjit. Por te shumica e varreve ose nuk ka emra, ose nuk dallohen, kështu që homazhi qe simbolik dhe lulet u vendosën mbi një varr të madh pa emër.

Në qershor të vitit 2016, kam shkuar personalisht me Hristo Kirjasin dhe Oliver Kirjasin te varrezat e Tërnovës. Ndonëse shumë varre ishin mbuluar me shkurre, bëmë çmos që të shikonim çdo varr, por nuk gjetëm asnjë shenjë

<sup>120</sup> Kuanrud, Xhon. *Gje-rasimi: predikues, iluminist, rilindës*. Shkup: ITSHKSH, 2016.

<sup>121</sup> Mendojmë se varri i Gje-rasimit që në këtë kohë (1992) ishte prishur dhe se guri i tij i varrit ishte aty, por mbuluar krejtësisht me ferra dhe shkurre.

<sup>122</sup> Në një intervistë në emisionin Pastel (TV21, Shkup) më 18 nëntor 2019, Quanrud dëshmoi, “Kam parë varrin atëherë [në vitin 1989]... por është zhdukur.” Por Quanrud sqaron se ka gabuar në të folur. Ai kishte parë *varrezat* dhe *varrin e Gjon Cikos*, por deri më sot nuk ka parë ende *varrin e Gje-rasim Qiriazit* (bisedë sqaruese e autorit, me John Quanrud, 11 dhjetor 2020).

<sup>123</sup> Kjo gojëdhënë mendohet të ketë si burim Petar Kirjas, i biri i Kristo Qiriazit, i ati i Hristo Kirjasit, gjyshi i Oliver Kirjas (intervistë e David Hosaflook me Oliver Kirjas, më 20 nëntor 2020). Por familja Kirjas nuk mban mend nëse Petari ishte i sigurt për varrimin e Gjergj Qiriazit në Tërnovë, apo a po transmetonte një hamendësim. Sigurisht, nëse Petari është burimi i vërtetë, përforcohet kjo tezë. Megjithatë, ende nuk është zbuluar asnjë provë e sigurt për këtë.

identifikuese për varret e Qiriazëve. Kështu, mbetet enigmë se ku janë eshtrat e Gjergj Qiriazit (si dhe ato të prindërve të tij).<sup>124</sup>

Një vit më vonë, në Shkup, u përkujtua 500-vjetori i Reformacionit Protestant dhe 200-vjetori i protestantizmit ndër shqiptarët. Nën patronazhin e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, katër institucione<sup>125</sup> e sponsorizuan Konferencën Ballkanike të Reformacionit Protestant, më 5-7 tetor 2017, me 23 referues nga 13 shtete. Pas konferencës, unë dhe John Quanrud-i u kthyem në Manastir. U takuam përsëri me pastor Aco Mitevin, i cili na çoi te varrezat protestante afër Heraklea-s. U tronditëm tek zbulonim se aty nuk kishte mbetur asgjë, as varri i bukur i Gjon Cikos, që Quanrud-i e kishte parë në vitin 1992. Dukej sikur një dorë po asgjësonte kujtimin historik të protestantëve në qytet. Meqë vendi ndodhet pranë pikës arkeologjike/turistike Heraklea, menduam se mos kishin zhvendosur varret, që të vazhdonin gërmimet e tjera. Por ku? Kërkuam përgjigje në Bashki dhe në Muze, por askush nuk dinte gjë, ose askush nuk thoshte gjë. Kështu, brenda një jave, po përjetonim dy ekstreme: 1) rizbulimin e historisë së Lëvizjes Protestante në rajon dhe 2) fshirjen e historisë protestante në një ndër qytetet më kryesore të Lëvizjes, në gjithë Ballkanin.

Pas një muaji, mora pjesë në një konferencë tjetër në Shkup, tek Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodi”, ku mbajta një kumtesë për origjinat teologjike dhe gjeografike të protestantizmit te shqiptarët<sup>126</sup>. Në auditor mori pjesë mbikëqyrësi austriak i Kishës Metodiste në Maqedoni dhe në Shqipëri, Wilfried Nausner. Pas konferencës, më takoi dhe më dha një lajm të papritur: *e kishte gjetur varrin e Gjerasim Qiriazit*. Më tregoi pak nga historia e gjetjes, por është më mirë t’i japim këtu fjalët e vetë Nausner-it, përkthyer nga parathënia e tij e një librushke 12-faqesh, *In Remembrance of Gerasim D. Kyrias*<sup>127</sup>:

<sup>124</sup> Varri i vëllait të vogël të Gjergjit, Kristo Qiriazit (1872–1956), ndodhet në varrezat kryesore të Manastirit.

<sup>125</sup> Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup; Instituti i Historisë Kombëtare, Maqedoni; Balkan Institute for Faith and Culture; Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante.

<sup>126</sup> “Scientific Wednesday: Protestantism in the Balkans”, University “St. Cyril and Methodius”, 1 November 2017. Kumtesa u botua: <http://digitalcommons.georgefox.edu/ree/vol38/iss1/9> – Hosaflook, David (2018) “The Theological and Geographical Origins of Protestantism in Albania,” *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*: Vol. 38 : Iss. 1 , Article 9.

<sup>127</sup> Cekov, Christina (red.). *In Remembrance of Gerasim D. Kyrias, the “Apostle of the Albanians” (extract from the book “Captured by Brigands”)*. Strumica: United Methodist Church in Macedonia, pa datë, në anglisht. Përkthimi shqip është i imi [DH].

Ishte viti 2010. Po vizitonim Bitolën për turizëm dhe aty kaluam te varrezat e vjetra protestante, bashkë me Mihail dhe Kristina Cekov.<sup>128</sup> Varreza ishte drejt rrënimit të plotë dhe përfundimtar. Për shkak të gërmimeve të qytetit të vjetër romak Heraclea Lyncestis, varret ishin të hapura dhe disa të hequra. Pra, një pjesë nga historia e lashtë e Maqedonisë po shkatërronte një pjesë tjetër të rëndësishme maqedonase – praninë dhe ndikimin e protestantizmit në shoqëri.<sup>129</sup>

Duke ecur nëpër rrënoja, e gjetëm gurin e varrit të Gjerasim Qiriazit. ... Te guri shkruhet “lëçitësi i parë i Shqipërisë”. Ai kishte qenë ndër maqedonasit të cilët kanë hedhur themelet e shkrim-leximit për shqiptarët. Ashtu sikur protestantët kanë qenë të parët që themelonin shkollën në Bullgari dhe në Maqedoni, po ashtu ndodhi edhe në Shqipëri. Kurdoherë ata përdorën gjuhën amtare, e jo gjuhën greke. Kjo sollti një ndryshim të rëndësishëm në shoqëri. Ata ndihmuan që të formonin shoqërinë, i dhanë popullit arsimim dhe këto i bënë paqësisht, duke ndihmuar dhe duke mbështetur të tjerët.

E vërteta e kaluar harrohet nëse nuk kemi prova dhe histori. Si varri i thyer dhe i braktisur i Gjerasim Qiriazit, historia mund të mbulohet nga shkurret e harresës dhe mitizimit, e pastaj humbet. Por historia është pjesë e identitetit tonë. Duhet të dimë se nga kemi ardhur, në mënyrë që të marrim vendime sa më të mira, që të kemi shpresë për të ardhmen...

Në kohën e kaluar, atë të Gjerasimit, jetuan së bashku grupe të ndryshme etnike dhe morën shpresë nga Ungjilli. Ky Ungjill tejkaloi kufijtë e gjuhës dhe lidhjet familjare. Në shërbim të Zotit, ata respektuan njëri-tjetrin në dashuri dhe bënë punën e kishës: ndërtimin e një shoqërie që respekton çdo njeri, veçanërisht ata që nuk janë të privilegjuar, por që kërkojnë një të ardhme plot shpresë.

Sipas sqarimit të mëtejshëm të Kristina Cekovit, ajo, në fakt, e kishte zbuluar gjendjen e varrezës para Nausnerit, teksa shoqëronte një grup nga Gjermania. Ajo shkruan:

Po vizitoja Heraklean me disa gjermanë, dhe e dija që kishte varreza protestante diku afër Herakleas, afër varrezës katolike në të njëjtin

<sup>128</sup> Christina Cekov është me origjinë gjermane, martuar me një maqedonas në Strumicë. Ata bashkëpunojnë në kishën metodiste të Strumicës, ku ka qenë pjesëtar i ndjeri President i Maqedonisë, Boris Trajkovski, i cili ishte edhe predikues aty.

<sup>129</sup> Për gjendjen e sotme, një korçare protestante, Elida Jorgoni, ka vizituar varrezat protestante më 22 nëntor 2020. Ajo shkruan: “Në pronën e Misionit Amerikan (Varreza Protestante) kanë ndërtuar urën me kangjella hekuri dhe WC – burrash dhe grash. E vetmja shenjë që ka mbetur e pandryshuar është muri me tulla të kuqe” (korrespondencë me autorin, më 10 dhjetor 2020).

vend. Por kur pashë ç'kishte mbetur nga varrezat protestante, u tmerrova dhe u trishtova. Menjëherë fola me Wilfried dhe Jean për këtë. U kthyem bashkë në Bitola, dhe rastësisht e gjetëm varrin shumë të veçantë [të Gjerasimit]. Atëherë filluam të bisedonim me drejtorin e Muzeut të Bitolës për shpëtimin e “varreve tona”. Nuk shfaqën shumë shqetësim për këtë çështje, por pastaj na ndihmuan kur kërkuam që të merrnim gjithçka që kishte mbetur aty, për t'i çuar në Strumicë për të krijuar një vend të përshtatshëm për ta te varrezat protestante. Z. Nausner siguroi fondet për këtë dhe vullnetarët e Qendrës “Miss Stone” shkuan për të gërmuar eshtrat dhe për të marrë të gjitha gurët aty. Disa nga varret ishin bosh dhe shumica e gurëve kishin humbur.<sup>130</sup>

Kur filluan punimet, vetëm atëherë filluan të kuptonin se çfarë kishte ajo varrezë dhe kush ishte varrosur aty. Mbeteshin tri gurë varri në vendet e tyre por, befas, gjatë punimit, W. Nausner e gjeti gurin e katërt, atë të Gjerasim Qiriazit, nëpër shkurre. Ishte thyer copë-copë dhe hedhur tej. Kishin mbetur vetëm tri copa të gurit të tij. Ndërkohë, dalloheshin dymbëdhjetë varre, tetë prej të cilëve janë ende të panjohur, sepse mungonin gurët e tyre. Të dhënat e dymbëdhjetë varreve janë si më poshtë<sup>131</sup>:



1. Fotografitë e varrezave te libri: *Velešanov, Dragan. Protestantizam u Makedoniji 1868–1922. Zagreb: Bogoslovni Institut, 2007*; 2. Gjendja e varrezës në vitin 2011

<sup>130</sup> Letërkëmbimet elektronike të autorit me Christina Cekov, 5 nëntor 2020. Ajo shtoi se Muzeu i Manastirit mori leje nga Ministria e Kulturës, për të autorizuar zhvendosjen e varreve.

<sup>131</sup> Sipas skicës së përgatitur në Strumicë. Arkivi ISSHP, B10-F01.



3. Gjatë punimeve për zhvendosjen e eshtrave (2011).

**Rreshti i parë, varret 1-4 (të panjohur)**



*Rreshti i parë, varri 5 (Paraskeva Ef. Stefanova)*



ПАРАСКЕВА ЕФ. СТЕФАНОВИЋ,  
ЖИВЕЛА 76 Г[ОДИНА]  
УМР. 27 ДЕЦ. 1928

PARASKEVA EF. STEFANOVIĆ JETOI  
76 VJET VDIQ 27 DHJETOR 1928

Paraskeva E. Stefanova (“Paraskeva Ef. Stefanović” te guri original), mendohet që të ketë qenë maqedonase por, meqë Bitola ishte asokohe nën sundimin serb, mbiemri i saj mund të ketë marrë mbaresën serbe. Ende nuk kemi dijeni për këtë njeri, por në shkollën protestante për vajza në Manastir, kishte dy vajza me emra të ngjashëm: Fanka Eftimova Stephanova (e cila për shumë vite dha mësim në Shkollën e Vashave në Korçë) dhe Aspasia (Spasika) Eftimova Stephanova (vdiq 1940) (shih: Mary Louisa Matthews Monastir Record Book, Houghton Library Harvard, ABCFM ABC 76 [NS2], Personal Papers).

**Rreshti i dytë, varret 6-7 (të panjohur)**



*Varri 6 ishte bosh, pa eshtra fare*



*Varri 7 kishte skeletin më të përmbledhur,  
nga të gjitha varret*

**Rreshti i dytë, varri 8 (Gjon Ciko)**



*Guri i varrit të  
Gjôn Cikos pas  
zhvendosjes së  
tij në Strumicë*

Le të analizojmë mbishkrimin e gdhendur te guri i varrit të Gjon Cikos, me disa tipare<sup>132</sup>:

Mbishkrimi te guri i varrit të Gjon Cikos	
<i>Siç është në origjinal</i>	<i>Në gjuhën e sotme</i>
KATU ÇLOBETË JOANA TSIKO LINDURË NE KORÇË MË 1850 VDIQ 19 SEPTEMBRJE 1922 ΓAKU JISU KRISTIT TE BIKIT E ATI NA QERON NGA CDO EAL I/JOAN /[?]/1/7/STI	Këtu çlodhet Joan [Gjon] Ciko, Lindur në Korçë më 1850, Vdiq 19 shtator 1922, Gjaku i Jezu Krishtit, Birit të tij, na qëron nga çdo faj 1 Gjoni 1:7-shti

1. Ky gur dhe guri i Gjerasim Qiriazit na bëjnë shumë përshtypje, sepse janë shkruar në shqip.
2. Mbishkrimi ka disa gabime: *katu* për “këtu”, *Bikit* për “Birit”, *eal* për “faj”. Kjo na lë të kuptojmë që shkruesi i tekstit mund të mos ishte shqiptar, e ndoshta për këtë arsye e ka kopjuar keq tekstin e porositur nga të afërmit e tij.
3. Fjala *Septembrie* (shtator) ka një trajtë maqedonase/bullgare.
4. Forma e emrit *Joana* (te emri *Gjon/Jovan Ciko* dhe te vargu biblik *1 Gjoni*) na kujton ndikimin bullgar, si edhe vendlindjen e Cikos në Korçë. Edhe pse përdoret gjerësisht tani forma e shqipëruar *Gjon Ciko*, duhet sqaruar se në Korçë nuk përdorej zakonisht forma *Gjon*. Trajta e zakonshme ishte *Joan* (si ndikim i bullgarishtes), *Jani* (si ndikim i greqishtes), por edhe *Jovan* (si ndikim i maqedonishtes). Në burimet angleze të Shoqërisë Biblike, emri i tij jepet si *Jovan Tsiku*.<sup>133</sup>

<sup>132</sup> Për këtë analizë më ka ndihmuar Agesil Qiriazit në Tiranë, përkthyes dhe studiues, të cilit i jam mirënjohës.

<sup>133</sup> Shih: Hosaflook, David (red.). *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the British and Foreign Bible Society, 1805–1955*. Tiranë: ISSHP, 2017.

5. Përdoret alfabeti i Stambollit për shkronjat kapitale, p.sh., shkronjën **Г** për **GJ** (ГАКУ) dhe shkronjën **Б** për **DH** (ЏЛОБЕТЃ); por dyshkronjëshi **TS** përdoret për **С** (ТСИКО).
- ПОЧИНА  
НА ДЕН 24-II-1959 Г. [ГОДИНА]  
СПИРО К. ДИМОВСКИ  
РОД НА 27-IV-1880 Г.
- Vdiq më 24 shkurt 1959  
Spiro K. Dimovski,  
lindur më 27 prill 1880
6. Shkronja **I** shkruhet me një kaligrafi ngatërruese: në disa vende del e ngjashme me shkronjën “**J**” apo “**j**” (ndoshta për efekt artistik), si te *TSJKO*, *LJNDURË*, *VDJQ*, *JËSU*; por del edhe si “**I**”, si te *KRISTIT* dhe *BIKIT*.
7. Vargu biblik është i njëjtë me vargun te varri i Gjerasim Qiriazit (varri 12). Meqë Ciko kishte miqësi shumë të ngushtë me Gjerasimin dhe meqë u varros në të njëjtën varrezë në Manastir, mund të ishte amaneti i tij që të përdorej i njëjti varg. Ka mundësi, madje, që ai, bashkë me të afërmit e Gjerasimit, të ishin autorët e mbishkrimit në gurin e varrit të Gjerasimit.
8. Lidhur me datat e lindjes dhe të vdekjes, besojmë se datat janë të sakta, sipas kalendarit të ri (gregorian), ndryshe nga kalendari i vjetër që u përdor te guri i Gjerasimit. Bullgaria, për shembull, e ndërroi kalendarin nga julian në gregorian më 21 mars 1916.

**Rreshti i dytë, varri 9 (i panjohur)**



*Ky gur ka një kornizë dekorative me engjëj në qoshe, si dhe një copë guri të rrumbullakët të thyer, i cili ka një engjëll dhe një libër me një shkrim në të (sigurisht Bibla), por shkrimi nuk dallohet. Ky gur nuk u çua në Strumicë dhe nuk dihet se ku gjendet sot.*

*Gjithashtu, ka disa copa të tjera guri sipër këtij varri, njera me shkronjat “ОВДЕ [П]ОЧИВА” (“Këtu çlodhet”), por nuk dihet se cilit varr i përket. As këta gurë nuk u çuan në Strumicë dhe nuk dihet se ku gjenden sot.*

**Rreshti i tretë, varri 10 (i panjohur)**



**Rreshti i tretë, varri 11 (Spiro Dimovski)**



*Mezi dallohen shkronjat nga dëmtimi i gurit dhe heqja e shkronjave metalike. Mbeti i panjohur ky varr deri në nëntor të vitit 2020, kur, duke përdorur miell të bardhë në faqen e gurit, mundëm të dallonim më qartë shkronjat. Duhet të kërkohet të dhëna për Spiro Dimovskin, sepse nuk e njohim.*

**Rreshti i tretë, varri 12 (Gerasim Qirias?)**



Nuk dihet me siguri nëse Varri 12 është varri i Gjerasim Qiriazit, por e quajmë provizorisht të tijin, sepse guri i thyer i varrit të tij u zbulua shumë afër Varrit 12 (por jo si pjesë e tij). Kjo “provë” është e pasigurtë, duke pasur parasysh gjendjen e mjerë të varrezës. Ka mundësi që Gjerasimi të ishte varrosur edhe te varri 1, 2, 3, 4, 6, 7, 9, 10, apo 12. Me interes, gjithashtu, është një gur tjetër, i ngjashëm në formë me gurin e Spiro Dimovskit (Varri 11), në formë kryqi, që gjendet sipër Varrit 12 (shih shigjetën e kaltër). Për fat të keq, as ky gur nuk u çua në Strumicë, dhe nuk dihet se ku gjendet sot ky gur varri. Nuk dimë, madje, nëse ka të ky gur një emër të dallueshëm. Mbetet për t’u zbuluar.

Le të analizojmë mbishkrimin e gdhendur te guri i varrit të Gjerasim Qiriazit.<sup>134</sup>



Guri i varrit të Gjerasim Qiriazit, rivendosur në një pllakë çimento

Mbishkrimi te guri i varrit të Gjerasim Qiriazit	
<i>Siç është në origjinal</i>	<i>Në gjuhën e sotme</i>
<p>Këtu ç'lodhet i pari lëçitës i Shqipërisë                      GERASIM D. QIRIAS                      Lindi mbë 6 të Vjeot II 1858. Fjeti                      mbë 21 të sënj' Dreut 1893                      Gjaku i Jisu Krishtit të Birit ati na                      7</p>	<p>Këtu çlodhet i pari predikues i Shqipërisë                      GJERASIM DH. QIRIAZI                      Lindi më 18 tetor 1858.                      Fjeti më 2 janar 1894.                      Gjaku i Jezu Krishtit, Birit të tij na                      qëron nga çdo faj, 1 Gjoni 1:7</p>

<sup>134</sup> Për këtë analizë më ka ndihmuar Agesil Qiriaz në Tiranë, përkthyes dhe studiues, të cilit i jam mirënjohës.

Le të vëmë re disa tipare të këtij mbishkrimi dhe të japim ca vërejtje:

I. Mjeshtri e ka gdhendur me një kaligrafi të mrekullueshme, punuar me merak.

II. Shkronjat e përdorura në shkrim janë të Alfabetit të Stambollit 1879.

III. “Çlodhet” dhe “Fjeti” – këto fjalë kanë nuanca biblike: besimtarët e krishterë kur vdesin, “çlodhen” (pushojnë) nga punët e tyre për Zotin në tokë dhe, një ditë, trupat e tyre, tani që “flenë”, do të “zgjohen” përsëri e do të shndërrohen (1 Korintasve 15:50–58, 1 Gjoni 3:2).

IV. “I pari lëçitës”. Këtu për *predikues*, jo për *mësues*. Fjalën *lëçitës* e gjejmë te fjalori i Kristoforidhit (1904), transkriptuar shqip prej Aleksandër Xhuvanit dhe botuar në vitin 1961 në Tiranë, fq. 180, në formën: *leçitës-i sh. leçitës-itë em. oa. = κήρυξ -κοξ*. Kjo fjalë greke do të thotë *predikues*, eng. *preacher*. Për shembull, misionari amerikan Phineas Kennedy i botoi dy herë predikimet e tij. Në botimin e parë (1912), libri u titullua *Lëçitje të folura prej z. Ph. B. Qennedy në Korçë*; kurse në botimin e dytë (1929) u titullua *Predikime prej Rev. P. B. Kennedy*. Nuk ishte Gjerasimi *mësuesi* i parë i Shqipërisë apo në gjuhën shqipe, por ishte njohur gjerësisht si i pari që *predikonte* Ungjillin rregullisht në shërbesat fetare në gjuhën shqipe, në Shqipëri.

V. “I pari lëçitës i Shqipërisë” – më 1894 Shqipëria ende ishte pjesë e Perandorisë Osmane, por njihej me këtë emër. Si shembuj mund të përmendim dy libra: librin e Pashko Vasës, *La vérité sur L’Albanie et les Albanais. Étude historique et critique, par Wassa Effendi, fonctionnaire chrétien albanis* (Paris 1879); dhe librin e Sami Frashërit, *Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë* (Bukuresht 1899).

VI. “GERASIM D. QIRIAS” – Shkronja “D” i referohet babait të tij, Dimitër (Dhimitër). Kurse, mund të themi që, forma *Qirias* ruan trajtën greke të shqiptimit *kyrios*, që do të thotë *zot, zotëri*. Mendojmë që kjo është trajta origjinale e mbiemrit të familjes. Këtë trajtë mbiemri e ruan edhe Sevastia, Gjergji e Parashqevia. Më vonë nga studiuesit shqiptarë mori trajtën e shqiptarizuar *Qiriaz* për “Qirias”, *Gjerasim* për “Gerasim” dhe *Dhimitër* për “Dimitër”.

VII. Lindi mbë 6 të **Vjesht II** 1858. Fjeti mbë 21 të **Shënj’ Dreut** 1893. Këtu për datat përdoret kalendari i vjetër. 6 të Vjesht II 1858 i bie 18 tetor 1858. Shënj’ Dreut këtu (*Shënëndre*) korrespondon me muajin dhjetor. Me

kalendarin e vjetër 21 dhjetor do të thotë 2 janar 1894, që njihet si data e vdekjes edhe në burimet perëndimore.<sup>135</sup>

VIII. **“Gjaku i Jisu Krishtit të Birit ati na...”** – Ky është vargu biblik nga Letra e Parë e Gjonit 1:7b. Te guri i varrit të Gjon Cikos, i cili u zbulua i padëmtuar, e lexojmë të njëjtin varg, por të plotë. Ndaj, edhe pse disa copa nga guri i varrit të Gjasimit kanë humbur, kuptohet përmbajtja e plotë e tekstit që mungon, sidomos meqë shihet numri “7” te guri i varrit të tij. Vargu është marrë nga varianti i përkthimit të Kristoforidhit në toskërisht: “edhe gjaku i Jisu Krishtit, Birit t’ati, na qëron nga çdo faj”. Ky varg biblik interpretohet nga vetë Gjasimi, në një broshurë fetare që u botua për shpërndarje masive. Titulli është “Shërim i fajit” dhe u botua më vonë si libër, me pesë broshura të tjera.<sup>136</sup> “Shërim i fajit” është kapitulli i fundit. Ndaj, mund të themi se mbi-shkrimi te ky gur varri, çiftëzuar me broshurën, mund të merren si “predikimi i fundit i Gjasimit”.

IX. Lidhur me pikën 8, dukshëm bie në sy natyra fetare e gurit. Me pak tekst, theksohet puna kryesore e Gjasimit si predikues ungjillor në Shqipëri dhe besimi i tij teologjik lidhur me veprën e Jezus Krishtit, si kurban zëvendësues për mëkatarët. Ky është një tjetër fakt që korrigjon trajtimet e periudhës së monizmit, kur, për shkak të rrethaneve të kohës, Gjasimi u lëvdua si iluminist, arsimtar dhe rilindës, por jo si teolog dhe predikues.<sup>137</sup> Madje, me disa raste, u mohua sinjeriteti i besimit të tij fetar, me tezën që ai i shfrytëzoi dhëlpërisht shoqëritë biblike dhe protestante, vetëm për qëllimet e tij kombëtare.<sup>138</sup> Kjo tezë nuk qëndron më. Gjasimi ishte vërtet një iluminist,

<sup>135</sup> P.sh., te: John Baird, “Rev. Gerasim D. Kyrias” (nekrologji), *Missionary News from Bulgaria*, 19 March 1894, nr. 49, 7–8, ose te: Mary Louisa Matthews Monastir Record Book, vep. cit. Por Sevastia Qiriazit-Dako gabon në jetëshkrimin e saj, duke thënë se se Gjasimi vdiq më 4 janar 1894. Shih: *Jeta ime* vep. cit., f. 125.

<sup>136</sup> Libri titullohet *Mësime të-vëjverë a fjalë shpirtërishte, të-folura ndë mësionjëtoret shqipe të çupave ndë Korçë* (1896). Për argumentet që na çojnë te përfundimi se Gjasimi është autori, shih parathënien e Teuta Toskës, në ribotimin e kësaj vepre: *Mësime të vyera a fjalë shpirtërishte të folura ndë mësionjëtoresh shqipe të çupave në Korçë* (1896) (Teuta Toska, Tiranë: ISSHP, 2017, f. xxiv–xxx).

<sup>137</sup> Disa shkrime nga Gjasim Qiriazit me tema teologjike, të cilët ishin fshehur gjatë kohës së regjimit komunist, janë: 1) *Kënkëtoresh: hymna për ndë falëtoresh të ungjillorëve* (1893, ribotuar dhe shtuar më 1906 dhe 1927); 2) *Mësime të-vëjverë a fjalë shpirtërishte, të-folura ndë mësionjëtoresh shqipe të çupave ndë Korçë* (1896), vep. cit.; 3) *Hristomathi a udhëheqës për ç’do shtëpi shqipëtare* (në dy vëllime, përmbledhur nga Gjergj Qiriazit, 1902 dhe 1907). *Hristomathi* u botua vetëm pjesërisht në botime të tjera, duke hequr përmbajtjen teologjike.

<sup>138</sup> Disa shembuj të kësaj propagande janë: “[Gjasim] herë-herë pranonte të mbante predikime në gjuhën shqipe jo vetëm në Manastir, por edhe nëpër fshatrat shqiptare. Ai e bënte këtë jo për të përhapur fjalën e perëndisë, po për t’u folur shqiptarëve në gjuhën amtare dhe për t’u ngjallur dashurinë për të dhe për çështjen shqiptare”; “[Gjasim Qiriazit] e përdori Shoqërinë Biblike jo vetëm si një mbështetje personale, por edhe si një mburojë kundër Turqisë për të zhvilluar aktivitetin e tij

arsimtar dhe rilindës kombëtar, por nga shkrimet e tij të bollshme dhe tani nga dëshmia e gurit të varrit të tij, e dimë se në jetë dhe në vdekje, ai ishte, mbi të gjitha, një predikues i Ungjillit të Jezus Krishtit.

\* \* \*


Nga dokumentet e transferimit, siguruar nga Kisha Metodiste në Strumicë, dimë se eshtrat dhe gurët u zhvendosen nga Manastiri në Strumicë me dt. 14 tetor 2011. Nga fotografitë dhe raportet që na janë siguruar, konstatojmë që kjo punë u krye me kujdesin më maksimal që mund të arrihej prej vullnetarëve, megjithëse nuk ishin të specializuar. Së pari, ata mbledhën eshtrat e shpërndara në sipërfaqen e varrezës dhe nëpër qoshet. I bashkuan të gjitha këto në një thes, meqenëse nuk mund të dallohej se kujt i përkisnin, duke mos qenë brenda varreve.

Së dyti, kur filluan gërmimet, janë munduar të ruajnë integritetin e çdo varri, duke mbledhur eshtrat e secilit varr dhe duke i ndarë veç e veç. Me vegla pune të zakonshme, kanë hapur çdo varr. Gjatë punës u kuptua qartë se këto varre kishin qenë hapur, mundësisht disa herë gjatë viteve, meqë disa varre ishin bosh, kishte parregullsi, dhe vetëm një varr (Varri 7) mbante një skelet deri diku të plotë e normal. Siç kemi evidentuar më sipër te fotografitë e varreve 9 dhe 12, dallohen disa gurë të vegjël me interes, të cilët u harruan disi nga ekipi i punës, dhe nuk dihet sot ku gjenden. Pastaj, ekipi nuk kishte mundësi për t'i marrë pllakat e mëdha, ato me kryqe, si p.sh. te varret 2, 6, 9 dhe 10. Nuk dihet ku kanë përfunduar ato pllaka. Sigurisht, do të donim që të ishin ruajtur gjithë këto gurë, por kjo vërejtje për ndonjë pakujdesi të vogël, nuk krahasohet me mirënjohjen dhe lëvdimet për atë që ka arritur të bëjë një grup vullnetarësh, për vëllezërit dhe motrat e tyre protestante, si edhe për historinë e popujve shqiptarë dhe maqedonas në përgjithësi, duke e shpëtuar dhe duke e ruajtur të shenjtë kujtimin e disa figurave të shquara nga historia e tyre. Pas shumë dekadave të përdhosjes – kur nuk interesohej askush për ta,

---

kombëtar. Dhe kur e luftonin Gjerasim Qiriazin si një ‘protestant’, ky qe vetëm një pretekst për ta luftuar si një patriot shqiptar”; “Puna është se lidhjet e tij me shoqëritë protestante Gjerasimi i përdori vetëm si mbështetje për të mbrojtur aktivitetin patriotik dhe qenë me rezultate pozitive për shkollën shqipe” (Skënder Luarasi, *Gjerasim Qiriaz: Jeta dhe vepra*, Tiranë: Naim Frashëri, 1962, f. 23–27,45; Bedri Dedja dhe Skënder Luarasi, red.*Gjerasim Qiriaz, Shkrime pedagogjike*, Tiranë: Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, 1966, f. 24–25, 47). Duhet të shtojmë këtu që Skënder Luarasi kishte për qëllim shpëtimin e familjes Dako/Qiriaz nga keqtrajtimi dhe persekutimi, një punë që e bëri trimërisht për shumë vite. Sigurisht, këtë punë nuk do të mund ta bënte sikur të ribotonte tekstet fetare të tyre apo të mos interpretonte lidhjet e tyre nën dritën e ideologjisë së shtetit. Viktoria Dako-Ruli na rrëfen një rast kur Skënder Luarasi botoi një jetëshkrim të Sevasti Qiriazit-Dakos, i cili përmendi besimin e saj ungjillor. Luarasi mori një kopje dhe ia çoi familjes, por brenda dy ditëve, u zhduk i gjithë tirazhi dhe nuk qarkulloi (bisedë e autorit me Viktoria Dakon, 14 dhjetor 2020).

as komuniteti protestant në Shqipëri, Kosovë, ose në Maqedoni, as ndonjë zyrë e qeverisë, as muzetë, as shoqëritë historike, as familjet e tyre, as qendrat e kulturës në rajon – më në fund, u shpëtuan nga humbja e plotë dhe përfundimtare. Por Kisha Metodiste dhe Qendra “Miss Stone” në Strumicë nuk u kënaqën vetëm me kaq. Në Strumicë, te varret protestante të qytetit, ata ndërtuan një vend të veçantë, të mbuluar dhe të rrethuar me hekura dekorativë, si një mauzole modest. Eshtrat i vendosën në kuti të vogla druri, si arkivola në miniaturë, që i kishin bërë enkas për këtë rast. Punimet përfunduan më 28 prill 2013, ditë kur të gjitha eshtrat u rivarrosën së bashku, në një ceremoni solemne.<sup>139</sup>



<sup>139</sup> Arkivi ISSHP, B10-F01.

Brenda hapësirës së rrethuar, janë vendosur edhe gurët e varreve që u shpëtuan (të Gjasim Qiriazit, Gjon Cikos, Paraskeva Ef. Stefanovas, Spiro Dimovskit). Copat e thyera të gurit dekorativ të Gjasimit u rivendosën në një pllakë çimentoje të bardhë.




*Varrezat protestante në Strumicë*



*Varret e protestantëve, dikur në Manastir. tani në Strumicë*

Meqë eshtrat e zbuluara ishin të përziera dhe të pidentifikueshme, janë vendosur gjithë së bashku dhe janë mbyllur me dy pllaka të mëdha të reja mermeri, me këto mbishkrime<sup>140</sup>.

### Pllaka e majtë:



Параскева Е. Стефанова  
27.12.1928

Joana Tsjko Ljndure<sup>141</sup>,  
1850 Korca  
19.09.1922 Bitola

Keta<sup>142</sup>

И моштите на 9 нелознати  
проотестанти<sup>143</sup>

<sup>140</sup> Teksti i mbishkrimit te pllakat e reja në Strumicë ka disa gabime, që do t'i identifikojmë.

<sup>141</sup> Si duket, është menduar në Strumicë se fjala “LJNDURE” (lindur) është mbiemri i dytë i Gjon Cikos.

<sup>142</sup> Nga pjesëtarët e ekipit, nuk kujtohet përse është shkruar “Keta” këtu. Mendojnë se është emër, por nuk kujtojnë burimin. Në vitin e ceremonisë më 2013, nuk kishin arritur të dallonin shkronjat e gurit të Spiro Dimovskit, e për këtë arsye emri i tij nuk gjendet te pllaka e re. Ka mundësi që fjala “Keta” të ishte lexuar (gabimisht) te guri i Dimovskit.

<sup>143</sup> Në shqip: “dhe reliket e 9 protestantëve të pidentifikuar”.

### Pllaka e djathtë:

Gerasim D. Kyrias  
(Gjerasim Quiriazì)<sup>144</sup>


Првиот учнтел на албански<sup>145</sup>  
18.10.1858 во Манастир (Битола)  
02.01.1894 во Манастир (Битола)

Во спомен на првите  
– познати и непознати –  
мисионери, учители – пионери  
на Евангелието во Македонија

Со љубов и благодарност,

Евангелско-методистичка  
црква во Македонија

28.04.2013<sup>146</sup>



\*\*\*

<sup>144</sup> Quiriazì – shkronja “u” këtu është gabim. Në dokumentet e kohës mbiemri “Qiriazì” paraqitet nganjëherë si “Kyrias” apo “Qirias”, por kurrë “Quiriazì”.

<sup>145</sup> Në shqip guri origjinal lexohet “lëçitësi i parë i Shqipërisë”. Por këtu te pllaka e re mermeri përkthehet gabimisht “Првиот учнтел на албански” (*Mësuesi i parë në shqip*). Duhet të ishte përkthyer “Првиот проповедник на Албанија” (*Predikuesi i parë i Shqipërisë*).

<sup>146</sup> Në shqip përkthehet: “Në kujtim të misionarëve, mësuesve – pionierëve të parë – të njohur dhe të panjohur – të Ungjillit në Maqedoni. Me dashuri dhe mirënjohje, Kisha Metodiste Ungjillore në Maqedoni, 28 prill 2013.”

Si përmbledhje, le te theksojmë çfarë dimë dhe çfarë nuk dimë rreth çështjes së varrezave protestante dhe të eshtrave të Gjerasim Qiriazit, Gjergj Qiriazit dhe Gjon Cikos:

1. Dimë se Gjon Ciko, Gjergj Qiriazit dhe Gjerasim Qiriazit ishin bashkëpunëtorë dhe besimtarë aktivë të kishës protestante.
2. Dimë se Gjoni dhe Gjerasimi kanë dashur një varrezë protestante, dhe që kanë blerë një tokë në Korçë për atë qëllim, e cila kaloi në pronësi të komunitetit vllah dhe nuk ekziston më.
3. Dimë se Gjoni dhe Gjerasimi u varrosën në Manastir në një varrezë protestante, një varrezë jo “shqiptare”, por protestante, e cila pasqyronte përmbajtjen shumetnike të Manastirit dhe të kishës protestante.
4. Dimë se, me kalimin e viteve, varrezat protestante në Manastir u dhunuan dhe u përdhosën, por nuk e dimë se nga kush dhe përse. Ka gjasa që ky veprim ka lidhje me gërmimet e Herakleas.<sup>147</sup>
5. Nuk e dimë se ku kanë përfunduar eshtrat dhe gurët e varrit të së paku tetë protestantëve, të cilët ishin varrosur në varrezat protestante të Manastirit.
6. Dimë se Kisha Protestante Metodiste e ka shpëtuar gjithçka kishte mbetur nga ajo varrezë dhe me shpenzimet e saj kanë ndërtuar një vend dinjitoz dhe të sigurt për ta, në varrezat protestante në Strumicë.
7. Ende nuk e dimë se ku janë eshtrat e Gjergj Qiriazit. Në fshatin Tërnovë? Ndoshta. Por nuk kemi asnjë dokument apo provë, përtej një gojëdhëne. Pyesim, atëherë, meqë Gjergj Qiriazit punoi dhe vdiq në Manastir (në fund të vitit 1912, pas Betejës së Manastirit dhe pushimit serb) dhe meqë ishte protestant, pse nuk do të varrosej pranë vëllait të tij, Gjerasimit? Meqë në Manastir u zbuluan 8-9 varre protestante që ende janë të paidentifikuar me dokumenta, ka shumë mundësi që njëri prej tyre të jetë varri i Gjergj Qiriazit. Prandaj, kur më 14 nëntor 2020, në kushtet e pandemisë, një delegacion i vogël me akademikë, zyrtarë të shtetit, ambasadorin e Kosovës në Maqedoninë e Veriut dhe drejtuesit e komuniteteve protestante nga Tirana dhe Prishtina, vajtën në Strumicë për një homazh të varrit të Gjerasim Qiriazit dhe ai i Gjon Cikos, ndoshta, pa ditur, kanë vizituar edhe vendin ku prehet Gjergj Qiriazit, nismëtari kryesor i Kongresit të Manastirit.

---

<sup>147</sup> Në këtë shkrim të natyrës shkencore, ku po shkruaj si historian, nuk mund t'i shpreh lirshëm mendimet e mia të prera kundër këtij veprimi në dëm të pakicës protestante në Maqedoni.

Përfundojmë me poezinë e Gjerasimit, “Lamtumirë”, shkruar në ditët e fundit të jetës së tij. “Këtë vjershë – thotë *Yll'i Mëngjezit* (1918) – ja gjetnë të tijtë nënë jastëk në orën e vdekjes edhe ja kanë shkrojtur mi vart’<sup>148</sup>

*Mëmedhe, s'munt të duronj,  
Zemra ime kjan për ty.  
Se për së shpejti do të shkonj  
E do të mos të shoh me sy.*

*Bijt e tu o mëmëdhe  
Ngrihen, meren që këtu.  
Po ti për gjithë jetën ron  
Dhe kjan ata që dëshëron.*

*Malli im, o mëmëdhe,  
Që kam pasurë për ty,  
Sot mbulonetë në dhe  
E do mos të shohç me sy.*

*O Zoti im, përse s'më le  
Të ç'mallem edhe pak me të  
Kujto, o Zot, vëllezrit e mi  
Të të shërbejnë siç do Ti*

---

<sup>148</sup> Gjerasim Qiriazi, “Lamtumirë”; *Yll'i Mëngjezit*, Boston, nëntor 1918, vëll. 3, nr. 7, f. 209.

## PËRKUJTIMI I NDRITSHËM PËR ZONJËN E PARË TË ALFABETIT – PARASHQEVI QIRIAZI

*Shkup, 22.11.2020* – Dita finale e manifestimit kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITSHKSH-Shkup, kur shënohet edhe përvjetori i themelimit të Institutit, iu kushtua Zonjës së Parët të Alfabetit – Parashqevi Qiriazi, e cila sivjet i mbushë 50-vjet nga kalimi në amshim.

Në nderim të këtyre datave të rëndësishme për historinë kombëtare të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe jo vetëm, gjatë aktivitetit të sotëm morën pjesë ambasadorja e SHBA-ve në Shkup, Kejt Bërns dhe ministrja e Kulturës, Irena Stefoska.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, në fjalën e tij tha se pikërisht në ditën kur 112 vjet më parë i mbylli punimet Kongresi i Manastirit, përkujtojmë njëri nga figurat kryesore të kohës, iluministen shqiptar Parashqevi Qiriazi, të cilën e kemi quajtur Zonja e Parët të Alfabetit. Përkundër vështirësive që patëm me pandeminë, megjithatë manifestimi kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit”, i dha një shije të veçantë gjithë këtyre ditëve, duke përkujtuar figura të shquara iluministe, që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në emancipimin tonë, nënvizoi Asani.

Ministrja e Kulturës, Irena Stefoska, duke uruar për manifestimin, tha se gjuha është mjet komunikimi, por gjuha amtare është amanet – ajo është fjala e parë që e dëgjojmë në ardhje në këtë botë, dhe e fundit derisa ikim nga kjo botë. “Në gjuhën shqipe, për mua është shumë e ëmbël dhe melodike fjala “Faleminderit”, tha Stefoska.

Ambasadorja e SHBA-ve në Shkup, Kejt Bërns, theksoi rëndësinë e respektit të ndërsjellë të kulturave të ndryshme që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Ajo uroi shqiptarët për Ditën e Alfabetit dhe Institutin për patronazhin, duke inkurajuar vazhdimin e kultivimit të vlerave të përbashkëta, mirëkuptimit dhe tolerancës.

Femi Cakolli, kryetar i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, u ndal në rëndësinë e misionarëve protestantë në përhapjen e dritës së diturisë diturisë, ku spikaste figura e Parshqevisë.

David Hosaflook, drejtor i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, foli lidhur me rolin e madh që patën misionaret protestante në përhapjen e shkrim-leximit në mesin e popullatës.

Njëra nga autoret e librit me dokumente “Ditari i Parashqevi Qiriazit”, Nora Maliqi-Zylali, theksoi rëndësinë e zbardhjes së këtyre dokumenteve, që flasin për një segment shumë të rëndësishëm të jetës së Parashqevisë, si njëra nga pjesëmarrëset e Konferencës së Parisit në vitin 1919.

Në fund u shfaq filmi dokumentar kushtuar Parashqevi Qiriazit, me kontributin e Jasmina Shopova, Merita Maksuti e Jasna Susa, i cili film do të paraqitet edhe në UNESCO.







**Skender ASANI**

*Drejtor i ITShKSh – Shkup*

## **ITSHKSH DO TË JETË PËR MË SHUMË AJËR NË AMBIENTIN TONË TË PËRBASHKËT KULTUROR E SHOQËROR**

Si për kohëzgjatje, edhe ky edicion i Ditëve të Alfabetit kushtuar iluministëve shqiptarë, po mbyllet me prezencën e dy zonjave të nderuara, mysafire të këtij manifestimi, Ambasadorja Amerikane në Maqedoninë e Veriut, zonja Kejt Bërns dhe ministrja e Kulturës, zonja Irena Stefoska, të cilat i përshëndesim përzemërsisht dhe iu dëshirojmë mirëseardhje në Promovimin e librit “Ditari i Parashqevi Qiriazit”, si dhe të dokumentarit për UNESCO kushtuar Parashqevi Qiriazit (në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante).

ITSHKSH në Shkup sot po e mbyll këtë edicion të Ditëve të Alfabetit, por po hap një shteg të ri në promovimin e kulturës së afrimit dhe mirëkuptimit midis popujve.

Në qytetin jugor të Maqedonisë së Veriut, në Manastir, para 101 viteve u kodifikua alfabeti i gjuhës shqipe si një shkrim i përbashkët për të gjithë shqipfolësit dhe të tjerët që do të komunikojnë me ta.

Kjo ngjarje neve sot na bën krenar për dy arsye:

*E para* – Alfabeti i një populli është radiografia shpirtërore e tij dhe duke qenë i tillë edhe Alfabeti i gjuhës shqipe shënjoj trokitjet e para në orën e civilizimit Perendimor, duke iu bashkuar popujve evropianë në përdorimin e alfabetit latin dhe

*E dyta* – Një popull që përdor shkronja për të vizatuar ëndërrat e tij, ai popull jeton në harmoni me fqinjë, duke i konsideruar ata garues të një loje që fituesi përcaktohet mbi sasinë e dashurisë që dhuron për tjetrin...

Për këto tetë ditë sa zgjatën Ditët e Alfabetit ne promovim një standard të ri në vlerësimin e gruas, duke i dhënë asaj peshën dhe rëndësinë në të gjitha proceset shoqërore, sociale e kulturore.

Trajtua profile të ndryshme grashë iluministe që në fusha të caktuara kishin lënë gjurmë, kurse kryefjala e këtij angazhimi është botimi i Ditarit të

Parashqevi Qiriazit, të cilin po e promovojmë sot e që i kushtohet kryesisht ditëve të bujshme para dhe pas Konferencës së Versajës.

Jemi me fat që ky Ditar tash më është publik dhe në të është e ngjizur një histori jo e largët, por tepër dramatike që lidhet me fatet e popujve të vegjël të Ballkanit.

Parashqevi Qiriazit udhëton nga Amerika për të sjellë në Konferencën e Versajës shqetësimet e bashkatdhetarëve të saj mbi ambiciet grabitqare të fuqive ekspansioniste të Ballkanit dhe Evropës. Ajo tregohet tepër këmbëngulëse në shpërfaqjen e këtyre shqetësimeve, duke i bërë ato sa më të kapshme dhe më të afërta edhe për Presidentin Amerikan Wodro Vilson. Ky i fundit, emrin e të cilit e mban salla ku ndodhemi sot, u tregua një politikan vizionar për arsye se zgjodhi të përfaqësoj interesat e atyre popujve të Ballkanit të cilët po rrezikoheshin nga marrëveshjet e fshehta të fqinjëve dhe të disa shteteve Europiane.

Familja Qiriazit ka dhënë kontribut kolosal në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare përmes emancipimit dhe iluminizmit, kurse Parashqevi Qiriazit duke u ndodhur në një kuvend burrash në Versajë shpartalloi paragjykimet mbi goja pafuqinë e gruas dhe u bë një prej zërave më kumbues në mesin e delegacionit të cilin ajo e përfaqësonte.

Duam të ndajmë edhe me juve kënaqësinë se botimet si ky që përbëjnë vet historinë e krjimit të gjeopolitikave rajonale para më shumë se 100 vite, janë produkt i një pune sistematike hulumtuese e shkencore të ITSHKSH-së për të nxjerrë nga pluhuri i harresës ngjarje e njerëz të cilët kanë qenë faktor nxitës në proceset e kohës.

Është kënaqësi e posaçme të ndaj me juve edhe përvojën shembullore me Ministrinë e Kulturës e Maqedonisë së Veriut, në përgatitjen e këtij Dokumentari kushtuar Parashqevi Qiriazit, i cili do të prezantohet në kalendarin e ngjarjeve të UNESCO-s për vitin 2020.

ITSHKSH do të jetë gjithmonë i hapur për rrymime që sjellin më shumë ajër në ambientin tonë të përbashkët kulturor e shoqëror. Urojmë që bashkëpunimet dhe projektet e tilla të jenë lajtmotiv i një fryme të re në politikat tona kulturore.

**Irena STEFOSKA**

*Ministre e Kulturës*

## **NËN KËTË QIELL TË PËRBASHKËT, NA QOFTË E GËZUAR DITA E ALFABETIT SHQIP**

Të nderuar,

Vendi ynë e ka privilegjin të ketë shumë gjuhë dhe dialekte, të jetë "zemra e kontaktit gjuhësor ballkanik", siç thotë gjuhëtari dhe miku i madh i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prof. Viktor Fridman. Ajo është një thesar, një thesar kulturor që na bën më të bukur dhe më të fortë.

Duke uruar Ditën e Alfabetit Shqip, 22 Nëntorin, nuk e fsheh kënaqësinë që ne arritëm, në kalendarin e UNESCO-s për mbështetjen e përvjetorëve të rëndësishëm të vitit 2020, ta vendosim edhe 50-vjetorin e prehjes së Parashqevi Qiriazit, pjesëmarrëse aktive në Kongresin e Manastirit. Kësaj gruaje të jashtëzakonshme, poliglote, erudite dhe pedagoge, ne ia kushtojmë 17 Dhjetorin.

Të nderuar,

Gjuha, sipas përkufizimit, është një mjet komunikimi, por gjuha amtare është një amanet. Është fjala e parë që dëgjojmë kur vijmë në këtë botë dhe e fundit që e themi kur largohemi.

Shtatë miliardë njerëz në botë flasin 7000 gjuhë dhe secila prej tyre ka melodinë e vet, bukurinë e vet. Në shqip, për shembull, fjala - FALEMINDERIT është shumë e bukur dhe e fortë për mua!

Të rinjtë që, për fat të keq, largohen nga vendi ynë, krijojnë ose do të krijojnë familje larg vendlindjes. Fëmijët e tyre gjithnjë e më pak do të flasin gjuhën e tyre amtare. Me këtë rast, le të premtojmë se, si shtet, do të bëjmë gjithçka që mundemi që të mos na ndodhë kjo. Se pse e them këtë, do ta citoj Gëten: "*Rrallë e ndiejmë bukurinë e gjuhës sonë amtare, atëherë kur ajo na prek veshët nën qiellin e huaj*"!

Nën këtë qiell të përbashkët, na qoftë e gëzuar Dita e Alfabetit Shqip.

Kur flasim, me dëshirën për të kuptuar njëri -tjetrin, dhe madje secili të flet në gjuhën e tij, nuk kemi nevojë për përkthyes.

Ju faleminderit!

**Kejt BËRNS**

*Ambasadore e SHBA-së në Shkup*

## **ÇMOJMË FORT RËNDËSINË E TRASHËGIMISË KULTURORE E SHPIRTËRORE**

Mirdita!

Jam shumë e nderuar që gjendem sot në këtë ngjarje e cila shënon dy përvjetorë të rëndësishëm për Maqedoninë e Veriut dhe në veçanti për komunitetin shqiptar - Ditën e Alfabetit të gjuhës shqipe dhe përvjetorin e 13-të të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Jam posaçërisht e lumtur që jam në këtë sallë që mban emrin e presidentit tonë Woodrow Wilson dhe në këtë ndërtesë e cila ishte shtëpia e Ambasadës amerikane për vite të tëra.

Në vitin 2013, Ambasada amerikane vendosi të financojë një vizitë studimore për një grup etnikisht të përzier të historianëve, i përbërë kryesisht nga stafi i ITSHKSH-së. Ata shkuan në SHBA, por kush mund ta merrte me mend sa shumë suksese do të vijonin pas kësaj vizite - nga publikimet e përbashkëta dhe konferencat ndërkombëtare të krijimi i koalicioneve për të kundërshtuar gjuhën e urrejtjes, antisemitizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, deri tek puna e përbashkët për avancimin e lirive fetare dhe ndihmesa për ta miratuar dhe ligjësuar definicionin punues të IHRA-s mbi mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit - unë ju përgëzoj të gjithëve për energjinë e jashtëzakonshme që keni investuar në punën tuaj të përditshme dhe vendosjen e kontakteve. Këto suksese sigurisht që do të ishin të pamundura pa një bashkëpunim të sinqertë e të hapur midis historianëve dhe hulumtuesve nga përkatësitë e ndryshme etnike, kombëtare, fetare dhe me profesione të ndryshme. Mu në këtë frymë do të dëshiroja ta shoh Maqedoninë e Veriut të vazhdojë ta ndjek përparimin, jo vetëm për t'i tejkaluar interpretimet kundërthënëse mbi historinë, por për të ndërtuar kohezion të mirëfilltë, si dhe për ta shndërruar historinë në një element konstruktiv në vend se të shërbejë si burim i mospajtimeve.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e çmojnë fort rëndësinë e trashëgimisë kulturore e shpirtërore, si dhe atë të diversitetit në Maqedoninë e Veriut.

Prandaj, ne do të vazhdojmë të promovojmë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin midis komuniteteve në këtë vend.

Në fund, më lejoni t'ia uroj Dr. Asanit dhe të gjithë kolegëve të tij këtë përvjetor të Institutit, si dhe t'u uroj të gjithëve në Maqedoninë e Veriut Ditën e Alfabetit Shqip!

Gëzuar Ditën e Alfabetit!

Urime dhe faleminderit!

**Nora MALIQI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## **PARASHQEVIA TEJKALOI STEREOTIPITË QË IMPONONTE APARTEIDI PATRIARKAL**

Vlerat e njerëzve, në të shumtën e rasteve, rrezatojnë shkëlqim pasi të vdesin, ose pasi ta kenë mbyllur karrierën e tyre.

Parashqevi Qiriazzi bëri histori atëherë kur popujve tanë historia po iu mohoj nga fuqitë ekspansioniste. Ajo erdhi në vëmendjen tonë shumë vonë, por roli dhe ndikimi i saj në proceset e rëndësishme vendimmarrëse, sidomos në Konferencën e Versajës (1919), kishte qenë tepër me peshë.

Tani kur i kemi në duar kujtimet e saj në formë ditari për muajt janar-tetor të vitit 1919, e kuptojmë zanafillën e altruizmit të kësaj gruaje, e cila përpos që ishte pjesëmarrëse direkte me kontribute dhe angazhime të ngjarjeve që shënuan kthesë, ajo ishte edhe kroniste pedante duke sjellë për publikun e gjerë rapaskanat dhe dritëhijet e një Konference të madhe botërore e cila po ‘qapte’ rrobat e popujve të vegjël.

Mund të jemi me fat që korridoreve të asaj Konference lëvizi edhe fryma e një gruaje të heshtur e bujare, e cila me aktivitetet botuese dhe kontaktet e shumta që mbajti, u bë njëkohësisht edhe themeltare e diplomacisë sonë.

Vetëm pasi ta kemi lexuar me vëmendje ditarin e saj, do ta kuptojmë se Parashqevi Qiriazzi jetoi dhe veprroi për një kauzë të cilën do ta vente në shërbim të një popullate me të drejta të rrezikuara. Ajo po çonte në vend amanetin e Rilindësve që çështjet e koklavitura të popujve të Ballkanit të realizohen përmes aleancave me Perëndimin, sidomos me SHBA-të.

Parashqevi Qiriazzi është shembulli më unik i një gruaje e cila tejkaloi me forcë stereotipitë që impononte aparteidi patriarkal i fillim viteve të shekullit të kaluar, duke imponuar frymën iluministe që e kishin filluar rilindësit dhe që e kishin vazhduar Qiriazët dhe bashkëkohanikët e tyre.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË  
SHQIPTARËVE – SHKUP

**DITËT E ALFABETIT – II –**

*Kryeredaktor dhe përgjegjës i botimit:*  
Prof. dr. Sevdail Demiri

*Transkriptimi: Gzime Naipi*  
*Redaktore gjuhësore: Florentina Fetahi*  
*Redaktor teknik: Naser Fera*

*Shtypi: Focus Print*  
*Adresa: Rr. Pelagonia, nr. 3 – Shkup*  
*Tirazhi: 500 copë*

*Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH–Shkup, nr. 0201-33/2, të datës 29.01.2021, si pjesë e programit të punës së Institutit për vitin 2021.*

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски

811.18'35

DITËT e alfabetit 2 : materiale nga manifestimi kulturor-shkencor  
"Ditët e alfabetit" : 14-22 Nëntor 2020, Shkup / [kryeredaktor Sevdail  
Demiri]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të  
shqiptarëve, 2021. - 208 стр. : илустр. ; 25 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4897-35-4

а) Албанска азбука -- Организирање на активности -- Собири

COBISS.MK-ID 55226885